

# UNIVERSITETI “UKSHIN HOTI” PRIZREN FAKULTETI JURIDIK

Revistë Juridiko-Sociale Nr.1/2020

## JUSTINIANI II



Prizren, 2020

UNIVERSITETI “UKSHIN HOTI”  
PRIZREN  
FAKULTETI JURIDIK

KDU33/34(05)

Revistë Juridiko-Sociale Nr. 1/2020

---

JUSTINIANI II

---

Prizren, 2020

# **REVISTË E SHKENCAVE JURIDIKO-SOCIALE**

## ***JUSTINIANI II***

### **Kryeredaktore**

Ass. Simeana BESHI

### **Redaktore Përgjegjëse**

Ass. Driola SUSURI

### **Bordi Editorial**

Prof.asoc.dr. Kadri KRYEZIU

Prof.asoc.dr. Eqrem ZENELAJ

Prof.asoc.dr. Halim BAJRAKTARI

Prof.asoc.dr. Arif RIZA

Prof.asoc.dr. Muharrem FAIKU

Prof.ass.dr. Armend PODVORICA

Prof.ass.dr. Berat AQIFI

Prof.ass.dr. Safet KRASNIQI

Ass. Dardan VUNIQI

Ass. Kastriote VLAHNA

Ass. Shefki SHTËRBANI

### **Dizajni:**

Tarik Han

### **Adresa e kontaktit:**

revista.justiniani2@uni-prizren.com

*Punimet përmbajnë të drejtat e autorëve dhe paraqesin qëndrimet e tyre.*

Prizren, 2020

## **PËRMBAJTJA**

Murat AJVAZI

GJERGJ KASTRIOTI – SKËNDERBEU NË VEPERËN E HISTORIANIT ZVICRAN  
FRANKOFON SIMONDE DE SISMONDI ..... 1

Safet KRASNIQI, Halim BAJRAKTARI

PËRDORIMI I GJUHËVE RAJONALE OSE TË PAKICAVE NE KOSOVË  
BAZUAR NË KORNIZËN LEGJISLATIVE ..... 5

Flaka BRAHA, Simeana BESHI

ANALIZË E SHKURTËR RRETH NDIKIMIT TË PANDEMISË COVID-19 NË BUXHET .. 16

Enver BUQAJ

SPIUNAZHI NË INTERNET DHE TERRORIZMI KIBERNETIK ..... 27

Enver GËRGURI

A ËSHTË BASHKIMI EUROPIAN NË KRIZË PAS BREXIT? ..... 38

Adem SHALA

CILËSIA QEVERISËSE E INSTITUCIONALE NË KOSOVË 2008-2019 ..... 49

Albatrit BYTYQI

PËRGJEGJËSIA JURIDIKO CIVILE PËR DËMIN E SHKAKTUAR NGA KAFSHËT ..... 72

Liridone BUQAJ

MBROJTJA DHE SIGURIA E TË PUNËSUARVE NË KOSOVË DHE BAZA JURIDIKE E  
SAJ..... 106

Egzon QOVANAJ

KRIMET E GJENOCIDIT NË KOSOVË, VËSHTRUAR SIPAS KPDGJ ..... 122

Endrit AJETI

TRASHËGIMIA LIGJORE DHE SHQYRTIMI I SAJ NË SISTEMIN E NOTERISË ..... 140

## ***Fjala hyrëse***

Të dashur studjues!

Të nderuar studentë!

Pata mundësi që së bashku me koleget dhe kolegët tonë, të hapim një dritare sado të vogël të mundësive për të dhënë mendimet dhe idetë, për të gjithë. Kjo bëhet me mund dhe sakrificë edhe përkundër krajetave nëpër të cilat herë-herë kalojmë dhe kemi kaluar bashkarisht.

Publikimi i numrit të radhës të Revistës Juridiko-Sociale, "Justiniani II", është edhe një përpjekje modeste e Fakultetit Juridik drejt forcimit të lidhjeve me studentë dhe studjues në tërë Republikën e Kosovës.

Besoj dhe shpresoj që në të ardhmen, Revista "Justiniani II", do të jetë pjesë e pandalshme e avancimit të saj në platforma shkencore !

URIME!

SUKSESE!

Prizren,

U.D. Dekan  
Prof.ass.dr. Safet KRASNIQI

**GJERGJ KASTRIOTI – SKËNDERBEU NË VEPRËN E HISTORIANIT  
ZVICRAN FRANKOFON SIMONDE DE SISMONDI**

***Hyrje***

*Madhështia e Gjergj Kastrotit Skënderbeut dhe e veprës së tij në mbrojtje të kombit shqiptar por edhe vetë Europës, ka tërëhequr gjithnjë vëmendjen e studiuesve të ndryshëm nga e gjithë botës. Kjo vëmendjen ka qenë gjithnjë e madhe edhe pse mbi pesë shekuj i kanë lënë vendin njëri – tjetrit. Ajo çfarë unë kam vërejtur me knaqësin ka të bëjë me faktin se edhe historiografia zvicerane nuk ka mbetur pas në vlersimin dhe lartësimin e figurës së heroit të kombit shqiptarë.*

*Në këtë rast dua të veproj historianin e mirënjohur zviceran, Zhan Charls Leonard Simode de Sismondi, i cili ka jetuar mes viteve 1773 dhe 1842. Përpara se të dalim të aktivitetit dhe çfarë i përcjell historisë së ndritur të Skënderbeut historiani Sismonde, le të njihemi shkurtimisht me këtë figurë kombëtare zvicerane, por edhe mik i shqiptarëve.*

***Entry***

*The greatness of Gjergj Kastroti Skënderbeu and his work in defense of the Albanian nation but also of Europe itself, has always attracted the attention of various scholars from all over the world. This attention has always been great even though over five centuries have given way to each other. What I have noticed with pleasure is the fact that the Swiss historiography has not lagged behind in the evaluation and exaltation of the figure of the hero of the Albanian nation.*

*In this case I want to act the well-known Swiss historian, Jean Charles Leonard Simode de Sismondi, who lived between 1773 and 1842. Before leaving the activity and what conveys to the bright history of Skanderbeg the historian Sismonde, let us briefly get acquainted with this Swiss national figure, but also a friend of the Albanians.*

## **Kush ishte Sismonde de Sismondi**

Sismonde de Sismondi lindi me 09.05.1773, në Gjenevë të Zvicrës dhe vdiq me 25.06.1842, në Chene Burg të Gjenevës. Në vitin 1973, në Gjenevë të Zvicrës me rastin e 200 vjetorit të lindjes së tij u mbajt një simpoziom kushtuar jetës dhe veprës së tij, për të cilën do të shkruajmë në një punim të radhës.

Sipas autorit të cekur më lartë, është e njohur se Skënderbeu dhe epoka e tij qenë objekt interesim të shumë autorëve të huaj në të gjithë botën. Edhe në historiografinë zvicerane personaliteti i Skënderbeut dhe lufta e shqiptarëve kundër sundimit osman kanë qenë dhe do të jenë edhe më tutje në atë masë të secilës historiografi evropiane dhe botërore. Përveç biografive dhe punimeve të tjera të cilën e hartuan autorët e ndryshëm evropian, mjaftë të dhëna interesante gjejmë edhe në punimin e historianit të sipërpërmendur.

### **Sismondia autor i librit « Historie des Republiques Italiennes du Moyen Age»**

Libri i Sismonde de Sismondi i botur në fillim të shekullit XIX (1807), me titull « Historie des Republiques Italiennes du Moyen Age » (Historia e Republikave italiane të mesjetës), është botim në 16 vëllime të botuara në Cyrih. Në këtë libër historiani flet pos të tjerash edhe për qëndresën e shqiptarëve kundër pushtimit osman të udhëhequr nga Gjergj Kastrioti –Skënderbeu në kohën kur perandoria osmane ishte në rritjen më të madhe pushtuese. Këtë luftë në pjesën e veprës së tij e lidh me historinë e shteteve italiane të shekullit XV, të cilat pushtimet osmane e friksuan Europën.

Europën sipas këtij autori ishte në gjendjen të zymtë ndërsa sundimtarët evropian nuk ndërmerrnin asgjë për ti ndaluar pushtimet osmane në ballkan. Ai më tutje kur flet për luftëtarët tregon edhe për luftën e Alfonsit, mbreti i Napolit, kundër familjës Malatestit të Riminit dhe kundër Gjenovezës. (revolucionit i Gjenovës, kryengritja e Alfonsit kundër Doe Pierre de Campo Fregoso), e cili u bë vdekja e këtij monarku dhe karakterit të tij. Ndër të tjera shkruante:

Megjithatë Alfonsi nuk i sulmoi menjëherë ata të cilët i mendohej tu shpallej luftë. Ai donte ti jepte popullit të tij një periudhë të qetë, i cili që pas vdekjes së mbretit Zhani II, kishin qenë nën kërcënimin e konflikteve civile dhe të pushtimeve të huaja. Se sa në rrezik ishte Italia nga lufta qytetare për këtë Simondi shkruante:

«Pregadi (Parlameti i Venecias) të gjithë fisnikët antërë ishin fshehur në fshat. Me praninë e këtij rrezikut ku të gjithë kishin frikën e një vdekjeje brutale, llogaritë për një politikë afatgjate nuk kishin asnjë interes. Po ashtu venecianët në pamundësi për tu sjellë fientinasve ndihma në njerëz dhe para të cilët shpresonin për këto të fundit nuk kishin të bënë tjetër, pas pritjeve të gjata vendosën të mblidhnin senatin për tu dhënë urdhërat e këtyre ambasadorëve të cilët do të vendosnin në Romë. Ambasadorët u ngarkuan me detyrën për të paralamjrmuar papën mbi rrezikun që i kanosej krishterimit nga luftratë që kishin përfshirë Italinë... ky rrezik ishte pak a shumë si rrezik i madh nga perandoria osane, nga të cilët mund të pritej pushtimi. Nëse papa nuk do të tërhiqej atëherë zotërit e Venecias në dakordësi me Perandorinë dhe mbretërin e Francës do të refuzonin ti bindeshin dhe do ti shpallnin dekretet e tij të padrejtë në një mbledhje të ardhshme të Këshillit. Akuza që i bënë për mbështetjen e projekteve të Mehmetit II, ishte shumë e rëndë. Përparimi i osmanëve e kishte vënë Italinë në rrezik më shumë se asnjëherë më parë. U vu në dyshim vetë ekzistenca e Venecias sa frika se ushtria e saj do i dorëzohej pa rezistencë armikut të madh të Krishterimit.

Ky autor shkruan gjithashtu se « shqiptarët i bënë ballë sulemve osmane pa ndihmën e askujt. Ai nuk la pa përmendur edhe fqinjët e parë të shqiptarëve pra italianët të cilën nuk luajtë ndonjë rol për të ndihmuar Skënderbeut. Ai ndër të tjera shkruante:

«Italianët ishin shikues pasiv të kësaj lufte të madhe të duartrokitnin heorit pa i dhënë ndihmë e cila do të bënte të mundshme të përfitonte nga fitoret e tij. Ata vetë ishin zënë me luftrat mes vete dhe ende nuk mendonin për rrezikun që u kërcënohej drjetpërsëdrejti » (faqe 197).

Ky historian në përmbledhjen e tij sistematike të qëndresës shqiptare është përqëndruar në disa momente më të rëndësishme për fëmijërinë e Skënderbeut dhe marrjen peng të tij, flet për Janosh Huniadin, arritja e Skënderbeut në Krujë, luftrat e Skënderbeut kundër osmanëve, por identifikon faktin se këto ekspedita osmane të cilat i udhëhoqi vet sulltan Murati. Autori flet gjithashtu për konfliktin e Skënderbeut me Venedikun dhe për tradhëtën e bashkëpunorëve të vet Mojsiut dhe Hamzait. Autori më tutje trajton edhe historinë e Italisë, marrëdhëniet e Skënderbeut me fqinjët e tij dhe për ndihmën që i dha Skënderbeu, mbret Ferdinandit për reivendosjen në front të Napolit.

Sismondi mohon mendimin e shumë studiuesve të më hershme se sulltan Murati vdiq në Krujë. Autori Sismondi ka dhënë edhe një pjesë të fjalimit të Skënderbeut i cili sillej shumë mirë me ushtarët e tij duke mos fyer asnjërinë dhe gjithnjë ishte shembull për të tjerët në luftë dhe ndarjen e plaçkës së luftës etj. Sismonde ishte ndër studiuesit me më autoritet të lartë në kohën kur jetoi ndërsa pas vdekjes së tij vepra që la pas vazhdoi të ushtronte ndikim



të madh në ribotimit e tij, dhe u përkthye në shumë gjuhë të huaja. Më tej për frikën e Venecianëve nga sulltan Mehmeti II, të cilët në fund të vitit 1475, i propozuar sulltanit paqë. Sulltan Mehmeti kërkoi në shkëmbim që Kruja që bashkë me territorët e tjera që zotëronin Venecianët, ti nënshtrohet pushtetit të tij. Ai kërkoi që ti paguheshin edhe njëqind e pesëdhjet mijë monedha floriri për borxhin e marrë nga administratorët e minierës së gurëve të çmuar dhe për një vjedhje që ishte bërë me autorizimin e Republikës së Venedikut. Këto kërkesa të ashpra nuk u pranuan të gjitha, por i dhanë rrugë përmbylles së një armpushimi prej 6 muajsh. Gjatë vitit 1476, venecianët nuk reagues kundër turqëve. Po ashtu ishin jo pak të shqetësuar për pushtimin e turqve në Levant. Çka do të thotë se ky autor është marr edhe me territoret shqiptarëve pas vdekjes së Skënderbeut.

Ky autor si bazë mbi të cilën ka mbështetur konstatimet e tij ka shfrytëzuar dokumente të ndryshme, botime italiane, franceze dhe gjermane dhe dokumentet të vjetra të gjetura në arkivat e Zvicres si dhe veprën e historianit shqiptar dhe bashkëkohës i Skënderbeut, Marin Barletin.

### **Konkluzion**

Në fund mund të konkludojmë se botimi i kësaj vepre është ngjarje e rëndësishme jo vetëm për vet kulturën zvicerane dhe europiane sepse heroi ynë kombëtarë është një emër i madh në historinë zvicerane. Simonde de Sismondi gëzoi repsekt të madh të populli zviceran sepse qëndresën heroike të udhëhequr nga Skënderbeu kishte rol e rëndësi të dyfishtë në Zvicër. Skënderbeu sipas tij mbronte njëkohësisht lirinë e shqiptarëve dhe pengonte vërshimin osmane drejt Italisë dhe vendeve të tjera Europiane. Pas vdekjes së Skënderbeut historiani zviceran vijoi ta nderonte e ta vlersonte shumë veprën e dyfishtë të pavdekshme të heroit shqiptarë si kampion i lirisë kombëtare, zvicerane dhe europiane. Simonde de Sismondi është ndër autorët zviceran dhe historiani më i shquar që ka ngritur Heroin tonë kombëtarë Gjergj Kastriotin Skënderbeun si mbrojtës i qytetimit shqiptarë, zviceran dhe europian gjatë shekullit XV, për të cilën shqiptarët në jetë të jetëve do të jenë mirënjohës.

### **Literatura**

Simonde de Sismondi « Historire des Republiques Italiennes Du Moyen Age », libri 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10, 11,12,13,14,15,16, Cyrih 1807,

Ky libër është përkthyer në gjuhën angleze dhe spanjolle.

**Prof. ass. dr. Safet KRASNIQI**

**KDU 34:**

**316.347.2**

**Prof. asoc. dr. Halim BAJRAKTARI**

**811.18**

**1282.4**

## **PËRDORIMI I GJUHËVE RAJONALE OSE TË PAKICAVE NE KOSOVË BAZUAR NË KORNIZËN LEGJISLATIVE**

### ***Abstrakt***

*Punimi përfshinë aspektin juridik dhe politik të harmonizimit të të drejtave dhe lirive të njeriut në kontekstin e funksionimit legjislativ dhe ekzekutiv të shtetit të Kosovës, gjithnjë sipas kornizës bazë të Planit Ahtisari. Zbatimi praktik ka filluar dhe tanimë, është pjesë e detyrimeve që kanë Institucionet e Kosovës që mbështeten në marrëveshjet bilaterale si dhe, në kornizën e të drejtave themelore të njeriut. Kjo çasje, më së shumti ka të bëjë me grupet e vogla shoqërore në Kosovë të cilat, juridikisht dhe politikisht janë emërtuar në Kushtetutën e Kosovës. Në këtë punim, janë përdorur disa metoda shkencore që janë kompatible me thelbin e punimit siç janë: metoda historike, metoda krahasuese, etj.*

***Fjalet kyçe: Përdorimi i gjuhëve, pakicat, legjislacioni dhe Kosova.***

### **Hyrje**

E drejta pozitive në Kosovë ka përcaktuar minimumin e të drejtave dhe lirive të garantuara për secilin qytetar të Kosovës e poashtu, konform standardeve ndërkombëtare, ka sanksionuar përdorimin e gjuhëve në nivel qendror dhe lokal. Legjislacioni në fuqi, përdorimin e gjuhëve dhe trajtimin e tyre e trajton në kuadër të njërës prej shumë të drejtave të të gjitha komuniteteve për ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e identitetit të tyre gjuhësor e kulturor.

Këto të drejta, burimin e kanë në aktet juridike ndërkombëtare që janë inkorporuar drejtpërdrejtë në të drejtën pozitive në Kosovë siç janë: KEDLNJ, Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave, Rekomandimet e Oslos, Komiteti Këshillimor i Konventës Kuadër për

Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare - Komentar tematik nr.3 për të drejtat gjuhësore të personave që u përkasin pakicave i miratuar më 24.Maj.2012 etj. Parlamenti i Kosovës ka miratuar Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, dhe ligje tjera që lidhen me përdorimin e gjuhëve përfshirë edhe dokumente dhe udhëzime tjera për përdorimin e gjuhëve në Kosovë. Çështja e përdorimit të gjuhëve, ka nxitur debate të ndryshme në qarqet vendore dhe ndërkombëtare prezente në Kosovë duke pasur parasysh statusin politik të pakicave dhe pozitën juridike të tyre në përputhje me standardet ndërkombëtare. Aktualisht, legjislacioni i Kosovës është ndërtuar mbi bazën e një plani ndërkombëtar i bazuar në ndryshimet e ndodhura në Kosovë në vitet 89/99. Nëse i referohemi principeve të së drejtës ndërkombëtare, sigurisht se legjislacioni i Kosovës fillëson e ka në aktet juridike ndërkombëtare, në rastin konkret Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare, aprovuar në Strazburg me 5.11. 1992. Janë të rëndësishme edhe rekomandimet e Oslos për gjuhët e pakicave e Komësariatit të Lartë për pakicat dhe Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare. Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare është një nga dokumentet ndërkombëtare të obligueshme për zbatim. Karta ka përkufizuar gjuhët minoritare në dy aspekte: si gjuhë që tradicionalisht janë folur brenda një territori të caktuar dhe në aspektin tjetër si grup që është numerikisht më i vogël se sa pjesa tjetër e popullsisë së atij shteti. Specifikat tjera kanë të bëjnë me dallueshmërinë e gjuhës nga gjuha e shumicës, si për nga dialekti e poashtu edhe nga vetë gjuha zyrtare.<sup>1</sup>

Në kuadër të obligimeve për zbatimin e kësaj Konvente, neni 2 ka obliguar shtetet për respektimin e së paku tridhjetepesë paragrafëve ose nënparagrafëve të pjesës së tretë të Kartës, së paku tre të zgjedhur prej nenit 8 dhe 12 dhe një prej nenit 9-12 të Kartës<sup>2</sup> Janë përcaktuar obligimet e secilit shtet për marrjen e masave për sanksionimin e kartës , përmes hartimit të dispozitave ligjore me qëllim, përkrahjen në përdorimin e gjuhëve rajonale ose të pakicave në institucionet gjyqësore, administrative dhe arsimore. Duke iu përmbajtur objektivave dhe parimeve të përcaktuara në nenin 2 par.1 të Kartës, neni 7 ka obliguar shtetet palë që duke hartuar legjislacionin bazë për zbatimin e Kartës , jo vetëm të pranojnë por, të përkrahin përdorimin e gjuhëve rajonale në aspektin e ndërmarrjes së veprimeve konkrete me qëllim që këto gjuhë të ruhen dhe kultivohen përmes lehtësimit të përdorimit të tyre e

---

<sup>1</sup> Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale dhe Minoritare, neni. 1.

<sup>2</sup> Po aty, neni. 2.

njëkohësisht për sigurimin e mjeteve dhe formave të ndryshme për përdorimin e tyre në jetën publike dhe institucionale.<sup>3</sup>

Qëllimi i këtij akti ndërkombëtar është sigurimi i plotë i përdorimit të gjuhëve të pakicave në sferat e jetës shoqërore , duke filluar nga administrata gjyqësore, arsimit etj. Një rëndësi të veçantë Karta i jep arsimimit të minoriteteve në të gjitha nivelet , hapjen e një kanali televiziv gazetave dhe mjeteve tjera të informimit.<sup>4</sup>

Në kuadër të obligimeve tjera ndërkombëtare janë Rekomandimet e Oslos lidhur me të drejtat gjuhësore të pakicave. Rekomandimet e Oslos janë nisur nga situata në ish Jugosllavi. Qëllimi i këtij rekomandimi ishte evitimi i përplasjeve të mundshme ndër etnike. Mbi këtë bazë , rekomandimet e Oslos kanë për qëllim sigurimin e të drejtave të domosdoshme të minoriteteve në sferën e përdorimit të tyre brenda një sistemi juridik. Bazë e këtyre rekomandimeve janë: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, KEDLNJ dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejta Civile dhe Politike. Në këto dokumente garantohet dinjiteti i njeriut , liria e të shprehurit dhe pjesëmarrja e barabartë në jetën shoqërore të pakicave. Vlen të theksohen nenet e këtyre dokumenteve që përcaktojnë parimet bazike. Deklarata Universale, në mënyrë të saktë definojnë pozitën shoqërore të individit duke vënë në spikam dinjitetin e tij në raport me të drejtën . Konventa për të Drejtat Civile dhe Politike në nenin 2 u kërkon shteteve që të sanksionojnë këto të drejta në drejtim të forcimit të raporteve juridike brenda shtetit.<sup>5</sup> Konventa për të Drejtat Civile dhe Politike ua garanton pakicave të drejtën e përdorimit të gjuhës pavarësisht nga numri i tyre.<sup>6</sup> Një dokument ndërkombëtar i rëndësishëm është edhe Deklarata e OKB për të Drejtat e Personave që u takojnë Pakicave Kombëtare ose Etnike, Fetare dhe Gjuhësore që u garanton pakicave përdorimin e gjuhës së tyre privatisht dhe publikisht, pa kurrëfarë diskriminimi.<sup>7</sup>

Në prizmin e këtyre akteve juridike ndërkombëtare , Kosova në legjislacionin e saj, i është përmbajtur tërësisht këtyre obligimeve. Kjo vërtetohet përmes përfaqësimit të tyre në Institucionet politike e juridike dhe përfshirjen e pakicave në shkollimin në shkolla publike të minoriteteve deri në nivelin universitar. Përgjithësisht, rekomandimet e Oslos janë të mbështetura në dokumente ndërkombëtare ku pakicave ju garantohet jeta e tyre shoqërore e publike përmes pjesëmarrjes së tyre në të gjitha sferat e veprimtarisë. Konventa ka përcaktuar

<sup>3</sup> Karta Europiane për Gjuhët Rajonale dhe Minoritare, neni. 7

<sup>4</sup> Po aty, nenet ,8,9,10,11

<sup>5</sup> Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 1.

<sup>6</sup> Konventa për të Drejta Civile dhe Politike, neni 27

<sup>7</sup> Deklarata e OKB për të Drejtat e Personave që u takojnë Pakicave Kombëtare ose Etnike, Fetare dhe Gjuhësore.

saktësisht një numër të madh të të drejtave të tyre siç janë: e drejta për përdorimin e emrit, emrave të paraardhësve të tyre dhe mbiemrin në gjuhën e tyre, manifestimin hapur të besimit të tyre dhe veçanërisht varrimet dhe martesat e tyre me rite fetare, organizimi i tyre në OJQ, punësimin dhe përdorimin e gjuhës së tyre në administratën publike dhe në gjykatë, themelimin e institucioneve arsimore e kulturore dhe financimi i tyre etj.<sup>8</sup>

Ngjashëm me Kartën Rekomandimet e Oslos, parashohin mundësinë dhe të drejtën e pakicave që të organizohen në OJQ, themelimin e mediave në gjuhën e tyre, emitimin e programeve në gjuhët e tyre, garantimin e pavarësisë mediale. Për sa i përket institucioneve të administratës dhe të gjyqësisë, përdorimi i gjuhës së minoriteteve dhe e drejta në dokumente publike në gjuhën e tyre, janë prioritete dhe bijnë në domenin e të drejtave themelore.<sup>9</sup>

Ajo çka R. e Kosovës ka bërë dhe po bën lidhur me përdorimin e gjuhëve të pakicave është korniza ligjore. Aktualisht, Parlamenti i Kosovës ka parovuar Ligjin për përdorimin e gjuhëve që ka hy në fuqi në vitin 2007. Ligji në fuqi, duke iu referuar Aktveve juridike ndërkombëtare, pakicave ju ka garantuar identitetin gjuhësor dhe krijimin e mjedisit për të gjitha komunitetet në Kosovë. sipas Kushtetutës së Kosovës, gjuhë zyrtare konsiderohen, gjuha shqipe dhe gjuha serbe<sup>10</sup> Në nivelin lokal, gjuhë zyrtare konsiderohen ato gjuhë të cilat përbëjnë popullsi në më shumë se 5 përqind. Gjuha turke bën përjashtim për shkak të traditës së të folurit të kësaj gjuhe në Prizren dhe rrethinë.<sup>11</sup>

Shteti i Kosovës ka përcaktuar procedurat për zbatimin e ligjit për përdorimin e gjuhëve në Kosovë duke siguruar të drejtën e tyre për të kërkuar shërbime në gjuhën e tyre nëse gjuha e tyre është njëra prej gjuhëve që konsiderohen zyrtare në nivel lokal. Të gjitha institucionet, ndërmarrjet publike dhe ato në pronësi shoqërore janë të detyruara ta zbatojnë barazinë gjuhësore.<sup>12</sup>

Ligji për gjuhët në Kosovë, duke ju referuar Konventave ndërkombëtare të akceptuara në Kushtetutën e Kosovës, ka dhënë hapësirë të mjaftueshme për të drejtën në përdorimin e gjuhëve të pakicave në nivel lokal dhe në organe shtetërore. Nenet 12-18, 19-24, 27, 28-30 garantojnë të drejtën e pakicave të njëjta sikurse të shumicës duke u nisur nga e drejta në

<sup>8</sup> Dokumenti i Kopenhagës, par.32.2.

<sup>9</sup> Dokumenti i Kopenhagës, nenet, 5-21.

<sup>10</sup> Kushtetuta e Kosovës, nenet, 5-6

<sup>11</sup> Udhëzimi Administrativ, 2007/06

<sup>12</sup> Udhëzimi Administrativ nr.2011/02

regjistrin e emrave personal në regjistrat publikë, themelimin dhe mbajtjen e subjekteve juridike, shoqatat kulturore etj.<sup>13</sup>

Përpos kornizës ligjore, Qeveria e Kosovës ka hartuar politika studimore lidhur me përdorimit të gjuhëve të pakicave në Institucionet e saja. Politika e gjuhëve në Kosovë, zbatimi në marrëdhënie me organet publike i vitit 2011, përpos studimit të përdorimit direkt të gjuhëve ka dhënë një sërë rekomandimesh me qëllim të vetëdijesimit të opinionit publik dhe ofrimin e kurseve të ndryshme për shërbyesit civil për njohjen e gjuhëve nëpër komuna etj.<sup>14</sup>

Kuvendi i Kosovës ka aprovuar ligjin kundër diskriminimit me çka, është rregulluar pozita e barabartë në sferën e jetës në Kosovë. Ligji zbatohet ndaj të gjitha veprimeve të personave fizik dhe juridik në sektorin publik dhe privat, përfshirë edhe organet publike që çenojnë të drejtat e personave fizik dhe juridik përpos sferave të punës edhe në aspektin e përdorimit të gjuhëve nga pakicat.<sup>15</sup> Në tërësi është mbuluar kornizën ligjore përsa i përket gjuhëve të pakicave.

Në sferën e punësimit dhe të shkollimit ka një afirmim të theksuar të këtyre të drejtave kur kihet parasysh numri i pakicave në Kosovë. Sipas raportit të Fondit për të drejtën Humanitare në Kosovë i cili ka prezentuar të dhënat zyrtare të marra nga OSBE, pakica kombëtare numerikisht më e madhe në Republikën e Kosovës është komuniteti serb me 5.32 përqind, përderi sa, pas tyre, radhitet pakica RAE me 1.72 përqind, Boshniakë me 1.72 përqind, Turqi me 0.70 përqind etj. Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë ka monitoruar prezencën e pakicave në Institucione dhe ndërmarrje publike të pakicave në Kosovë, mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Kundër Diskriminimit përmes punësimit të pakicave dhe akteve juridike që lëshojnë këto institucione. Në këtë raport të vitit 2007, kanë konstatuar se numri më i madh i të punësuarve në ndërmarrjet publike është në Prizren me 36 përqind nga numri i përgjithshëm e më së paku në ndërmarrjen e ujësjellesit në Mitrovicë, 5.1 përqind. Në Prizren duke iu referuar Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës është ndryshuar emblema e komunës dhe është bërë përfshirja e tri gjuhëve si gjuhë zyrtare në komunë. Emblema tanimë është simbol i përfaqësimit të të gjitha komuniteteve që jetojnë në komunën e Prizrenit. Në nivel të komunës janë në përdorim zyrtar gjuhët që fliten në Prizren<sup>16</sup>.

Në projektin e USAID-it me titull "*Plani i veprimit për përmirësimin e cilësisë në përdorimin e gjuhëve në Komunën e Istogut*", janë analizuar nga ana statistikore dhe analitike

<sup>13</sup> Ligji për Përdorimin e Gjuhëve nr.02/L-37, nenet, 12-18, 19-24, 27, dhe 28-30

<sup>14</sup> Politikat e gjuhëve në Kosovë, zbatimi në marrëdhënie me publikun, Shtator, 2011

<sup>15</sup> Ligji kundër Diskriminimit nr.2004/3, neni 4.

<sup>16</sup> Shih më shumë në ue-mailj Kurtişi kundër Asamblesë Komunale të Prizrenit, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, 18 mars 2010, paragrafi 54–56, nr. i lëndës. Ko 01/09, nr. ref. AGJ 07/10.

niveli i komunikimit për zhvillim shoqëror. Ky projekt ka analizuar mundësinë e vetëdijesimit të qytetarëve për mundësinë e shfrytëzimit të të drejtës së tyre për mundësinë e plotësimit të kushteve për mbrojtjen e të drejtës së tyre për gjuhë, sikurse edhe bashkëpunimi me përfaqësues të institucioneve përkatëse. Nga aspekti statistikor, raporti ka dhënë një tabelë të përbërjes etnike të komunës së Istogut të marra nga Agjensia e Statistikave të Kosovës .

1. Shqiptarë: 36,154
2. Egjiptianë : 1,544
3. Boshnjakë: 1,142
4. Serb: 194
5. Ashkali: 111
6. Romë: 39
7. Turq: 10
8. Tjetër: 45
9. Të papërcaktuar: 50

Duke u bazuar në Zyrën për Komunitete dhe Kthim, të paktën 2,316 serb dhe 1,670 egjiptianë jetojnë në këtë Komunë. Projekti u fokusua në mbikqyrjen e zbatimit praktik të Ligjit për Gjuhët dhe dokumentet tjera juridike në fuqi. Projekti “Mbështetje e përpjekjeve të Komisionerit për gjuhët për të promovuar përdorimin e gjuhëve zyrtare në 12 komuna partnere të programit të USAID-it – Të Avancojmë Kosovën së Bashku” një prej aktiviteteve kryesore ishte “Klienti i fshehtë”. Projekti u bazua në Disponueshmëria e informatave në gjuhët zyrtare, Kultura e komunikimit dhe Komunikimi përmes postës elektronike.

*Gjatë zbatimit të projektit. Nga konsumatorët e fshehtë ishte kërkuar që të vlerësonin disponueshmërinë dhe kulturën e përgjithshme të zyrtarëve komunal për komunikim dhe kërkesën për informata përmes e-mailit.*

*Sa i përket kulturës së komunikimit, bartësit e projektit vërejtën egzitim të prëkthyesve, komunikimi në gjuhën e klientit në komunën e Istogut, formularët ish në të dy gjuhët . klienti i fshehtë, gjatë shlytjes dhe kontakteve me zyrtarët komunalë kka vërejtur se shumicqa e zyrtarëve flasin gjuhët zyrtare. Komunikimi përmes postës elektronike , posta elektronike e dërguar në komunë në gjuhën e pakicës së komunës është kthyer në gjuhën amëtare të Klientit të fshehtë. E tërë kjo tregon qasjen serioze të Republikës së Kosovës në arritjen e barabarësisë gjuhësore në tërë territorin e saj <sup>17</sup>.*

---

<sup>17</sup> Plani i veprimit për përmisimin e cilësisë së përdorimit të gjuhëve në komuna Istog, USAID, 2016, f.2-6

Për sa i përket përdorimit të gjuhëve lokale në ndërmarrjet publike, ka vërejtje përsa i përket konkurseve, logove në hyrje të ndërmarrjeve, faturave etj. të cilat përpilohen në gjuhën shqipe dhe serbe dhe rekomandimet që i ka dhënë FDH ka qenë pikërisht në zbatimin e plotë të Ligjit për përdorimin e gjuhëve në nivel lokal në të gjitha ndërmarrjet publike.<sup>18</sup>

Për sa i përket prezencës së Organizatave ndërkombëtare në Kosovë, shembull konkret janë raportet vjetore të OSBE për implementimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve nga komunat e Kosovës e veçanërisht ato nga vitit 2008. Në raport përpos tjerash janë evidentuar edhe të metat përsa i përket vështirësisë në komunikim në mes të komunitetit shumicë dhe pakicë në institucione publike, mungesën e informimit të opinionit për mundësinë e përdorimit të gjuhëve nëpër komuna etj. Ajo që e specifikon ky raport, është mungesa e përkthimeve në dokumente zyrtare, të gjuhëve lokale me çka, nga anketa e zhvilluar me banorë të ndryshëm në komuna të Kosovës vërehen vështirësi në të kuptuarit e dokumenteve të lëshuara nga ana e institucioneve komunale, vetëm në gjuhën shqipe dhe serbe, mungesa e aprovimit të rregulloreve nëpër Komuna për futjen në përdorim zyrtar të gjuhëve në nivel të Komunave. Nga rekomandimet e dhëna nga OSBE, vërehen vështirësi por edhe përparime përsa i përket përdorimit të gjuhëve të pakicave. Shembull konkret është Komuna e Prizrenit e cila, në vitin 2007 ka aprovuar rregullore për përdorimin e gjuhëve të pakicave si gjuhë zyrtare në nivel lokal.<sup>19</sup>

Një mekanizëm i rëndësishëm në drejtim të mbrojtjes së standardeve të të drejtave të njeriut, ai i përdorimit të gjuhëve është përcaktuar me Rregulloren nr.07/12 për Zyren e Komisionerit për Gjuhët, nga Qeveria e R.së Kosovës që ka të bëjë me themelimin, funksionin dhe mënyrën e punës së kësaj zyreje. Zyra vepron nën udhëheqjen e Komisionerit për gjuhët i cili është përgjegjës për menaxhimin e zyrës dhe ushtrimin e kompetencave<sup>20</sup>. Zyra mbështetet nga dy mekanizma; Bordit për Politika të Gjuhëve dhe Rrjeti i Politikave për Gjuhët. Sipas kësaj rregulloreje, Zyra ka kompetenca në zbatimin e ligjit me qëllim të ruajtjes, promovimit dhe mbrojtjes së përdorimit të gjuhëve zyrtare në Republika e Kosovës, gjuhëve në nivel komunal, gjuhëve të komuniteteve që nuk e kanë gjuhë amtare njëri prej gjuhëve zyrtare etj.<sup>21</sup>

---

<sup>18</sup> FDH, Zbatimi i ligjit kundër diskriminimit dhe ligjit për përdorimin e gjuhëve në ndërmarrjet publike në Kosovë, Prishtinë, 2007.

<sup>19</sup> OSBE, Departamenti për Monitorim, Implementimi i Ligjit për Përdorimin e gjuhëve nëpër Komunat e Kosovës, Prishtinë, 2008.

<sup>20</sup> Rregullore për Zyren e komisionerit për Gjuhët nr.07/12, neni 3, par. 2.

<sup>21</sup> Po aty, neni 16 par.1.



Jurisdiksioni i zyrës përfshin përdorimin e gjuhëve nga institucionet e R. së Kosovës, organizatave dhe ndërmarrjeve tjera që ushtrojnë funksione publike. Në kuadër të autorizimeve, zyra ka kompetenca për monitorimin e përputhshmërisë së ligjit nga ana e institucionit, rekomandon dhe ndërmjetëson lidhur me hartimin e rregulloreve të reja apo Udhëzimet Administrative . Poashtu, në kuadër të autorizimeve të saja, zyra ka kompetenca edhe në kryerjen e hetimeve me iniciativën e vetë apo në bazë të ankesave të parashtruara nga persona fizik ose juridik. Poashtu, zyra ofron edhe këshilla ose ndihmë për publikun lidhur me të drejtat e tyre sipas ligjit për përdorimin e gjuhëve , vetëdijesimit publik të qytetarëve etj.<sup>22</sup>

Padyshim se një gamë e mekanizmave logjor e poashtu një infrastrukturë ligjore e zgjeruar ka bërë që gjuhët e pakicave si pjesë e të drejtave të tyre të jetë plotësisht e barabartë me ato të shumices në Kosovë. Në këtë aspekt, shkalla e të drejtave dhe lirive politike, civile ekonomike etj. e pakicave shpeshherë tejkalon nivelin dhe shkallën e proporcionit numerik dhe gjeografik brenda territorit të republikës së Kosovës. Andaj, nëse flitet për standardet e Bashkimit Europian, Republika e Kosovës është përpara nga shtetet e rajonit. Kjo është një vlerësim i vetë shtetit tonë në raport me të drejtat dhe liritë e njeriut e për më tepër, në rastin e pakicës serbe, niveli i të drejtave të tyre tejkalon të drejtat të parapara në të drejtën ndërkombëtare.

Në aspektin praktik të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjeve në Kosovë për sa i përket përdorimit të gjuhëve të pakicave ka akoma të meta për shkak të joprofesionalizmit, mungesës financiare ose edhe të neglizhencës së personave, organeve ose institucioneve kompetente lokale. Disa organizata prezente në Kosovë, kanë publikuar raporte të shkruara që kanë të bëjnë me të meta teknike ose profesionale të përkthimeve të legjislacionit të Kosovës. Kjo vërehet edhe në raportet periodike të OJQ- ve dhe Organizatave Ndërkombëtare prezente në Kosovë. Nga raporti i ECMI Kosova që është organizata kryesore joqeveritare që merret me çështjet e minoriteteve në Kosovë, Tetor, 201 me titull: *"Drejtë cilësisë gjuhësore të legjislacionit të Kosovës në Gjuhën serbe - Një hap në plotësimin e zbrastësirave në zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve"* vërehet se ka pasaktësi evidente të legjislacionit të Kosovës të përkthyer në gjuhën serbe. Hulumtimet janë kryer nga Zyra e Komisionerit për Gjuhët, Zyrat e Kryeministrit të Kosovës në bashkëpunim me OSBE-në, organizata jo-qeveritare dhe gazeta lokale. Hulumtimi i bërë nga gazeta serbe Vesti ka gjetur rreth 4,500 gabime në një mostër të ligjeve të ndryshme të përkthyer nga gjuha shqipe

---

<sup>22</sup> Po aty, neni. 17

në gjuhën serbe dhe rreth 5,500 gabime në përkthimin në gjuhën serbe të Kodit Penal të Kosovës, duke përfshirë një gabim gramatikor në vetë titull (Petković, 2014; Petković, 2015). Këto gabime janë gabime të thjeshta gramatikore; gabime ku shihet një ndërthurje me fjalët në gjuhën boshnjake dhe kroate. Gabime vërehen edhe tek përdorimi i fjalëve joadekuate, lëshime të fragmenteve dhe formulime të pakuptimta<sup>23</sup>.

Raporti mëtej thekson se arsyeja kryesore e mospërputhjes së legjislacionit të Kosovës në të dyja gjuhët është mungesa e diskutimit dhe konsultimit publik të iniciativave ligjore në të dyja gjuhët. Për këtë kanë marrë argument Ligjin për Nisma Legjislative (Nr.04/L-025), Neni 9 dhe Regulloren për Standardet minimale për procesin e konsultimit publik (Nr. 05/2016), Neni 4.1.1. Në raport mëtej theksohet mungesa e stafit profesional nëpër komuna për përkthime të tilla . Në nivelin qendror mungon buxheti, trajnimet profesionale por edhe pajisjet profesionale. Mungesa e përkthyesve profesionistë ka të bëjë më shumë me pamundësinë e pagesës së tyre sipas kualifikimeve pasi që, Qeveria punëson përkthyes të kategorisë 2 të përkthyesve<sup>24</sup>.

Pikënisje e këtij problemi është aftësia dhe kualifikimet e përkthyesve në gjuhët angleze, shqipe dhe serbe sepse, ligjet fillimisht përpilohen në gjuhën angleze si gjatë kohës së UNMIK-ut e pashtu edhe tani. Për shkak të këtyre mungesave, përkthyesit e ligjeve në gjuhën serbe, si version final e marrin atë në gjuhën angleze. Një situatë e tillë ka mundësi të krijojë dykuptimësi gjatë zbatimit praktik të legjislacionit tonë pasi që, nuk është i sigurt edhe kualiteti i përkthimit në versionin anglisht. Pra, problemi konkret nuk është tek zbatimi i obligimeve të e Kosovës për sigurimin dhe garantimin e të drejtave gjuhësore të pakicave por në rrezikun që ka zbatimi praktik i ligjit për shkak të divergjencave profesionale që ka një ligj i përkthyer në gjuhë të ndryshme. Raporti shkon shkon në rrafshin politik duke tërhequr vërejtjen se një diskrepancë e tillë mund të jetë shkas edhe për luhajtje të legjitimitetit të shtetit të Kosovës në sytë e minoritetit serb. Mungesa e një kualiteti përkthimesh, mund të

---

<sup>23</sup> ERAC mbledh së bashku shtatë (7) OJQ që punojnë në fushën e sundimit të ligjit dhe të të drejtave themelore, të cilat punojnë së bashku me 19 OJQ, me fokus në ngritjen e një rrjeti të qëndrueshëm të OJQve, që janë aktive në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave themelore të grupeve të rrezikuara dhe/ose të marginalizuara. Specifika e projektit janë komunitetet jo-shumicë, gratë, rinia, dhe komuniteti LGBT. Edhe pse punojnë apo shtrijnë veprimet e tyre në tema dhe çështje të ngjashme, këtyre OJQ-ve u mungon bashkëpunimi dhe shpesh përqendrimi i punës së tyre është i ndarë në bazë të grupeve të veçanta të synuara, me të cilat punojnë ato, apo i ndarë sipas rajoneve ku ato shtrijnë aktivitetet e tyre.

<sup>24</sup> Raporti i ECMI Kosova, Drejt cilësisë gjuhësore të legjislacionit të Kosovës në gjuhën shqipe dhe serbe - Një hap në plotësimin e zbrazëtirave në zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve , Prishtinë, Tetor. 2018, fq. 10-14.

përfashtojë komunitetet nga marrja e shërbimeve cilësore që mund të çojë në pasiguri juridike të cilat mund të prodhojnë situata që rrisin tensionet<sup>25</sup>.

Përpos vërejtjeve evidente që egzistojnë, ky raport tejkalon aspektin profesional duke u zgjeruar në rrafshin politik. Raporti është bazuar në deklaratat dhe konstatime të përfaqësuesve ose të të punësuarve të komunitetit serb në institucione të Republikës së Kosovës dhe të OJQ-ve serbe në veriun e Republikës së Kosovës. Kjo vërehet nga fusnotat e këtij raporti. Edhe pse, raporti ka vënë në pah mangësitë evidente gjuhësore si mjet për komunikim brenda insitucional, besoj se kjo ka të bëjë më së shumti me raportet ndërmjet folësve të gjuhës shumicë dhe të gjuhës pakicë. Komentari tematik nr.3 i Komitetit Këshillimor të Konventës kuadër për mbrojtjen e pakicave që lidhet me të drejtat gjuhësore të personave që u përkasin pakicave kombëtare i miratuar me 24.Maj të vitit 2012, thekson faktin se në shumë vende të Evropës e më gjerë, kemi të bëjmë me shqetësimin për ndarjet gjuhësore të cilat përdoren për arsye politike. Refuzimi i përafrimit dhe të kuptuarit e gjuhëve të komuniteteve në territorin ku jetojnë këto si shkak kryesor kanë mungesën e tolerancës që nxitet nga diskutimet politike<sup>26</sup>.

## Konkluzione

Përdorimi i gjuhëve në Kosovë përbën njërin nga shumë të drejta që Kushtetuta e Kosovës ua garanton minoriteteve dhe atë, në të shumtën e rasteve e tejkalon nivelin e përcaktuar të të rejtave sipas të Drejtës Ndërkombëtare.

Niveli i tillë i standardizimit të këtyre të drejtave, shpesh ka nxitur debate rreth asaj nëse, të drejtat dhe liritë e njeirit janë të lidhura me grupe etnike, kombëtare etj apo, duke iu përmbajtur konceptit qytetar të rregullimit shtetëror të Kosovës, shtrirja e këtyre të drejtave duhet të bëhet përmes konceptit mbinacional, që nënkupton, pengimin e rrezikut që bartë mbi vete homogjenizimi nacional e që çon në ndarje etnike brenda territorit të Kosovës? Shembull: për këtë janë gjuhët e pakicave të cilat, në nivelin lokal nuk kanë përfaqësim adekuat. Si shembull praktik mund të merren komuna të shumta të Kosovës ku përqindja e minoritetit serb është gati zero përqind kurse, minoriteteve tjera ka një përqindje të konsiderueshme dhe përdorimi i gjuhës serbe në nivel lokal është gati i panevojshëm. Në

<sup>25</sup> Raporti i ECMI Kosova, Drejt cilësisë gjuhësore të legjisllacionit të Kosovës në gjuhën shqipe dhe serbe - Një hap në plotësimin e zbrazëtirave në zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve , Prishtinë, Tetor. 2018, fq. 16-17

<sup>26</sup> komentari tematik nr.3 të Komitetit Këshillimor të Konventës kuadër për Mbrojtjen e pakicave që lidhet me të drejtat gjuhësore të personave që u përkasin pakicave kombëtare, pika 2.2 . pjesa 35, Strasburg, 5 korrik 2012, i miratuar me 24.Maj të vitit 2012, fq. 13 .

univeristete të shumta në Kosovë, nuk mësohet në gjuhën serbe përderi sa, dokumentet lëshohen edhe në këtë gjuhë.

### **Rekomandime**

- Në nivelin lokal, gjuhë zyrtare të jenë vetëm ato gjuhë ku jeton pakica e cila e përdor këtë gjuhë.
- Në komunat veriore të Kosovës (në bashkëpunim me mekanizmat ndërkombëtarë) të futen në përdorim zyrtar njësoj gjuhët që janë në komunat me shumicë shqiptare.
- Në shkolla fillore dhe të mesme ku mësojnë pakicat, krahas arsimimit të tyre në gjuhën amtare, në cilësinë e gjuhës jo amtare si gjuhë zyrtare e shumicës të mësohet edhe gjuha shqipe.
- Dokumentet zyrtare, çertifikatat, diplomat shkollore e Unviersitare etj. Të lëshohen edhe në gjuhën e nxënësit ose studentit që i përket grupit etnik të pakicave.

### **Literatura**

1. Karta evropiane për Gjuhët Rajonale dhe Minoritare, neni-1
2. Deklarata universale për të drejtat e njeriut, neni -1
3. Konventa për të Drejta Civile dhe Politike, neni- 27
4. Deklarata e OKB për të Drejtat e Personave që u takojnë Pakicave Kombëtare ose Etnike, Fetare dhe Gjuhësore
5. Dokumenti i Kopenhagës, par. 32.2
6. Kushtetuta e Kosovës, nenet, 5-6
7. Udhëzimi Administrativ, 2007/06
8. Udhëzimi Administrativ nr. 2011/02
9. Ligji për Përdorimin e Gjuhëve nr.02/L-37, nenet, 12-18 ,19-24 , 27, dhe 28-30
10. Politikat e gjuhëve në Kosovë, zbatimi në marrëdhënie me publikun, Shtator, 2011
11. Ligji kundër Diskriminimit nr.2004/3, neni 4
12. <sup>12.</sup> ûemailj Kurtişi kundër Asamblesë Komunale të Prizrenit, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, 18 mars 2010, paragrafi 54–56, nr. i lëndës. Ko 01/09, nr. ref. AGJ 07/10.
13. Plani i veprimit për përmisimin e cilësisë së përdorimit të gjuhëve në komuna Istog, USAID, 2016, fq. 2-6

14. FDH, Zbatimi i ligjit kundër diskriminimit dhe ligjit për përdorimin e gjuhëve në ndërmarrjet publike në Kosovë, Prishtinë. 2007
15. OSBE, Departamenti për Monitorim, Implementimi i Ligjit për Përdorimin e gjuhëve nëpër Komunitetet e Kosovës, Prishtinë, 2008
16. Rregullore për Zyren e komisionerit për Gjuhët nr.07/12, neni3, par.-2
17. Raporti i ECMI Kosova, Drejt cilësisë gjuhësore të legjislacionit të Kosovës në gjuhën shqipe dhe serbe - Një hap në plotësimin e zbrastërave në zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve , Prishtinë, Tetor. 2018, fq. 10-14
18. komentari tematik nr.3 të Komitetit Këshillimor të Konventës kuadër për Mbrojtjen e pakicave që lidhet me të drejtat gjuhësore të personave që u përkasin pakicave kombëtare, pika 2.2 . pjesa 35, Strasburg, 5 korrik 2012, i miratuar me 24.Maj të vitit 2012, fq. 13.

**MSc. (PhD Cand.) Flaka BRAHA**  
**614.4(496.51)**

**KDU 33:**

**MSc. (PhD Cand.) Simeana BESHI**

## **ANALIZË E SHKURTËR RRETH NDIKIMIT TË PANDEMISË COVID-19 NË BUXHET**

### ***Abstrakt***

*Përmes këtij punimi do të trajtohen efektet e shkaktuara nga situata e pandemisë COVID-19 në buxhetin dhe ekonominë e vendit në përgjithësi. Pandemia COVID-19 ka rënduar ekonominë botërore, përfshirë edhe atë të Kosovës. Qeveria e Kosovës, ngjashëm sikurse edhe qeveritë e vendeve të tjera filloi zbatimin e masave për tejkalimin e sfidave socio-ekonomike të shkaktuara nga pandemia COVID-19.*

*Nga mesi i muajit Mars deri në Maj vendi ka qenë i bllokuar totalisht, duke kufizuar lëvizjen e lirë të njerëzve, mallrave dhe shërbimeve, ndalimin e udhëtimeve, pezullimin e procesit mësimor, mbylljen e bizneseve joesenciale (...), gjë e cila ka reflektuar në rritjen e numrit të papunësisë në vend, uljen e standardit jetësor të qytetarëve, rritja ekonomike është minuar e kjo do të shkaktojë probleme në buxhetin e vitit të ardhshëm, duke thelluar më tej deficitin tregtar, kryesisht për shkak të rënies së vëllimit të remercave dhe turizmit të diasporës.*

*Situata pandemike ka ndikuar thellë në aftësinë e sektorit privat për të operuar ku shumë biznese janë mbyllur, të tjerat kanë funksionuar me orare të reduktuara të punës madje është vënë në rrezik edhe mbijetesa e tyre. Bruto Produkti Vendor pritet të zvogëlohet, të hyrat fiskale pritet të ulen për shkak të rënies së TVSh-së dhe detyrimeve doganore. Poashtu, edhe Investimet e Huaja Direkte dhe flukset e tjera financiare pritet të ulen përgjysmë. Rënia ekonomike ka sfiduar edhe mbledhjen e të hyrave. Në skenarin e saj negativ, mund të parashohim recension të thellë në Kosovë.*

*Në këtë studim do të përdoret analiza e kërkimit sasior. Disa nga metodat që do të përdoren janë: metoda deskriptive dhe krahasuese.*

*Rezultatet e këtij punimi do të ofrojnë të dhëna dhe informacione mbi ndikimin aktual të pandemisë në buxhetin e vendit, gjendjen e mbledhjes së të hyrave si dhe studimet e kryera nga shoqatat e biznesit dhe organizatat joqeveritare në vend.*

***Fjalët kyçe: pandemia, buxheti, deficit, ekonomia***

#### ***Abstract***

*This paper will address the effects caused by the COVID-19 pandemic situation on the budget and economy of the country in general. The COVID-19 pandemic has aggravated the world economy, including that of Kosovo. The Government of Kosovo, like the governments of other countries, began implementing measures to overcome the socio-economic challenges caused by the COVID-19 pandemic.*

*From mid-March to May, the country was completely blocked, restricting the free movement of people, goods and services, banning travel, suspending the teaching process, closing non-essential businesses (...), which was reflected in increase in the number of unemployment in the country, decrease in the living standard of citizens, economic growth is undermined and this will cause problems in next year's budget, further deepening the trade deficit, mainly due to the decline in the volume of remittances and tourism of the diaspora.*

*The pandemic situation has profoundly affected the ability of the private sector to operate where many businesses have closed, others have operated with reduced working hours and even their survival has been put at risk. Gross Domestic Product is expected to decrease, fiscal revenues are expected to decrease due to the decline in VAT and customs duties. Also, Foreign Direct Investment and other financial flows are expected to be halved. The economic downturn has also challenged revenue collection. In its negative scenario, we can predict a deep review in Kosovo.*

*Quantitative research analysis will be used in this study. Some of the methods that will be used are: descriptive and comparative methods.*

*The results of this paper will provide data and information on the current impact of the pandemic on the country's budget, the state of revenue collection as well as studies conducted by business associations and non-governmental organizations in the country.*

**Keywords: pandemic, budget, deficit, economy**

## Hyrje

Ndikimi negativ i pandemisë COVID-19 në buxhet, por edhe mundësitë dhe rreziqet që përmes shpenzimeve publike të bëhet rimëkëmbja ekonomike dhe sociale e shkaktuar kjo pandemi, bëri që me 28 shkurt 2020, Qeveria e Kosovës të marrë vendimin e parë për ndarjen e mjeteve financiare me qëllim të parandalimit të situatave të mundshme emergjente për pandemi.<sup>27</sup> Dy javë pas marrjes së këtij vendimi, u raportuan dy raste të para me koronavirus në Kosovë.

Ndërkohë, jashtë afateve të rregullta ligjore, vendi ka shfrytëzuar 1/12 pjesë të buxhetit, ku nga ana e Kuvendit është miratuar kërkesa e Qeverisë për shfrytëzimin e këtij buxhetit deri në muajin Mars. Me 15 Mars, Kuvendi miratoi buxhetin për vitin 2020. Poashtu, Qeveria e Kosovës, ka miratuar “Planin për gatishmëri dhe reagim kundër virusit korona” me vlerë buxhetore prej 10 milionë euro.<sup>28</sup> Më 11 Mars, filluan vendimet për masat e para preventive me qëllim të parandalimit të virusit korona, si:<sup>29</sup>

- “Mbyllja e kufijëve tokësor për udhëtarët që hyjnë në Kosovë, kjo nuk vlen për qytetarët kosovarë. Të gjithë shtetasit e Kosovës të cilët hyjnë përmes këtyre kufijve do t’iu nënshtrohen kontrolleve të shtuara mjekësore me urdhrin që ata të vet izoloohen për 14 ditë;
- Nga data 16 mars 2020 ora 24:00, bëhet pezullimi i përkohshëm i të gjitha linjave të udhëtimit ajror në Aeroportin e Prishtinës, përveç fluturimeve ushtarake, dhe emergjencave

---

<sup>27</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendim Nr. 07/04, <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-4-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs-2020.pdf> (e qasur më: 05.09.2020)

<sup>28</sup> AA, Anadolu Agency, <https://www.aa.com.tr/sq/balkani/qeveria-e-kosov%C3%ABs-ndau-10-milion%C3%AB-euro-kund%C3%ABr-koronavirusit/1761222> (e qasur më: 06.09.2020)

<sup>29</sup> Republika e Kosovës, Ambasada e Republikës së Kosovës në Tokio, <http://www.ambasada-ks.net/jp/?page=1,8,123> (e qasur më: 07.09.2020)

medicinale (MEDIVAC). Përjashtim bëjnë linjat e udhëtimit në ardhje me ekuipazh, por pa udhëtarë që shërbejnë vetëm për largim të udhëtarëve nga Kosova;

- Ndërpritet me efekt të menjëhershëm transporti ndër-urban në Republikën e Kosovës, si dhe transporti i organizuar ndërkombëtar (13 mars 2020);

- Reduktohen në veprimet esenciale dhe staf esencial çdo institucion publik, përveç stafit të sektorit të shëndetësisë dhe të sektorit të sigurisë;

- Urdhërohen kompanitë private që ta organizojnë punën në atë mënyrë që shumicën e aktiviteteve punëtorët t'i kryejnë nga shtëpia;

Rekomandim: U bëhet thirrje të gjithë qytetarëve në Kosovë që t'u shmangen ambienteve të frekuentuara me njerëz dhe t'u përmbahen të gjitha masave të ndërmarra nga Qeveria dhe rekomandimet e dhëna nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës;

Për më tepër, më 12 mars 2020, Qeveria ka themeluar Komisionin e posaçëm për parandalimin e Corona Virusit COVID-19 në Kosovë, ndërkaq, më 15 mars 2020, Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për shpalljen e Emergjencës për Shëndetin Publik”.

Të gjitha këto masa kishin impakt edhe në mirëqenien socio-ekonomike të qytetarëve dhe funksionimin e sektorit privat.

Për t'i dalë në ndihmë krizës socio-ekonomike të krijuar si rezultat i masave të sipërpërmendura dhe kufizimit të punës së shumicës së bizneseve në sektorin privat, Qeveria aprovoi Pakon Emergjente Fiskale me vlerë prej 179.6 milionë euro të shpërndara në 15 masa të ndryshme. Në aspektin buxhetor, Kosova hyri në këtë pandemi me një borxh publik mjaft të ulët - rreth 20 pikë përqindje më i ulët se borxhi i lejuar me ligj dhe kjo i lejonte hapësirë të konsiderueshme fiskale për adresim të krizës. Mirëpo, hyrja në kredi të reja dhe tejkalimi i rregullës për kufirin e deficitit buxhetor u pamundësuan si alternativë sepse koalicioni qeverisës pësoi votë mosbesimi në Kuvendin e Kosovës. Kufizim tjetër sa i përket krijimit të hapsirës buxhetore për adresimin e krizës ishte edhe përqindja shumë e lartë e buxhetit për investime kapitale që ishte vazhdim nga vitet e kaluara.

Qëllimi i këtij punimi është që të paraqes ndikimin e pandemisë COVID-19 në buxhetin e Kosovës si dhe kufizimet dhe mundësitë ligjore që ka Qeveria e Kosovës për adresimin e krizës në aspektin buxhetor. Në pjesën e parë është bërë një rishikim i bazës ligjore lidhur me kufizimet dhe mundësitë e ekzekutivit sa i përket menaxhimit të krizës. Pastaj është paraqitur ndikimi i krizës në të hyrat, shpenzimet dhe deficitin fiskal të vitit 2020. Pjesa e dytë përmban një përmbledhje të ndikimit të pandemisë në të hyrat buxhetore. Në



pjesën e tretë analizohet rishikimi i KASH'it si rezultat i pandemisë dhe për ndikimin e pandemisë në buxhet.

Situata e krijuar nga pandemia COVID-19 na obligon që të veprojmë në sienergji me të gjithë akterët drejt rimëkëmbies ekonomike, në mënyrë që të përmirësohet mirëqenia e qytetarëve dhe krijimi i një ambienti sa më të përshtatshëm të të bërit biznes.

### **Kufizimet ligjore për menaxhim të buxhetit në kohë të krizave**

Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, parasheh kufizime sa i përket rregullimit të ndarjeve buxhetore të organizatave buxhetore, në situata të krizave dhe shpenzimeve të paparashikueshme dhe paplanifikuara buxhetore.

Me kërkesë të udhëheqësve të organizatave buxhetore, Ministri/ja e Financave mund të transferojnë vetëm 15 deri 25% të ndarjeve buxhetore nga një kategori në tjetrën dhe duke përjashtuar transferin në kategorinë e pagave dhe medijtjeve vetëm pas marrjes së miratimit me shkrim nga Qeveria.<sup>30</sup> Ky Ligj poashtu parasheh edhe reduktimin e fondeve të alokuara, sipas të cilës Ministri mundet ta urdhërojë Drejtorin e Përgjithshëm të Thesarit që të bëjë reduktimin e nivelit të fondeve të alokuara nga një ndarje buxhetore e cila është autorizuar sipas një Ligji për Ndarjet Buxhetore nëse: a) Ministri konstaton se ky reduktim është bërë i nevojshëm për shkak të (i) një tronditje makroekonomike e cila rezulton në zvogëlimin e të ardhurave të mbledhura, (ii) një fatkeqësie natyrore ose (iii) pezullimit ose anulimit nga Qeveria të programit ose projektit për të cilin vlen alokimi, dhe b) Ministri pranon një autorizim me shkrim nga Qeveria me anë të të cilit miratohet reduktimi i propozuar.<sup>31</sup>

Në kategorinë e investimeve kapitale ekziston edhe një kufizim shtesë. Në rast të rialokimit të shumave brenda projekteve të ndryshme kapitale, atëherë ato duhet të bëhen vetëm në nën-programin e njëjtë.<sup>32</sup> Mirëpo, për çdo transfer buxhetor që e tejkalon këtë përqindje apo në rast të ndonjë transferi buxhetor ndërmjet organizatave buxhetore, atëherë nevojitet aprovim nga Kuvendi i Kosovës.<sup>33</sup> Kur organizata buxhetore ka nënshpenzim krahasuar me planin e rrjedhës së parasë së gatshme të dorëzuar në Thesar, Ministri mundet

<sup>30</sup> Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Neni 30, 2008, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524>, (e qasur më: 01.10.2020)

<sup>31</sup> Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Neni 36, 2008, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524>, (e qasur më: 01.10.2020)

<sup>32</sup> Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, Neni 16, 2020, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=27690>, (e qasur më: 01.10.2020)

<sup>33</sup> Ibidem, Neni 15

gjatë tre (3) mujorit të fundit të vitit financiar me aprovimin paraprak nga Qeveria, pas pranimit të një arsyetimi të vlefshëm nga organizata buxhetore kërkuese, të autorizojë shkurtimin e ndarjes buxhetore për të gjitha kategoritë e shpenzimeve të asaj organizate buxhetore, duke përjashtuar të hyrat vetanake, të hyrat e dedikuara dhe huamarrjet, të transferojë atë brenda po të njëjtës organizatë buxhetore apo të transferojë atë ndarje tek një organizatë tjetër buxhetore, duke përjashtuar të gjithë paragrafët dhe nenet të cilët kufizojnë transferet buxhetore. Këto mjete nuk mund të transferohen për projekte të reja kapitale. Vlera kumulative e të gjitha këtyre transfereve nuk duhet të tejkalojë pesë përqind (5%) të vlerës totale të të gjitha ndarjeve buxhetore duke përjashtuar të gjitha ndryshimet e ndarjeve buxhetore të ndodhura deri më 30 shtator të vitit fiskal.<sup>34</sup>

Ministri/ja gjithashtu mund të shmang kufizimet në rastin e transferit të kontigjencave në MF dhe shuma e kësaj kontigjence këtë vit është 36.8 milionë euro.

Sikurse u tha më lartë, qeveria mund të transferoj mjete deri në 25% të një kategorie buxhetore, por, për çdo transfer që tejkalon 25% të një ndarje buxhetore të institucionit përkatës nevojitet përfshirja e Kuvendit. Kuvendi nevojitet edhe për miratim të marrëveshjeve të reja kreditore dhe tejkallim të rregullës për kufirin e deficitit. Deficiti buxhetor në planifikimin e buxhetit për vitin 2020 është 2% e BPV-së që është njëkohësisht edhe maksimumi i lejuar i kufirit të deficitit buxhetor.<sup>35</sup>

Për tejkaimin e këtij deficitit, Qeveria e Kosovës duhet t'i propozojë Kuvendit të Kosovës hyrjen në kredi të reja dhe rritjen e kufirit të deficitit buxhetor. Kuvendi mundet të rrisë kufirin e deficitit nëse shfaqet ndonjë ngjarje apo kombinim i ngjarjeve, duke përfshirë rastin kur pasojat e specifikuara financiare dhe ekonomike parashikohet të kenë ndikim të madh në buxhetin e përgjithshëm në vitin fiskal kur shfaqen ato ngjarje apo në vitin fiskal pasues (...).<sup>36</sup>

Pa marrë parasysh lejimit për rritjen e deficitit buxhetor, buxheti i nënshtrohet edhe Ligjit për borxhin publik i cili nuk lejon rritjen kryegjësë së borxhit të përgjithshëm mbi 40% të BPV-së. Mirëpo, edhe pse planifikohet rritje e kufirit të deficitit, në periudhën afatmesme borxhi i përgjithshëm pritet të jetë rreth 27% e BPV-së apo rreth 13 pikë përqindje nën kufirin

---

<sup>34</sup> Ibid. Neni 15 par. 3

<sup>35</sup> Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/l-194 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/l-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/l- 221 dhe nr. 04/l-116, neni 22A, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524>, (e qasur më: 01.10.2020)

<sup>36</sup> Ibidem, Neni 22B

e lejuar.<sup>37</sup> Gjithashtu, edhe pas rritjes së parashikuar të këtij borxhi, Kosova pritet ta ketë borxhin më të ulët publik në rajon.

### **Ndikimi i pandemisë COVID-19 në buxhet dhe ndryshimet e shkaktuara prej tij**

Në përpjeke për të frenuar përhapjen e pandemisë COVID-19, shumë shtete janë detyruar të ndërmarrin masa të shumta të cilat madje kanë kufizuar liritë dhe të drejtat themelore të qytetarëve të tyre sikundër që ka pasur rënie të theksuar edhe në aktivitetin ekonomik të bizneseve.

Fillimi i situatës së pandemisë (Covid-19), përkatësisht shpallja e situatës së emergjencës shëndetësore, kishte efekte të konsiderueshme edhe te të hyrat dhe shpenzimet në gjashtëmujorin e vitit 2020, gjithsesi këto efekte nga Covid-19 ndikim më të theksuar kishin në tremujorin e dytë të këtij viti (prill-qershor).

Të hyrat buxhetore kanë arritur vlerën prej 760.35 milionë euro, duke shënuar ulje prej 11%, që korrespondon me 93.16 milionë euro më pak, krahasuar me gjashtëmujorin e vitit paraprak. Kjo shumë e të hyrave përfaqëson 38% të planit vjetor të parashikuar, ndërsa ulja në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak ka ardhur kryesisht nga ulja e të hyrave të rregullta tatimore dhe jo-tatimore. Ky trend i uljes së të hyrave tatimore dhe jo-tatimore vjen si rrjedhojë e performancës së sektorit privat që lidhet me efektet e pandemisë dhe zvogëlimit të aktivitetit biznesor në raport me situatën e krijuar nga Covid-19.

Të hyrat e mbledhura nga Dogana e Kosovës kanë arritur vlerën bruto prej 471.43 milionë euro, apo 38% e planit buxhetor për Vitin 2020, duke shënuar ulje prej 54.83 milionë, apo 10% më pak krahasuar me periudhën e njëjtë të Vitit paraprak.

Të hyrat e mbledhura nga Administrata Tatimore e Kosovës kanë arritur vlerën bruto prej 215.97 milionë euro, apo 39 % e planit buxhetor për Vitin 2020, duke shënuar ulje prej 22.66 milionë euro, apo 9.5% më pak krahasuar me periudhën e njëjtë të Vitit paraprak.<sup>38</sup>

Lidhur me performancën e shpenzimeve, gjatë gjashtëmujorit pagesat ishin në shumë prej 933.73 milionë euro dhe paraqesin 37% të planit vjetor për shpenzime, ndërsa krahasuar me realizimin e gjashtëmujorit të Vitit paraprak kemi rritje prej 38.78 milionë euro ose 4%. Kjo periudhe u karakterizua me ekzekutimin e masave të pakos emergjente të Qeverisë së

<sup>37</sup> Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L - 175 Ligji për Borxhet Publike, Neni 5, 2010, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2663>, (e qasur më: 02.10.2020)

<sup>38</sup> Republika e Kosovës, Ministria e Financave, Thesari i Kosovës, "Raporti Gjashtëmujor Financiar", <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4DFA6900-411B-4ACD-B0EF-3F8DCDB61640.pdf>, (e qasur më: 02.10.2020)

Republikës së Kosovës, si dhe shpenzimeve të ndërlidhura me menaxhimin e pandemisë covid-19. Shpenzimet buxhetore gjatë kësaj periudhe raportuese arritën vlerën prej 890.98 milionë euro (duke përfshirë pagesën e interesit), duke shënuar rritje prej 2%, që korrespondon me 20.84 milionë euro më pak krahasuar me gjashtëmujorin paraprak.<sup>39</sup>

Tek të hyrat buxhetore nga tatimet indirekte, që janë burim i rreth 80% të të hyrave vjetore, krahasuar me vitin paraprak, rënie prej mbi 59 milionë euro apo 29% në periudhën mars-maj 2020 ka tek të hyrat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH). Rënia është kryesisht tek TVSH e mbledhur në kufi (44 milionë euro). Të hyrat nga detyrimi doganor janë ulur për rreth 12.8 milionë euro apo 39%. Kurse, një rënie më të lehtë gjatë periudhës mars-maj 2020 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kanë pësuar të hyrat nga akciza për rreth 11.7 milionë euro apo 11%. Ndikim në rënien e të hyrave nga tatimet indirekte në këtë periudhë kishte edhe rënia e çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare. Edhe pse sasia e importuar e lëndëve djegëse ishte thujse e njëjtë, në prill të vitit 2020 raporti mes vlerës së këtyre produkteve dhe sasisë së importuar ishte 0.24 (euro/njësi), kurse në prill të vitit 2019 raporti ishte 0.52 (euro/njësi).<sup>40</sup>

Tek të hyrat buxhetore nga tatimet direkte, rënie më të theksuar në periudhën mars-maj 2020 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kanë pësuar të hyrat nga tatimi në të ardhura të korporatave me rreth 11 milionë euro apo 37%. Ngjashëm, të hyrat nga tatimi në të ardhurat personale kanë rënë për rreth 8.7 milionë euro apo 20%. Po ashtu, tek tatimi në pronë janë ulur të hyrat për rreth 4.5 milionë euro apo 62%. Mirëpo, tek kjo kategori ndikim ka edhe vendimi i qeverisë për të ua shtyrë afatet për pagesën e tatimit në pronë qytetarëve. Një pjesë e këtyre mjeteve mund të grumbullohen gjatë pjesës së mbetur të vitit, gjë që e neutralizon rënien totale vjetore të këtyre të hyrave.<sup>41</sup>

Sa i përket gjendjes së fondeve, bilanci bruto i fondeve më 30 Qershor 2020 ishte 513.35 milionë Euro, e cila përmban të gjitha fondet në llogari, duke përfshirë ato të marra me kredi ndërkombëtare nga FMN (53 milionë Euro) si dhe emetimi i letrave me vlere (50 milionë euro). Ndërsa, gjendja fillestare e fondeve të Buxhetit të Republikës së Kosovës 1 Janar 2020 ishte 458.25 milionë Euro. Si rezultat i pranimeve më të mëdha sesa pagesave (rritje në të hyrat tatimore) për periudhën janar – qershor 2020, bilanci i fondeve ka rezultuar

---

<sup>39</sup> Ibidem

<sup>40</sup> Instituti GAP, “Ndikimi i pandemisë COVID-19 në buxhetin e Kosovës”, 2020, [https://www.institutigap.org/documents/31153\\_Ndikimi%20i%20pandemis%C3%AB%20ne%20Buxhet.pdf](https://www.institutigap.org/documents/31153_Ndikimi%20i%20pandemis%C3%AB%20ne%20Buxhet.pdf), (e qasur më: 03.10.2020)

<sup>41</sup> Ibidem

rritje prej 55.94 milionë Euro, për dallim nga periudha e njëjtë e Vitit 2019 kur rritja ishte 180.66 milionë euro.<sup>42</sup>

### **Rishikimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASh-it) si rezultat i pandemisë**

Meqenëse, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2021-2023 paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet buxheti vjetor për vitin vijues 2021, Ministria e Financave e ka konsideruar si të domosdoshme të bëjë rishikimin e KASh-it. Qëllimi kryesor i rishikimit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve është adaptimi i prioriteteve të përgjithshme të Qeverisë si rezultat i pandemisë. Përmes kësaj synohet që të bëhet ndërlidhja duke u bazuar në analizat gjithëpërfshirëse të mjedisit makroekonomik në vend dhe planifikimeve buxhetore për vitet vijuese me një perspektivë 3(tre) vjeçare në përputhje me objektivat strategjike të Qeverisë.

Në fund të muajit maj 2020, Ministria e Financave azhurnoi projeksionet makro-fiskale në kuadër të rishikimit të Buxhetit për vitin 2020. Sipas këtyre projeksioneve, ekonomia e Kosovës vlerësohej të shënonte rënie me rreth -3.0% me goditjen më të madhe të reflektuar në tremujorin e dytë të vitit 2020. Përditësimi i projeksioneve me të dhënat më të fundit të disponueshme sugjerojnë për një përkeqësim të perspektivës ekonomike afatshkurtër dhe për zgjatjen e kohës së rikuperimit të aktivitetit ekonomik. Sipas vlerësimeve të MF-së, ekonomia e Kosovës gjatë vitit aktual pritet të tkurret me rreth 6.4% në terma realë. Efekti negativ i pandemisë pritet të kulmojë në tremujorin e dytë të vitit 2020, si rezultat i mbylljes së aktiviteteve ekonomike dhe masave të tjera të distancimit social. Edhe pse gjatë tremujorit të tretë të 2020-ës, ka ndodhur një lehtësim i masave për kufizimin e përhapjes së pandemisë, rritja ekonomike do të vazhdojë të ngelet në territor negativ, si rezultat i pasigurisë për të ardhmen, vazhdimin të një pjese të kufizimeve (veçanërisht të udhëtimeve) dhe natyrës globale të kësaj situate, e cila pritet të thellojë më tej impaktin negativ në ekonominë vendase. Megjithatë, trajektorja rënëse e projeksioneve tona do të jetë më e zbutur pas tremujorit të dytë. Rënia e BPV- së reale prej 6.4% gjatë vitit 2020 i atribuohet kryesisht rënies së investimeve private (më kontribut negativ rreth 4.8 pikë përqindje) dhe rënies së eksportit të mallrave dhe shërbimeve (me kontribut negativ rreth 5.5 pikë përqindje). Kjo e fundit vjen kryesisht si rezultat i rënies së ndjeshme të eksportit të shërbimeve (veçanërisht të

---

<sup>42</sup> Republika e Kosovës, Ministria e Financave, Thesari i Kosovës, “Raporti Gjashtëmuor Financiar”, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4DFA6900-411B-4ACD-B0EF-3F8DCDB61640.pdf>, (e qasur më: 02.10.2020)

udhëtimit) me rreth 27% në terma realë, ndërkohë që eksporti i mallrave pritet ta mbyllë vitin me rritje pozitive, por me një normë rritje më të ulët se ajo e shfaqur gjatë periudhës janar-korrik 2020. Konsumi privat pritet gjithashtu të ketë kontribut negativ në rritjen ekonomike reale, me rreth 1.8 pikë përqindje, si rezultat i rënies së të ardhurave të disponueshme dhe rritje së pasigurisë së konsumatorëve për të ardhmen por edhe natyrës së masave kufizuese për parandalimin e përhapjes së COVID-19. Investimi publik pritet të ngadalësohet krahasuar me vitin e kaluar (me kontribut negativ në rritjen ekonomike me rreth 1.1 pikë përqindje) si rezultat i situatës së krijuar nga COVID-19 dhe si rezultat i një fillimviti të karakterizuar nga ngërç politik, që solli në vonesa të aprovimit të Ligjit të Buxhetit për vitin 2020. Konsumi publik pritet të jetë pozitiv si rezultat i rritjes së shpenzimeve rrjedhëse (kategoria e “mallrave dhe shërbimeve” dhe kategoria e “pagave dhe mëditjeve”) në kuadër të akomodimit të një sërë masash emergjente të ndërmarra nga qeveria më qëllim zbutjen e ndikimit negativ të pandemisë. Kontributi i importeve të mallrave dhe shërbimeve ka qenë pozitiv (6.1 pikë përqindje), si rrjedhojë e rënies së të dy nënkomponentëve: i) rënies së mallrave duke qenë në linjë me rënies e vlerësuar të konsumit dhe investimeve; dhe ii) rënies së shërbimeve (veçanërisht të udhëtimit) për shkak të masave kufizuese të udhëtimit.<sup>43</sup>

Gjatë vitit 2021, ekonomia e Kosovës pritet të rritet me një normë reale mbi trendin e vet historik, me rreth 5.4%, duke i'u rikthyer nivelit të ngjashëm të regjistruar para krizës COVID19 (viti 2019) me kontribut kryesor të ardhur nga konsumi privat (me rreth 3.2 pikë përqindje); investimet private (me rreth 2.9 pikë përqindje); për t'u ndjekur nga eksporti total, veçanërisht ai i shërbimeve (me kontribut total rreth 2.04 pikë përqindje). Gjatë vitit 2021, gjithashtu pritet një dinamikë më e shpejtë e ekzekutimit të investimeve publike, ndërkohë që kontributi i konsumit publik do të jetë i ngjashëm me vitin 2020. Megjithatë, sa më shumë të zgjasë periudha e distancimit social apo izolimit, aq më të vogla janë gjasat për një rimëkëmbje të ekonomisë sipas një trajektore të paraqitur në grafik 6. Ndërsa, në dy vitet e tjera (2022 dhe 2023), rritja ekonomike reale do të luhet rreth nivelit të vet historik prej 4%. Është e rëndësishme të theksohet që vlerësimi për perspektivën afatmesme të ekonomisë varet ndjeshëm se si do të mbyllet viti 2020 dhe nëse rimëkëmbja në vitin 2021 do të jetë e ngadaltë dhe e pjesshme apo anasjellas.<sup>44</sup>

---

<sup>43</sup> Republika e Kosovës, Ministria e Financave, “Korniza Afatmesme e Shpenzimeve e Rishikuar 2021-2023”, 2020, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/D4BAD11A-D341-45C0-8FBB-52BD3770E5BD.pdf>, (e qasur më: 04.10.2020)

<sup>44</sup> Ibidem

## Përmbledhje

Padyshim se situata e krijuar si rezultat i pandemisë COVID-19 ka ndryshuar persepektivën ekonomike në Kosovë. Ndikimi në ekonomi i pandemisë dhe masave të ndërmarra nga qeveria kanë bërë që parashikimet fiskale për këtë vit të ndryshojnë krahasuar me projeksionet e buxhetit 2020. Vlerësimet për të hyrat totale nga Ministria e Financave për vitin 2020 tregojnë që të hyrat do të kenë një rënie vjetore prej rreth 5.3%, shtyrë nga një aktivitet ekonomik i ngadalësuar. Në anën tjetër, shpenzimet buxhetore në vitin 2020 priten të kenë një rritje prej rreth 25.2% krahasuar me vitin e kaluar. Kjo është si rezultat i akomodimit të të gjitha shpenzimeve që rrjedhin nga Pakoja Emergjente Fiskale dhe Programi i Rimëkëmbjës Ekonomike (me vlerët totale prej 365 milionë euro).

Duke pasur parasysh urgjencën aktuale të shëndetit publik, ekonomia e Kosovës është e ekspozuar ndaj tronditjeve të jashtme që do të ndikojnë në sektorë dhe aspekte të ndryshme të ekonomisë. Ndikimi negativ i pritshëm varet nga ashpërsia e masave mbrojtëse, kohëzgjatja e këtyre masave dhe e periudhës së izolimit, si dhe nga përgjigja e sektorit privat dhe e qeverisë së Kosovës për të stabilizuar ndikimin e këtyre goditjeve.

## Literatura

1. AA, Anadolu Agency, <https://www.aa.com.tr/sq/balkani/qeveria-e-kosov%C3%ABs-ndau-10-milion%C3%AB-euro-kund%C3%ABr-koronavirusit/1761222> (e qasur më: 06.09.2020)
2. Instituti GAP, “Ndikimi i pandemisë COVID-19 në buxhetin e Kosovës”, 2020, [https://www.institutigap.org/documents/31153\\_Ndikimi%20i%20pandemis%C3%AB%20ne%20Buxhet.pdf](https://www.institutigap.org/documents/31153_Ndikimi%20i%20pandemis%C3%AB%20ne%20Buxhet.pdf), (e qasur më: 03.10.2020)
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L - 175 Ligji për Borxhet Publike, Neni 5, 2010, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2663>
4. Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Neni 30, 2008, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524>
5. Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/l-194 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/l-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/l- 221 dhe nr. 04/l-116, neni 22A, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524>
6. Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, Neni 16, 2020, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=27690>

7. Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendim Nr. 07/04, <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-4-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs-2020.pdf> (e qasur më: 05.09.2020)
8. Republika e Kosovës, Ambasada e Republikës së Kosovës në Tokio, <http://www.ambasada-ks.net/jp/?page=1,8,123> (e qasur më: 07.09.2020)
9. Republika e Kosovës, Ministria e Financave, “Korniza Afatmesme e Shpenzimeve e Rishikuar 2021-2023”, 2020, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/D4BAD11A-D341-45C0-8FBB-52BD3770E5BD.pdf>, (e qasur më: 04.10.2020)
10. Republika e Kosovës, Ministria e Financave, Thesari i Kosovës, “Raporti Gjashtëmujor Financiar”, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4DFA6900-411B-4ACD-B0EF-3F8DCDB61640.pdf>

**Prof.ass.dr. Enver BUÇAJ**

**KDU**

**004:323.28**

## **SPIUNAZHI NË INTERNET DHE TERRORIZMI KIBERNETIK**

### ***Abstrakt***

*Dukuria e spiunazhit në përgjithësi dhe e spiunazhit kibernetik në veçanti është e lidhur ngusht me terrorizmin kompjuterik dhe me luftën e informatave. Kur dëgjojmë fjalën spiunazh, mund të kemi një imazh të një spiuni joshës i cili është i patronditur, i patrazuar dhe udhëton në vende joshëse e me shoqëri joshëse etj. Por, spiunazhi bëhet rreth informatave dhe zakonisht kryhet pa ndonjë bujë të madhe. Anonimiteti është shoku më i mirë i një spiuni profesionist, dhe, me qenë se në kompjuter ruhen shumë informata, atëherë themi se pikësynim i qartë i çdo operacioni të spiunazhit janë sistemet kompjuterike. Ndonëse këto gjëra nuk janë pranuar publikisht, shumica e ekspertëve pajtohen që agjencitë e ndryshme të inteligjencës sipas rrethanave angazhohen në operacionet kibernetike të spiunazhit. Në të vërtetë, heqja dorë nga një burim i tillë i vlefshëm, siç është interneti, për një agjenci të inteligjencës do të ishte veprim qëllimisht i pakujdesshëm.*

*Megjithatë, është po ashtu e rëndësishme të kuptohet se qeveritë, agjencitë e inteligjencës, dhe organizatat terroriste, sikur Alkaida, Isis dhe tjera, jo vetëm që e*



*shfrytëzojnë spiunazhin por shkojnë edhe më larg. Ndërkaq, këto subjekte vërtetë angazhohen në spiunazh, dhe me siguri nuk janë të vetme që e bëjnë këtë. Dëshira e organizatave të lartpërmendura për të marrë informacion për qëllime politike dhe ushtarake nuk është befasi, por mund të shokojë disa lexues kur mësojnë se spiunazhi i përbashkët është problem kryesor. Tani për tani, nuk ka ndonjë rast ku kompanitë e mëdha kanë spiunë bashkëpunues në listën e pagave, të paktën nuk ka pasur raste të cilat kanë ndodhur dhe që ne i dimë.*<sup>45</sup>

## **Rëndësia e informacionit**

Ekspertët besojnë në përgjithësi se shumë kompani kanë blerë informata nga individë të pavarur, pa pyetur prej nga e kanë burimin apo si erdhën. Sidoqoftë, mund të jetë shumë vështirë të konstatohet sa e përhapur është kjo metodë e marrjes së informacioneve. Në raste të caktuara, një shkelje e tillë e sigurisë të mos mund ta vë kompaninë në pozitë të palakmueshme ndaj kërkesave përgjegjëse prej konsumatorëve të dhënat e të cilëve mund të kenë qenë komprometuar. Për këto arsye, kompanitë shpeshherë ngurrojnë të bëjnë të ditur ndonjë aktivitet spiunazhi industrial, nëse ata janë autorë të krimit apo viktime.

Në vitin 2008, Instituti SANS renditi spiunazhin kibernetik si kërcënim të tretë më të madh në internet.<sup>46</sup> Shumica e ekspertëve të sigurisë pajtohen se ky aktivitet ndodhë shumë më shpesh se që është raportuar dhe ata gjithashtu pajtohen se do të vazhdojë të rritet edhe më tutje. Instituti SANS gjithashtu pret që spiunazhi kibernetik të jetë faktor në rritje në marrëdhëniet ndërkombëtare, si dhe në spiunazhin industrial.

Spiunazhi industrial nënkupton përdorimin e teknikave të spiunazhit për të gjetur se informata kyçe janë me vlerë ekonomike. Në shumicën e rasteve informatat janë pasuria më e vlefshme që ka çdo organizatë. Këto të dhëna mund të përfshijnë listën e klientëve të një konkurrenti, të dhënat e kërkimeve për një produkt të ri, apo çdo informacion që mund t'i japë organizatës së spiunazhit ndonjë epërsi.

Ndonëse spiunazhi, bashkëpunimi edhe spiunazhi në mënyrë të organizuar ndryshojnë nga spiunazhi ushtarak, teknikat bashkëpunuese janë shpeshherë të njëjta me metodat që i kanë përdorur agjencitë e inteligjencës dhe mund të përfshijnë monitorimin elektronik, kopjimin e skedarëve, ose komprometimin e një anëtari të organizatës së synuar. Në shumë

---

<sup>45</sup> David L. Parry, "Repugnant Philosophy": Ethics, Espionage, and Covert Action", gjendet në <http://www.scu.edu/ethics/publications/submitted/Perry/repugnant.html#a>, accessed on June 17, 2013.

<sup>46</sup> Network World, "Cyber Espionage seen as growing threat to business government 2008", <http://www.nwtworld.com/news/2008>.

raste, softueri spiun që është përdorur për të ndihmuar kryerjen e aktit të vjedhjes së identitetit mund të jetë mjet parësor i spiunazhit të korporatave.

Kur individë të tillë sjellin aftësi dhe përvoja të fituara nga trajnimet e tyre në botën e spiunazhit të korporatave, situata bëhet shumë më e vështirë për ekspertët e sigurisë së kompjuterëve. Megjithëse ekspertë të ndryshëm kompjuterikë dhe agjenci qeveritare bëjnë përpjekje për të vlerësuar ndikimin dhe përhapjen e spiunazhit të korporatave, vetë natyra e problemit bën që vlerësimet e sakta të jenë pothuajse të pamundura. Jo vetëm që kryerësit nuk dëshirojnë t'i zbulojnë krimet e tyre, por shpeshherë as viktimat nuk dëshirojnë ta bëjnë një gjë të tillë.<sup>47</sup> Por fakti është se shumica e incidenteve rreth shkeljes së informacionit në një kompani, gjurmët e një shkeljeje të tillë shpiejnë në rezultate se burim i rrjedhjes së informacionit është vetë i punësuar.

Shtrohet pyetja, sa është e vlefshme ajo informatë? Kjo pyetje mund të shikohet nga disa kënde. Në të vërtetë, mund të thjeshtësohet sipas dy kritereve: kriteri i parë është çmimi për prodhimin e asaj informate. Për shembull, së pari mund të merret parasysh vlera e një kërkimi studimor të një tregu dhe të shihet sa mund të kushtojë për ta kopjuar atë hulumtim, më qëllim që ta plasojë në treg për përfitime materiale. Kriteri i dytë është përparësia ekonomike që informacioni i marrë mund t'ia japë një konkurruesi.

Përderisa disa njerëz ende nuk janë plotësisht të familjarizuar me konceptin, të dhënat në të vërtetë pasqyrojnë një vlerë të çmuar. Në shumë raste, kjo është pasuria më e rëndësishme që e ka një kompani. Informata është një mall i vërtetë dhe produkt, si çdo produkt tjetër fizik. Ajo është një pasuri ekonomike, si çdo pasuri dhe kapital fizik në dispozicion të një kompanie. Në të vërtetë, shpeshherë ndodh që të dhënat në kompjuterët e një kompanie vlejnë shumë më tepër se vetë hardueri dhe softueri i sistemit kompjuterik të kompanisë. Zëvendësimi i të dhënave është me siguri shumë më i vështirë sesa i hardverëve ose softverëve të kompanisë.

Për të ndihmuar vlerësimin e vërtetë të konceptit të informacionit si mall më i çmuar, kemi bërë analizimin e procesit të marrjes së një diplome në kolegji. Studenti i kalon katër vjet ulur në klasa të ndryshme; paguan një sasi të konsiderueshme të parave për privilegjin e të ulurit në një klasë duke dëgjuar dikë me orë të tëra rreth disa temave. Në fund të katër vjetëve, i vetmi produkt që merr është një copë e vetme e letrës. Me siguri ai mund të

---

<sup>47</sup> SANS Institute InfoSec Reading Room, "Corporate Espionage 201", Version 1.0, 2007, në [http://www.sans.org/reading\\_room/whitepapers/engineering/corporate-espionage-201\\_512](http://www.sans.org/reading_room/whitepapers/engineering/corporate-espionage-201_512), accessed on June 18, 2013. Shih: H. Keith Melton and Craig Pilligan. "The Spy's Guide: Office Espionage". 2003.

marrë një copë letër me një çmim më të ulët dhe me më pak mundim. Çka pagoi ai, në të vërtetë, ishin informatat që i mori. E njëjta gjë qëndron në vlerën e vërtetë të shumë profesioneve: mjekë, avokatë, inxhinierë, konsulentë, drejtorë, e kështu me radhë. Të gjithë janë konsultuar për informata rreth ekspertizës së tyre.

Vetë informata si servis është një komoditet i vlefshëm,<sup>48</sup> dhe togfjalëshi "epokë e informacionit" në të dhënat e ruajtura në sistemet kompjuterike ka një vlerë të madhe për dy arsye. Së pari, nevojitet shumë kohë dhe përpjekje për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave dhe krijimin e informatës. Nëse kaloni gjashtë muaj me një ekip prej pesë njerëzve në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave dhe prodhimin e informatës, atëherë këto informata vlejné të paktën sa pagat dhe përfitimet e gjashtë personave. Së dyti, të dhënat shpeshherë kanë vlerë të përceptuar, pavarësisht nga përpjekjet dhe koha e hargjuar për marrjen dhe analizimin e të dhënave. Nëse faktet janë në lidhje me një shpikje apo algoritma, vlera e saj është e qartë. Megjithatë, çdo e dhënë që mund të sigurojë një epërsi konkurruese është e natyrshme dhe e vlefshme. Madje edhe një listë e kontakteve për klientë ka një vlerë të qenësishme. Për shembull, kompanitë e sigurimeve shpeshherë punësojnë ekipe të cilat merren me statistika dhe akterë që përdorin teknologji më të fundit në përpjekjet e tyre për t'i parashikuar rreziqet e mundshme që lidhen me ndonjë grup të caktuar të të siguarëve. Rezultatet e informacionit statistikor mund të jenë shumë të vlefshme për një kompani konkurruese të sigurimeve.

Spiunazhi i korporatave nuk është as i ri, e as i kufizuar për kompanitë e teknologjisë. Në vitin 1993, General Motors (GM) dhe njëri prej partnerëve të saj filluan të hetojnë një ish-ekzekutiv të quajtur Lopez Inaki<sup>49</sup> ku GM pretendonte se Lopez dhe shtatë të tjerë ishin të punësuar dhe i kishin transferuar një informacion thelbësor të GM-së pronarit Volkswagen (VW) në Gjermani nëpërmjet rrjetit të GM-së. Informacionet e supozuara të vjedhura përfshijnë të dhënat lidhur me çmimet, planet ndërtimore, llogaritjet e çmimeve të brendshme dhe një listë të blerjeve.

Një tjetër rast, ka ndodhur në gusht 2003 ku Oleg Zezev, një 29-vjeç teknik i PC nga Kazakistani, hyri në Bloomberg Inc<sup>50</sup> të sistemeve kompjuterike dhe përdori alias "Alex" për

---

<sup>48</sup> Për më shumë shih Beth Allen, "New developments Economic Theory-Information as an Economic Commodity", në <http://ptarpp2.uitm.edu.my/silibus/informationeconomic.pdf>, last accessed June 18, 2013. Shih po ashtu 'Information is a commodity' në <http://birch.co/post/3381813112/information-is-a-commodity>. Last accessed on June 18, 2013.

<sup>49</sup> CNN, GM, VS Lopez: Much about nothing 1993, [http://money.cnn.com/magazines/fortune\\_archive/1993](http://money.cnn.com/magazines/fortune_archive/1993).

<sup>50</sup> U.S Department of Justice: Kazakhstan Hackers Sentenced to four years prison for breaking into Bloomberg System and Attempting Extortion, <http://www.Cybercrime.gov.zezevSent.htm>.

të shantazhuar firmën. Zezev ilegalisht i mori të dhënat personale, postën elektronike dhe letërkredinë e Michael Bloomberg, i cili po ashtu ishte drejtor ekzekutiv i Bloomberg LP. Hakerët pastaj i përdorën këto informacione për të shantazhuar firmën. Pas një shqyrtimi që zgjati më pak se gjastë orë, juria në Gjykatën e Qarkut të SHBA-së në Manhatan e shpalli kryerësin e veprës fajtor për të gjitha akuzat: për konspiracion, për tentativë grabitjeje, për dërgimin e mesazheve elektronike kërcënuese dhe për ndërhyrje kompjuterike. Ky rast tregon qartë se spiunazhi kompjuterik dhe zhvatja kompjuterike janë probleme reale.

Informacionet e vjedhura përfshijnë një përmbledhje të planeve për operacionet ushtarake nga Koreja e Jugut dhe për trupat amerikane në rast të një lufte me Korenë e Veriut. Autoritetet spekuluan se Koreja e Veriut ishte përgjegjëse, megjithëse sulmet ndiqen në një adresë IP kineze. Ky rast tregon qartë se spiunazhin kibernetik nuk e kryejnë vetëm subjektet e ndryshme, duke përfshirë qeveritë.

Qeveritë evropiane vihen rregullisht nën shënjestër të hackerëve të cilët përpiqen të ndërpusin programe spiunazhi në sistemet e tyre kompjuterike. Sulmet, të cilat shpesh kryhen nga Kina, po bëhen gjithnjë e më të sofistikuara. Premtimi që i bëri kryeministri kinez, Uen Xhiabao, kancelares gjermane Angela Merkel gjatë vizitës së kësaj të fundit në Kinë, në verën e vitit 2007, u erdhi shumë për shtati gjermanëve. Uen u shpreh se qeveria e tij do të ndërmernte veprime “të vendosura” dhe “masa mjaft të ashpra” për të ndaluar sulme të paligjshme në rrjetet kompjuterike të qeverisë gjermane dhe premtimi nuk u bë aspak rastësisht. Vetëm pak ditë para udhëtimit të Angela Merkel në Kinë, revista gjermane “Der Spiegel” kishte raportuar se sistemet e qeverisë së vendit ishin bërë pre e sulmeve masive.

Shërbimet e fshehta gjermane kishin arritur të gjurmonin shumë prej tyre duke arritur në përfundimin se burimin e kishin nga disa provinca kineze.<sup>51</sup> Ishin fjalë të bukura dhe që i bënin nderë kryeministrit kinez, por sulmet me softuerë spiunë në rrjetet kompjuterike gjermane janë shtuar edhe më tej që prej asaj deklarate. “Kemi zbuluar përpjekje të përditshme për të kaluar sistemet mbrojtëse të kompjuterëve qeveritarë”, thotë Burkhard Even, kreu i divizionit të kundërinteligjencës në Zyrën Federale për Mbrojtjen e Kushtetutës, Agjenci e Shërbimeve të Brendshme të Fshehta të Gjermanisë.

Dyshimet kryesore vazhdojnë të biejnë në pjesën dërmuese mbi Kinën. Rasti më i spikatur ishte ai i rrjetit të kiber-spiunazhit të njohur si “Ghostnet” (rrjeti fantazmë), i cili u zhvillua nga ekspertët kanadezë dhe britanikë në fundin e marsit të këtij viti (2007).

---

<sup>51</sup> Espionage Report, *Merkel's China Visit*, Marred by Hacki Allegations. <http://www.spiegel.de/international/2007/>.

Programet e “Ghostnet”-it kishin infektuar të paktën 1,295 kompjuterë në 103 shtete të botës. “Shkencëtarët kanadezë konfirmuan informacionet tona,” vëren Even.<sup>52</sup>

Programet e posaçme antivirus kapin për çdo vit rreth 600 tentativa për të ndërftuar softuerë të sofistikuar spiunë në dy prej rrjeteve qendrore të internetit të IVVB, një sistem që lidh kompjuterët e kancelares gjermane me ministrinë e qeverisë në Bon dhe Berlin. Këto dhe tentativa të tjera të ngjashme janë provë e shtimit të vazhdueshëm të sulmeve të sofistikuara kompjuterike, një pjesë e mirë e të cilave as që arrihet të kapet prej ekspertëve gjermanë.<sup>53</sup>

Mund të thuhet se spiunazhi kompjuterik dhe kundërspiunazhi tani janë segmente të rëndësishme në mbrojtjen kombëtare. Mund të shqyrtohen edhe dhjetëra raste por, në këtë pikë, ne mendojmë se shumica e lexuesve mund të vlerësojnë rrezikun real të paraqitur nga spiunazhi kibernetik. Duket se raste të tilla në të ardhmen do të bëhen më të shpeshta, e assesit të bie numri i rasteve dhe se këto probleme janë reale dhe janë në rritje. Nga një pikëpamje hetimore, spiunazhi kompjuterik, qoftë ai korporativ apo spiunazhi i mbështetur nga qeveria, duhet të hetohen duke përcjellur informatat. Informatat që janë komprometuar mund të japin menjëherë të dhëna se kush i do këto informata, natyrisht nëse kompanitë të cilat kanë dhënë informata pajtohet të zbulojnë se kujt po i japin informacione të tilla. Kjo i siguron hetuesit më të dyshuar të menjëhershëm.

### **Postimi i kodeve të dëmshme si formë e terrorizmit kibernetik**

Kode të dëmshme mund të jenë pjesë e mesazhe të postave elektronike dhe të bashkëngjiten në programe që shërbejnë për hapjen e portave për spiunët, gjë që mundëson kontrollin e kompjuterëve të infektuar nga çdo pikë e globit dhe lejon shkarkimin e programeve të dëmshme brenda tyre. Mesazhet e këtij lloji u dërgohen adresave të caktuara që u përkasin punonjësve apo institucioneve që operojnë në fusha specifike. Në më të shumtën e rasteve, shënjestër e sulmeve bëhen nëpunësit e niveleve të mesme.

Interesant është rasti i një punonjësi të Ministrisë së Brendshme Federale të Gjermanisë, i cili kishte pranuar një postë elektronike e cila në pamje të parë dukej se ishte dërguar nga një tjetër punonjës i departamentit të tij. Mesazhi ishte pothuajse perfekt dhe të bashkëngjitur kishte një program spiun. Një numër i konsiderueshëm adresash në Organizatën

---

<sup>52</sup> Ibid.

<sup>53</sup> Ibid.

Botërore të Shëndetësisë dhe në Bashkimin Evropian ka marrë posta elektronike të ngjashme të nisura, po ashtu, nga dërgues të besueshëm.

Ekzistojnë qëllime të ndryshme të postimeve të kodeve të dëshme si formë e terrorizmit kompjuterik. Megjithatë, qëllimi që kanë këto sulme mund të mësohet, në njëfarë mënyre, nga karakteristikat teknike me të cilat kryhen, ashtu si dhe nga identiteti i caktuar ku drejtohen. Për shembull, qëllimi i sulmeve të kryera pak kohë para vizitës së kancelares gjermane në Kinë, ishte zbulimi i të dhënave mbi atë që donte të diskutonte Merkel me zyrtarët e lartë kinezë. Shërbimet e fshehta gjermane vërejtën një rritje të ndjeshme të sulmeve kompjuterike para takimit të Angela Merkel me Dalai Lamën. Ekspertët kanë arritur në përfundim se këta hakerë për të cilët po flasim ishin tepër aktivë në çdo gjë që kishte të bënte me Tibetin. Në janarin e vitit 2008 shumë zyrtarë gjermanë morën një postë elektronike e cila kishte të bashkëngjitur dokumentin me titull: “Analiza të Qeverisë kineze në lidhje me Tibetin”. Në pamje të parë dukej se atë e kishte dërguar një organizatë tibetiane në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në analizë ishte fshehur një program piratërie.

Hans Elmar Remberg,<sup>54</sup> numri dy i agjencisë së shërbimeve të fshehta brenda vendit në Gjermani, tha në një intervistë dhënë për rrjetin televiziv WDR se agjentët e tij kishin arritur në përfundimin se sulmet vinin “nga burime kineze” dhe se pas tentativave qëndronin “punonjës të qeverisë ose së paku njerëz që punonin për llogari të qeverisë kineze”. Edhe ekspertët e vendeve të tjera që iu vunë pas gjurmëve të “Ghostnet”-it arritën në përfundimin se pjesa më e madhe e sulmeve bëhej nga serverët me vendndodhje në Kinë. Gjithsesi, u treguan të kujdesshëm dhe vërejtën se nuk kishte prova të mjaftueshme për të vërtetuar përfshirjen e qeverisë kineze në këtë aktivitet spiunazhi. Është vështirë t’i identifikosh fajtorët e vërtetë në internet, pasi edhe serverët e kontrollit mund të bëhen pre e sulmeve dhe të kontrollohen nga hakerët nga një largësi.

Dihet që agjencitë e shërbimeve të fshehta kineze, si dhe forcat e armatosura të këtij vendi, kanë qenë aktive në spiunazhin kibernetik që në fundin e viteve nëntëdhjetë. Kina mburret, gjithashtu, edhe për një komunitet të hakerëve me motive patriotike dhe tepër të aftë, të cilët hyjnë e dalin vite me radhë në web-faqet e huaja të internetit. Kina e kontrollon në mënyrë shumë të përpiktë internetin brenda kufijve të vet më shumë se çdo shtet tjetër në botë, por qeveria ka lejuar hakerët kinezë të bëjnë ç’të duan me faqet e huaja. Ndoshta nuk

---

<sup>54</sup> Bogdan Popa, “Germany Attacks China for Starting the Cyber War!” <http://news.softpedia.com/news/Germany-Attacks-China-For-Starting-The-Cyber-War-68994.shtml>, accessed on June 18, 2013.

është aspak rastësi që vetëm tri ditë pasi zbulimi i “Ghostnet”-it zuri web-faqet e para të shtypit botëror, u ndie i detyruar të deklaronte se edhe ai vetë ishte bërë pre e sulmeve të tilla. Hakerë nga Tajvani kishin mundur të hynin në një kompjuter të Këshillit të Shtetit Kinez duke shtënë në dorë disa raporte të rëndësishme qeveritare. Kryeministri “ishte tmerrësisht nervoz” për atë ngjarje, raportonte një e përditshme kineze.<sup>55</sup>

Në përfundim, terrorizmi kibernetik është padyshim një fenomen i vazhdueshëm. Si i tillë, ai duhet të merret seriozisht nga të gjitha palët e interesuara kryesore, qoftë nga sektori i IT-së, OJQ-të, apo qeveritë në mbarë botën. Megjithatë, pikëpamja jonë është se në luftën kundër terrorizmit kibernetik pikësëpari duhet të ketë një vullnet të mirë politik. Siç mund të shihet nga incidentet e ndryshme terroriste kibernetike, krijohet përshtypja se situata e tillë e zyrtë është krijuar me përfshirjen e politikës apo qeverive. Pra, duket se forcë lëvizëse prapa shumicës se incidenteve kompjuterike terroriste janë politikanët e nivelit të lartë dhe qeveritë. Ndoshta e gjithë kjo është duke u bërë për të qenë një hap përpara njëri-tjetrit në fushën e teknologjisë së lartë. Kështu, për ta trajtuar këtë çështje në mënyrë sa më të mirë, pikënisja duhet të jetë nga lartë-poshtë (top-down), do të thotë se një vullnet i mirë politik është komponent thelbësor për një zgjidhje më të mirë dhe kjo është ajo çfarë duhet të vihet në pah parasëgjithash. Në praktikë, nuk duken reale konkludimet se po luftohet terrorizmi kibernetik, duke e ditur faktin se hackerët inkurajohen qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në kryerjen e akteve terroriste kibernetike siç është dërgimi i viruseve në posta elektronike.

## **E ardhmja e terrorizmit kibernetik**

Bota e teknologjisë është duke rritur përdorimin e rrjeteve kompjuterike dhe ne duhet të ecim në hap me te, por duhet të jemi të vetëdijshëm për rreziqet që paraqet terrorizmi kibernetik. Është me rëndësi të mbahet në mend se "brezi i ardhshëm i terroristëve tani është duke u rritur në një botë digjitale në të cilën mjetet e hakerimit do të jenë sigurisht më të fuqishme, më të thjeshta për t'u përdorur dhe më të lehta për t'u qasur."<sup>56</sup> Për hir të të kuptuarit të së ardhmes së terrorizmit kibernetik është e dobishme të përmendim edhe një

---

<sup>55</sup> <http://www.gazeta-shqip.com/ndryshe/1d923b2abdf6ec5f3efddb00ef1f30f.html>

<sup>56</sup> Weimann Gabriel, *Terror on the Internet: the new arena, the new challenges*. Washington, D.C.: United States Institute of Peace Press, fq 170.

studim të Grupit Monterey, i cili prezanton tri nivele të aftësive të terrorizmit përmes kompjuterit<sup>57</sup>

*Grupi i parë* është i thjeshtë dhe i pastrukturuar: ka aftësinë themelore për të kryer hakerizëm kundër sistemeve individuale duke përdorur mjete dhe programe të krijuara nga dikush tjetër. Organizata e grupit të parë ka pak objektiva, ka pak komanda dhe kontrole por anëtarët e saj kanë aftësinë e të mësuarit.

*Grupi i dytë* është grup i përparuar dhe i strukturuar: ka aftësi për të kryer sulme më të sofistikuar kundër sistemeve apo rrjeteve të shumta dhe mundësi për të modifikuar ose krijuar mjete themelore të avancuara. Organizata ka një objektiv elementar, ka grupin e analizave dhe kontrollin e komandës, dhe aftësi të të mësuarit.

*Grupi i tretë* është kompleks dhe shumë i bashkërenditur: ka aftësi për të kryer sulme të bashkërenditura dhe për të shkaktuar përçarje në masë kundër mbrojtësve të integruar heterogjenë (duke përfshirë kriptografinë). Organizata ka aftësi për të krijuar mjete të avancuara dhe shumë të sofistikuar. Ai bën një analizë shumë të aftë dhe synon ta ketë kontrollin e komandave, ka aftësi të shkëlqyera të organizimit dhe të mësuarit. Hulumtime të shumta përcaktojnë gjithashtu se grupe të hakerëve janë psikikisht të përgatitura dhe kanë organizim të përshtatshëm për terrorizëm kompjuterik dhe se do të ishte kundër interesave të tyre për të shkaktuar shkatërrim në masë të infrastrukturës së informacionit. Në këtë kohë, terroristët kompjuterikë nuk duket se paraqesin një kërcënim të pashmangshëm.<sup>58</sup>

Nëse dihet sa është lehtë të arrihen mjete dhe aftësi të nevojshme për të kryer një sulm, atëherë duhet të kihet parasysh kërcënimi i vërtetë që terrorizmi kibernetik përbën për sigurinë tonë kombëtare. Rrjedhimisht, "mund të vërtetohet se armë e zgjedhjes për terroristët në të ardhmen mund të jetë më parë bomba elektronike sesa ajo konvencionale."<sup>59</sup> Pritet që "kërcënimi i terrorizmit kibernetik në të ardhmen të duket shumë më ogurzi ... sepse

---

<sup>57</sup> Dorothy E. Denning is Professor of Computer Science at Georgetown University. She has been working on cyberspace security issues and technologies for almost thirty years and is author of *Information Warfare and Security* and numerous other books and articles. She has received the National Computer Systems Security Award and the Distinguished Lecture in Computer Security Award, and in April was named TechnoSecurity Professional of the Year. She received the Ph.D. degree in computer science from Purdue University.

<sup>58</sup> Ibid.

<sup>59</sup> Hodge C. Carl, *CR defining European security*. *Garland reference library of social science*, v. 1154. New York: Garland 1999, faqe. 105.



terroristët kibernetik kanë epërsinë për të sulmuar pothuajse nga kudo, vetvetiu, me një shpenzim minimal, pa rrezikun e dëmtimit, dhe me rrezik të kufizuar të zbulimit."<sup>60</sup>

Shumë studiues besojnë se ky është një kërcënim real dhe duhet të trajtohet me shumë kujdes siç sygjeron Barry Collins, analist hulumtues në Institutin për Inteligjencë dhe Siguri, "terrorizmi kibernetik ... është një term i gabuar, sepse pasojat nuk janë të kufizuara për botën e internetit, por ndodhin edhe në botën fizike."<sup>61</sup> Ai thekson më tutje se, "në qoftë se nuk jemi gati kur të bashkohen bota virtuale dhe fizike, atëherë e tërë ajo që do të mbetet është terrori."<sup>62</sup>

Historikisht, terrorizmi është karakterizuar nga aktet e dhunës të kryera me qëllim për të shkaktuar panikë dhe frikë. Por, fytyra e terrorizmit po ndryshon me terrorizmin kibernetik. Derisa motivet mbeten të njëjta, tani ballafaqohemi me armë të reja dhe të panjohura.<sup>63</sup> Frank Cilluffo, nga Zyra për Siguri Kombëtare deklaroi, "derisa Bin Laden mund të ketë gishtin e tij në këmbë, nipërit e mbesat e tij mund t'i kenë gishtërinjtë e tyre në miun kompjuterik."<sup>64</sup> Dalja në pah nga kërcënimi i terrorizmit kibernetik është duke u rritur shpejt dhe dita-ditës po bëhet kërcënim më përmasa botërore. Prandaj, nuk mund të rrimë duarkryq dhe t'i shpërfillim mundësitë e një sulmi kompjuterik prej hakerëve. Së këtejmi, ka gjasa që "mundësia e kërcënimit nga një krim kompjuterik të bashkërenditur do të rritet në të ardhmen... si dhe sulmet e terrorizmit kompjuterik do të bëhen gjithnjë e më të zakonshme."<sup>65</sup>

Nëse dështojmë të përgatitemi për këtë të ardhme të pashmangshme, në të vërtetë u krijojmë terroristëve hapësirë për t'i arritur qëllimet e tyre. Andaj, duhet ta kemi parasysh mundësinë që terroristët nesër mund të jenë në gjendje të bëjnë më shumë me një tastierë sesa me një bombë.<sup>66</sup> Shtetet e Bashkuara kanë nevojë për një plan të trajtimit të terrorizmit kibernetik. Duhet të bëhen përpjekje dhe të ndërmerren masa parandaluese në SHBA.

Strategjia për terrorizmin kibernetik duhet të jetë e dyanshme. Së pari, duhet pasur një qasje proaktive për parashikimin e ngjarjeve të ardhshme dhe duhet bërë përpjekje për t'i shmangur ato. Mënyra më e mirë për t'u marrë me një sulm është të jemi të përgatitur dhe ta parandalojmë atë që të mos ndodhë në rend të parë. Së dyti, duhet pasur, po ashtu, një qasje

---

<sup>60</sup> Purpura, P. Philip, *Terrorism and homeland security: an introduction with applications. The Butterworth-Heinemann homeland security series.* Amsterdam, Butterworth-Heinemann, 2007, p. 61.

<sup>61</sup> USA Department of Justice, op.cit.

<sup>62</sup> (<http://afgen.com/terrorism1.html>).

<sup>63</sup> (<http://afgen.com/terrorism1.html>).

<sup>64</sup> Espionage Report, op.cit.

<sup>65</sup> Wilson Clay, "Computer attack and cyber terrorism vulnerabilities and policy issues for Congress. Washington", D.C, Congressional Research Service, Library of Congress, 2005, fq. 22.

<sup>66</sup> Arquilla J, & Ronfeldt D, "Networks and net wars: the future of terror, crime, and militancy". Santa Monica, CA: Rand. Code of Federal Regulations Title 28 Section 0.85 Set. (2007). Government Inst. 200, fq.82.

reaktive e cila merret me përgjigje të një ngjarjeje si rezultat i terrorizmit kibernetik . Kjo përfshin identifikimin dhe reagimin ndaj një sulmi.

Në përpjekje për parandalimin e terrorizmit kibernetik një qasje proaktive për të siguruar infrastrukturën globale të informatave mund të ndihmojë në parandalimin e katastrofave në të ardhmen.<sup>67</sup> Ne duhet t'i njohim dobësitë tona dhe t'i eliminojmë ato para se të keqpërdoren nga terroristët në internet. Infrastruktura thelbësore duhet të sigurohet, por pa e lënë anash sigurimin e rrjetit të kompjuterëve që kontrollojnë infrastrukturën kompjuterike në tërësi. Domosdoshmërinë për sigurimin e rrjetit të kompjuterëve nuk e kuptojnë vetëm agjencitë qeveritare, por edhe sektori privat që ka bazë më të rëndësishme të të dhënave. Qasja ilegale në këto rrjete mund të jetë katastrofike. Një qasje proaktive duhet të ripërtërihet rregullisht dhe të jetë një hap para atyre të cilëve u është disenjuar për t'u mbrojtur. Masat e sigurisë duhet të hulumtohen dhe të zbulohen vazhdimisht për një trajtim sa më serioz të kërcënimeve të padukshme kundër Shteteve të Bashkuara.

Sulmet e terrorizmit kibernetik do të shtohen në një të ardhme të afërt dhe, sipas të gjitha gjasave, do t'i synojnë objektet e SHBA-së, sikurse edhe qendrat e infrastrukturës dhe të organizatave joqeveritare siç janë agjencitë bëmirëse etj.<sup>68</sup> Kur këto sulme ndodhin ne duhet të jemi të përgatitur.

Thënë shkurt, kundërpërgjigjja ndaj sulmeve është një qasje reaktive. Në rrethana të tilla duhet të jenë në fuqi standardet kundër terrorizmit kibernetik. Gatishmëria jonë si dhe kundërpërgjigjja ndaj këtyre sulmeve duhet të planifikohen më herët dhe duhet të jemi në gjendje ta zbulojmë e pastaj të këndellemi nga çdo tentim ilegal për të pasur qasje në rrjetin e kompjuterëve. Një strategji e suksesshme reaktive do të zbulonte dhe reagonte në lidhje me ngjarjet në internet dhe do ta bashkërendonte sigurinë kompjuterike si dhe reagimin ndaj incidenteve me partnerët lokalë, privatë si dhe me partnerët ndërkombëtarë.<sup>69</sup>

---

<sup>67</sup> Colarik M Andrew, *Cyber terrorism Political and economic implications*, Hershey, PA: Idea Group Pub.

<sup>68</sup> 2006, (<http://www.israel21c.org/bin/en.jsp?enScript=PrintVersion.jsp&enDispWho=Articles^140>).

<sup>69</sup> Shih: ([http://www.pcworld.com/article/111066/homeland\\_security\\_to\\_oversee\\_cybersecurity.html](http://www.pcworld.com/article/111066/homeland_security_to_oversee_cybersecurity.html)).

**Dr.Sc. Enver GËRGURI**

**KDU**

**327(4/9)**

## **A ËSHTË BASHKIMI EUROPIAN NË KRIZË PAS BREXIT ?**

### ***Abstrakti***

*Ky punim siguron të dhëna të cilat tregojnë në lidhje me rolin e daljes së Mbretërisë së Bashkuar nga Bashkësia Evropiane. Duke analizuar problematikat që lindin nga kjo temë, une kam synuar që të paraqes a do ket krizë në BE apo jo pas daljes së MB.*

*Në këtë punim jam përpjekur që të shtrojë problematikat që vijë nga mënyrat e paraqitjes së kërkesës për dalje deri te menaxhimi i referendumit në MB si dhe rezultatet e atij referndumi .*

*Të dhënat e paraqitura në këtë punim na japin një informacion se si ka rrjedhë procedura e largimit të MB nga BE dhe si do jetë MB pas daljes nga familja e BE-së.*

*Në fillim të këtijë punimi kam parqitur çfarë është BREXIT dhe a do jetë BE në krizë pas kësaj pune , poashtu kam paraqitur se kush janë kundërshtarët e BREXIT , cilët janë argumentet kryesore pro dhe kundër BREXIT si dhe mendimi dhe rekomandimi i Mretreshës.*

**Fjalë kyçe : BE (Bashkimi Evropian) , MB (Mbretëria e Bashkuar)**

## **IS THE EUROPEAN UNION IN CRISIS AFTER BREXIT?**

### **Abstract**

*This paper provides data on the role of the UK's exit from the European Union. Analyzing the problems that arise from this topic, I aimed to present whether there will be a crisis in the EU or not after the UK exit.*

*In this paper I have tried to raise the issues that come from the ways of submitting the request for exit to the management of the referendum in the UK and the results of that referendum.*

*The data presented in this paper provide us with information on the UK withdrawal procedure from the EU proceeded and how the UK will be after leaving the EU family.*

*At the beginning of this paper I presented what BREXIT is and whether the EU will be in crisis after this. I have also presented who the opponents of BREXIT are, the main arguments for and against BREX and the opinion and recommendation of the Queen.*

**Keywords: EU (European Union), UK (United Kingdom).**

## **HYRJE**

Bashkimi Evropian (shkurtesa shqip: BE, zyrtarisht: EU) është një bashkësi e disa shteteve Evropiane e themeluar me qëllim të lirisë së qarkullimit të mallrave, shërbimeve, njerzve dhe kaplitalit. Në fillim të themelimit BE përbëhej nga një numër i vogël shtetesh. Me rënien e Bashkimit Sovjetik, u bë paraqitja e kërkesave për anëtarësim nga shtete ish-komuniste. Tani BE ka gjithësejt shtatë runde zgjerimi dhe pas kërkesës për dalje të Britanisë së Madhe nga BE këtë vit, kjo strukturë gjeopolitike tani ka 27 shtete anëtarë me të drejta të plota. Prandaj pikërisht daljen e Britanisë së Madhe nga BE do ta shqyrëtojmë në kontekstin e krizave ndërkombëtare. Cilat janë shkaqet dhe cilat mundë të jenë pasojat nga ky veprim i Mbretërisë së Bashkuar, dhe si do të reflektojë e tërë kjo në mardhënjet ndërkombëtare, do të mundohemi që të gjejmë një përgjigje duke e bërë një analizë të ngjarjeve dhe rrethanave, të cilat sollën deri në këtë gjendje.

## **Çfarë është Brexit?**

Qytetarët britanikët votuanë me referendum për qëndrimin ose jo të Mbretërisë së Bashkuar në BE. Referendumi, pyetja e të cilit ishte: “A duhet Mbretëria e Bashkuar të mbetet anëtare e Bashkimit European apo duhet ta lërë Bashkimin European?”, është zhvilluar me datë 23 qershor të këtij viti, por shqetësimet dhe dilemat kanë kohë që i kanë prekur si institucionet e BE-së ashtu edhe ato britanike. Edhe pse të gjithë flasin për të, për shumë akterë dhe individë mungon informacioni i plotë ndaj këtij procesi dhe një analizë e situatave çfarë mund të ndodhë nëse Britania del nga BE, në dimensionet e saj ekonomike, shoqërore dhe politike si dhe si do të ndikojë kjo më pas në të gjithë arenën ndërkombëtare dhe marrëdhëniet strategjike mes Europës - Britanisë së Madhe dhe akterëve të tretë.

Fillimisht është me rëndësi të bëhet një përshkrim më i qartë dhe i plotë se çfarë është Brexit dhe çfarë nënkupton ai?

Ndikuar nga frika e daljes së Greqisë nga BE që u cilësua si Grexit (kombinim i emrit Greqi me Exit), shumë shpejt ky kombinim u përdor edhe për Britaninë e Madhe, kur u shpall nga kryeministri që një referendum do të zhvillohej për të vendosur qëndrimin ose jo të Britanisë në BE. Ndërkohë që shumë akterë politikë, parti politike dhe individë janë pro-Brexit, pjesa tjetër bën pjesë në grupin e atyre që duan të mbeten pjesë e unionit që sot njihet me termin Bremain (Britain + remain (qëndro)).

Sipas një raporti të publikuar nga qeveria britanike në shkurt të këtij viti “mbi procesin e tërheqjes nga BE”, nëse në referendum do të votohet për daljen nga BE atëherë do të vendoset në zbatim Neni 50 i Traktatit të Lisbonës<sup>70</sup>, që do të nënkuptonte dhe përdorimin për herë të parë të këtij neni. Sipas këtij neni “Çdo shtet anëtar mund të zgjedhë të tërhiqet nga Unioni në përputhje me kërkesat e tij kushtetuese.” Por procesi vazhdon me negociatat me vendet e tjera anëtare të BE-së, mbi kushtet e tërheqjes dhe brenda dy viteve vendi duhet që të ketë arritur një marrëveshje me BE-në. Duke qenë që rasti i Brexit do të ishte hera e parë që ky proces do të vendosej në zbatim, askush nuk mund ta parashikojë nëse dy vjet janë një periudhë e mjaftueshme për të arritur marrëveshjen. Shumë ekspertë britanikë kanë filluar të shqetësohen për faktin që kjo çështje është shumë komplekse dhe e vështirë të përmbillet brenda periudhës së përcaktuar nga ligji.

Tani mund të shtrohet pyetja: “Çfarë ndodh me Britaninë e Madhe nëse nuk arrin dot marrëveshjen brenda afatit?”

---

<sup>70</sup> **Traktati i Lisbonës** - Traktati i Lisbonës është marrëveshje ndërkombëtare në mes të 27 shteteve anëtare të Bashkimit European i cili u nënshkrua më 13 dhjetor 2007 dhe me 01 dhjetor 2009 hyri në fuqi. Traktati i Lisbonës i cakton qëllimet e Bashkimit European dhe vlerat e tij si paqen, demokracinë, respektimin e të drejtave të njeriut, drejtësinë, barazinë, ushtrimin e ligjit dhe qëndrueshmërinë.

Janë dy mundësi: bisedime të tjera për zgjatjen e afatit ose dalje nga BE pa asnjë privilegj apo trajtim special, pa asnjë mbrojtje nga ligji i BE-së për bizneset dhe tregtinë, pa privilegje për qytetarët e Britanisë për të jetuar dhe punuar në Europë, apo për të udhëtuar lirshëm dhe pa viza. Këto të drejta mund t'i humbasin rreth 2 milion qytetarë britanikë që jetojnë, punojnë dhe udhëtojnë në vendet anëtare të Unionit, gjithashtu ata humbasin aksesin ndaj shërbimeve shëndetësore, pensioneve apo shërbime të tjera publike në këto vende.

Dhe nëse Britania arrin ti sigurojë nga marrëveshja këto të drejta, me shumë mundësi duhet që të bëjë të njëjtën gjë për qytetarët europianë që jetojnë dhe punojnë në MB<sup>71</sup>. Por nëse kjo ndodh, bie poshtë një nga arsyet kryesore të mbështetësve të Brexit, se pse atëherë duan të dalin nga BE`ja?!

Por a është referendumi i pakundërshtueshëm dhe i pakthyeshëm?

Edhe pse në mënyrë racionale asnjë parti politike apo deputet nuk do të kishte guxim të dilte kundër vullnetit të popullit, pasi do të ishte një vetëvrasje politike, sipas BBC, deputetët e kanë aftësinë ta bllokojnë daljen nga BE, pasi rezultati i referendumit nuk është i detyrueshëm ligjërisht. Gjithashtu, kjo marrëveshje duhet të ratifikohet nga Parlamenti dhe mund të ndodhë që të votohet kundër si nga Shtëpia e Lordëve, ashtu edhe nga Dhoma e Ulët. Një skenar që do të ndalonte daljen e MB nga BE sipas BBC është nëse pas rezultatit të referendumit do të zhvilloheshin zgjedhjet e përgjithshme, dhe ato do të fitoheshin nga partitë politike që kanë bërë fushatë pro qëndrimit të Britanisë. Vetëm atëherë mund të justifikohet kundërshtimi i rezultateve të referendumit, me arsyetimin që zgjedhjet parlamentare prevalojnë ndaj tij.

### **Cilët janë mbështetësit dhe kundërshtarët e Brexit?**

Sipas BBC, sondazhet tregojnë që publiku është i ndarë pothuaj përgjysmë për sa i përket çështjes së daljes nga BE, dhe për sa i përket partive dhe akterëve të tjerë politikë, Partia e Pavarësisë në Mbretërinë e Bashkuar (UKIP), është mbështetësja më e fortë e Brexit duke bërë një fushatë aktive. Shumica e deputetëve konservatorë janë gjithashtu pro daljes nga BE, por nuk mungojnë edhe deputetë laburistë dhe pesë ministra të kabinetit qeveritar, përcillet informacioni nga BBC.

---

<sup>71</sup> MB - Mbretëria e Bashkuar  
Sipas blogut **Debating Europe**<sup>71</sup>,

## **Argumentet kryesore pro BREXIT janë:**

**1. Ekonomia.** Është më e thjeshtë për Britaninë të nënshkruajë marrëveshje ekonomike dhe tregtare me vendet e tjera si një aktor i vetëm dhe i pavarur. Dalja nga BE do t'i lehtësonte procedurat e negociatave me vende si Kina apo Rusia për të vendosur marrëveshje, duke u bazuar vetëm në interesin kombëtar britanik. Nga ana tjetër vendi do të çlirohej nga barra për të kontribuar në buxhetin e Unionit, dhe kjo do të lehtësonte taksapaguesit duke bërë që Britania të kursente çdo ditë 20 milion £. Bizneset e vogla, fermerët dhe peshkatarët do të liroheshin një herë e mirë nga kontrollet dhe politika burokratike e Brukselit.

**2. Liria politike dhe qeverisëse.** Britania e Madhe cilësohet si nëna e demokracive parlamentare, dhe për mbështetësit e Brexit vendimmarrja e BE-së dhe vendimet e një Komisioni të pazgjedhur nga populli, thjesht i cenon autonominë dhe lirinë për të vendosur vetë për çështje me rëndësi për vendin. Gjithashtu ata theksojnë që demokracia e BE-së lë shumë për të dëshiruar pasi ajo nuk i përfshin njerëzit në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke rritur zhgënjimin dhe mosinteresimin e tyre ndaj këtyre institucioneve dhe duke ulur legjitimitetin e tyre.

**3. Kontroll i plotë i kufijve.** Individë nga vende të tjera të BE-së më pak të zhvilluara si vendet e Europës Lindore, e kanë shfrytëzuar lëvizjen e lirë si një mundësi për të emigruar në Britani dhe për të jetuar atje. Polakët janë grupi më i madh i imigrantëve në Britani të Madhe dhe për mbështetësit e Brexit kjo është shqetësuese për ekonominë, shërbimet sociale dhe politikën britanike. Nuk është e drejtë nga ana tjetër që numri i atyre që vijnë në Britani, e kalon numrin e shtetasve britanikë që shkojnë të jetojnë dhe punojnë në vendet e tjera të BE-së. Problemi tjetër mbeten edhe imigrantët e paligjshëm dhe terroristët që e kanë më të thjeshtë të vijnë në Britani, edhe pse Britania nuk është në Schengen. Me daljen nga BE vendi merr kontrollin e plotë të kufijve, dhe mund të vendosë për kushtet dhe pranimin e të huajve dhe refugjatëve në territorin e tij.

David Cameron, Kryeministri britanik kërkon që Mbretëria e Bashkuar të mbetet pjesë e Bashkimit Europian, dhe ai mbështetet nga 16 ministra të tjerë të qeverisë. Partia Laburiste gjithashtu është deklaruar se është pro qëndrimit në BE. Dhe përveç politikanëve, edhe bizneset e mëdha e mbështesin këtë qasje, pasi të qenurit pjesë e ekonomisë së BE-së, nënkupton lehtësi për lëvizjen e parave, njerëzve dhe prodhimeve kudo në botë.

## Argumentet kryesore kundër BREXIT janë:

**1. Ekonomia.** Në një kohë që Britania e Madhe njihet për ofrimin e shërbimeve, marrëveshjet e tregtisë së lirë nuk do ta ndihmonin shumë për t'i shitur ato në vende të tjera, pasi në këtë rast kërkohet një legjislacion i detajuar dhe institucione specifike për zbatimin e tij. Shërbimi shëndetësor apo ai financiar, nuk mund të shitet në vende të tjera. Për Britaninë është i nevojshëm kuadri institucional dhe ligjor i tregut unik të BE-së pasi dhe fokusi i zhvillimit të saj ekonomik janë shërbimet, dhe jo mallrat. Shkëputja do të rëndonte ekonominë britanike ku për çdo vit tregtia me BE-në i sjell një fitim për 400 bilion £, sipas Debating Europe<sup>72</sup>. Nga ana tjetër Brexit mund të ulë PBB britanike me 10% dhe 1 në dhjetë shtetas britanikë ka një punë të lidhur drejtpërdrejtë me BE-në. Nga ana tjetër BE mbetet një aktor i madh ekonomik, një negociues dhe një zbatues i ligjit ndërkombëtar, kështu largimi nga ky aktor mund të jetë me shumë rrezik për ekonominë dhe zhvillimin e Mbretërisë së Bashkuar.

**2. Siguria.** Kohët janë bërë të vështira dhe aspak të sigurta, me terrorizmin, krizën e refugjatëve dhe shtetet nukleare nuk do të ishte një lëvizje zgjuar të këpusje lidhjet dhe marrëdhëniet me një aktor strategjik dhe të fuqishëm si BE. Britania e Madhe është më e fuqishme nëse do të bashkëpunojë me vende të tjera të Unionit si Gjermania apo Franca pasi e vetme ajo do të dobësohej dhe do të dobësonte si BE-në, ashtu edhe NATO-n duke rritur pasigurinë globale.

**3. Lëvizja e Lirë.** Nëse Britania lë BE-në atëherë ajo nuk do të jetë më pjesë e zonës së tregtisë së lirë, tarifa të reja dhe kontrole për lëvizshmërinë e mallrave, individëve dhe shërbimeve do të vendosen. Qytetarët britanikë që jetojnë dhe punojnë në BE do të kenë probleme për sigurimin e shërbimeve të tyre shëndetësore, pensionet dhe punësimin nëse Brexit ndodh. Kjo do të vështirësojë dhe do t'i kushtojë shumë Britanisë së Madhe dhe 2 milion qytetarëve britanikë që aktualisht jetojnë në BE.

## Cili ishte qëndrimi i Mbretëreshës

---

<sup>72</sup> **Debating Europe** - Është një faqe interaktive interneti në të cilën zhvillohen debate të ndryshme në mes të qytetarëve të BE dhe politikanëve europian,ku drejtpërdrejt mund të dërgohen pyetjet e qytetarëve dhe politikëbërësit dhe ekspertët europian u përgjigjen atyre.



Gazeta 'The Sun' nxori në faqe të parë titullin: "Mbretëresha mbështet Brexit", duke e justifikuar që dy burime mjaft të sigurta e verifikonin këtë qëndrim. Ndërkohë që ky titull bëri bujë në Britani dhe më gjerë, ai solli pakënaqësi në Pallatin Mbretëror duke e cilësuar këtë histori si të pakuptimtë dhe që sjell shumë probleme për një institucion neutral dhe që qëndron mbi çdo palë politike. Zëdhënësi i Pallatit Buckingham, gjithashtu deklaroi që një ankesë ndaj gazetës "The Sun" është bërë tashmë pranë Organizatës së Standardeve të Shtypit të Pavarur. Për sa i përket përfaqësuesve të gazetës ata e justifikojnë këtë veprim duke theksuar se nëse mbretëresha ka një pikëpamje ndaj Brexit, atëherë votuesit kanë të drejtë ta dinë. Por ekspertë të tjerë nuk e pranojnë këtë gjë duke theksuar, që Mbretëresha gjithmonë ka qenë neutrale dhe e kujdesshme në deklaratat e saj për të qenë gjithmonë jashtë palëve partiake dhe mbi interesin e vetë kombit.

### **Tre skenarët financiarë nëse ndodh Brexit**

Financial Times që i ka dhënë një fokus të veçantë daljes së Mbretërisë së Bashkuar nga BE, në nja nga artikujt e tij analizon skenarët që mund të realizohen për ekonominë e ishullit nëse Brexit ndodh. Këto skenarë të shoqëruar me analiza nga ekspertë dhe specialistë të ekonomisë, japin tre pikëpamje të ndryshme me tipare pozitive, realiste apo pesimiste për të ardhmen ekonomike të një Britanie jo më shtet anëtar i BE-së.

#### **1. Një Britani në zhvillim**

Pikëpamja pozitiviste parashikon një vend të zhvilluar dhe të begatë për popullin në një periudhë afatmesme. Kjo do të ndodhë vetëm nëse Britania e Madhe plotëson katër kushte:

a) duhen rregulluar ligjet për të mbushur boshllëqet nga ligji i BE-së b) për të marrë kontrollin e kufijve të tij duhet të ndryshojë politikat e migracionit, c) duhet të nënshkruajë marrëveshje me BE-në dhe vende të tjera si SHBA, Kinë, Japoni apo Australi, në mënyrë urgjente dhe d) duhet të ruajë shumën e parave që i transferonte buxhetit të BE-së të paprekur. Por përfaqësuesit e këtij skenari parashikojnë që nëse Mbretëria e Bashkuar çlirohet nga mentaliteti proteksionist i BE-së dhe vendos tregtinë e lirë shumë shpejt ekonomia e saj do të lulëzojë, pasi sipas tyre influenca e BE-së nuk po e lejon atë të marrë të gjithë potencialin ekonomik dhe avantazhin që i ofron bashkëpunimi ekonomik me pjesën tjetër të botës.

## **2. Tranzicion me turbullira**

Sipas këtij skenari disi më realist, dalja nga BE do të sjellë një shqetësim në jetën ekonomike të vendit, por pas kësaj tronditjeje më vonë situata nuk do të ketë ndonjë ndryshim të madh nëse është brenda apo jashtë BE-së. Sipas kësaj qasjeje, marrëdhëniet ekonomike me BE-në nuk do të sjellin shqetësime të mëdha për ekonominë britanike, e cila shumë shpejt mund të krijojë marrëdhënie me vende të tjera. Për zhvillimin ekonomik ka dhe elemente të tjera që ndikojnë përveç tregtisë, dhe që mbeten të pandryshuar nëse ndodh apo jo Brexit siç janë investimet, aftësitë, konkurrenca, sipërmarrja dhe inovacioni. Por dalja nga unioni sigurisht që do të sjellë pasiguri në ekonominë britanike duke krijuar një periudhë të paqëndrueshme, me investime të pakta dhe rrezik të zhvlerësimit të paundit. Por kjo vetëm në një periudhë afatshkurtër. Shumë shpejt ekonomia britanike do të rigjallërohet me vendosjen e marrëdhënieve dhe marrëveshjeve të reja. Shembuj të tillë janë Norvegjia apo Zvicra. Kriza më shumë se ekonomike mund të jetë burokratike, shprehen disa nga ekspertët e ekonomisë të pyetur nga Financial Times.

## **3. Vendim shkatërrimtar**

Pikëpamja pesimiste parashikon që ekonomia britanike do vuajë shumë nëse Brexit ndodh dhe nuk do të ketë mundësi të përfitojë nga asnjë vend tjetër. Gjithashtu parashikohet që Britania do e ketë të vështirë të nënshkruajë marrëveshje tregtie të mira me vendet e tjera, investimi i huaj do të ulet shumë, nuk do të përmirësohen rregullat për ekonominë dhe do të ketë më pak imigrantë sa janë të nevojshëm për forcë pune në vend. Një nga mbështetëset e kësaj qasjeje, znj. Rebecca Driver, konsultuese e Analytically Driven thekson se një marrëveshje e tregtisë së lirë nuk është njësoj me tregun e vetëm, pasi rregullat që duhen plotësuar janë të shumta dhe mund të shkojnë deri në 200 faqe vetëm për një produkt dhe kjo mund të jetë shkatërrimtare për bizneset e vogla apo të mesme. Gjithashtu marrëveshjet me GBR pas Brexit nuk do të jenë dhe aq të lehta. Nëse SHBA duhet të vendosë mes MB dhe BE-së të gjithë e dimë mirë se kë do të zgjidhte ajo.

## **BREXIT - i dhe Ballkani Perëndimor**

*Brexit-i mund të ketë shkaktuar qëndrime kontraverse mes disa politikanëve dhe analistëve të Ballkanit Perëndimor, por, megjithatë, integrimi në BE mbetet një ndër opsionet më të mira për këtë regjion.*

Referendumi i mbajtur në Mbretërinë e Bashkuar më 23 qershor, nga i cili doli fituese fushata për largim nga BE, ka nxitur deklarata kontraverse mes politikanëve, analistëve dhe ekspertëve politikë në Ballkanin Perëndimor. Përderisa disa parti kanë bërë thirrje hapur që shtetet respektive të bëhen më skeptikë ndaj Europës dhe i janë referuar Bashkimit European si një projekt i dështuar, qëndrimi i përgjithshëm mbetet se e ardhmja e të dyjave, Kosovës dhe Serbisë, është në Bashkimin European. Në anën tjetër, ekspertë të marrëdhënieve ndërkombëtare janë më të shqetësuar nga shtrirja e mundshme e ndikimit rus në politikën dhe ekonominë në Ballkan.

### **Ndikimi i BREXIT në mardhënjet ndëretnike në shtetet e Ballkanit**

Analisti amerikan Daniel Serwer thotë se Brexit “do t’i hapë derën ndikimit më të madh rus” dhe se Putini definitivisht do të përpiqet për t’i shtyrë këto vende që të mos anëtarësohen në BE (euractiv<sup>73</sup>). Gazetarë të tjerë dhe politikanë po ashtu bënë deklarata politike që thonë se Rusia do të ushtrojë presion në vendet e përmendura me qëllim të rritjes së ndjenjave kundër integritit në BE. Euroskepticizmi do të përbëjë vështirësi, sidomos meqë rajoni i Ballkanit aktualisht po ballafaqohet me shumë probleme si kriza e refugjatëve, radikalizmi, tensionet etnike, etj. Duke e përdorur Brexit-in si arsyetim, partitë e djathta mund t’i shtyjnë agjendat e tyre, të cilat kërkojnë që shtetet e Ballkanit të mos marrin pjesë në përpjekjet e përbashkëta të EU-së, si politikat e përbashkëta që zbatohen nga shtetet e tjera të Bashkimit European. Euroskepticizmi tek qytetarët serbë nuk është diçka e re – anketimi i fundit i Eurobarometrit ka treguar se Serbia është një prej shteteve më euroskeptike në regjion, me 22% të qytetarëve që besojnë se integrimi evropian është negativ për vendin.

Çuditërisht, pak vëmendje i është kushtuar asaj se si qytetarët e Bashkimit European e përceptojnë tani zgjerimin e Bashkimit European, dhe nëse pas Brexit-it është rritur numri i

---

<sup>73</sup> **EurActiv** - Është një platformë e pavarur mediale europiane e specializuar në publikimin online të artikujve që merren me lajme Europiane dhe tema europiane. Ajo është e pranishme në 12 kryeqytetet e BE-së. EurActiv boton artikuj e saj në 12 gjuhë, duke dhënë lajme të një Komuniteti të BE-së akterëve.

atyre që e kundërshtojnë zgjerimin e BE-së. Më herët, në një anketë tjetër të Eurobarometrit<sup>74</sup>, doli se 49% e qytetarëve të Bashkimit Evropian nuk e përkrahnin zgjerimin e mëtejshëm, përderisa vetëm 39% e tyre ishin në favor të zgjerimit të mëtejshëm. Duke marrë parasysh Brexit-in dhe rritjen e përgjithshme të partive të djathta euroskeptike, është po ashtu interesante të hulumtohet nëse këto shifra kanë ndryshuar në favor apo kundër zgjerimit të Bashkimit Evropian. Në disa shtete si Gjermania, Austria apo Finlanda, numri i atyre të cilët e kundërshtojnë zgjerimin e Bashkimit Evropian i afrohet 70% - shit. Pastaj, është akoma e paqartë se si Bashkimi Evropian do të veprojë mëtej në negociatat e anëtarësimit që tashmë kanë filluar me Serbinë apo në procesin e liberalizimit të vizave me Kosovën. Brexit mund t'i vonojë këto bisedime të rëndësishme, që definitivisht do të kishin efekt në marrëdhëniet e BE-së me Ballkanin Perëndimor, por gjithashtu do t'i ngadalësonin proceset e reformës konform legjislacionit të BE-së, që tashmë kanë nisur në disa shtete të Ballkanit si Bosnjë, Serbi dhe Kosovë.

Por sa do t'i lëkundë Brexit marrëdhëniet e BE-së me Ballkanin Perëndimor, sidomos mes BE-së dhe Kosovës, Serbisë dhe Bosnjës? Kjo mbetet të shihet, por tashmë ka sinjale nga liderët e vendeve se e ardhmja e Ballkanit Perëndimor është në BE. Kryeministri i Serbisë, Aleksandar Vučić, deklaroi se ky është “tërmeti më i madh që e ka goditur Europën që nga rënia e murit të Berlinit”, dhe se qeveria e Serbisë nuk do t'i përmbushë kërkesat e partive të ekstremistëve të djathtë për të mbajtur një referendum mbi integrimin në Bashkimin Evropian: “Përgjigja ime është shumë e qartë: nuk do të ketë referendum pavarësisht numrit të iniciativave për këtë” (euractiv). Serbia e zhvillon shumicën e biznesit/tregtisë me Bashkimin Evropian, andaj, nuk mund thjesht ta injorojë integrimin. Veç kësaj, kriza e refugjatëve i ka mbyllur shumë njerëz brenda kufirit serb, dhe kështu Serbia ka mbetur duke kërkuar ndihmë për t'ia dalë këtij fluksi.

Liderët kosovarë përgjithësisht kanë deklaruar se janë të befasuar dhe të “pikëlluar” për ikjen e Britanisë. Do të jetë veçanarisht sfiduese për rrugën e Kosovës drejt integritimit në BE, meqë Mbretëria e Bashkuar ka qenë një ndër mbështetësit më të zëshëm të këtij procesi. Komentet e presidentit aktual të Kosovës, Z. Thaçi, kanë qenë të një linje me ato të liderëve të vendeve të tjera se Brexit mund të vë një precedent të keq dhe se mund të ketë një efekt domino tek shtetet e tjera anëtare, të cilat mund të dëshirojnë ta konsiderojnë pozicionin e tyre pas Brexit-it. Ai madje shkoi edhe më larg duke thënë se “Brexit do ta nxisë

---

<sup>74</sup> **Eurobarometer** - Eurobarometer është një seri e sondazheve të opinionit publik i kryer rregullisht në emër të Komisionit Evropian që nga viti 1973. Këto anketa të trajtuar një shumëllojshmëri të gjerë të çështjeve aktuale që lidhen me Bashkimin Evropian në të gjitha vendet anëtare të BE.

kolapsin e BE-së” dhe se blloku “pa Britaninë do ta humbiste kuptimin”. Sidoqoftë, komenti i tij më kontravers ishte se ai beson se Brexit do të nxisë anëtarët e tjerë të BE-së, që nuk e kanë njohur Kosovën, ta njohin atë. Sidoqoftë, është e paqartë përse mendon ai ashtu, kur të kihet parasysh çështjet e brendshme politike e etnike me të cilat ballafaqohen Spanja, Qipro dhe Greqia - sidomos me ato grupe etnike që vazhdimisht kërkojnë pavarësi apo autonomi.

Si përfundim, Brexit-i mund të ketë shkaktuar qëndrime kontraverse mes disa politikanëve dhe analistëve të Ballkanit Perëndimor, por, megjithatë, integrimi në BE mbetet një ndër opcionet më të mira për këtë regjion. Ballkani Perëndimor ballafaqohet me shumë sfida, përfshirë mosmarrëveshje territoriale, tensione ndëretnike, mospranim të krimeve të luftës, vështirësi në implementimin e marrëveshjeve reciproke të tregtisë (sidomos Kosova dhe Serbia), andaj kërkesat e legjislacionit dhe politikave të BE-së shihen si stabilizues i çështjeve politike dhe financiare brenda regjionit. Shumica e marrëveshjeve tregtare tashmë janë arritur bazuar në modelet e dhëna nga Bashkimi European dhe kjo tregon se interesat dhe aspiratat e vërteta duhet të synojnë të zhvillojnë mëtej lëvizjen e lirë brenda regjionit, por edhe me shtetet e tjera anëtare të Bashkimit European. Së fundmi, lejimi i anëtarësimit të këtyre shteteve në BE pa i shtrënguar edhe më shumë kushtet e pranimit, do t’ia bënte më vështirë Rusisë dhe mbështetësve të saj të ushtrojnë ndikim mbi këtë regjion.

BE nuk i kontrollon dot më krizat

### **Konkluzione dhe Rekomandime**

Kjo krizë është vetëm njëra prej shumë krizave: kriza e refugjatëve, kriza e Grexit<sup>75</sup> dhe kështu me radhë. Që BE si sistem nuk është më në gjendje t’i kontrollojë krizat, këtë e shohim prej kohësh. Kështu që çështja që shtrohet nuk është se a mund të bëjë diçka BE, por a është në vërtetë e gatshme që të mendojë në mënyrë fundamentale për riorganizimin politik dhe demokratik të këtij kontinenti. Kjo do të duhej të ishte detyra e momentit dhe ky është sinjali ose paralajmërimi që na jep Brexiti.

Europa do duhet që urgjentisht të riorganizohet pas daljes së Britanisë së Madhe nga BE, dhe është i kuptueshëm zemërimi i qytetarëve me BE në. Një hap të tillë të braktisjes mund ta ndjekin edhe shtetet tjera anëtare, dhe poqese do të ndodhte një situatë e tillë, atëherë do të vihej në pikëpyetje i tërë koncepti i funksionimit të Bashkimit European. Kjo do të mund të sillte një krizë më afatgjatë në kontinentin European, nga e cila do të mund të përfitonte më

---

<sup>75</sup> **Grexit** - (Greece Exit), është terminologji për daljen e Greqisë nga BE

së shumti Rusia, por dhe një tronditje vështirë të riparueshme në aspektin gjeopolitik dhe në tregjet botërore financiare.

### **Literatura**

\* Ulrike Guérot Drejtuese në Katedrën për Politikën Evropiane dhe Kërkimet Demokratike në Universitetin e Danubit në Krems/ Austri

\* Florian Bieber - Profesor i degës së Historisë dhe Politikës së Europës Juglindore në Universitetin e Gracit dhe Koordinator për Ballkanin për Grupin Këshillues të Politikave Evropiane (BiEPAG)

\* DW Deutsche Welle

**Dr. Sc. Adem SHALA**

**KDU**

**32(496.51)“2008/2019”**

## **CILËSIA QEVERISËSE E INSTITUCIONALE NË KOSOVË 2008-2019**

### ***Abstrati***

*Cilësia institucionale dhe qeverisëse kosovare, paraqet nivelin konsolidues shtetror dhe faktorin esencial ndërveprues në procesin zhvillimor e integruar. Pas pavarësisë së Kosovës 2008, u krijuan parakushtet për qeverisje e organizim institucional më përcaktim kushtetues e ligjor sipas standardeve demokratike dhe të së drejtës ndërkombëtare.*

*Janë arritur suksese konkrete qeverisëse, institucionale e juridike, por kërkohet implementim më efikas, më cilësor e më efektiv i rendit juridik e politik, për të mos lejuar tjetërsimin e qëllimeve e përcaktimeve kushtetuese në procesin qeverisës. Kërkohen efekte të institucioneve kryesore politike: legjislativ, ekzekutiv, gjyqësor e administrativ dhe në*

*raportin reciprok në mes tyre, të ndërlidhura me subjektet e jetës politike parlamentare e qeverisese; kerkohen efekte sipas aspektit kushtetues e implementues në pluralizmin politik e shumpartiak, në zgjedhjet, legjitimitetin, sovranitetin popullor-qytetar e territorial, shoqërinë civile, kulturën politike, mediat, etj, Procesi i qeverisjes është ballafaquar më kushte të pavolitshme: a) nivel të ultë të zhvillimit ekonomik privat; b) vonesë në reformat e tranzicionit; c) mungesë të traditës demokratike plurale; ç) pengesa të jashtme; d) kulturë politike e biznesore të kaluar; dh) përqendrim të pushtetit partiak e grupor, mbi burimet dhe sektoret egzistencial; e) ambient biznesor të papërshtatshem; ë) dukuri negative në institucione; f) mungesë të opozitës së mirëfilltë; etj. Të gjitha këto rrethana ndikuan drejtëpersedrejt në karakteristikat dhe efektet institucionale qeverisese. Njëkohësisht, subjektet politike dhe shoqëria, përmes procesit qeverisës janë të obliguara t'i ndryshojnë e tejkalojnë këto rrethana penguese në favor të krijimit të parakushteve për rritje ekonomike dhe zhvillim të sferave tjera, duke krijuar një ambient të sigurtë e të përshtatshem investues dhe ambient liberal demokratik e integrues.*

***Fjalët kyçe: Qeverisja, Zhvillimi, Siguria, Integrimi, Kosova***

### ***Abstract***

*Kosovo's institutional and governing quality represents the state consolidation level and the essential interactive factor in the development and integration process. After the independence of Kosovo in 2008, the preconditions for governance and institutional organization were created with constitutional and legal provisions according to democratic standards and international law.*

*Concrete governing, institutional and legal successes have been achieved, but more efficient, more qualitative and more effective implementation of the legal and political order is required, in order not to allow the alienation of the goals and constitutional determinations in the governing process. Effects of the main political institutions are required: legislative, executive, judicial and administrative and in the mutual relationship between them, related to the subjects of parliamentary and governmental political life; effects are required according to the constitutional and implementing aspect in political and multiparty pluralism, in elections, legitimacy, popular-civic and territorial sovereignty, civil society, political culture, media, etc., The governance process is faced with unfavorable conditions: a) low level private economic development; b) delays in transition reforms; c) lack of a plural democratic*

*tradition; ç) external obstacles; d) past political and business culture; dh) concentration of party and group power, on existential resources and sectors; e) unsuitable business environment; ë) negative phenomena in institutions; f) lack of genuine opposition; etc. All these circumstances directly affected the characteristics and institutional governing effects. At the same time, political entities and society, through the governing process, are obliged to change and overcome these obstacles in favor of creating preconditions for economic growth and development of other spheres, creating a safe and appropriate investment environment and liberal environment. democratic and integrative.*

**Keywords: Governance, Development, Security, Integration, Kosovo**

## **Hyrje**

Procesi qeverisës në Kosovë, ishte i ndikuar nga Bashkësia ndërkombëtare dhe nga efektet globale në bashkëdyzim me faktorët e rrethanat specifike kosovare. Në rastin e konsolidimit të qeverisjes dhe institucionalizimit në Kosovë, efektet globale ishin më specifike si rezultat i grumbullimit të madh të problemeve për një kohë të gjatë, të cilat ndikuan dhe po ndikojnë në: kushtet, shkaqet, pasojat, aktet juridike, vendimmarrjet, dhe në sfidat e efektet kryesore të qeverisjes; pëkatësisht, në mungesën e cilësisë demokratike në qeverisjen dhe në veprimtarinë institucionale. Andaj, është e dobishme të gjinden përgjigje se, si të konsolidohet tutje cilësia demokratike e qeverisjes në Kosovë në këto kushte e rethana dhe si të ndryshohen kushtet e rrethanat sfiduese? Ngase, cilësia institucionale dhe qeverisëse kosovare, paraqet faktorin esencial shtetëndertues dhe faktorin kryesor ndërveprues në procesin zhvillimor e integrues. Edhe klasa politike dhe qytetarët gjithënjë e ma shum po e kuptojnë se, cilësia e procesit të qeverisjes është thelbësor për shtet-ndërtim, zhvillim e integrim. Pa sundim të rendit politik dhe sundim të ligjit, nuk ka siguri për investime. Qeverisja demokratike efektive sjell paqen demokratike në rajon dhe botë; sjell kushte për investime të sigurta, për bashkëpunim rajonal, integrim e zhvillim. Nuk ka zhvillim të asnjë sfare, e as integrim më vendet dhe organizatat rajonale e ndërkombëtare, pa kapacitete e cilësi qeverisëse e institucione të mirëfillta demokratike. Andaj, roli dhe ndikimi i cilësisë qeverisëse është esencial për proceset zhvillimore të ndërlidhura më proceset integruese kombëtare, rajonale e globale. Shoqëria dhe politika kosovare gjithëherë duhet të jetë e vetëdijshme dhe e parapërgaditur që të krijoj parakushte për procese pozitive e të



pashmangshme globale, për t'i tejkeluar pengesat e politikave dominuese negative në ballkan. Këto pengesa janë shumëdimensionale, dhe po shprehen edhe kundër integritit e konsolidimit shtetror kosovar. Andaj, faktori kosovar duke i fuqizuar institucionet dhe qeverisjen cilësore, i tejkalon më se miri këto pengesa dhe se bashku më faktoret pozitiv ndërkombëtar, konsolidon pozitën integruese e ndërkombëtare të shtetit të Kosovës.

Pra, të gjitha efektet e qeverisjes kosovare, duhet të krijojnë parakushte e ambient të përshtatshëm për procesin e zhvillimit dhe integritit. Këtë rolë dhe funksion të qeverisjes kosovare po e kërkon Shoqëria kosovare dhe Bashkësia ndërkombëtare më orientim demokratik. Shtetet liberale dhe demokratike sjellin paqe dhe stabilitet të sistemit ndërkombëtar. Kjo vlenë edhe për Kosovën. Fukuyama theksonte se „Qeverisja e dobët e komprimon parimin e sovranitetit mbi të cilin është ndërtuar rendi ndërkombëtar mbas sistemit Westphalian” (2010).

Ai thekson se qellimi i përkrahjes ndërkombëtare është: „si të promovojmë qeverisjen e shteteve të dobëta, të përmirësojmë legjitimitetin e tyre demokratik dhe të forcojmë institucionet e vetëqendrueshme”. Këto qellime „bëhen në këtë menyrë projekti kryesor i politikave bashkëkohore ndërkombëtare...si rezultat i shpresës sonë se vendet e varfëra do të kenë një mundësi për tu zhvilluar ekonomiksht.”(2010) Në këtë proces dhe kontekst konkret, Fukuyama e ka fjalën edhe për Kosovën, të cilën e cek edhe tekstualisht.

Çdo dështim në qeverisje paraqet destabilitet me pasoja multidimensionale. Për këtë duhet të jenë të përgjegjshëm të gjithë qytetarët, elitat partiake e politike, shoqëria civile dhe faktori pozitiv ndërkombëtar; të marrin përgjegjësinë, të përcaktohen e veprojnë për qeverisje e institucione demokratike sa më efektive. Sfidat kosovare pas shpalljes së Pavarësisë e deri me sot, janë: konsolidimi i mirëfilltë demokratik i institucioneve dhe qeverisjes, pavarësimin e mirëfilltë nga Serbia, integrimin, tejkalimin e dukurive negative në institucione dhe qeverisje, tejkalimin e varfërisë, papunësisë dhe konsolidimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Rëndësia dhe përgjegjësia e faktorit vendor në qeverisje, është esenciale në jetësimin e këtyre proceseve si dhe në tejkalimin e pengesave të brendshme e të jashtme. Sfidat që lidhen më integrimin e pakices serbe-deinstrumentalizimin e saj nga politika e gabuar serbe, paraqet një rëndësi ndër sfidat momentale. Kërkohej nga Bashkësia Ndërkombëtare të ruaj parimin e respektimit të multietnicitetit në Kosovë, dhe të mos i favorizon kerkesat e papranueshme te komunitetit serb në dem të komuniteteve tjera.

## **1. Konsolidimi institucional e juridik**

Më krijimin e rrethanave ndërkombëtare, Kuvendi shpalli Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës (17 shkurt 2008). Pasi njohja ndërkombëtare e një numri të konsiderueshëm të vendeve më ndikim global. Kushtetuta e Kosovës (2008) përcaktoi karakterin, funksionet dhe organizimin e institucioneve. Të gjitha përcaktimet dhe autorizimet e pushtetit qeverisës e institucional, u konsoliduan sipas kërkesave të Planit të Ahtisarit, duke i theksuar garantet e të gjitha grupeve etnike dhe të drejtat e qytetarit, veçmas minoritetit serb në Kosovë. Kushtetuta e përcaktoi sistemin politik e juridik: Republikë parlamentare e ngjajshme me sistemin qeverisës të demokracisë përendimore dhe të vendeve të tranzicionit; shtet unik, me qeverisje lokale komunale të decentralizuar. Politika konstitucionale i përshtatët nivelit dhe synimeve demokratike e zhvillimore të shoqërisë kosovare. Kushtetuta e Kosovës paraqet zgjidhjet bazë për procesin qeverisës dhe institucional, sipas standardëve demokratike. Kushtetuta, si akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës, (Kapitulli I në nenin 16.2.) të Dispozitave themelore, thekson se: „Pushteti qeverisës buron nga Kushtetuta.” Në (nenin 2.1, të K-I), përkufizon se: „Sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet në pajtim me Kushtetutën nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, me referendum, si dhe në forma tjera, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute” Duke shpreh epërsinë e këtij akti dhe kushtetutshmërinë në procesin qeverisës, në (nenin 16.1, K-I), përkufizohet se: „Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë”. Në Dispozitat themelore (neni 4.1, K-1) përcaktohet forma e qeverisjes dhe ndarja e pushtetit: „Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me Kushtetutë”. Në pajtim me zgjidhjet kushtetuese, ligjet, procedurat dhe aktet tjera nenligjore, u konstituan të gjitha institucionet, sipas kompetencave e përgjegjësisë. Edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë së OKB-së në Hagë (22 korrik 2010), publikoi opinionin këshillëdhënës pozitiv, lidhur me ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, duke theksuar se nuk është në kundërshtim as me Rezolutën 1244 të OKB-së. Ndër sukseset e mëdha, është edhe fundi i mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë,(shtator/2012), e cila shënoi edhe implementimin e plotësimin e kritereve që kërkoheshin nga Pakoja e Marti Ahtisarit.

Pra, më këtë u rrumbullaksuan parakushtet nga aspekti konstitucional, juridik e organizativ funksional, i konstituimit të institucioneve dhe qeverisjes së Republikës së Kosovës. Më përjashtim të mos shtrirjes së plotë të pushtetit në veri. Ka filluar qeverisja

përmes institucioneve të pavarura, legjitime dhe funksionale sipas përcaktimeve juridike. Ka rezultate të dukshme e konkrete, por nuk ishte cilësia e duhur e lidershit dhe e zyrtarëve në institucionet: përfaqësuese, ekzekutive, në gjyqësor, në administratë, në shërbimet publike dhe as në institucionet tjera të pavarura, si dhe as në udheheqjet e strukturat partiake. Vërejtje të theksuara ka në organet e ndjekjes dhe të gjyqësori, të cilat nuk ishin efektive kundër dukurive negative në institucione, dhe nuk kishin përkrahje serioze nga institucionet kryesore politike dhe as nga liderhipi. Kishte dhe ende ka ndërhyrje të theksuara ndërmjetësuese nga faktori i jashtëm, në zgjidhjen e krizave institucionale dhe në proceset vendimmarrëse. Mbrojtja nga sulmet e jashtme po bëhet nga forcat ushtarake ndërkombëtare dhe nga politikat përcjellëse të Bashkësisë ndërkombëtare. Ruajtja dhe mbikqyerja e kufirit dhe siguria e brëndshme po bëhet nga Policia e Kosovës. Kosovës, ende po i mungon forca ushtarake më rolet dhe funksionet e plota të sajë.

Zbatimi i ligjit nuk është në nivelin e duhur. Ka përpjekje konkrete dhe kërkesa, presione e përkrahje nga jashtë, që të përmirësohet kjo sferë esenciale për qeverisje demokratike, pa të cilën nuk ka efekte dhe funksione demokratike qeverisëse në asnjë sferë. Vetëmbrojtja e brëndshme po bëhet nga institucionet e sigurisë, të mbikqyrura e të kontrolluara nga forcat civile institucionale dhe nga sistemi juridik. Interpretimi dhe vlerësimi-interpretimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në qeverisje, po bëhet nga gjykata kushtetuese, në të cilën kishte edhe përfqësues ndërkombëtar. Penges konstitucionale paraqet vetoja e pakicave-proceset e ndryshimit kushtetues e ligjor-kerkohet pelqimi- miratimi i 2/3 të votave të pakicave; kjo zgjidhje kushtetuese nuk është sqaruar qartë ngase kjo duhet të vlejë vetem në rastet që preken të drejtat e këtyre komuniteteve pakicë, e jo të mundësohet bllokimi i proceseve avancuese kushtetuese, ligjore, institucionale dhe bllokimi i proceseve zhvillimore. Kjo zgjidhje e paqartë, duhet të sqarohet edhe nga interpretimi kushtetues nga Gjykata kushtetuese. Rregullimi juridik konsiderohet si rregullim relativisht i përshtatshëm, i qartë dhe i qëllimshëm kushtetues e ligjor dhe me politikat konstitucionale për qeverisjen efektive e me parashikime: Sistem parlamentar dhe balancimin e pushtetëve; Sistem elektoral proporcional; Garantim i të drejtave të njeriut sipas Konventave dhe standarteve ndërkombëtare, decentralizmin përmes qeverisjes lokale në nivelin komunal, etj. Pas pavarësisë 2008, janë arritë suksese konkrete në konsolidimin institucional e juridik të qeverisjes, por kërkohet implementim më efikas, më cilësor e më efektiv i rendit juridik e politik; sundimin e ligjit, duke luftuar dukuritë e shumta negative në institucione, për të mos lejuar tjetërsimin e politikave e qëllimeve konstitucionale të qeverisjës.

Detyrimet juridike, kushtetuese e ligjore, ndarja e pushtetit, etj, kufizojnë pushtetin arbitrar. Shteti i së Drejtës sipas Wolfgang Merkel-it, vendos: përcaktues politik-institucional dhe ‘regjime të pjesësishme’, zgjedhje të përgjithshme të lira dhe të barabarta, të drejtat politike për të marrë pjesë, të drejtat e liritë qytetare, sigurimi institucional i kontrollit të pushteteve dhe sigurimit de jure dhe de facto të pushtetit efektiv të përfaqësuesve të përzgjedhur, thekson Merkel(2010). Por, de facto në Kosovë: pa kulturën politike, pa mundësitë ekonomike, pa shpërqendrimin e pushtetit partiak e grupor, pa pozitë të volitshme ndërkombëtare dhe integrim, etj. është vështirë të arrihet qeverisje efektive demokratike. Modeli i kufizimit të kontrollit të pushtetit nga shoqëria, nga opozita, nga e drejta, balancimi i pushteteve, decentralizimi, e drejta ndërkombëtare, shpërndarja e burimeve, vlerat qëndrimet e sjelljet demokratike, atmosfera ndërkombëtare dhe proceset globale, etj, edhe pse nuk janë në nivel, megjithatë, po sigurojnë një ambient relativisht të përshtatshëm për procesin qeverisës dhe institucional demokratik në Kosovë. Me sistemin zgjedhor proporcional u influencua paksa bashkërenditja, kooperimi dhe toleranca ndërpartiake dhe ulja e tensioneve në mes tyre në procesin qeverisës dhe në funksionet institucionale, duke konsoliduar një minimum kulture e tradite politike plurale.

Sistemi zgjedhor/elektoral proporcional në Kosovë, i vendosur nga faktori ndërkombëtar dhe ai kosovar, u konsiderua i përshtatshëm për rrethanat dhe kulturen politike kosovare. Por, ky sistem po rezulton në shumëpartizëm të fragmentuar në disa parti të mesme e të vogla, në jo efikasitet e jo efektivitet të sistemit politik, jo-stabilitet të qeverisjes, vështirësi në konsolidimin institucional pas zgjedhjeve, vështirësi në vendim-marrje, vështirësi në zgjedhjen e presidentit, etj. Sistemi proporcional u mundësoi partive të vogla të ekzistojnë dhe të jenë të fokusuar në një apo disa çështje dhe më vonë u bënë me shumë ndikim-kjo ishte pozitive për Kosovën. Dukurit negative mund të ndodhin në të dyja sistemet zgjedhore, në sistem proporcional dhe në atë mazhoritar por, efektet qeverisëse janë specifike dhe dalluese. Qellimi i efekteve të sistemit egzistues zgjedhor proporcional ishte që, t'i detyroi subjektet në bashkëpunim, bashkërendim, debat dhe kompromis e konsensus ndërpartiak të domosdoshëm, e jo në konfrontim dy polar te partive të medha që mund të sjellte sistemi mazhoritar. Pra, edhe një sistem zgjedhor tërësisht mazhoritar nuk do ishte dhe ende nuk është ideal; ngase, do të prodhonte dy tirani të shumicave'' dhe konfrontime emocionale jo të përshtatshme, më jo tolerancë dhe thellim të dukurive negative “parti-shtet”. Por, edhe sistemi egzistues tërësisht proporcional, po krijon fragmentarizim të tepruar me pasoja. Andaj, një sistem zgjedhor i përzier mund të jetë më i përshtatshëm ngase, do të

absorbonte anët pozitive të të dyja sistemeve zgjedhore, duke ndikuar sado pak në: demokratizimin e partive politike, do të përmirësonte procesin zgjedhor, efektivitetin dhe efikasitetin institucional e qeverises.

Mënyra e tanishme e zgjidhjes se presidentit nga parlamenti është e papërshtatshme ngase, po i mundëson pozitës të kandidojë kandidatë më orientim të ngushtë partiak e klanor, e jo të përshtatshëm për rolin dhe funksionin që parasheh Kushtetuta. Zgjedhja e kandidatit sipas mënyrës së tanishme është një grumbull mekanik i votave dhe pazar ndërpartiak i koalicioneve për të krijuar pozitën, pa përfillur vlerat dhe cilësitë e duhura të kandidatit për atë funksion. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e Kuvendit dhe përsëritja e zgjedhjeve ne rast të mos votimit të presidentit nga kuvendi, është e papërshtatshme. Zgjedhja nga qytetarët-votuesit, do t'i detyron subjektet të dalin me kandidatë më unifikues dhe me cilësor. Pra, në reformim/ndryshim te sitemit zgjedhor-zgjedhja e presidentit nga votuesit mbetet forma me e pershtatshme.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e tij/saj janë të avancuara dhe mund të jenë të njëjtat, për të mos ndryshuar karakterin parlamentar të qeverisjes, por zgjedhja nga qytetarët drejtpërdrejtë nxjerr kandidatët dhe Presidentin më cilësor për kompetencat, rolet dhe funksionet që ka ky institucion. Zgjedhja e drejtpërdrejtë e presidentit nga qytetarët, i shtynë subjektet politike të dalin me kandidatë më unifikues dhe më të përshtatshëm e cilësor për ushtrimin e roleve dhe funksioneve të përcaktuara më kushtetutë dhe ligje. Shumica e votuesve do të përcaktoheshin për kandidatin më cilësi përkatëse. Kjo mënyrë e zgjedhjes së presidentit forcon legjitimitetin dhe forcën vendimmarrëse, qeverisëse dhe stabilizuese. Edhe gjatë zgjedhjeve parlamentare, presidenti i zgjedhur nga qytetarët, do të luante rol pozitiv në stabilitet dhe qeverisje sipas kompetencave, e edhe gjatë procesit zgjedhor e konsolidues të institucioneve.

Në krizat eventuale qeveritare dhe gjatë procesit zgjedhor, funksionimi stabil i institucionit të presidentit i zgjedhur drejtpërdrejtë, mund t'i kryen më mirë detyrat e funksionet e përcaktuara më kushtetutë, do jetë më i pavarur nga grupet e ngushta partiake. Pra, ndryshimet kushtetuese e ligjore në mënyrën e zgjedhjes se tanishme të presidentit, duket se janë më pragmatike.

## **2. Tradita dhe rrethanat social-kulturore**

Sistemi socialist, shtypja nacionale e shqiptarëve në jugoslavi, suspendimi i autonomisë 1989, dhunimi i kësaj popullate dhe i proceseve demokratike, etj. në Kosovë, kishin pasoja direkte në mungesën e krijimit të traditës demokratike qeverisëse. Edhe gjatë Administrimit ndërkombëtar, si rezultat i mungesës së statusit shtetror të Kosovës, subjektet politike kosovare kishin shumë pak kompetenca në procesin bashkëqeverisës. Për qeverisje demokratike, kërkohet si parakusht një traditë politike e kulturore qeverisëse demokratike paraprake. Në Kosovë kjo traditë mungonte, si rezultat i së kaluarës qeverisëse. Ende nuk janë në nivelin e duhur vlerat kulturore, që kërkohen si parakusht e faktor esencial për cilësinë demokratike qeverisëse, si: konsensusi votues-elitë, vlerat altruiste ndaj komunitetit, traditat pozitive ndaj institucioneve, traditat e respektimit të të drejtave të njeriut dhe ndaj së drejte, arsimimi e njohuritë kognitive për kostot dhe përfitimet e qeverisjes demokratike, njohurit mbi kostot afatgjata të keqëqeverisjes, optimizmi, qëndrimi ndaj barazisë, ndaj korrupsionit, qëndrimet ndaj së kaluarës, marrëdhënieve ndërpersonale, përcaktimi për demokraci, etj. Ende nuk është në nivelin e duhur: respekti ndaj individit, lirisë, ideja e barazisë, besimin në fuqinë e fjalës, rëndësinë e bindjes, retorikës, diskutimit dhe kultures së debatit konstruktiv dhe kompromisit.

Kemi mungesën e tradites së respektimit të të drejtave individuale, kemi vënje në rend të parë të klanit para individit, prirje ndaj dhunes, ndarje e dobët e pushteteve, tendenca për qeverisje jodemokratike, përqendrim i pushtetit mbi ekonominë dhe mbi të ardhurat si rezultat moszhvillimit dhe jokonkurrencës në sektorin privat, etj. Andaj, për të arrit efektet e duhura qeverisëse, duhet avancuar urgjentisht këto vlera të domosdoshme përmes menyrave të shumta. Në këtë drejtim shkon edhe doktrina e "zhvillimit human." Kërkohet arsim cilësor, vlera kulturore e humane të institucionalizuara dhe të mbrojtura efektshëm juridikisht.

Sipas teorive demokratike (Inglehart/Wellzel, 2005), kërkohet që së paku 45% të qytetarëve të jenë të përcaktuar për qeverisje demokratike. Pra, ky problem keqëqeverisës qëndron në shoqërinë e qeverisjen kosovare, ngase, si rezultat i përqendrimit të pushtetit, papunësisë e varfërisë, vlerave e kulturës politike, mediave, etj, votuesit vrapojnë pas liderve e partive arbitrare për përvetësime grupore e individuale pa kritere, e jo për qeverisje të mirefilltë demokratike. Më rëndësi janë edhe shprehja ndaj punës, ndaj biznesit dhe pronës, ndjenja e përgjegjësisë, shfaqja e vlerave vetëshprehëse, por edhe niveli social-ekonomik dhe proceset ekonomike, që duhet të krijojnë motiv e vlera të reja kulturore e qeverisëse. Shtresëzimi dhe struktura plurale e shoqërisë kosovare po mungon si rezultat i jozhvillimit ekonomik në sferën prodhuese e shërbyese private. Guximi qytetar dhe aktiviteti racional politik, ka filluar të rritet.

Shoqëria civile gjithënjë po konsolidohet. Edhe mediat kanë ngrit nivelin e pavarësisë , analizës dhe kritikës së bazuar. Por, këto të fundit ende anojnë nga ngjyrimet partiake e grupore dhe nuk janë sa duhet gjithëkritike e te pavarura.

#### Shpërqendrimi i pushtetit

Për qeverisje demokratike në Kosovë, kërkohet shpërqendrim i burimeve të pushtetit partiak e grupor mbi institucionet, shoqërinë dhe ekonominë: në pronësi, kapital, dije, informim, largim i pushtetit partiak nga shërbimet dhe kompanitë publike, administratë efikase, liria e qarkullimit dhe kushte për veprimtari biznesore private, e denim te keqëperdoruesve dhe konfiskim i pasurisë se fituar jashtëligjshem. Pa zhvillimin ekonomik e sherbyes të sferës private në Kosovë, nuk mund të ketë shpërqendrim të pushtetit, e as shoqëri civile të mirëfilltë, e as cilësi demokratike qeverisese. Të gjitha mundësitë momentale për punësim dhe egzistencë, po varën kryesisht nga sfera publike-ngase sfera private eshte tejet fillestare. Elitat partiake dhe grupet e interesit e te presionit, të krijuara nga dukuritë negative në institucione dhe qeverisje, janë shndërruar në uzurpuese grupore arbitrare të institucioneve. Institucionet dhe qeverisja kosovare duhet t'i siguroi qytetarët nga presioni i këtyre grupeve të presionit, nga grupet e korruptuara në pushtet dhe nga grupet e ndërlidhura me to. Këto grupe dhe kjo gjendje uzurpuese dhe përqendrim ekstrem i pushtetit mbi burimet egzistenciale, janë penges e qeverisjes demokratike dhe po reflektojnë pasiguri per investime dhe jozhvillim të sferes private, dhe jokonkuresces e integritimit. Votuesit në këtë situatë të vafërisë, papunësisë, etj, shum lehtë po manipulohen nga demagogjitë partiake dhe populizmi; qorraz po vrapojnë pas uzurpuesve të pushtetit dhe institucioneve, duke shpresuar në premtimet e tyre boshe.

Në parakushtet e qeverisjes demokratike, Vanhanen (2003) theksonte se "përqendrimi i burimeve të pushtetit çon në autokraci, kurse shpërqendrimi i burimeve të pushtetit, në të shumten e rasteve, në demokraci." Në shpërqendrim të pushtetit, luajnë rolë format e shumta decentralizuese dhe zhvillimi i sferave ekonomike private. Seymour Martin Lipset në vepren Political Man (1960), kërkonte shpërndarjen e burimeve e resurseve të pushtetit në shoqëri e ekonomi. Pra, pushteti të mos i zotëroi këto burime. Në këtë pikëpamje Lipset i fut edhe tregues tjerë të shpërndarjes së burimeve: psh burimet e dijes, ekonomisë, gjendjes së pronësisë, pronësinë agrare, informacionin, etj, në raport më pushtetin.(1960) Në Kosovë analizat dhe treguesit e monitoruesve vendor e ndëkombëtar, tregojnë raste të shumta uzurpuese të pushteteve grupore ndaj institucioneve dhe mbi shërbimet e burimet ekonomike publike, mbi institucionet e dijes, informacionit, etj. Ky

reduktim, zvoglim, joshtrirje dhe shpërqendrim i pushtetit ndaj ekonomisë dhe shoqërisë nuk dmth. zvoglim i shtetit-institucioneve, përkundrazi, ky proces demokratik i shpërqendrimit, kërkon forcim dhe fuqizim më të madhë të efektivitetit e efiksitetit të institucioneve në sferat e sundimit të rendit e ligjit sipas kushtetutshmërisë. Pa këtë respektim të kushtetutshmërisë e ligjëshmerisë në qeverisje, nuk ka as institucione të përshtatshme, e as zhvillim ekonomik në Kosovë. Këtë e kërkon edhe Bashkësia ndërkombëtare dhe proceset globale ekonomike e integruese. Këtë e thekson edhe Fukuyama (2010:175): „Një problem jetik me të cilin përballen vendet e varfëra, që bllokun mundësitë e tyre për zhvillim ekonomik, është niveli i papërshtatshëm i zhvillimit institucional. Ato nuk kanë nevojë për shtete të zgjeruara, por kanë nevojë ama për shtete të forta dhe efektive brenda fushës së kufizuar të funksioneve të domosdoshme shtetore.” Më këto probleme është ballafaquar edhe zhvillimi institucional dhe qeverisja kosovare.

### **3. Rrethanat ndërkombëtare e rajonale**

Vendet që shtrihen në mesin e vendeve të zhvilluara e demokratike, e kanë më lehtë qeverisjen demokratike. Por Kosova, nuk e kishte këtë pozitë, sa i përket vendeve fqinjë dhe arbitraritetit të konfrontimeve globale. Faktor tjetër me rëndësi pozitive për qeverisje demokratike kosovare, janë proceset integruese të rajonit në BE dhe pozita ndaj tregjeve e proceseve globale në rajon, etj. Ndryshimet e pas viteve 90-ta, proceset integruese europiane, proceset globale në shum sfera, pozita gjeografike, pozita ekspozuese e tregut global, investimet regjionale, etj. janë forcë ndikuese dhe rrethana pozitive për proceset konkrete në Kosovë, kuptohet, krahas angazhimit të faktorit kosovar, por, keto i munguan Kosovës. Ndikimet negative nga Serbia dhe disa rivalitetete të vendeve më ndikim, reflektuan drejtpërdrejt edhe në efektet qeverisese e institucionalizimin në Kosovë. Dhe të gjitha këto krijuan pengesa e vonesa në qeverisje, në reforma, në integrim dhe rrjedhimisht në konsolidim demokratik në Kosovë. Por, proceset globale integruese dhe veprimtaria e organizatave ndërkombëtare po ndikojnë në Kosovë, që të përfillet dhe inkorporohen konventa e praktika qeverisese demokratike e të dobishme në rendin kushtetues, në respektimin e të drejtave të njeriut, të pakicave, sundimin e rendit dhe ligjit etj. Por, ende Kosova po ballafaqohet me presione të jashtme me qëllime e interesa të lloj-llojshme ndërkombëtare ndaj rajonit dhe rrjedhimisht edhe ndaj Kosoves. Politika destruktive e Serbisë ende është aktive, edhe tolerancat e vendeve më ndikim ndaj saj ende janë të theksuara.



#### 4. Qeverisja dhe zhvillimi ekonomik

Rrethanë e favorshme për qeverisje demokratike dhe qëllim i qeverisjes demokratike, është zhvillimi i qendrueshem ekonomik. Martin Lipset e theksonte qartë se: „Sa më i pasur të jetë një vend, aq më të mëdha janë mundësitë për ta ruajtur demokracinë’’(1959) Mungesa e zhvillimit ekonomik privat po i kushton qeverisjes në Kosovë, ngase siq theksuam me lartë, nuk ka shpërqendrim të pushtetit mbi burimet egzistenciale, e as zhvillim te shumë sferave te dodomosdoshme. Pa zhvillim të sferës ekonomike private nuk ka qeverisje demokratike dhe as shpërqendrim të pushtetit, e as shoqëri civile të avancuar. Por, edhe pa qeverisje efektive, sundim të rendit e ligjit, sigurisë, politikave të përshtatshme ekonomike, administratë cilësore, shërbime publike cilësore, integrim, etj të cilat duhet t’i siguroi mirëqeverisja, nuk ka zhvillim ekonomik e as shoqëri civile përkatëse. Pra, egziston një ndërlidhje e ndërveprim reciprok kushtëzues për tejkalimin e situatës-qeverisje-zhvillim ekonomik.

Kjo sfidë, mund dhe duhet të menaxhohet duke e shtuar legjitimitetin politik me efektivitetin e tij; duke plotësuar funksionet e sistemit qeveritar në sundimin e rendit dhe ligjit; duke mbrojtë interesat publike dhe të shumicës së popullsisë; zgjidhjen e konflikteve strukturore; duke i integruar politikisht shtresat e mesme dhe të ulëta; duke i kushtuar vemendje shperndarjes dhe mirëqenjes, etj. Të synohet krijimi i parakushteve për liberalizim, konkurrencë e ekonomi të tregut; politikave të qarta me projekte zhvillimore të suksesshme afatmesme e afatgjata. Të gjitha sferat duhet të jenë në favor të zhvillimit e perspektivës, ngase zhvillimi ekonomik reflekton mundësi për qeverisje demokratike dhe në qendrueshmërinë e saj. Por, krejt kjo varet nga fuqizimi i sundimit të ligjit dhe krijimi i sigurisë dhe parakushteve infrastrukturore e shërbimeve cilesore publike dhe luftim te dukurive negative në institucione dhe në qeverisjen e gjertanishme.

Kërkohen politika të qarta zhvillimore dhe largim i pushtetëve partiake e grupe nga ekonomia publike dhe nga pengesat arbitrare keqepërdoruese ndaj sferave private; liberalizim dhe bashkëpunim intenziv ekonomik e konkurrencë të plotë rajonale e globale; siguri politike e juridike dhe politika sociale gjatë transformimit. Veçmas, pergaditje për integrim në ekonominë e BE-së. Ndarje të ekonomisë nga menagjimi i drejtëpersdrejtë nga shteti dhe qeverisja. Fukuyama,F.(2010:142) kërkon liberalizim ekonomik afatgjatë në njëren anë, por, kërkon forcim të institucioneve dhe sferave tjera të sigurisë dhe rendit në anën tjetër. Në munges të kuptimit, qasjes dhe zbatimit në disa vendeve në zhvillim dhe të tranzicionit, ai

theksonte se: "reforma e liberalizmit të ekonomisë dështoi në arritjen e objektivave të premtuar në shumë vende. Më të vertetë në disa vende, mungesa e kuadrit të duhur institucional i la ato më keq pas liberalizimit sesa do të ishin pa e zbatuar fare ato. Problemi qëndron në dështimin konceptual themelor për të ndarë dimensionet e ndryshme të shtetit dhe për të kuptuar se si lidhen ato më zhvillimin ekonomik." Një gjë e tillë po ndodhë edhe në politikat, qeverisjen dhe institucionet kosovare, duke filluar nga kuadri institucional, mungesa e liberalizimit ekonomik, mungesa e forcimit të institucioneve kryesore dhe mungesa e sundimit të ligjit si domosdoshmëri primare. Veçmas në mungesën e qellimeve të sinqerta të elitës politike për zhvillim afatgjatë dhe në dështimin e kuptimit të ndarjes së roleve të institucioneve në raport me ekonominë. Pra, moskuptimi se si të ndikohet në zhvillimin ekonomik, përmes forcimit të institucioneve kryesore politike në njërin anë, dhe liberalizim ekonomik e konkurrencë njëkohësishtë. Pra, kërkohet ndërtimi i sistemit të ekonomisë sipas kërkesave të një ekonomie të hapur ndaj tregut rajonal, europian dhe atij botëror, me një politikë rregullative të përshtatshme të rendit, sigurisë dhe sundimit të ligjit në sferat tjera, dhe kuptimi se këto funksione joekonomike të qeverisjes edhe pse duken të tërëthorta, janë thelbësore për zhvillimin ekonomik.

Zhvillimi i kapitalit human në pajtim me trendet teknologjike dhe ligjësive të tregut e konkurrencës në nivelin rajonal e global, për qeverisjen kosovare, duhet të jetë prioriteti kryesor, thekson UNDP (2009-2019). Pra, menaxhim i efektshëm i burimeve humane dhe terheqje e kapitalit në investimet strategjike për Kosovën dhe liberalizim ekonomik, të cilat do sjellin zhvillim të shpejtë dhe të qëndrueshëm. Ekonomia e Kosovës, ka normë pozitive të rritjes ekonomike, por kjo është e pamjaftueshme për një zhvillim të qëndrueshëm dhe zvogëlim të deficitit tregtar, varfërisë dhe papunësisë. Edhe privatizimi dhe shumë shërbime tjera në Kosovë, janë të ndërlidhura me grupet e dukurit korruptuese në pushtet, si rezultat i josundimit të rendit dhe ligjit. Pra, roli dhe funksioni i qeverisjes kosovare është krijimi i parakushteve për rritje ekonomike dhe zhvillim të të gjitha sferave, në funksion të sigurisë së mirëqenies dhe zhvillimit human të çdo qytetari kosovar.

Dominimi i deficitit të theksuar tregtar, importi i lartë në raport me mundësitë prodhuese vendore të atyre produkteve, eksporti tejet i ultë-exporti mbulon importin vetëm rreth 16%, janë tregues të politikave joefektive. Bankat komerciale ofrojnë kredihënje të papërshtatshme, ka inflacion, investime të ulta vendore dhe thithje e dobtë e investimeve të jashtme (BQK,2010). Mundësitë dhe disa faktorë potencial të zhvillimit egzistojnë: kapitali human, burimet natyrore e hapsinore të pashfrytëzuara, tregu, etj, të cilat më një politik

ekonomike e makroekonomike konsistente dhe sundim të ligjit, do t'i aktivizonte këto potenciale ekonomike kosovare. Politikat ekonomike të gjertanishme, nuk ishin pragmatike, konkrete e specifike; nuk ishin projekte e strategji afatëmesme e afatgjata, për zhvillim të qëndrueshem ekonomik. Ngase, politikat ekonomike kontrolloheshin nga grupet keqëpërdoruese në institucione, për përfitime te paligjshme.

## **5. Çështja e veriut dhe integrimi i pakices serbe**

Zgjidhjet juridike të Planit të Ahtisarit, të përfshira në tërësi në Kushtetutën dhe sistemin politik e juridik funksional të Kosovës, si dhe niveli i integritit të pakices serbe, janë argumente të patejkalueshme, janë praktika të suksesëshme për zgjidhjen e problemeve të veriut, përkatësisht, integrimin e plotë të tij. Edhe qendrimet ndërkombëtare janë të qarta, se nuk ka ndryshim kufijsh në baza etnike. Andaj, roli destruktiv i Serbisë në pengimin e institucionalizimit dhe qeverisjes kosovare në këtë pjesë, gjithnjë po amortizohet. Plani i Ahtisarit, Kushtetuta e Kosovës dhe integrimi i pakices serbe, janë fakte që tregojnë garantimin dhe zgjidhjet më të avancuara në rajon për të drejtat e Komunitetit serb në pushtetin lokal dhe qendror, më standarte më të theksuara demokratike. Diplomati Rohan, A. (2012), zavëndes i Ahtisarit në bisedimet e Vjenës për caktimin e statusit të Kosovës, më hapjen e Bisedimeve për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi, në kontekst të veriut thot se: „Plani i Ahtisarit përmban autonominë substanciale për serbet e veriut të Kosovës.” Andaj, çdo largim nga ky Plan „krijon komplikime në sistemin politik e juridik të Republikës së Kosovës” thekson ai.

Këtë e kanë kuptuar të gjitha palët. Edhe Republika e Serbisë e detyruar nga nevojat e brendshme dhe integruese, ka filluar të ndryshoj qasjen ndaj Kosovës dhe veriut. Fuqizimi i institucioneve dhe qeverisjes demokratike kosovare në të gjitha nivelet, do të ndikon në integrimin cilësor të këti komuniteti dhe territori. Pra, cilësia qeverisëse e institucionale në Kosovë, paraqet faktorin kryesor për integrimin e pakices serbe dhe mbrojtjen e sovranitetit, dhe anasjelltas, keqëqeverisja i stimulon proceset negative që gjithnjë po theksohen koheve te fundit.

Vetëqeverisja lokale komunale po i kryen më sukses funksionet e veta në të gjitha komunat; parakushtet juridike mundësojnë edhe në komunat multietnike-qe gabimisht po quhen ”më shumicë serbe”. Edhe Komunitet multietnike-”me shumicë serbe” në veri të Kosovës, nuk kanë asnjë arsye që të mos funksionojnë sikurse komunat tjera. Tani çështja

është si të integrohet sa më shpejtë dhe sukseshem kjo pjesë dhe të qeveriset e institucionalizohet sipas Kushtetutës; sipas qeverisjes qendrore dhe qeverisjes lokale komunale mjaftë të avancuara sipas Kartës europiane të vetëqeverisjes lokale. Kushtetuta dhe rendi juridik e politik i Kosovës është shtet unik me qeverisje lokale komunale mjetë të avancuar e funksionale dhe më përfaqësim e vendimmarrje përmbajtësore të komunitetëve pakicë në nivelin lokal e qendror.

Prandaj, nuk ka asnjë arsye për asnjë formë destruktive e enklavizuese, që do ta dëmtonte multietnicitetin dhe përcaktimet demokratike të qeverisjes lokale e qendrore kosovare.

Marrëveshjet prill/2013, dhe gusht/2015, që kanë të bëjnë me Asociacionin për Komunitetet “me shumicë serbe” në Kosovë, paraqesin një problem politik që mundet dhe duhet të zgjidhet në rrafshin juridik-përmes interpretimit dhe implementimit të tyre vetem e vetem përmes respektimit të plotë, të qartë dhe të sigurtë të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë kosovare. Sadoqë, Marrëveshja prill 2013 është ratifikuar në Kuvend me shumicë të kualifikuar, dhe faktit se është thënë qartë se “do të krijohet një Asociacion/Bashkësi e komunave me shumicë serbe në Kosovë”, dhe tani Marrëveshja mbi Asociacionin për Komunitetet Serbe-gusht/2015, e cila ka natyrë administrative e implementuese të së pares, dhe faktit se kërkesat e dispozitat e së cilës janë antikushtetuese e antiligjore dhe ngrejnjë çështje kushtetuese fundamentale ngase, prekun themelet e rendit kushtetues kosovar, dhe tani edhe Vendimi i Gjykatës kushtetuese- ato, munden dhe duhet të sfidohen nga të gjitha institucionet kosovare, nga pozita dhe opozita, dhe nga vet rendi kushtetues e juridik-tani funksional dhe i pranuar edhe ndërkombëtarisht.

Ndërtimi i asociacionit mbi baza krejtësisht mononacionale (serbe) zvogëlon të drejtat dhe liritë kushtetuese të komuniteteve joserbe në këto komuna-Kapitulli III, shkel të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve të komuniteteve joserbe-Kapitullin II. Pra, sipas këti përcaktimi monoetnik-serb krijohen situata diskriminuese për komunitete joserbe dhe pjestaret-qytetarët e tyre. Andaj, në statutin e Asociacionit duhet të sigurohet veto vendimmarrëse e përfaqësim përmbajtësor për komunitetet jo të pakices serbe. Të mbrohen me përcaktime të qarta të drejtat dhe liritë kushtetuese të garantuara me Kapitullin II, III, dhe të mos preken dispozitat e Kapitullit X të Kushtetutës për qeverisjen lokale dhe organizimin territorial.

Zgjidhjet juridike funksionale e efektive të pushtetit legjitim lokal-komunal dhe marrëdhëniet me pushtetin qendror, nuk mund t'i damtoj e pengoj asnjë asociacion. Ngase,

raporti i tyre dhe pergjegjësitë e kompetencat lokale komunale janë tejet të avancuara për sa i perket respektimit të multietnicitetit; janë efektive e funksionale dhe të definuara qartë me rendin kushtetues për vetëqeverisjen lokale komunale-Kapitulli X. Andaj, pozita kushtetuese e ligjore e komunave në kuadër të këtij Asociacioni dhe raporti i komunave me pushtetin qendror nuk guxon të preket. Gjykata kushtetuese duhet të precizoi e sqaroi akoma më qartë, dhe të marrë qendrim më të mirëfilltë-aktgjykim plotësues kundrejt parimeve e dispozitave antikushtetuese të këtyre marrëveshjeve, dhe të kërkoj monitorim më të angazhuar përmes institucioneve përkatëse implementuese dhe interpretim në të gjitha aktet, fazat e procedurat; Asociacioni/Bashkësia e komunave “me shumicë serbe”-multietnike në Kosovë, duhet të jetë në kuader të Asociacionit të Komunave të Kosovës më të njëjtat role, detyra, kompetenca dhe përgjegjësi-statut identik që ka Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe në kuader të saj. Në Asociacionin/Bashkësinë e komunave “me shumicë serbe” në Kosovë, të përfaqësohen dhe të kenë veto vendimmarrëse komunitetet tjera jo serbe në këto Komuna. Njësia bazë-themelore e pushtetit lokal të jetë Komuna me raportet egzistuese me pushtetin qendror-ashtu siq janë të rregulluara e funksionale në të gjitha komunat e R. se Kosovës

## **6. Dukuritë negative në institucione**

Në qeverisjen kosovare, ndodhi uzurpimi i partive nga udhëheqjet partiake arbitrare dhe depërtimi i ketyre grupeve të korruptuara në institucione, si dhe mosluftimi i dukurive negative në institucione për një kohë të gjatë. Këto rrethana e shkaqe, patën pasoja në cilësinë e funksioneve institucionale, në nivelin e realizimit të roleve dhe përgjegjësi të vetë parlamentit si institucion bazë i demokracisë parlamentare, dhe rrjedhimisht, edhe në institucionet tjera.

Moszbatimi i ligjit, mungesa e autonomisë së pushteteve dhe pamundësia e kontrollit reciprok, veçmas e parlamentit ndaj ekzekutivit. Gjyqësori joefektiv ndaj bartësve të korrupsionit të lartë, mungesa e funksionimit të mirëfilltë të procesit zgjedhor, karakteristikat e subjekteve politike dhe lidërshpit të tyre, etj, kanë sjell pasoja në rritjen e korrupsionit, papergjegjësisë, dhe krimin të organizuar, si dhe në mosluftimin e tij për një kohë të gjatë.

Dukuritë negative në institucione po e dëmtojnë buxhetin e shtetit, ekonominë dhe shoqërinë: duke i penguar e deformuar investimet publike dhe duke krijuar pasiguri për investitorët potencial të brëndshëm e të jashtëm. Po ndikojnë drejtëpersedrejti në moszhvillimin ekonomik, pasigurinë, në cilësinë e shërbimeve publike e administrative dhe në

vonesen integruese. Andaj, janë të doemosdoshme masat dhe reformat e caktuara qeverisëse, për tejkalim të gjendjes. Drejtoresha e Bankës Botërore për Europën Juglindore, Jane Armitage, në një intervistë, (nëndor/2012), duke kërkuar reforma në këto sfera kosovare thekson se:”duhet të bëhen shumë gjera, të luftohet korrupsioni, të përmirësohet gjyqësori, të gjitha këto janë pjesë e mjedisit biznesor. Pra, kur bëhen indikatorët e biznesit dhe afarizmit, investitorët i shikojnë të gjithë këta indikatorë.” theksonte ajo. Kjo gjendje po vazhdon ngase, Gjyqësori është ende joefikas, jo i pavarur sa duhet dhe i ndërlidhur me dukuritë negative qeverisëse, si dhe nën presion të grupeve të interesit dhe grupeve të presionit në institucionet e larta. Funksionimi i sistemit gjyqësor është qenësor për sundim të ligjit, por ende nuk është i pavarur e efektiv.

Në aspektin juridik e kushtetues duket i pavarur, por aspekti faktik është krejtë tjetër. Kosova në opinionet e qytetarëve dhe organizatave monitoruese, çoftë vendore çoftë ndërkombëtare, cilësohet si një shtet me nivel të lartë të korrupsionit në: ndërmarrjet publike, në proces të prokurimit dhe në shpenzimet qeveritare. Punësimet në administratë dhe në sferat tjera publike, bëhen përmes nepotizimit dhe përkatësisë partiake pa përfillur cilësitë profesionale dhe etike. Ka një administratë publike të politizuar/partizuar dhe ende të përfomuar sa duhet.

Mungon konkurrenca reale e partive si rezultat i dukurive negative të futura në vetë udhëheqjet partiake, dhe përmes tyre në institucione. Garat në mes tyre nuk bëhen për alternativa qeverisëse e programore, por për përvetësime, privilegje dhe keqpërdorime grupore. Mu për këtë, debatet në mes tyre janë të ashpra, fyese, etiketuese e destruktive. Në të gjitha raportet monitoruese të organizatave ndërkombëtare dhe vendore, mediat hulumtuese, etj, theksojnë se elitat e larta politike janë të korruptuara përmes procesit të privatizimit të manipuluar, keqpërdorimit të tendërve dhe në procesin e prokurimit, shpenzimeve të pakontrolluara buxhetore të qeverisë, nga keqperdorimet e fondeve të donatorëve, partneritetit të korruptuar publiko-privat, nepotizmit, etj. Këto grupe përpos presioneve dhe korrupsionit, informalitetit, kriminit të organizuar dhe kontrabandes, po pengojnë demokratizimin dhe funksionimin kushtetues e ligjor të institucioneve. Po e manipulojnë dhe e deformojnë procesin zgjedhor dhe manipulimin e opinionit përmes mediave të varura, shantazheve, demagogjisë, etj. Këto grupime i sjellin lojalet e tyre në institucionet kryesore dhe në agjencitë e pavarura.

Këto dukuri dhe bartësit e tyre po e pengojnë qeverisjen demokratike dhe rrjedhimishtë, po e pengojnë zhvillimin ekonomik, zhvillimin e sferave tjera dhe integrimin.

Korrupcioni në Kosovë është pjesë e sistemit. Pra, vetë bartësit e pushtetit dhe institucionëve janë të përfshirë në dukuri të tilla. Në Barometrin Global të Korrupsionit (korrik, 2013) partitë politike janë identifikuar si fushë më e prekur nga korrupsioni në Kosovë, dhe përpjekja e qeverisë për luftimin e tij është tejet e paefektshme. Kosovën në vitin 2012 e renditi në vendin e 105-të në listën e shteteve më të korruptuara.(korrik/2013) Nuk ka përmirësime të dukshme as më 2019.

Luftimi i dukurive negative të lartpërmendura mundë të arrihet nga bashkërendimi i veprimtarisë së: qytetarëve, subjekteve politike opozitare dhe lidhësive të reja, më përkrahjen e qartë të faktorit pozitiv ndërkombëtar. Pra, bashkimi dhe bashkërendimi i këtyre faktorëve mund të japin rezultate, duke konsoliduar integritetin e institucioneve dhe të procesit qeverisës; duke filluar nga transparenca, nga ndryshimi i strukturës së vetëdijes dhe vlerave të votuesve, konsolidimi dhe respektimi i parimeve demokratike të procesit zgjedhor dhe kthimi legjitimitetit të mirëfilltë i institucioneve. Pra, kthimin e efikasitetit e integritetit të institucioneve; fuqizim i shoqërisë civile, mediave të pavarura, kritike e analitike. Përkrahja ndërkombëtare efikase përmes presioneve, por edhe përmes shpejtimit të procesit të integritetit e zhvillimit, është më se e domosdoshme. Zhvillimi i qendrueshmërisë ekonomike private, paraqet domosdoshmeri për demokraci, por ai nuk mund të arrihet pa qeverisje të institucioneve të përgjegjshme e më efekte paraprake të sigurimit të rendit dhe ligjit dhe pa përkrahjet e jashtme të procesit paraprak integruar.

Konsolidimi i Gjyqësorit më kuadro të guximshme dhe të pavarura nga politika e korruptuar, është një hap para, por kërkohet mbështetje e të gjitha institucioneve dhe e qytetarëve. Shefi i zyrës ndërlidhëse të Komisionit Europian në Kosovë, (Khalidun, 2012) në përfundim të mandatit, në një intervistë vlerësoi se: „Lufta kundër korrupsionit, reformimi i sistemit zgjedhor, reforma e administratës publike, zhvillimi ekonomik i vendit, janë disa nga kushtet që duhet t'i përmbushin institucionet, nëse deshirojnë që ta shprijnë vendin drejt integritetit në BE”. Duke shtuar se:”përveç institucioneve që kanë obligim të luftojnë korrupsionin, duhet kujtuar se korrupsioni është problem edhe i shoqërisë dhe i mentalitetit,” thekson ai në këtë intervistë. Kjo situatë vazhdon të jetë e njëjtë deri në fundin e vitit 2019.

Autoriteti dhe legjitimiteti qeverisës e institucional po përceptohet negativ tek qytetarët, si rezultat i dukurive negative të grupeve në udhëheqjet partiake dhe në institucione. Konkurrenca ndërpartiake është jo parimore: e përcjellur më akuza, shpifje e ofendime dhe jo sa duhet bashkërenduese në vendimmarrjet pozitive. Mungojnë forcat opozitare të mirëfillta. Si rezultat i kësaj ka pjesëmarrje të ultë në votime dhe mungesë të pjesëmarrjes cilësore e

sasiore të qytetarëve në procesin politik. Mosndëshkim nga gjyqësori i bartësve të dukurive negative në institucione dhe përzjerja e politikës në gjyqësor. Mosndëshkim i subjektëve dhe liderve të tyre më votë nga qytetarët, si rezultat i votuesve emocional dhe më struktur të vetëdijes politike të ngarkuar nga e kaluara dhe jo sa duhet kognitive, si dhe nga përqendrimi i lartë i pushtetit mbi burimet egzistenciale publike dhe mediave jo të pavarura sa duhet.

Andaj, kërkohet ndryshime e angazhime të shumanshme në krijimin e vlerave, njohurive dhe qëndrimëve të votuesve; konsolidimi i subjektëve opozitare më lider dhe kuadro më integritet; presion dhe mbështetje nga shoqëria civile; përkrahje nga jashtë përmes politikave mbështetëse edhe përmes shpejtimit të integritimeve. Përkrahja ndërkombëtare është efikase dhe e domosdoshme, ngase përmes identifikimit të shkaqeve e fajtorëve, informimit, presioneve dhe përmes shpejtimit të procesit të integritimit, mobilizon qytetarët dhe opozitën e mirëfilltë që të veproji kundër dukurive negative. Mundëson lindjen e forcave të reja opozitare dhe përkrahjen e tyre deri në ndryshimin e gjendjes dhe ndeshkimit e keqëqeverisjes. Thirrje te tilla kishte para zgjedhjeve-2019, nga faktori pozitiv ndërkombëtar.

## **7. Proceset integruese**

Nuk ka zhvillim të as një sfere, e as integrim më vendet dhe organizatat rajonale e ndërkombëtare, pa kapacitete e cilësi qeverisëse e institucione të mirëfillta efikase demokratike.

Në rastin e Kosovës, kjo është më se e domosdoshme në të gjitha proceset që kaloi Kosova. Andaj, roli dhe ndikimi i cilësisë qeverisëse është esencial për proceset zhvillimore e integruese kombëtare, rajonale e globale. Shoqëria dhe politika kosovare, gjithëherë duhet të jetë e vetëdijshme dhe e parapërgaditur që të krijoj parakushte për proceset pozitive e të pashmangshme globale, për t'i tejkaluar pengesat e politikave dominuese negative në ballkan. Këto pengesa janë shumë-dimensionale, dhe u shprehen edhe kundër integritimit. Andaj, faktori kosovar duke i fuqizuar institucionet dhe qeverisjen cilësore, i tejkalon më se miri këto pengesa dhe se bashku më faktoret pozitiv ndërkombëtar, konsolidon pozitën integruese e ndërkombëtare të shtetit të Kosovës. Edhe Bashkësia Ndërkombëtare, ndër kërkesat themelore për integrim po kërkon cilësi e efikasitet në qeverisje, institucionalizim e kulturë sa më demokratike efikase. Qeverisja dhe rendi demokratik në Kosovë, reflekton siguri dhe paqë ndërkombëtare në këtë rajon dhe më gjerë. Psh. Fukuyama, thekson se, mungesa e qeverisjes efikase, efektive e legjitime, krijon jostabilitet të brendshëm dhe ka pasoja direkte në



destabilitetin ndërkombëtar.(2010) Keqëqeverisja kosovare po i kontribon krijimit te situatave të tilla.

Edhe pse kishte mangësi, vonesa, kontradikta, e dukuri negative nga jashtë, Kosova ka përfituar shumë nga përkrahja që i është dhënë prej BE-së, SHBA-së e shteteve tjera dhe nga Organizatat e shumta ndërkombëtare. Ka përfituar asistencë të konsiderueshme, të drejtëpërdrejtë qeverisëse, institucionale e juridike, si dhe financiare e të sigurisë. Përmbyllja e Marrëveshjes për Stabilizim-Asocim, do të kontribon në hapjen e shoqërisë kosovare. Por, askush nuk duhet të ketë iluzione se rruga e Kosovës drejt anëtarësimit në BE është e lehtë.

Kushtet për anëtarësim janë përcaktuar nga Këshilli Evropian. Vendet kandidate, pra edhe Kosova, duhet të ndjekin vlerat e përbashkëta të vendosura në Traktatin e Unionit dhe ato kërkohet që të kenë arritur stabilitet të institucioneve dhe qeverisjes demokratike, si dhe ekzistim të një ekonomie konkurrenente të tregut; të miratojnë dhe implementojnë tërësinë e ligjeve e standarteve të BE-së, të ashtuquajturin “Acquis Communautaire“. Ky është një proces i gjatë dhe i vështirë. Derisa BE-ja do të vazhdojë me sigurimin e çdo lloj asistence, rezultatet varen nga vetë Kosova, nga lidërshipi i saj dhe qytetarët. Për Kosovën do të ishte me rëndësi vitale që të jetë në proces të integritimit dhe e integruar në BE. Kjo sfidë i takon procesit qeverisës e institucional kosovar, së bashku me Bashkësinë ndërkombëtare dhe politikave të tyre në rajon.

Integritet rajonale dhe integritet mbarëshqiptare janë të pashmangshme ngase, proceset globale integruese dhe konfrontuese do t'i provokojnë keto procese. Andaj, edhe cilësia qeverisëse kosovare duhet të jetë e parapërgaditur për këto zhvillime.

## **8. Konkluzion**

Pas shpalljes së pavarësisë (2008) e deri më (2019), mund të konstatojmë se qeverisja dhe institucionet kosovare gjatë kësaj periudhe moren këto karakteristika qeverisëse:

Ka filluar qeverisja përmes institucioneve të pavarura, legjitime dhe funksionale sipas përcaktimeve juridike. Ka rezultate të dukshme e konkrete, por nuk ishte cilësia e duhur e lidërshpitit dhe e zyrtarëve në institucionet përfaqësuese, ekzekutive, në gjyqësor, në administratë, në shërbimet publike dhe as në institucionet tjera të pavarura. Vërejtje të theksuara ka në organet e ndjekjes dhe të gjyqësori, të cilat, nuk ishin efektive kundër dukurive negative në institucione.

Nuk kishte politika të qarta ekonomiko-zhvillimore. Ka ngecje në krijimin e kushteve për mjedis të përshtatshëm biznesor dhe të sigurisë për investime. Mungojnë reformat dhe politikat e qarta ekonomike e makroekonomike. Politikat ekonomike të gjertanishme, nuk ishin konkrete e specifike, e as strategji afatëmesme e afatgjata, për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Autoriteti dhe legjitimiteti qeverisës e institucional po përceptohet negativ tek qytetaret, si rezultat i dukurive negative të grupeve në udhëheqjet partiake dhe në institucione. Konkurenca ndërpartiake ishte jo parimore: e përcjellur më akuza, shpifje e ofendime dhe jo sa duhet bashkërenduese ndërpartiake në vendim-marrjet.

Mungojnë forcat opozitare të mirëfillta. Si rezultat i kësaj ka pjesëmarrje të ultë në votime dhe mungesë të pjesëmarrjes cilësore e sasore të qytetarëve në procesin politik.

Mosndëshkim i mjaftushëm i subjektëve dhe liderve të tyre më votë nga qytetarët, si rezultat i votuesve emocional dhe më struktur të vetëdijes politike të ngarkuar nga e kaluara dhe jo sa duhet kognitive, si dhe nga përqendrimi i lartë i pushtetit mbi burimet egzistenciale publike dhe mediave jo të pavarura sa duhet.

Guximi qytetar dhe aktiviteti racional politik, ka fillue të rritet. Shoqëria civile përmes OJQ-ve gjithënjë po konsolidohet. Edhe mediat kanë ngrit nivelin e pavarësisë, analizës dhe kritikës së bazuar; por, ende anojnë nga ngjyrimet partiake e grupore.

Mbrojtja nga sulmet e jashtme po bëhet nga forcat ushtarake ndërkombëtare dhe nga politikat përcjellëse të Bashkësisë ndërkombëtare. Ruajtja dhe mbikqyerja e kufirit dhe siguria e brëndshme po bëhet nga Policia e Kosovës. Kosovës, po i mungon forca ushtarake më rolet dhe funksionet e saja të plota.

Nuk ka zhvillim e as integrim të mjaftushëm më vendet dhe organizatat rajonale e ndërkombëtare, pa kapacitete e cilësi qeverisëse. Edhe Bashkësia Ndërkombëtare, ndër kërkesat themelore për integrim po kërkon cilësi e efikasitet në qeverisje, institucionalizim e kulturë sa më demokratike. Andaj, roli dhe ndikimi i cilësisë qeverisëse është esencjal për proceset zhvillimore e integruese kombëtare, rajonale e globale.

Subjektet politike dhe shoqëria, përmes procesit qeverisës janë të obliguara t'i ndryshojnë e tejkalojnë këto rrethana penguese në favor të krijimit të parakushteve për rritje ekonomike dhe zhvillim të sferave tjera, duke krijuar një ambient të sigurtë e të përshtatshëm investues dhe ambient liberal demokratik qeverisës dhe integruës.

Të konsolidohet struktura e vetëdijes politike të votuesve me vlera e kultur politike në favor të kognitivës-zhvillimit human, përcaktimit për demokraci, krijimin e subjekteve e

liderëve të përgjegjës, zgjedhje e konkurrencë parimore, institucione të hapura e funksionale, rritje e zhvillim ekonomik, shërbime publike cilësore, avancim të pozitës ndërkombëtare, integrim të mirëfilltë, integrimin e komuniteteve pakicë, respektim të të drejtave të njeriut, etj. Pra, këto janë disa nga sfidat institucionale e qeverisëse aktuale; konsolidimi i qeverisjes cilësore efikase e efektive, paraqet sfiden kryesore për t'u përballuar suksesshem me sfidat tjera të zhvillimit.

## 9. Referencat

1. AhtisaariPlanNorthKosovo.pdf
2. Constitution of the Republic of Kosovo 2008, retrieved from [http://www.gjks.org/repository/docs/Kushtetuta\\_RK\\_ang.pdf](http://www.gjks.org/repository/docs/Kushtetuta_RK_ang.pdf)
3. Kosovo Declares Independence from Serbia. MSNBC. Retrieved from <http://www.msnbc.msn.com/id/23203607>. February 18<sup>th</sup>, 2008.
4. Banka Qendrore të Kosovës (2012). Gjendja financiare, Gazeta Kosova Sot, p. 20.
5. BQK. Raporti i Stabilitetit Financiar nr 3. Retrieved from <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,131>
6. BQK. Raporti i Bilancit të Pagesave. Retrieved from <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,133>
7. European Commission, (2011), “Kosovo 2011 Progress Report”, Brussels.
8. European Commission, (2012), “Kosovo 2012 Progress Report”, Brussels.
9. European Commission, (2013), “Kosovo 2013 Progress Report”, Brussels.
10. European Commission, (2014), “Kosovo 2014 Progress Report”, Brussels.
11. European Commission, (2015), “Kosovo 2015 Progress Report”, Brussels.
12. European Commission, (2016), “Kosovo 2016 Progress Report”, Brussels.
13. European Commission, (2017), “Kosovo 2017 Progress Report”, Brussels.
14. European Commission, (2018), “Kosovo 2018 Progress Report”, Brussels.
15. Declaration of Independence (17 February 2008). Retrieved from <http://www.assembly-kosova.org/?cid=2,128,1635>
16. Instituti Demokratik i Kosovo’s (KDI) (2013). Raport monitorues: Mbi 10 vjet parlamentarizem në Kosovë, Koha ditore 04.08.13, p. 2.

17. Armitage, J. (Nëndor/2012), "Gjyqësori dhe korrupsioni pengojnë ekonominë", Prishtinë, Kosova sot f.1
18. Inglehart, Wellzel, Christian (2005). Modernization, Cultural Change and Democracy: The Human Development Sequence, Cambridge, p.300.
19. Fule, S. (2012). MSA për Kosovën, Gazeta Koha Ditore, p. 2.
20. FMN (4 janar 2013): Rritja ekonomike, Bruksel, 2012, Telegrafi.
21. FMN (October 2008): Global Financial Stability Report. Bruksel
22. Khaldun, S. (2012). Korrupsioni-problem i institucioneve dhe i shoqërisë, Koha ditore, p. 2
23. Grupi Nndërkombëtar Drejtues (2012). Përfundimi i mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë Kosova sot, p.1
24. GJND (2010). Opinioni për Deklaratën e Pavarësisë 2009. Gazeta Koha Ditore.
25. International Court of Justice advisory opinion on Kosovo's declaration of independence retrieved from [http://en.wikipedia.org/wiki/International\\_Court\\_of\\_Justice\\_advisory\\_opinion\\_on\\_Kosovo%27s\\_declaration\\_of\\_independence](http://en.wikipedia.org/wiki/International_Court_of_Justice_advisory_opinion_on_Kosovo%27s_declaration_of_independence)
26. Merkel, W. (2010). System transformation. Eine Einführung in die Theorie und Empirie der, Wiesbaden, p.30.
27. Fondi Monetar Ndërkombëtar (2013). Rritja ekonomike 2012, Bruksel, Telegrafi, p.1.
28. Organizata Europiane e Gjyqësisë (2013). Korrupsioni largon investoret nga Kosova, Gazeta Kosova sot, p. 1.
29. Lijphart, A. (1999): Patterns of Democracy. Government forms and Performance in 36 Countries, New Haven-London.
30. Lijphart, A. (1994): Electoral Systems and Party systems, Oksford
31. Lijphart, A. 1992: Parliamentary and Presidential Government, Oxford
32. Lijphart, A. (1994): Democracies: Forms, Performance, and Constitutional Engineering, EJPR
33. Lipset, S. M. (1959). Economic development and political Legitimacy, in: APSR 53, 69-105
34. Lipset, S. M. (1960). Political man, London, p. 48.
35. Sekretari i përgjithshëm i OKB-së (2012). Raporti tre mujor për Kosovën, Kosova Sot, p. 1.

36. Fukuyama, F. (2010). State Building–Governance and World Order in the Twenty-First Century in Albanian, AIIS, Tiranë, p. 174-177.
37. Rohan, A. (2012). Plani i Ahtisarit permбанë autonominë e serbëve. Interview. Gazeta Koha Ditore, p. 3.
38. Fule, S. (2012). MSA për Kosovën. Gazeta Koha Ditore, p. 2.
39. Galluci, G., M. (2011). The Ahtisaari Plan and North Kosovo. Retrieved from [http://www.transconflict.com/10/wp-content/uploads/2011/11/PolicyPaper\\_AhtisaariPlanNorthKosovo.pdf](http://www.transconflict.com/10/wp-content/uploads/2011/11/PolicyPaper_AhtisaariPlanNorthKosovo.pdf)
40. Freedom House, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, 2017,2018, Parts of Kosovo. Retrieved from <http://www.freedomhoese.org/> on December 28<sup>th</sup>, 2019.
41. UNDP (United Nations Development Programme), (2009). Human Development Report 2009.
42. UNDP (United Nations Development Programme), (2013). Overcoming barriers: Human mobility and development
43. UNDP (2010). Kosovo Human Development Report 2011: Social Inclusion.
44. Vanhanen, T. (2003). Demokratization. A Comparative Analysis of 170 Countries, London.

## **PËRGJEGJËSIA JURIDIKO CIVILE PËR DËMIN E SHKAKTUAR NGA KAFSHËT**

### ***A b s t r a k t***

*Ky punim ka për qëllim që të shpalosë rëndësinë e përgjegjësisë juridiko-civile për dëmin e shkaktuar nga kafshët. Përgjegjësia juridiko civile për dëmin e shkaktuar nga kafshët bën pjesë në llojin e përgjegjësisë për sendet e rrezikshme ose veprimtaritë e rrezikshme. Duke qenë se inkuadrimit të saj e hasim në kuadër të kësaj përgjegjësie, atëherë afërmendsh se kjo përgjegjësi duhet trajtuar në aspektin e përgjegjësisë pavarësisht fajit për dëmet që shkaktojnë kafshët ndaj të tjerëve; mirëpo, duke mos përjashtuar edhe përgjegjësinë subjektive (sipas fajit), si dhe përgjegjësinë sipas supozimit të fajit, të cilat në raste të caktuara paraqiten si bazë për aplikim.*

*Kësisoj, duke marrë në konsideratë faktet të cilat jo rrallëherë paraqiten për dëmet që shkaktojnë kafshët, si dhe dilemat se cila bazë juridike e përgjegjësisë duhet aplikuar për t'u mbrojtur nga këto dëme, për këto shkaqe dhe jo vetëm, jam munduar që të paraqes rolin e kësaj përgjegjësie në pikëpamjen e së drejtës pozitive, se si sipas bazave juridike të drejtave subjektive iu ofrohet mbrojtje në rast cenimi nga ky lloj dëmi.*

***Fjalët kyçe:*** *Përgjegjësia juridiko-civile, kafshë, dëm, bazë juridike, përgjegjësi pavarësisht fajit, përgjegjësi subjektive, përgjegjësi sipas supozimit të fajit.*

### **SHQYRTIME HYRËSE**

**(Një histori e shkurtër e përgjegjësisë pavarësisht fajit)**

Revolucioni industrial, i cili mundësoi vënien në shërbim të njeriut të energjive me potenciale tepër të mëdha, sikurse energjia termike, kimike, elektrike e atomike<sup>76</sup>, bëri të mundur që të zhvillohej *mekanika* gjatë shekullit XIX, e cila u bë kështu dhe shkaktari i shumëfishimit të aksidenteve (kryesisht aksidentet në punë e, më vonë, edhe në qarkullim); aksidente të shumta që shkaktinin dëme, e për të cilat nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse dikush ka faj<sup>77</sup>. Kështu, në një sistem me përgjegjësi të bazuar ekskluzivisht tek faji, ishte pra e pamundur për viktimat (të dëmtuarit) e këtyre rasteve që të merrnin dëmshpërblim. Për këto arsye dhe me dëshirën për të përmirësuar gjendjen e këtyre personave, u kërkuar edhe parimi i përgjegjësisë pa faj<sup>78</sup>. Ngase po të kishte mbetur përgjegjësia civile nga dëmet jashtëkontraktore vetëm tek domosdoshmëria e provimit të fajësisë, shumë të dëmtuar do të mbeteshin të padëmshpërblyer<sup>79</sup>. Prandaj, me shfaqjen e përgjegjësisë objektive, pra për sendet ose veprimtaritë e rrezikshme, përveçse që u mbulua natyra juridike e një burimi që paraqiste rrezik të shtuar për të tjerët, njëherit u eliminua edhe koncepti i dominimit të frymës tradicionale, ku dëmtuesi mbante përgjegjësi vetëm për dëmet e shkaktuara sipas fajit<sup>80</sup>.

Pra, siç mund të shihet, zanafillën e krijimit të përgjegjësisë objektive e gjejmë më vonë në raport me atë të fajit; pasi që deri vonë faktori determinues i përgjegjësisë deliktore ka qenë vetëm faji. Vlen për t'u theksuar, se në të Drejtën e Detyrimeve njihet edhe përgjegjësia sipas supozimit të fajit (*për veprimet e të tjerëve*). Ndërsa ka dilema për sa i përket ekzistimit edhe të një bazë tjetër të përgjegjësisë, asaj të drejtshmërisë<sup>81</sup>.

### 1.1. Bazat e përgjegjësisë juridiko civile

Duhet bërë një dallim substancial ndërmjet bazave juridike që derivojnë nga përgjegjësia juridiko-civile, pasi që, vetëm në këtë drejtim, pas krijimit të njohurive në lidhje me dallimet në mes tyre, bëhet e mundur edhe aplikimi i tyre në mënyrë të veçantë për çdo shkaktim dëmi.

Andaj, në këtë aspekt themi se kemi të bëjmë me përgjegjësi subjektive kur baza shprehet në *faj*, tek përgjegjësia për të tjerët, kur baza shprehet në *fajin e supozuar*, kur kemi

<sup>76</sup> Muskaj, A, *Përgjegjësia civile nga shkaktimi i dëmit jo pasuror*, Tiranë, 2013, fq. 39.

<sup>77</sup> Bytyçi, A, *Përgjegjësia juridike civile për sendet dhe veprimtaritë e rrezikshme – aspekte krahasuese Kosovë – Shqipëri*, Prishtinë, 2019, fq. 14.

<sup>78</sup> Legier, G, *E Drejta Civile – Detyrimet*, Botimi 19 – 2008, fq. 128.

<sup>79</sup> Mataj, R, *Përgjegjësia jashtëkontraktore e organëve publike në Shqipëri*, Tiranë, 2017, fq. 64.

<sup>80</sup> Bytyçi, A, *op.cit*, fq. 14.

<sup>81</sup> Alishani, A, *E Drejta e Detyrimeve - Pjesa e Përgjithshme*, Prishtinë, 1985, fq. 609.

të bëjmë me përgjegjësinë për sendet ose veprimtaritë e rrezikshme themi se kemi të bëjmë me përgjegjësi *pavarësisht fajit*; çka nënkupton se, me rastin e shpërblimit të dëmit, nuk merret parasysh elementi subjektiv i shkaktuesit të dëmit, pasi detyrimi për zhdëmtim e ngarkon edhe pa pasur nevojë që të vërtetohet prezenca e fajit<sup>82</sup>. Ngase thjesht kërkohet të ekzistojë **lidhja kauzale**<sup>83</sup>. Ndërsa me *lidhje kauzale*<sup>84</sup> nënkuptojmë raportin ndërmjet shkakut dhe pasojës së dëmshme. Përndryshe ky raport (*shkak-pasojë*), duhet të ketë koneksitet të vazhdueshëm deri në momentin e shkaktimit të dëmit, si dhe mos të ketë edhe ndonjë pengesë<sup>85</sup> që do të ndikonte në përjashtimin e përgjegjësisë së dëmtuesit për dëmet që shkaktojnë kafshët e tij, tjetrit. *A contrario*, do të përjashtohet përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga kafshët.

Në këtë kontekst, mund të themi se një pjesë e përgjegjësisë juridike për dëmin e shkaktuar nga kafshët (të rrezikshme) u evoluua nën dritën e vetë zhvillimit të përgjegjësisë objektive ose pavarësisht fajit. Kështu, krahas kësaj, duke u bërë edhe shkaktar i krijimit të detyrimeve sipas ligjit.

## **PËRGJEGJËSIA JURIDIKO CIVILE PËR DËMIN E SHKAKTUAR NGA KAFSHËT<sup>86</sup>**

Gjatë gjithë zhvillimit të shoqërisë njeriun me kafshën e ka karakterizuar një marrëdhënie e veçantë, marrëdhënie kjo e cila ka ndryshuar dita – ditës, duke evoluuar. Ajo është shfaqur në forma nga më të ndryshmet, si p.sh.: përdorimi i tyre nga njeriu për përfitime<sup>87</sup>, e deri tek dëmet<sup>88</sup> që shpeshherë kanë cenuar integritetin fizik, trupor, ose pasurinë e të tjerëve<sup>89</sup>. E kur dëmi shkaktohet prej tyre (*kafshëve*), atëherë themi se kemi të

---

<sup>82</sup> Mamuti, A, *Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit në Maqedoni*, Tiranë, 2013, fq. 82.

<sup>83</sup> Bytyçi, A, *op.cit.*, fq. 14.

<sup>84</sup> Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit. Shih nenin 154 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), Gazeta Zyrtare 16/2012, data e publikimit 19.06.2012.

<sup>85</sup> P.sh. dëmi është shkaktuar nga i dëmtuari, nga personi i tretë, nga fuqia madhore, ose rasti.

<sup>86</sup> Me nocionin kafshë nënkuptojmë të gjitha kafshët e gjalla, duke përfshirë edhe shpezët, peshqit dhe bletët, larvat që jetojnë të lira dhe format larvore riprodhuese, por pa përfshirë format fetale ose embrionike. Shih nenin 3 të Ligjit Nr. 02/L-10 për Përkujdesjen ndaj Kafshëve të Kosovës, Gazeta Zyrtare 5/2006, data e publikimit 01.10.2006.

<sup>87</sup> Bardhi, A, *Përgjegjësia civile për dëmin jashtë kontraktor të shkaktuar nga të tretët në legjislacionin shqiptar*, Tiranë, 2016, fq. 119.

<sup>88</sup> Me nocionin dëm, nënkuptojmë zvogëlimin e pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi i dhembjeve fizike tjetrit, vuajtjes psikike, ose frikës (dëm jo material). Shih nenin 137 të LMD-së.

<sup>89</sup> Dauti, N, *E Drejta e Detyrimeve - Pjesa e Përgjithshme*, Prishtinë, 2013, fq. 183.



bëjmë me paraqitjen e një baze të veçantë të përgjegjësisë që inkuadrohet në kuadër të përgjegjësisë për sende të rrezikshme<sup>90</sup>, përkatësisht kemi të bëjmë me përgjegjësi objektive, por me një bazë edhe më të zgjeruar<sup>91</sup>. Pra, baza e përgjegjësisë për pronarin apo shfrytëzuesin e sendit (kafshës) nuk është faji i tij, por rreziku që rezulton nga mbajtja apo përdorimi i këtyre sendeve si dhe pa-aftësia për të mbajtur nën kontroll sendin e rrezikshëm<sup>92</sup>. Me këtë mund të themi se me shkaktimin e dëmit krijohet situata specifike juridike ndërmjet viktimës dhe pronarit të kafshës, ose shfrytëzuesit të saj, ose personave tjerë që mund të jenë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga kafshët.

Po ashtu, vlen për t'u theksuar se në raste të caktuara përgjegjësia - pavarësisht fajit për dëmin e shkaktuar nga kafshët - mund të eliminohet si rezultat i paraqitjes së përgjegjësisë subjektive (*sipas fajit*), ose përgjegjësisë sipas supozimit të fajit.

Kjo ecuri e shkoqitjes së dallimeve se cila përgjegjësi (bazë) juridike vjen në shprehje në momentin e shkaktimit të dëmit nga kafshët, na e bën të domosdoshme qasjen në dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve të Republikës së Kosovës<sup>93</sup> (në tekstin e mëtutjeshëm: LMD), të cilat në mënyrë të qartë na paraqesin sajimin e njëjës ose tjetrës. Kësodore, përderisa nën 163 paragrafi 1 i LMD-së pasqyrohet përgjegjësinë *pavarësisht fajit*<sup>94</sup>, ndryshe qëndron situata me paragrafin 2 të nenit 163, ku kjo dispozitë e proklamonte përgjegjësinë sipas *supozimit të fajit*<sup>95</sup>. Nga kjo mund të konkludojmë se implementimi i njëjës ose tjetrës bazë juridike të përgjegjësisë ndikohet nga faktori kafshë se në çfarë vetie (karakteristika) paraqitet pas shkaktimit të dëmit. Pra, nëse kafsha është e rrezikshme, atëherë themi se kemi të bëjmë me *përgjegjësi pavarësisht fajit*. LMD nuk jep përkufizim të nocionit send (*kafshë*) të rrezikshëm, mirëpo përkufizimin e sendit e gjejmë në praktikën gjyqësore dhe në doktrinën juridike ku sendin e konsiderojnë të rrezikshëm, i cili sipas pozitës, përdorimit, *vetive* ose përbërjes paraqet rrezik për rrethin, prandaj duhet të mbikëqyret me kujdesin më të madh<sup>96</sup>. Pra, me nocionin kafshë të rrezikshme në kuptimin e gjerë duhet nënkuptuar të gjitha kafshët

<sup>90</sup> Bytyçi, A, *op.cit*, fq. 27.

<sup>91</sup> Bardhi, A, *op.cit*, fq. 120.

<sup>92</sup> Bardhi, A, *op.cit*, fq. 120.

<sup>93</sup> Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), Gazeta Zyrtare 16/2012, data e publikimit 19.06.2012.

<sup>94</sup> Shih nenin 163 parag. 1 të LMD, Zotëruesi i kafshës së rrezikshme është përgjegjës për dëmin e shkaktuar prej saj.

<sup>95</sup> Shih nenin 163 parag. 2 të LMD, Zotëruesi i kafshës shtëpiake është përgjegjës për dëmin e shkaktuar prej saj, përveç nëse provohet se zotëruesi ka treguar kujdesin dhe mbikëqyrjen e nevojshme. Kështu edhe në të drejtën komparative, shih Kodin Civil të Shqipërisë (KCSH), nenin 621.

<sup>96</sup> Dauti, N, *op.cit*, fq. 176; Dauti, N & Berisha, R & Vokshi, A & Aliu, A, *Komentari i Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve*, Libri I, Prishtinë, 2013, fq. 194; Maljkovic.M, *Objektivna odgovornost u gradanskom pravu (opasna stvar)*, Gospic, 2016, fq. 19; Bytyçi, A, *op.cit*, fq. 15-16 (pasuruar edhe me raste nga praktika gjyqësore).

që janë në gjendje që në raste dhe situata të ndryshme të shkaktojnë dëm. Këto mund të jenë: kafshët shtëpiake në cilësinë e kafshëve të rrezikshme, kafshët e egra<sup>97</sup> që janë në pyllin e mbrojtur, kafshët e egra në parkun nacional, edhe eventualisht kafshët e egra në rezervate, kafshët e egra që shfrytëzohen për nevoja të cirkut, ose kopshtit zoologjik, si dhe kafshët e egra që janë jashtë pyllit të mbrojtur.

Por nëse kafsha është shtëpiake, atëherë kemi të bëjmë me *përgjegjësinë sipas supozimit të fajit*. Marrë në përgjithësi, kafshë të rrezikshme do të konsideroheshin kafshët e egra<sup>98</sup>. Kafshët shtëpiake, në rrethana normale, nuk konsiderohen kafshë të rrezikshme<sup>99</sup>. Mirëpo, kjo nuk vlen gjithmonë dhe për të gjitha kafshët. Themë gjithmonë ngase disa nga kafshët shtëpiake, në periudha të caktuara, mund të jenë të rrezikshme<sup>100</sup>. Në këtë mënyrë, edhe kafshët shtëpiake mund të konsiderohen të rrezikshme, varësisht nga veset (shprehitë) që kanë. Kështu një qen, varësisht nga vetitë që ka, mund të konsiderohet i rrezikshëm, ndërsa tjetri jo. P.sh. qentë e racës Pit bull, Presa Canario, Rottweiler, Dogo Argentino, etj., edhe pse njihen si kafshë shtëpiake, konsiderohen kafshë të rrezikshme për shkak të tipareve dalluese që kanë, gjë që nuk ndodh me qentë e luksit; ose në rastin tjetër, dashi konsiderohet se ka veti të rrezikshme, gjë që nuk ndodh me delen, përveç nëse është e infektuar.

Përndryshe, ky dallim për *vetitë* e kafshëve nuk mund të bëhet nga një laik, prandaj për krahasimin, përkatësisht për fitimin e njohurive në lidhje me *vetitë* e tyre, duhet të kërkohet edhe ndihma e ekspertëve të lëmive përkatëse, të cilët nëpërmjet ofrimit të ekspertizave të tyre profesionale, japin edhe vlerësimet në lidhje me vetitë e kafshëve se a konsiderohen apo jo të rrezikshme për dëmin që shkaktojnë.

## **BAZAT JURIDIKE TË PËRGJEGJËSISË PËR DËMIN E SHKAKTUAR NGA KAFSHËT**

Baza juridike e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar nga kafshët nuk është unike. Këtë e themi duke pasur parasysh mësimet e doktrinës juridike, qëndrimet e praktikës gjyqësore dhe rregullativën nacionale<sup>101</sup>. Kjo nënkuptohet kështu, pasi që dëmet që shkaktojnë kafshët

---

<sup>97</sup> Verzioni Final i Projekt Kodit Civil të Kosovës (PKCK), neni 3 parag. 1. nënparag. 6, Kafshët e egra i nënkupton kafshët dhe shpendët e egra të caktuara me ligj, që formojnë popullata në gjendje të lirë në natyrë ose në sipërfaqe të kufizuara të parapara për kultivim intenziv apo për shumim.

<sup>98</sup> Dauti, N & Berisha, R & Vokshi, A & Aliu, *op.cit*, fq. 210.

<sup>99</sup> Ibid.

<sup>100</sup> Ibid.

<sup>101</sup> Alishani, A, *Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendet e rrezikshme ose veprimtaritë e rrezikshme në të drejtën kontinentale (Civil law) dhe në të drejtën anglosaksone (common law)*, Prishtinë, 2011, fq. 508.

janë të natyrave specifike, prandaj edhe llojet e bazave juridike të përgjegjësive duhet t'i përgjigjen secilit fakt të dëmit në mënyrë të veçantë. Kafshët janë sende të rrezikshme me të cilat mund të kryhen edhe veprimtari të rrezikshme<sup>102</sup>. Këtu duhet thënë se rregullat e të drejtës së detyrimeve shërbejnë me fiksionin juridik, ngase ekziston interesi i caktuar legjitim që thuhet se kafshët janë sende të rrezikshme, edhe pse dihet se kafshët nuk janë sende, por janë gjallesa të cilat konsiderohen si sende të rrezikshme me të cilat mund të kryhen edhe veprimtari të rrezikshme<sup>103</sup>.

Kafshët kanë dobi për njeriun dhe shoqërinë, sepse na kanë shërbyer dhe do të vazhdojnë të na shërbejnë për nevoja të caktuara. Kështu, në periudhat e mëhershme të shoqërisë ato kanë shërbyer si mjet mbijetese, pastaj transporti, me kalimin e kohës ato janë përdorur edhe nëpër luftëra që kanë zhvilluar perandoritë, për qëllime pune, ndërsa sot ato kanë role më të veçanta, si p.sh.: atë të argëtimit, gjuetisë, rojës etj. Ndërsa, në shumë shtete ato shërbejnë edhe si vlera të kombësisë. Si p.sh. flamuri i Shqipërisë e posedon shqiponjën, pastaj në stemën e Francës, në një anë është koka e luanit dhe në anën tjetër koka e shqiponjës. Ndërsa ka shtete të cilat shkojnë edhe më tej, duke i konsideruar kafshët si të shenjta, p.sh. në Indi, lopa konsiderohet e shenjtë. Ndërsa ka pasur raste kur kafshët janë bërë edhe shkaktarë të nxitjes së luftërave, si p.sh. në vitin 1859: ishte vrasja e një derri, që shkaktoi konfrontim ndërmjet autoriteteve amerikane dhe atyre britanike në kufirin mes dy vendeve, në veriun e kontinentit amerikan<sup>104</sup>.

Pra, siç mund të shihet roli i kafshëve nuk është dosido, prandaj edhe të njëjtat nuk mund t'i trajtojmë si sende në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, mirëpo, duke qenë se pronarët, poseduesit ose shfrytëzuesit e tyre nxjerrin interesa të caktuara nga to, atëherë duhet të mbajnë përgjegjësi edhe për çdo dëm që shkaktojnë, e që nëpërmjet *fiksionit* juridik, këto dëme konsiderohen dëme që rrjedhin nga sende të rrezikshme, edhe pse në të vërtetë nuk janë të tilla.

Duke marrë parasysh këtë që u tha më lart, në vijim, nëpërmjet analizimit, do të paraqesim çdo bazë juridike të përgjegjësisë civile për mënyrat se si themelohen pas shkaktit të dëmit nga kafshët. Përkatësisht, bazën juridike subjektive, të supozimit të fajit, si dhe atë pavarësisht fajit.

---

<sup>102</sup> Ibid.

<sup>103</sup> Alishani, A, *Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendet e rrezikshme ose veprimtaritë e rrezikshme në të drejtën kontinentale (Civil law) dhe në të drejtën anglosaksone (common law)*, Prishtinë, 2011, fq. 508.

<sup>104</sup> <https://tiranatoday.al/ja-cilat-jane-6-lufterat-te-cuditshme-te-zhvilluara-ne-bote/> - konsultuar më 10.04.2020.

### 3.1. Baza juridike e përgjegjesisë subjektive (sipas fajit) të përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga kafshët

Kjo përgjegjësi sajohet sipas fajit. Andaj edhe themi se kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij<sup>105</sup>. Siç mund të shihet, *faji* është elementi kryesor që ndikon në themelimin e kësaj bazë juridike të përgjegjesisë e që mbulohet me nenin 136 paragrafin 1 të LMD-së. Për këtë arsye të jesh i kujdesshëm do të thotë që të drejtat dhe detyrimet t'i ushtrosh brenda suazave ligjore. E kur personi del jashtë këtyre suazave, atëherë themi se është përgjegjës për veprimet e tija personale të rëna ndesh me ligjin. Ngase dihet kafsha nuk posedon zotësi, e ndaj tyre detyra e përkujdesjes i përket pronarit, poseduesit ose shfrytëzuesit. Andaj ka raste kur pronari, ose poseduesi i kafshës nëpërmjet tyre shkakton dëme, kështu duke qenë përgjegjës sipas fajit. Faji përbëhet nga dy forma: *me dashje* dhe *nga pakujdesia*<sup>106</sup>. Përkufizimin e njërës ose tjetrës si forma të fajit nuk i hasim në rregullat e përgjithshme të përgjegjesisë për dëmin e shkaktuar, e as në përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar nga kafshët. Është paksa për t'u habitur se si doktrina juridike në komentimin që ia ka bërë nenit 163 paragrafit 2 të LMD-së, të njëjtën e paraqet si bazë të përgjegjesisë subjektive (ose fajit)<sup>107</sup>, për çka pretendoj se një cilësim i këtillë i përgjegjesisë është jo adekuat, ngase kjo dispozitë sipas bindjes sime proklamon bazën e përgjegjesisë sipas supozimit të fajit, e për të cilën do të flasim në vijim.

Duke qenë se përkufizimet e formave të fajit nuk i hasim në kuadër të rregullave të përgjithshme të shkaktimit të dëmit, atëherë për të kuptuar të njëjtat duhet t'u qasemi dispozitave të Kodit Penal të Kosovës (KPK)<sup>108</sup>. KPK, dashjen e klasifikon në direkte ose eventuale. Dashja direkte nënkupton kur personi është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj<sup>109</sup>. Ndërsa dashja eventuale kur personi është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij dhe ai e pranon shkaktimin e saj<sup>110</sup>. Në vijim do të paraqesim vetëm dashjen direkte dhe atë eventuale në këtë bazë juridike të përgjegjesisë për dëmin e shkaktuar nga kafshët, pasi që forma tjetër e fajësisë, pakujdesia (*kujdesi* ose *mbikëqyrja*), do të paraqitet te baza juridike e përgjegjesisë sipas supozimit të fajit. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se edhe kjo formë e fajit nuk mund të

<sup>105</sup> LMD, neni 136 parag. 1.

<sup>106</sup> LMD, neni 140, Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia.

<sup>107</sup> Dauti, N & Berisha, R & Vokshi, A & Aliu, A, *op.cit*, fq. 211.

<sup>108</sup> Kodi Penal i Kosovës, Gazeta Zyrtare 2/2019, data e publikimit 14.01.2019.

<sup>109</sup> KPK, neni 21 parag. 2.

<sup>110</sup> *Ibid*, 21 (3).

paraqitet te kjo bazë juridike e përgjegjesisë, por rrethanat në të cilat paraqitet janë më të rralla në krahasim me ato që i hasim në bazën juridike të përgjegjesisë sipas supozimit të fajit. Si raste të paraqitjes së dëmit nga kafshët te përgjegjësia subjektive si shkak i pakujdesisë kemi p.sh. kur shitësi ia shet blerësit kafshën e infektuar, e ndërsa e ka ditur ose ka pasur mundësi të dinte se është e infektuar para shitjes, dhe me këtë blerësit i infektohen kafshët, ose të tjerëve; ose kur pronari e di ose ka pasur mundësi të dinte për veset dhe të metat e kafshës, mirëpo nuk ia cek përcjellësit, organizatorit, ose hanxhiut etj., duke menduar se të njëjtat nuk janë të një intensiteti aq të lartë saqë mund të bëhen edhe shkas i dëmit etj. Pra, kjo lloj baze shkaktohet nga momenti kur pronari, poseduesi ose shfrytëzuesi i kafshës ia kalon zotërimin e kafshës tjetrit, ndërsa ky kalim, pas vete ka përcjellë edhe ndonjë fakt të fshehur dëmtues të pa dëshiruar, për çka përfituesi i posedimit të kafshës, ose të tjerët janë dëmtuar pas momentit të kalimit të kafshës. Në të kundërtën, nëse nuk ekziston pakujdesia, atëherë baza juridike e përgjegjesisë për bartësin e kafshës do të objektivizohet, ngase do të mungonte subjektiviteti – faji i tij.

Mirëpo, siç u tha edhe më lart, faktori qenësor që ka rëndësi te përgjegjësia subjektive (*faji*) është dashja. Në të drejtën pozitive, praktikën gjyqësore si dhe në doktrinën juridike, dashja ka rëndësi, ngase është forma më e rëndë e fajit. Duke qenë si forma më e rëndë e fajit, e njëjta ndahet në *dashje direkte* dhe *eventuale*. Kurse dallimin e saktë të njërës apo tjetrës e hasim vetëm kur vihen në zbatim. Dashja direkte zbatohet atëherë kur pronari, ose poseduesi i kafshës ndërmerr veprime nxitëse ndaj kafshës së tij për të shkaktuar dëm ndaj të tjerëve. P.sh e nxit qenin për të sulmuar. Përndryshe sulmi nuk duhet nënkuptuar vetëm ndaj njeriut, por mund të drejtohet edhe ndaj kafshëve tjera, si p.sh. dyluftimi i qenve etj.. Ndërsa pronari ose poseduesi i kafshës vepron me dashje eventuale kur nuk ekziston dëshira për të shkaktuar dëm, mirëpo përkundër kësaj shkaktimi i dëmit nga kafsha është në shkallë jashtëzakonisht të lartë për të ndodhur sa që edhe (mund të) ndodh. Siç mund të shihet, dallimi ndërmjet këtyre dy llojeve të dashjes, ekziston vetëm për sa i përket elementit volutiv ose të dëshirës. Më konkretisht, është intelekti (vetëdija) dhe/ose dëshira e pronarit, ose poseduesit të kafshës që ndikojnë në themelimin e njërës apo tjetrës. Pra, mbi bazën e tyre, gjendet edhe arsyeja e krijimit të përgjegjesisë subjektive për pronarin, ose poseduesin e kafshës që shkakton dëm.

### **3.2. Baza juridike e përgjegjesisë sipas fajit të supozuar te përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga kafshët**

Ka dilema se kjo bazë - a është e sanksionuar apo jo. Unë them se po dhe atë me nenin 163 paragrafin 2 të LMD-së<sup>111</sup>. Kështu pretendohet edhe nga një pjesë e mësimeve të shkencës juridike dhe të qëndrimeve të praktikës gjyqësore, ku bazë e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar nga kafshët konsiderohet se është faji i supozuar (*praesumptio iuris et de iure*)<sup>112</sup>. Pra, sipas përfaqësuesve të këtij mendimi kur dëmin e shkakton kafsha supozohet se ekziston faji i pronarit ose poseduesit ose shfrytëzuesit të saj<sup>113</sup>. Ky supozim nuk është absolut, ngase mund të rrëzohet nga pronari, ose poseduesi i kafshës, kur provon se ka ndërmarrë masa për të parandaluar çfarëdo lloj dëmi nga kafsha, mirëpo përsëri është shkaktuar dëmi.

Përndryshe, ky lloj baze të shkaktimi i dëmit nga kafshët nuk duhet ngatërruar me bazën juridike të përgjegjësisë subjektive, edhe përkundër asaj që, pakujdesja si formë e fajit derivon nga përgjegjësia subjektive. Arsytet e mos-ngatërrimit të njërës bazë nga tjetra qëndrojnë në një mori karakteristikash dalluese. Fillimisht, baza juridike e përgjegjësisë sipas fajit sanksionohet me nenin 136 paragrafin 1 të LMD-së, siç nuk ndodh me bazën juridike të përgjegjësisë sipas fajit të supozuar, ku sanksionimin e gjejmë në nenin 163 paragrafin 2 të LMD-së. Pastaj te përgjegjësia subjektive barra e provës i përket të dëmtuarit<sup>114</sup>, për dallim nga përgjegjësia sipas supozimit të fajit, ku i përket pronarit ose poseduesit të kafshës. Përndryshe, ky supozim është i mohueshëm (*praesumptiones juris tantum*), dhe mund të argumentohet e kundërta<sup>115</sup>. Karakteristikë tjetër e përgjegjësisë subjektive ose fajit është se sajohet nga veprimet – qëllimet dashëse të pronarit, ose poseduesit të kafshës që i paraprijnë, përkatësisht po të mos kishte kafsha lidhje me to as dëmi nuk do të rezultonte, e që ndryshe ndodh te përgjegjësia sipas supozimit të fajit, ku veprimet dëmtuese të kafshës nuk janë të lidhura me qëllimet e pronarit, ose poseduesit të saj, por me mungesën e mbikëqyrjes, përkatësisht pengimit të kryerjes së faktit (*culpa in vigilando*). Përveç këtyre elementeve, për këtë bazë të përgjegjësisë thuhet se është bazë joefikase (*inefficace*), sepse është shumë vështirë të provohet mungesa e fajit (*l'absence de faute*)<sup>116</sup>, nga ana e pronarit, poseduesit ose shfrytëzuesit të kafshës.

---

<sup>111</sup> Kështu edhe sipas nenit 242 parag. 2 të PKCK, si dhe në të drejtën komparative, shih nenin 1243 të Kodit Civil të Francës; nenin 621 të KCSH; nenet 1320-1322 të Kodit Civil të Austrisë; nenin 2052 të Kodit Civil të Italisë; si dhe nenin 56 të Ligjit për Detyrimet i Zvicrës.

<sup>112</sup> Alishani, A, *op.cit*, fq. 514.

<sup>113</sup> Alishani, A, *op.cit*, fq. 514.

<sup>114</sup> Ibid, fq. 509; Kështu edhe sipas nenit 7 parag. 1, lidhur me nenin 319 parag. 1 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, Gazeta Zyrtare 38/2008, data e publikimit 20.09.2008.

<sup>115</sup> Gams, A, *Hyrje në të Drejtën Civile*, 1986, fq. 163.

<sup>116</sup> Alishani, A, *op.cit*, fq. 514.

Ndërsa ajo se çka na intereson ose shpreh interes më shumë tek ky lloj bazë është *pakujdesia*. Pakujdesia është forca rënduese e krijimit të përgjegjësisë së supozimit të fajit të dëmi i shkaktuar nga kafshët shtëpiake. Edhe pakujdesia sikurse dashja që u sqarua te baza juridike e përgjegjësisë subjektive, klasifikohet në dy lloje: Në pakujdesinë e vetëdijshme dhe të pavetëdijshme. Në teorinë juridike të së Drejtës së Detyrimeve, pakujdesia vlerësohet në *culpa lata* ose *culpa levis*. Personi vepron me pakujdesi të vetëdijshme kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij, por me mendjelehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet apo se ai do të mund ta parandalojë shkaktimin e saj<sup>117</sup>. Ndërsa personi vepron me pakujdesi të pavetëdijshme kur nuk është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij edhe pse në rrethanat dhe sipas vetive të tij personale ka mund të ishte apo do duhej të ishte i vetëdijshëm për këtë mundësi<sup>118</sup>. Pakujdesia e pavetëdijshme e pronarit, ose poseduesit të kafshës për dëmin e shkaktuar nga kafsha, vjen në konsideratë kur nuk pritet që të shkaktohet dëmi nga kafsha. P.sh. nga qentë e luksit etj.

Pra, kafshët që shërbejnë për kryerjen e ndonjë profesioni dhe ndërkohë shkaktojnë dëm atëherë supozohet faji ose i pronarit ose i poseduesit ose i shfrytëzuesit të kafshës.

Ndërsa përcaktimi se kur kemi të bëjmë me pakujdesinë e vetëdijshme ose atë të pavetëdijshme varet nga rrethanat e mbikëqyrjes së kafshës.

Në të vërtetë, ajo se çka vlen për diskutim është rasti kur dëmi shkaktohet nga kafsha e rrezikshme, mirëpo që paraprakisht ka bërë pjesë në kafshët shtëpiake dhe, me këtë sajone përgjegjësinë sipas supozimit të fajit. Pra, si është e mundur që më lart është thënë se për dëmin që shkaktojnë kafshët e rrezikshme sajohet përgjegjësia pavarësisht fajit, e këtu thuhet ndryshe?!

Prandaj, në lidhje me këtë çështje, përgjigjja do të jepet si në vijim:

Përderisa te rasti i parë dëmi paraqitet vetëm nga kafsha e rrezikshme, aty nuk gjenden edhe format e fajit, andaj në këtë drejtim natyrshëm që pritet të jetë edhe përgjegjësia pavarësisht fajit, e që ndryshe është situata te rasti i dytë, ku pakujdesia paraqitet krahas dëmit të kafshës shtëpiake, por që vetitë i ka të kafshës së rrezikshme, dhe me këtë ndikohet në themelimin e përgjegjësisë sipas supozimit të fajit, e cila përgjegjësi mbështetjen ligjore e gjen në nenin 163 paragrafin 2 të LMD-së.

---

<sup>117</sup> KPK, 23 (2).

<sup>118</sup> Ibid, 23 (3)

Në të vërtetë, dilema tjetër është se si do të veprohet në rastin kur dëmi shkaktohet nga kafsha shtëpiake që fiton cilësitë e kafshës së rrezikshme, pronari ose poseduesi i saj ka treguar kujdes (nuk mungon kujdesi), mirëpo fillojnë të paraqiten elemente të bazës juridike të përgjegjesisë pavarësisht fajit?! Kur themi për kafshët shtëpiake këtë mendojmë për kafshët siç janë lopa, demi, kau, mushka, gomari, kali, kafshët që shërbejnë për dëfrim, për sport, kafshët luksoze<sup>119</sup> etj. Me këtë rast themi se është ende diskutabile mundësia e kalimit nga përgjegjësia e supozimit të fajit në atë objektive, ngase dëmi paraqitet nga kafsha shtëpiake, dhe ky dëm mbulohet vetëm me bazën juridike të përgjegjesisë së supozimit të fajit. Mirëpo, edhe për këtë ka mendime që i kundërvihen këtij konstatimi. Kështu, baza e përgjegjesisë nuk është zgjidhur në mënyrë unike dhe, lirisht mund të themi se do të jetë *dominus ai i cili do ta zgjidhë këtë ekuacion me të panjohura në praktikën gjyqësore varësisht nga rasti në rast.*

Për fund, lidhur me këtë bazë të përgjegjesisë, themi se lind kur dëmi shkaktohet nga kafsha shtëpiake, kur pronari, poseduesi ose shfrytëzuesi i saj që ka në zotërim të njëjtën nuk ka treguar kujdes dhe, nga kjo pakujdesi është shkaktuar edhe dëmi. Ndërsa në rastet kur dëmi paraqitet nga kafshët shtëpiake, por që vetitë i kanë të kafshëve të rrezikshme, pronari, poseduesi ose shfrytëzuesi i tyre është treguar i kujdesshëm, mirëpo prapëseprapë është shkaktuar dëmi, atëherë themi që këtë lloj dëmi e mbulon baza e përgjegjesisë pavarësisht fajit; pasi që i dëmtuari në një mënyrë ose tjetrën duhet kompensuar. Përndryshe, duhet kuptuar mirë se jo çdo herë dëmin që shkakton kafsha shtëpiake, mund ta konsiderojmë si dëm të kafshës së rrezikshme, me qëllim të përfitimit nga baza e përgjegjesisë pavarësisht fajit.

### **3.3. Baza juridike e përgjegjesisë objektive (pavarësisht fajit) të përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga kafshët**

E drejta materiale e sanksionon edhe përgjegjësinë pavarësisht fajit<sup>120</sup>. Nisma e kësaj bazë të përgjegjesisë është në përgjegjësinë noxale (action noxalis)<sup>121</sup> të së drejtës romake<sup>122</sup>.

---

<sup>119</sup> Në Kodin Civil të Gjermanisë dallohet lloji i përgjegjesisë në rastin kur dëmin e shkaktojnë vetëm kafshët shtëpiake. Sipas këtij kodi, nëse dëmin e shkaktojnë kafshët shtëpiake, të cilat pronari i ruan për kryerje të punëve apo të ndonjë veprimtarie tjetër me interes komercial (lopa, kali, qeni për roje etj.) baza e përgjegjesisë për pronarin është sipas fajit të supozuar. Kurse, kur bëhet fjalë për kafshë të cilat pronari i ruan për argëtim, përkatësisht kafshët luksoze, atëherë baza e përgjegjesisë së pronarit është e njëjta si edhe tek kafshët e egra, pra kemi përgjegjësi **pa faj, objektive**. Shih Bardhi, A, *op.cit*, fq. 130.

<sup>120</sup> LMD, neni 136 parag 2 lidhur me nenin 163 parag. 1. Kështu edhe PKCK, neni 242 parag. 1.

<sup>121</sup> Ishte një përgjegjësi që i ngarkohej zotëruesit të skllavit për dëmin që shkaktonte ky i fundit dhe, në këtë rast zotëruesi kishte dy alternativa ose të paguante dëmin e bërë ose t'ia dorëzonte skllavin palës ankuese.



Është e vetëkuptueshme se përgjegjësia noksale nuk korrespondon me perfeksionimin që gëzon sot përgjegjësia për sendet ose veprimtaritë e rrezikshme. Mirëpo, e njëjta ka shërbyer si një bazë që përgjegjësia pavarësisht fajit të avancohet gradualisht. Pra, kjo bazë e përgjegjësive është baza juridike më e vjetër në këtë lëmi, por edhe më gjerë, sepse sipas mësimëve të shkencës juridike romake dhe kazuistikës së tyre baza e përgjegjësive për dëmin nga kafshët mbështetet në faktin e ekzistimit të dëmit dhe në bazë të tij është sajuar përgjegjësia e pronarit të kafshës kur ajo ka shkaktuar dëm<sup>123</sup>. Andaj, edhe thuhet se për dëmet, të cilat i shkaktojnë kafshët përherë ka ekzistuar përgjegjësia e rreptë<sup>124</sup>.

Me krijimin e kësaj përgjegjësie mund të themi se u bë edhe një revolucion i madh në të drejtën e detyrimeve, respektivisht në krijimin e marrëdhënieve të detyrimeve ndërmjet viktimës dhe dëmtuesit. Ngase për dallim nga degët e tjera të së drejtës, si p.sh. në të drejtën penale, etj., ky lloj përgjegjësia nuk pranohet; ngase në këtë degë të së drejtës faji (përgjegjshmëria) paraqitet si njëri prej elementëve të përgjithshëm të veprës penale dhe konstituimit të përgjegjësive penale të kryerësit të veprës penale.

Sipas kësaj baze juridike të përgjegjësive për dëmin e shkaktuar nga kafshët, përgjegjësia sajuhet pa marrë parasysh fajin<sup>125</sup>. Pasi që e drejta pozitive e njeh si të tillë dhe i jep efekte të aplikimit që në çastin kur dëmi ka lidhje kauzale. Them **lidhje kauzale** ngase shkak dhe pasoja e dëmshme rrjedh nga **kafsha e rrezikshme**. Pra mjafton ky fakt, që të ekzistojë e të bëhet shkak paraqitja e kësaj baze.

Prandaj, për këtë arsye dhe jo vetëm për këtë, u zhvillua edhe kjo bazë e përgjegjësive që të mbulonte këtë lloj dëmi kur shkaktohet nga kafshët e rrezikshme. E me rregullin përjashtimor edhe nga kafshët shtëpiake<sup>126</sup>.

## KUSHTET E PËRGJEGJËSISË PËR DËMIN E SHKAKTUAR NGA KAFSHËT

### 4.1. Duhet të shkaktohet dëmi

Një prej disa kushteve për sajimin e përgjegjësive juridiko – civile për dëmin e shkaktuar nga kafshët është që të shkaktohet dëmi nga kafshët. Për arsyen e thjeshtë se, po të mos ishte ky dëm nuk do të ishte as kjo përgjegjësi. Pra, dëmi nga kafsha është ajo që sajón

---

<sup>122</sup> Alishani, A, *op.cit*, fq. 516.

<sup>123</sup> Ibid.

<sup>124</sup> Millosheviq, LL, *E Drejta e Detyrimeve*, 1977, fq. 190.

<sup>125</sup> Millosheviq, LL, *E Drejta e Detyrimeve*, 1977, fq. 190.

<sup>126</sup> Krahaso, *supra*, me bazën juridike të përgjegjësive sipas supozimit të fajit.

këtë lloj të përgjegjësisë. Me nocionin dëm nënkuptojmë zvogëlimin e pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi i dhembjeve fizike tjetrit, vuajtjes psikike, ose frikës (dëm jo material)<sup>127</sup>.

Themi se dëmi shkaktohet nga kafshët kur ai rrjedh nga kafshët e rrezikshme ose kafshët shtëpiake. Me kafshë të rrezikshme nuk duhet nënkuptuar vetëm kafshët të cilat në bazë të sjelljeve të tyre të zakonshme paraqesin rrezik për rrethin, por ato duhet konceptuar në një kuptim më të gjerë, duke përfshirë por pa u kufizuar vetëm në kafshët shtëpiake në cilësinë e kafshëve të rrezikshme, kafshët e egra që janë në pyllin e mbrojtur, kafshët e egra në parkun nacional, edhe eventualisht kafshët e egra në rezervate, kafshët e egra që shfrytëzohen për nevoja të cirkut, ose kopshtit zoologjik, si dhe kafshët e egra që janë jashtë pyllit të mbrojtur.

Në parim kafshët e rrezikshme janë sende të askujt (res nullius), por jo gjithmonë<sup>128</sup>. Me këtë nuk duhet nënkuptuar se baza e përgjegjësisë pavarësisht fajit nuk mund të themelohet, me arsyetimin se janë kafshë të lira dhe përgjegjësia nuk rëndon mbi askënd. Pasi që sot shumica e të drejtave kombëtare kanë hequr ose e kanë zvogëluar në maksimum mundësinë që kafshët e egra të trajtohen si “pa zot”, kjo pasi në rastin e një dëmi të mundshëm të ardhur prej tyre, viktimia apo pala e dëmtuar nuk do të mund të realizonte zhdëmtimin e tij<sup>129</sup>. Kjo mund të interpretohet kështu duke u bazuar edhe në parimin kushtetues me anë të të cilit sigurohet integriteti i njeriut dhe pasuria e tij, çka nënkupton se pala e dëmtuar gati çdoherë fiton të drejtën për shpërblimin e dëmit, edhe në rastin kur dëmi është shkaktuar nga kafshët e egra<sup>130</sup>.

Ndërsa themi se dëmi shkaktohet nga kafshët shtëpiake kur nga të njëjtat nuk pritet që në bazë të sjelljeve të shkaktohet dëmi. Kafshët shtëpiake janë gjallesa që rrinë, rriten dhe shumohen nën kontrollin dhe pushtetin e njeriut ose institucioneve të caktuara<sup>131</sup>. Përndryshe kafshët shtëpiake janë krijuar nga kafshët e egra, pasi që njeriu ato i ka zbutur dhe në këtë mënyrë është krijuar grupacioni i kafshëve që ka pasur dhe ka vlerë evidente për njeriun dhe mbarë shoqërinë<sup>132</sup>. Kafshë shtëpiake janë delja, lopa, kau, buallica, kali, qeni, dhia e butë, derri i butë, maca shtëpiake, bletët në zgjoje, kafshët me pupla (biba, pata, pula, rosa), etj<sup>133</sup>.

---

<sup>127</sup> LMD, nenin 137.

<sup>128</sup> Për më hollësisht në lidhje me këtë shih Gams, A, *Bazat e së Drejtës Reale*, 1972, fq. 2.

<sup>129</sup> Bardhi, A, *op.cit*, fq. 121-122.

<sup>130</sup> Ibid.

<sup>131</sup> Alishani, A, *op.cit*, fq. 525.

<sup>132</sup> Ibid.

<sup>133</sup> Ibid.

#### **4.2. Duhet të ekzistojë lidhja kauzale ndërmjet veprimit të kafshës dhe dëmit të shkaktuar**

Një tjetër kusht mjaft i rëndësishëm për themelimin e përgjegjësisë juridiko civile për dëmin e shkaktuar nga kafshët është që të ekzistojë edhe **lidhja kauzale**. Me lidhje kauzale nënkuptojmë raportin ndërmjet shkakut dhe pasojës. Më konkretisht veprimi i kafshës duhet të jetë në lidhje të drejtpërdrejt me pasojën e dëmshme. Me këtë themi se nuk do të kishte pasojë po të mos kishte shkak (*conditio sine quo non*). Pra, trupi do ta ruante gjendjen e prehjes apo të lëvizjes së njëtrajtshme po që se mbi të nuk do të ushtrohej ndonjë forcë (veprim).

*Conditio sine quo non*, zbatohet në formë të ndryshme të dëmi i shkaktuar nga kafshët. P.sh. te kafshët e rrezikshme themi se pasoja paraqitet drejtpërdrejt nga to, te kafshët shtëpiake po ashtu, por si rezultat i neglizhencës së mbikëqyrjes (*culpa in inspiciendo*), ndërsa në rastet tjera mund të jetë vetë personi si shkaktar që ndikon në paraqitjen e dëmit nga kafsha.

#### **4.3. Duhet të ekzistojë veprimi ose mosveprimi**

Thënë të drejtën ky lloj kushti nuk luan ndonjë relevancë të jashtëzakonshëm të dëmi i shkaktuar nga kafshët. Ngase kushti kryesor dhe më i rëndësishëm i themelimit të përgjegjësisë juridiko-civile për dëmin e shkaktuar nga kafshët është *lidhja kauzale*. Mirëpo, nuk do të thotë se veprimi apo mosveprimi nuk hyjnë fare në punë për sa i përket sajimit të kësaj përgjegjësie.

Mjafton të diktojmë bazën e përgjegjësisë subjektive dhe atë të supozimit të fajit, nga ku do të vërtetojmë se po të mos ishte ushtruar te njëra veprimi, e te tjetra mosveprimi, atëherë edhe dëmi nga kafsha nuk do të rridhte.

#### **4.4. Duhet të parashtrohet kërkesa e të dëmtuarit për zhdëmtim**

Natyrshëm se, çdo kush që tjetrit i shkakton dëm, i lind detyrimi kundrejt atij që ka të drejtë për të kërkuar kompensim. Personi i dëmtuar quhet ai, i cili dëmtohet nga veprimet e kafshës. Në momentin e shkakimit të dëmit, atëherë krijohet edhe raporti jashtëkontraktor ndërmjet tij dhe dëmtuesit, i cili është pronar, posedues ose shfrytëzues i kafshës që ka

shkaktuar dëm. Ky raport nënkupton që të dëmtuarit t'i krijohet mundësia si nëpërmjet rrugëve jashtëgjyqësore apo atyre gjyqësore, të realizojë kompensimin e dëmit. Kompensimi i dëmit mund të realizohet si për dëmin material ashtu edhe për atë jo-material (p.sh.: *lëndim trupor, frikë*, etj.). Në qoftë se kompensimi i dëmit nuk realizohet nëpërmjet rrugëve jashtëgjyqësore, pra me marrëveshje, atëherë i dëmtuari ka të drejtë që nëpërmjet padisë për kompensim të dëmit të kërkoj nga gjykata që ta detyroj dëmtuesin për t'ia kompensuar dëmin, për të cilin nuk kanë mundur të arrijnë akord të kompensimit në rrugë jashtëgjyqësore. Përndryshe i dëmtuari kërkesën e vetë për shpërblimin e dëmit të shkaktuar duhet ta paraqes brenda afatit prej tri (3) vite nga data kur ka marrë dijëni për dëmin dhe për personin, i cili ka shkaktuar dëmin<sup>134</sup>. Në çdo rast kjo kërkesë parashkruhet për pesë (5) vite nga shkaktimi i dëmit (afat objektiv). Në të kundërtën pas kalimit të kësaj periudhe i shuhet e drejta e kërkimit të përmbushjes së detyrimit<sup>135</sup>. Pasi që dëmtuesi fiton të drejtën e kundërshtimit<sup>136</sup>.

Ky kusht ka rëndësi si në teori ashtu edhe në praktikë, ngase nëpërmjet tij jetësohen edhe kushtet e tjera, në atë mënyrë që, së bashku me to i japin vlerë përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar nga kafshët.

## **SUBJEKTI PËRGJEGJËS**

Për kafshët, përgjegjësinë e mban pronari ose zotëruesi (poseduesi)<sup>137</sup> i tyre. Pronari, mban përgjegjësi për dëmet që shkaktojnë kafshët e tij, kur njëherit është edhe posedues i tyre. Ndërsa poseduesi ose shfrytëzuesi kur nga kafsha nxjerr dobi të caktuar.

Përveç pronarit të sendit, dhe njësoj si ai, përgjigjet edhe personi të cilit pronari ia ka besuar sendin (kafshën) që të shërbehet me të, ose personi i cili përndryshe e ka për detyrë ta mbikëqyrë, ndërsa nuk ndodhet në punë të ai<sup>138</sup>. Vlen për t'u theksuar se, formulimi i kësaj dispozite proklamon një qasje krejtësisht tjetër në raport me atë që paraqet teoria (doktrina) në lidhje me detencën, ku theksojnë se detenca nuk duhet ngatërruar me posedimin, pasi që te detenca është i qartë pushteti faktik mbi sendin, por për dallim nga posedimi, ai kryhet vullnetarisht për tjetrin<sup>139</sup>. Sipas këtij përkufizimi, logjikisht, për çdo dëm që shkaktojnë

---

<sup>134</sup> LMD, neni 357 parag. 1.

<sup>135</sup> LMD, 341 (1).

<sup>136</sup> Ibid, 341 (1,2).

<sup>137</sup> Ibid, 155, lidhur me 163 (1,2).

<sup>138</sup> Ibid, 157 (1).

<sup>139</sup> Krasniqi, A, *E Drejta Biznesore*, Prishtinë, 2016, fq. 114.

kafshët, përgjegjësi duhet të mbajë prapë pronari e jo detentori<sup>140</sup>. Arsyeja korrespondon në atë se: mbajtësit i mungon vullneti, ana shpirtërore, animus<sup>141</sup> që gjendet te posedimi sipas botëkuptimit subjektiv. Mirëpo, ky qëndrim tanimë është suprimuar sikurse nga praktika gjyqësore<sup>142</sup>, ashtu edhe nga e drejta pozitive<sup>143</sup>, ku për të ekzistuar posedimi mjaftohet vetëm pushteti faktik mbi sendin (botëkuptimi objektiv). Kësisoj, duke qenë se ligjvënësi kosovar ka paraparë një sanksionim të këtillë, atëherë themi se edhe *mbajtësit* (detentori) e kafshëve mund të jenë përgjegjës për dëmet që shkaktojnë kafshët ndaj të tjerëve, përgjatë kohës sa gjenden nën mbikëqyrjen e tyre.

Përveç mbajtësit që e ka në posedim, gjegjësisht përdoruesi i kafshës që ia ka dhënë pronari për ta përdorur për interesat e tij, përgjegjësi mund të mbajë edhe pronari i vetë kafshës (sendit), po qe se dëmi ka rrjedh nga ndonjë e metë e fshehur ose nga veçoria e fshehur e sendit për të cilën pronari nuk ia ka tërhequr vëmendjen mbajtësit<sup>144</sup>. P.sh. kur pronari ia jep tjetrit qenin e vetë në ruajtje duke mos i treguar se ka vese dhe gjatë kohës së ruajtjes qeni shkakton dëm; ose kur pronari ia jep hua për përdorim kafshën e infektuar huamarrësit, me ç'rast infektohen kafshët e tij ose të të tjerëve<sup>145</sup> etj.,. Përgjegjësia e pronarit qëndron vetëm në faktin se nuk i ka tërhequr vërejtjen personit të cilit ia ka besuar sendin për të metat apo ndonjë veçori të tij, të cilat kanë qenë të fshehta, por që janë bërë shkak për dëmin e pësuar<sup>146</sup>. E nëse personi (mbajtësi) përgjegjës ia ka kompensuar dëmin të dëmtuarit, atëherë ka të drejtë të kërkojë nga pronari rimbursimin e mjeteve<sup>147</sup>.

Përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga kafshët, përkatësisht për të metat fizike të tyre<sup>148</sup>, do të mbajë pronari edhe atëherë kur marrësit ia dhuron kafshën e nuk ja kumton të fshehtat (metat) e saj, e ndërsa të njëjtat janë bërë shkas i dëmit.

Pronari i sendit (kafshës) të rrezikshëm mban përgjegjësi edhe atëherë kur të njëjtën ia ka besuar personit që nuk është i aftësuar apo nuk është i autorizuar të manipulojë me atë, e ky fakt ka ndikuar që shkaktohet edhe dëmi nga kafsha<sup>149</sup>.

<sup>140</sup> Rregullim të ngjashëm parashihte edhe e drejta zakonore shqiptare – Kanuni i Lek Dukagjinit, saktësisht Nyja e Katërdhjetë e Dytë, § 145: „Po i bani dam kuej bariu me gjë, i zoti i tufës e lan e jo bariu.”

<sup>141</sup> Kondili, V, *E Drejta Civile II, Pjesa e Posaçme, Pronësia, të drejtat reale të përkohshme, trashëgimia*, Geer, 2008, fq. 116.

<sup>142</sup> Praktika gjyqësore posedimin e ka vlerësuar si mbajtje që shprehet në pushtetin faktik mbi sendin dhe që nuk është e nevojshme dëshira e mbajtësit që sendin ta mbajë si të tij. Shih Gjykata Federative e Jugosllavisë MCL-33/94, Krasamanović, T & Kervavica, M, Beograd, 1994, fq. 159-160, cituar prej Musa, M & Musa, K, *E Drejta e Procedurës Civile – Pjesa e Dytë*, Gjilan, 2017, fq. 68.

<sup>143</sup> Për më hollësisht shih Gams, A, *Bazat e së Drejtës Reale*, 1972, fq. 206.

<sup>144</sup> LMD, 157 (2).

<sup>145</sup> Dauti, N, *Kontratat*, Prishtinë, 2016, fq. 364.

<sup>146</sup> Dauti, N & Berisha, R & Vokshi, A & Aliu, *op.cit.*, fq. 199.

<sup>147</sup> LMD, 157 (3).

<sup>148</sup> Alishani, A, *Përgjegjësia për Mungesat Materiale të Sendeve*, Prishtinë, 2004, fq. 188-189.

Pastaj, në rastet kur kafsha i merret kundërligjshëm pronarit, përgjegjës do të jetë përvetësuesi i paligjshëm për dëmet që shkakton kafsha, përveç nëse pronari nuk është përgjegjës për këtë<sup>150</sup>.

### 5.1. Përgjegjësia e pronarit për dëmin e shkaktuar nga kafshët

Është rregull tradicionale që pronari duhet të mbajë përgjegjësi për sendet e tij, kur të njëjtat shkaktojnë dëm ndaj të tjerëve; ngase nga përdorimi ose shfrytëzimi i tyre nxjerr dobi (fitim) të caktuar, të cilat i shërbejnë për plotësimin e nevojave vetjake, familjare ose më gjerë (të realizimit të profitit, etj.). Natyrshëm se kur sendi, përkatësisht kafsha gjendet nën *zotërimin* e tij, dhe gjatë kësaj kohe shkakton dëm, atëherë edhe përgjegjësia duhet të bie mbi të, pronarin. Ngase pronari është dhe duhet të jetë njohës më i mirë i kafshës së vet sepse ka pushtetin faktik dhe juridik ndaj kafshës<sup>151</sup>.

Siç mund të shihet, jo çdo herë poseduesi jo-pronar mban përgjegjësi për dëmet që shkakton kafsha, ngase ka raste kur përgjegjësia sajohet edhe ndaj pronarit të kafshës kur njëkohësisht ka edhe posedimin. Pronari mban përgjegjësi për dëmet që shkaktojnë kafshët e tij, të tjerëve, si gjatë kohës sa janë tek ai, ose kur ikin nga ai<sup>152</sup>, ose kur i humbasin, kur ngacmohen, ose gjatë tentimit të pronarit për t'i zaptuar<sup>153</sup>, ose gjatë tentimit për t'i ndalur derisa janë të shqetësuara, ose gjatë tentimit për t'i zënë, etj.<sup>154</sup> Në këto dhe rastet e tjera eventuale, kafsha i shkakton dëm njeriut, pasurisë ose kafshës tjetër, me çka sipas rregullave krijohet mundësia e kërkesës për zhdëmtim<sup>155</sup>. Kuptohet, ky zhdëmtim realizohet vetëm e vetëm kur plotësohen kushtet e nevojshme<sup>156</sup>.

---

<sup>149</sup> Ibid, 157 (4)

<sup>150</sup> Ibid, 156.

<sup>151</sup> Alishani, A, *op.cit*, fq. 535.

<sup>152</sup> Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPTDS), Gazeta Zyrtare 57/2009, data e publikimit 04.08.2009, neni 32 parag. 4, citon: “Një luzmë (tufë) bletësh bëhet pa pronarë kur gjendet në natyrë të lirë, nuk është ndjekur nga pronari i saj brenda dyzetetë (48) orëve dhe nuk është vendosur ndonjë shenjë në vendqëndrimin e saj të ri.” Pra, siç mund të shihet, kjo dispozitë, pronarit, ende ia njeh pronësinë mbi luzmët e bletëve edhe pse i kanë ikur. Andaj, çdo dëm që shkaktohet nga luzmët e bletëve, brenda kësaj periudhe kohore, përgjegjësia mbi këtë dëm të shkaktuar bie mbi pronarin e tyre, edhe përkundër asaj që luzma e bletëve i ka ikur.

<sup>153</sup> LPTDS, 32 (1).

<sup>154</sup> Ibid.

<sup>155</sup> Alishani, A, *op.cit*, fq. 535.

<sup>156</sup> Me plotësim të kushteve të nevojshme nënkuptojmë një mori rrethanash të cilat duhet të ekzistojnë për themelimin e përgjegjësisë së pronarit për dëmin që shkaktojnë kafshët e tij, tjetrit. Në të kundërtën, nëse nuk ekzistojnë këto kushte, përkatësisht ekzistojnë rrethana që ndikojnë në lirimin e pronarit nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga kafshët, atëherë pamundësohet zhdëmtimi i dëmit. Të tilla raste mund të jenë p.sh. dëmi është shkaktuar nga kafsha nën ndikimin e personit të dëmtuar, të personit të tretë, nga fuqia madhore, rasti, pastaj kur pronarit nuk i kthehet kafsha e humbur sipas zakonit lokal, ose kur pronari ia jep kafshën e tij tjetrit,

Te ky lloj i përgjegjesisë për dëmin që shkaktojnë kafshët ndaj të tjerëve, baza juridike e përgjegjesisë së pronarit mund të sajohet në atë pavarësisht fajit, për dëmin që shkaktojnë kafshët e rrezikshme; në atë sipas supozimit të fajit, kur dëmi rrjedh nga kafsha shtëpiake dhe ndaj saj nuk është treguar kujdes i shtuar; si dhe në atë të fajit, kur veprimet nxitëse të pronarit drejtohen për ta përdorur kafshën me qëllim të shkakimit të dëmit<sup>157</sup>.

## 5.2. Përgjegjësia e shfrytëzuesit të kafshës

Përveç pronarit të kafshës, për dëmin që u shkaktojnë ato të tjerëve, përgjegjësi mund të mbajë edhe shfrytëzuesi që shfrytëzon kafshën për nevoja të caktuara. Arsyeja se pse shfrytëzuesi mban përgjegjësi për dëmin që shkaktojnë kafshët, edhe pse nuk janë të tija, qëndron në faktin se shfrytëzuesi është subjekt që vepron në bazë të autorizimit të pronarit të kafshës. Me këtë autorizim të pronarit, shfrytëzuesi i kafshës krijon prerogativë të caktuar ndaj kafshës së caktuar si dhe realizon synimet e veta që ka për shfrytëzimin e saj, ndërsa pronari nga ana tjetër realizon interesat e veta që ka nga shfrytëzimi i kafshës së tij<sup>158</sup>.

Konkretisht këto situata krijohen te disa lloje të kontratave nga të cilat derivojnë edhe të drejtat dhe detyrimet e shfrytëzuesit kundrejt kafshës së pronarit. P.sh. te *kontrata e huapërdorjes së kafshës*, për çdo dëm që shkakton kafsha gjatë kësaj kohe sa gjendet te përdoruesi huamarrës, përgjegjësi mban ky, ngase përgjegjësia i ngarkohet për shkak të pakujdesisë së mbikëqyrjes. Përveç nëse kafsha e kontratës së huapërdorjes shkakton dëm si rrjedhojë e ndonjë vesi ose ndonjë të mete, për të cilën përdoruesin huamarrës huadhënësi nuk e ka informuar më parë, atëherë për dëmin e shkakuar përgjigjet huadhënësi dhe atë sipas fajit.

Kur lidhet *kontrata e qirasë për kafshën* ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit, për çdo dëm që shkakton kafsha gjatë kohës sa ekziston kontrata në fuqi, përgjegjësi lidhur me to mban qiramarrësi. Kuptohet me përjashtimin nëse kafsha ka pasur ndonjë ves ose të metë që qiradhënësi nuk ia ka treguar më parë qiramarrësit para shkakimit të dëmit.

---

për t'u shërbyer me të dhe, gjatë kësaj kohe e njëjta shkakton dëm, ose në rastin tjetër kur pronari e humbet kohën e paraparë ligjore për ta ruajtur kontinuitetin e pronësisë mbi kafshët e ikura, etj.

<sup>157</sup> Krahaso, *supra*, kapitullin III të këtij punimi.

<sup>158</sup> Alishani, A, *op.cit*, fq. 537-538.

Kur lidhet *kontrata mbi depozitimin e kafshës* krijohen relacione të caktuara juridike ndërmjet depozitarit (ruajtësit) dhe deponentit (lënësit) të kafshës. Ruajtja e kafshës mund të jetë me shpërblim dhe pa shpërblim, mund të jetë me të drejtën e shfrytëzimit të kafshës ose pa të drejtën e shfrytëzimit të kafshës. Parimisht, në rastin e parë, kur kafsha shkakton dëm, depozitari përgjigjet për dëmin, kurse në rastin e dytë, kur kontrata mbi depozitimin e kafshës është pa shpërblim dhe kafsha shkakton dëm, atëherë për dëmin e shkaktuar nga kafsha përgjigjet vetë deponenti i kafshës. Këto janë dy rregulla parimore nga të cilat mund të ketë përjashtime.<sup>159</sup> Thënë të drejtën ky qëndrim i proklamuar, ndoshta në teori mund të gjejë zbatim, mirëpo në aspektin e të drejtës pozitive jo, ngase neni 157 paragrafi 1 i LMD-së, nuk njeh dallime ndërmjet shërbimeve me shpërblim ose pa shpërblim, pasi që sipas kësaj dispozite të përgjithshme, mjafton që sendi (kafsha në këtë rast) të jetë dhënë në shërbim ose nën mbikëqyrje, dhe nga ky moment për çdo dëm që shkakton kafsha përgjegjësia të sajohet mbi dhënësin e shërbimit, ose mbikëqyrësin e saj (*kafshës*).

Pra, nga sa u konstatua më lart, ky lloj përgjegjësie vjen në konsideratë vetëm atëherë kur kafsha paraqitet si *lëndë* e kontratave për shfrytëzimin e sendeve dhe të drejtave. Dhe baza e përgjegjësisë për shfrytëzuesit ose mbikëqyrësit e kafshëve për dëmin që shkaktojnë të njëjtat, ndaj të tjerëve, mund të sajohet në atë pavarësisht fajit, ose supozimit të fajit. Ndërsa probabiliteti i shfaqjes së përgjegjësisë sipas fajit është në shkallë më të ulët.

### 5.3. Përgjegjësia e përcjellësit të kafshës

Shpeshherë në praktikë lind nevoja e lëvizjes apo transportimit të kafshëve të buta, apo edhe atyre të egra, nga një vend në një tjetër<sup>160</sup>. Përcjellja e tyre mund të bëhet në këmbë ose me mjete të ndryshme transporti<sup>161</sup>. Përgjatë përcjelljes së kafshëve ka raste kur dëmi shkaktohet nga të njëjtat të cilat janë duke u transportuar. Ky lloj dëmi mund të jetë dëm ndaj individëve, mjeteve të tjera, apo edhe ndaj kafshëve që gjenden në mjetin transportues. Pyetja që lindë është se, me rastin e shkaktimit të dëmit nga kafsha gjatë përcjelljes, kush duhet të mbajë përgjegjësi për dëmin që shkakton e njëjta? Në lidhje me këtë themi se varësisht nga cili fakt shkaktohet dëmi nga kafsha, ndikohet që të mundësohet edhe krijimi i përgjegjësisë ndaj subjektit. Subjekt përgjegjës mund të jetë përcjellësi, organizatori i transportit, ose edhe vetë pronari i kafshëve që transportohen.

---

<sup>159</sup> Ibid.

<sup>160</sup> Bardhi, A, *op.cit*, fq. 123.

<sup>161</sup> Ibid.



*Përcjellësi* është përgjegjës për dëmin që shkakton kafsha gjatë transportit, kur mbikëqyrjen nuk e realizon në mënyrë të duhur. P.sh. përgjatë udhëtimit, sipas rregullave, pas disa orëve ose në disa vende të caktuara, duhet ta ndalë mjetin transportues dhe t'i zbret kafshët për kryerjen e nevojave fiziologjike, në këtë rast, nëse kafsha shkakton dëme gjatë kësaj kohe, themi se përcjellësi është përgjegjës. Ose në situatën tjetër, kur pas këtij momenti përcjellësi i futë kafshët në mjetin e transportit rrugor, mirëpo nuk sigurohet se ka mbyllur mirë, dhe pas kësaj ndodh që ndonjëra prej tyre të kërcejë nga automjeti, duke shkaktuar kështu aksident në ndonjë veturë, apo mes disa veturave së bashku, të cilat mund të jenë duke ecur pas mjetit transportues të kafshëve.

*Organizatori i transportit* është përgjegjës për dëmin që shkaktojnë kafshët, kur organizimi i transportimit të tyre nuk është realizuar mirë nga fillimi. P.sh. ka vendosur që t'i bëjë bashkë disa lloje të ndryshme të kafshëve; ose kur mjeti transportues është jostabil, saqë mund të tendosë kafshët për të shkaktuar dëm etj. Në bazë të këtyre shkaqeve, e jo vetëm, çdo dëm që mund ta pësojë përcjellësi ose të tretët nga kafshët gjatë transportit, përgjegjësia bie mbi organizatorin.

Ndërsa *pronari* është përgjegjës sipas fajit për dëmet që shkaktojnë kafshët e tij gjatë transportimit, kur e ka ditur ose ka mundur të dinte se ndonjëra prej tyre ka ndonjë ves ose ndonjë të metë të fshehur, por nuk ka treguar, me ç'rast ky fakt i fshehur ka bërë që të shkaktohet dëmi. Në këtë rast, përgjegjësia e pronarit për dëmin që u shkakton kafsha e tij të tjerëve, është sipas fajit dhe solidare, ndërsa mund të shprehet edhe në përgjegjësi pavarësisht fajit kur nuk ka ditur as nuk ka pasur mundësi të dinte për të metat e kafshës.

Sipas këtyre rasteve, bazat e përgjegjësive mund të jenë në faj të supozuar, ose pa faj. Faji i supozuar mbështet në dëmin që shkaktojnë kafshët shtëpiake gjatë transportit, si dhe në pakujdesinë e mbikëqyrjes, ndërsa baza e përgjegjësive pavarësisht fajit mbështetet te dëmi i shkaktuar nga kafshët e rrezikshme. Siç mund të shihet, baza e përgjegjësive sipas fajit, në këtë lloj të përgjegjësive së subjekteve për dëmin e shkaktuar nga kafshët gjatë transportit, në parim nuk gjen zbatim, përveç rasteve kur natyra e dëmit të shkaktuar nga kafsha/ët është si rezultat i veprimit (dashjes) të përcjellësit, apo pakujdesisë së pronarit të kafshës kur në momentin e kalimit të kafshës organizatorit të transportimit ia ka fshehur veset apo të metat. Ndërsa dilema që shtrohet është në lidhje me përgjegjësinë e organizatorit, se a duhet të mbajë përgjegjësi pavarësisht fajit, ose supozimit të fajit, kur organizimin nuk e ka bërë në mënyrë të duhur për transportimin e kafshëve, e nga kjo pakujdesi është ndikuar që të shkaktohet edhe dëmi nga kafsha? Sipas mendimit tim, përgjegjësia duhet të jetë pavarësisht fajit, ngase

organizimi i transportimit të kafshëve është veprimtari me burim rreziku për rrethin. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se përgjegjësia sipas supozimit të fajit mund të përjashtohet gjithmonë ndaj organizatorit, kur gjatë kohës së organizimit për transportimin e kafshëve shtëpiake, këto shkaktojnë dëme.

#### **5.4. Përgjegjësia e spitalit ose veterinarit**

Si njerëzit ashtu edhe kafshët ndonjëherë kanë nevojë për tretmane mjekësore. Mirëpo, gjatë kësaj kohe sa janë duke gëzuar tretmane, ka raste kur kafshët në ordinancat veterinarë, apo te veterinari pësojnë lëndime, ose shkaktojnë dëm ndaj kafshëve të tjera, ose personave që gjenden në ordinancë apo te veterinari, etj.. Për këto arsye lind edhe përgjegjësia e spitalit ose veterinarit për dëmin që shkaktojnë kafshët gjatë kohës sa janë duke pranuar kujdes mjekësor.

*Veterinari* mban përgjegjësi për dëmet që shkaktojnë kafshët gjatë kohës sa janë duke u trajtuar nga ai, ku si rezultat i pakujdesisë së tij, e njëjta lëndohet, ose u shkakton dëm të tjerëve. Kjo bazë e përgjegjësisë sajohet sipas supozimit të fajit, ose fajit kur ai e lëndon kafshën që është në tretman.

*Ordinanca (klinika)* mban përgjegjësi për dëmin që shkaktojnë kafshët, nga momenti kur kafsha vendoset në të për t'u kuruar. Kjo pasi pronari që i ka dorëzuar kafshën një individ apo institucioni për shfrytëzim, respektivisht ia ka besuar këtij të fundit për ruajtje dhe përkujdesje, dhe në rast të shkaktoimit të dëmit do të përgjigjet tjetri apo institucioni, ashtu siç i leverdis dhe pronarit<sup>162</sup>. Pronari, këtë të drejtë e gjen në bazë të nenit 157 paragrafit 1. të LMD-së. Prandaj, themi se çdo dëm që shkaktohet nga kafsha gjatë kohës së mjekimit, përbën bazë të krijimit të përgjegjësisë së spitalit ose veterinarit.

#### **5.5. Përgjegjësia e hanxhiut**

Kjo përgjegjësi konsiderohet se u përket më shumë periudhave më të hershme, pasi vllente kryesisht për kohërat kur transporti i njerëzve dhe sendeve organizohet kryesisht me kafshë<sup>163</sup>. Dhe gjatë kësaj kohe të udhëtimeve ndodhte që transportuesit bashkë me kafshët e tyre, ose vetëm kafshët, të ndaleshin dhe të sistemoheshin nëpër hane (bujtina) për të pushuar. Përderisa kafsha gjendej tek hanxhiu (pronari i hanit), baza e përgjegjësisë për dëmin e

---

<sup>162</sup> Ibid, 125.

<sup>163</sup> Ibid.

shkaktuar në këtë rast, duhej të ishte sipas fajit, sepse konsiderohej se kishte munguar kujdesi, kontrolli ose mbikëqyrja e duhur ndaj kafshës nga hanxhiu ose personeli i tij<sup>164</sup>. Përsëri edhe në këtë rast doktrina proklamon një bazë të përgjegjësisë për të cilën nuk jam dakord se duhet të jetë, ngase përgjegjësia sipas fajit, formësohet vetëm atëherë kur pasojat dëmtuese kanë koneksitet me veprimet (qëllimet dëmtuese) e hanxhiut. Prandaj, mendoj se baza e cila do t'i përgjigjej më së miri llojit të kësaj përgjegjësie është ajo sipas supozimit të fajit<sup>165</sup>, ngase dëmi paraqitet si veprim i kafshës, për të cilën shfrytëzuesi ose mbikëqyrësi i saj (hanxhiu) ka për detyrë të ushtrojë kujdes para se të shkaktohet dëmi. Përveç bazës juridike të përgjegjësisë sipas supozimit të fajit, në këtë lloj të përgjegjësisë mund të paraqitet edhe baza juridike e përgjegjësisë pavarësisht fajit, kur dëmi rrjedh nga kafshët e rrezikshme gjatë kohës sa gjenden në bujtinë. Natyrisht, se ky dëm mund të drejtohet ndaj kafshëve tjera, pasurisë, apo personave të caktuar.

Vlen për t'u theksuar se, ky lloj përgjegjësie tani nuk gjen ndonjë zbatim të madh në praktikë (për të mos thënë fare), ngase shoqëria, gradualisht me kohën ka ndryshuar dhe do të vazhdojë t'i ndryshojë format e arritjes sa më shpejt dhe sigurt të mallrave apo vetë atyre në destinacione të caktuara përmes makinave, aeroplanëve, trenave super të shpejtë etj. Dhe nga kjo mund të konkludojmë se roli i udhëtimit të njerëzve ose transportimit të mallrave nëpërmjet kafshëve, në ditët e sotshme është zbehur dukshëm, sa që edhe dëmi i shkaktuar nga to është në masë jashtëzakonisht të ulët, pasi që nga mos-udhëtimi rezulton mos-ndalimi, nga mos-ndalimi mos-shkaktimi i dëmit, e nga mos-shkaktimi i dëmit edhe mos-themelimi i kësaj përgjegjësie.

## 5.6. Përgjegjësia e nallbanit (mbathtarit)

Disa kafshë kanë thundra<sup>166</sup>. Andaj, nisur nga nevoja që kanë për t'u mbathur, siç janë kuajt, qetë, buajt për tërheqje, lopët për tërheqje, devetë, mushkat, gomarët, dhe me qëllim që të mund të shfrytëzohen si dhe sa duhet, pronarët i dërgojnë tek nallbani<sup>167</sup>. Gjatë kësaj kohe

---

<sup>164</sup> Ibid.

<sup>165</sup> Ndryshe po të ishte nuk do të gjente zbatim neni 163 parag. 2 i LMD-së.

<sup>166</sup> Pjesë e birtë në fund të këmbëve të disa gjitarëve, thua i madh që kanë në këmbë kuajt dhe ripërtpësit. Me thundër të sheshtë (të pjerrët). Kockat e thundrës. Tabani i thundrës. Kyçi i thundrës. Kafshë me një thundër (me dy thundra). Nguli thundrat. Rrihte tokën me thundra.

Spec. Fundi i gjerë i diçkaje, mbi të cilin mbështeten pjesë të tjera të saj; pjesa e një pajisjeje, e një vegle etj., që shërben si bazë për pjesët e tjera. Thundër e pa lëvizshme. <https://fjale.al/thund%C3%ABr> – konsultuar më 23.04.2020.

<sup>167</sup> Ai që mbath kafshët thundrake me patkonj, mbathtar. <https://fjale.al/nallban> - konsultuar më 23.04.2020.

sa janë duke u mbathur kafshët nga nallbani, mund të shkaktojnë dëm ndaj kafshëve, pasurisë, ose personave tjerë. Të dëmtuarit e këtyre rasteve duhet kompensuar për dëmin që pësojnë, andaj edhe kërkojnë bazën juridike të përgjegjesisë. Përgjegjës për këtë lloj dëmi mund të jetë vetë nallbani, ose pronari i kafshës që ka dërguar kafshën për t'u mbathur te nallbani.

*Nallbani* mban përgjegjësi pavarësisht fajit, ngase veprimtarinë të cilën e ushtron konsiderohet si një veprimtari që bartë rrezik. Pasi që, puna me mbathjen e kafshëve ndonjëherë sjell pasiguri tek to, e cila më pastaj përcillet me tendosje dhe kështu duke shkaktuar edhe dëme.

Kurse *pronari* i kafshës është përgjegjës sipas fajit, kur në momentin e dorëzimit të kafshës tek nallbani për ta mbathur nuk ia ka treguar të metat e saj, ose sëmundjen nga e cila lëngon. Kjo lloj bazë e përgjegjesisë është e akceptueshme për të ngarkuar pronarin, ngase kush më mirë se ai mund ta njeh kafshën e tij. Prandaj, mungesa e paralajmërimit të nallbanit për shprehitë e këqija të kafshës, janë shkak që pronarit t'i sajohet kjo lloj bazë juridike.

### 5.7. Përgjegjësia e shoqatës së gjuetarëve

Lloj tjetër i përgjegjesisë për dëmin e shkaktuar nga kafshët është edhe ajo e shoqatës së gjuetarëve. Shoqatat e Gjuetarëve janë persona juridikë të themeluar konform rregullave ligjore, të cilëve qeveria shpeshherë u jep në administrim hapësira të caktuara të pasura me kafshë të egra<sup>168</sup>. Duke pasur autorizime nga shteti (ministra përkatëse) për gjueti<sup>169</sup>, shoqatat e gjuetarëve apo personat fizikë fitojnë të drejtën e gjahut<sup>170</sup> që në zona<sup>171</sup>, përkatësisht në vende (të hapura, të mbyllura ose për kultivimin e kafshëve të egra) të caktuara të gjuajnë kafshë të egra<sup>172</sup> gjatë sezonit të gjuetisë<sup>173</sup>. Mirëpo, gjatë sezonit të gjuetisë, ka mundësi të shkaktohet dëmi nga kafshët e egra ndaj të tjerëve. Në këto raste, lind pyetja se kush do të përgjigjet në rast se ndodh shkaktimi i një dëmi gjatë këtyre organizimeve. Meqë bëhet fjalë për dëme të shkaktuara nga veprime të organizuara, pa dyshim që përgjegjësia për

---

<sup>168</sup> Bardhi, A, *op.cit*, fq. 126.

<sup>169</sup> Me gjueti nënkuptojmë ndjekjen, plagosjen, vrasjen, ose zënien e kafshës dhe çfarëdo përpjekje në këto aktivitete. Shih nenin 3 të Ligjit Nr. 02/L-53 për Gjuetinë të Kosovës (LGJK), Gazeta Zyrtare 8/2007, data e publikimit 01.01.2007.

<sup>170</sup> Me të drejtë të gjahut nënkuptojmë të drejtën që në sipërfaqen e caktuar të tokës apo ujit të ndërmer veprime dhe masa të kultivimit, mbrojtjes, shfrytëzimit të kafshës së egër dhe pjesëve të saj. Ibid, 3, lidhur me nenin 5.

<sup>171</sup> Me zonë nënkuptojmë sipërfaqen e gjerë në të cilën janë kushtet e njëjta ose të ngjashme (bujqësore, të pyjeve dhe zona të larta malore me mbi 1000 m lartësi mbidetare) për jetesë të kafshëve të egra. Ibid, 3.

<sup>172</sup> Me kafshë të egra nënkuptojmë kafshët dhe shpendët e egra të caktuara me ligj, që formojnë popullata në gjendje të lirë në natyrë ose në sipërfaqe të kufizuara të parapara për kultifim intensive apo për shumim. Ibid, 3. Ndërsa neni 4 përmban listën e kafshëve të egra.

<sup>173</sup> Me sezon të gjuetisë nënkuptojmë kohën në të cilën lejohet gjuetia në lloje të caktuara të kafshëve për gjueti. Ibid, 3.

shpërblimin e dëmit bie mbi vetë organizatorët<sup>174</sup>. Shoqata e gjuetarëve do të përgjigjet në bazë të përgjegjësisë objektive, bazuar në të gjitha rregullat e përgjegjësisë për ushtrimin e veprimtarisë së rrezikshme<sup>175</sup>. Përveç organizatorit të gjuetisë, përgjegjësia mund të zgjerohet edhe në menaxhuesin, pronarin apo shfrytëzuesin e tokës në të cilën gjendet vendgjuetia, të cilët detyrohen që të ndërmarrin masa për pengimin e dëmeve që mund t'u shkaktojnë kafshët e egra pronës dhe njerëzve në gjueti<sup>176</sup>.

### 5.8. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga egërsirat (kafshët e egra)

Përgjegjësi pavarësisht fajit mbahet edhe në rastet kur dëmi shkaktohet nga kafshët e egra. Arsyeja se pse themelohet ky lloj përgjegjësie konsiston në atë se kafshët e egra konsiderohen kafshë të rrezikshme, prandaj edhe bazën juridike të përgjegjësisë pavarësisht fajit ose objektive, e hasim të sanksionuar në kuadër të këtyre kafshëve. Egërsirat paraqiten send i rrezikshëm, sepse sjellja e saj nuk është e parashikueshme, as që i nënshtrohet vullnetit të pronarit<sup>177</sup>. Dhe të tilla janë dreri i rëndomtë, dreri lopatar, kaprolli, dhia e egër, muflioni, derri i egër, ariu i murrmë, vjedulla, lundërza, shqarthe i artë, shqarthe i bardhë, bukla e madhe, bukla e vogël, qelbësi i zakonshëm, lepuri i zakonshëm, ketri, gjeri i rëndomtë, miu bizam, dhelpra, ujku, çakalli, macja e egër, rrëqebulli, pula e egër e madhe, stërvinarja, fazani, thëllëza gurore, thëllëza e fushës, shkurtëza, shaptorja malore, shaptorja e kënetës, shaptorja e livadheve, pëllumbi gungash, pëllumbi i zgavrave, pëllumbi i zi, turtullesha, kumria, pata e përhimët, pata e murrizit, pata ballëbardhë, rosa shurdhake, rosa e përhimët, rosa, rosa bishtgërshërë, rosa sp, polaga, kukuvajka e bardhë, huti veshor i pyjeve, huti i maleve, sokoli pulngrënës, krahëthata zogngrënëse, orli, petriti celenger, korbi i zi, sulkoka, korbi, stërqoka, laraska, cota<sup>178</sup>. Vlen për t'u theksuar se, jo të gjitha kafshët e egra kanë cilësi të kafshëve të rrezikshme (p.sh *lepuri i zakonshëm, thëllëza, pëllumbi gungash, kumria, etj.*), mirëpo meqenëse të njëjtat nuk bëjnë pjesë në grupin e kafshëve shtëpiake, atëherë themi se dëmet që i shkaktojnë mbulohen me bazën juridike të përgjegjësisë pavarësisht fajit, e të cilën përgjegjësi e gjejmë të sanksionuar te kafshët e rrezikshme. Ndërsa për sa i përket listës së kafshëve të egra, ato nuk mund të jenë *numerous clausus*, ngase ka raste kur pronarët e cirqeve etj., sjellin kafshë si p.sh. luan, tigër, etj., të cilat fare nuk e kanë habitatin e të jetuarit

<sup>174</sup> Bardhi, A, *op.cit*, fq. 126.

<sup>175</sup> Ibid.

<sup>176</sup> LGJK, neni 49.

<sup>177</sup> Alishani, A, *op.cit*, fq. 547.

<sup>178</sup> LGJK, neni 4.

në vendet ku dërgohen për shfaqje, e aq më shumë të jenë të listuara në këto vende ku nuk shquhen për habitat të tyre, mirëpo përkundër këtij fakti, në momentin kur të njëjtat shkaktojnë dëm ndaj të tjerëve, themi se edhe për to zbatohet baza e përgjegjësisë pavarësisht fajit ose objektivit.

Në rastet kur dëmi shkaktohet nga këto kafshë kundrejt kafshëve të tjera, pasurisë, ose personave, atëherë lind edhe përgjegjësia e subjekteve. Subjektet përgjegjëse janë të shumtë në rastin kur egërsira shkakton dëm. P.sh nëse kafsha e egër shkakton dëm në perimetrin ku gjendet zona e gjuetisë, themi se përgjegjës është Shoqata e Gjuetisë, përkatësisht organizatori i gjuetisë, ose në bazë të zgjerimit të përgjegjësisë menaxhuesi, pronari apo shfrytëzuesi i tokës ku gjendet vendgjuetia, të cilët nuk kanë ndërmarrë masa për pengimin e dëmit. Madje, kur dëmi shkaktohet nga kafshët e egra gjatë kohës së ndalimit të gjuetisë në atë egërsirë, përgjegjësi mban organi që ka nxjerr vendimin për ndalimin e gjuetisë për kohë të caktuar ose të pacaktuar. Kur dëmi nga kafshët e egra shkaktohet në kopshtin zoologjik, përgjegjësia bie mbi pronarin e kopshtit zoologjik, duke mos marrë në konsideratë llojin e kopshtit {privat apo publik (shtetëror)}. Kur dëmi shkaktohet nga kafsha e egër gjatë kohës sa gjendet në cirk, përgjegjësi mban pronari i cirkut. Në rastin kur dëmi shkaktohet nga kafsha e egër në parkun nacional, në rezervat, në pyllin e mbrojtur, ose në pronën publike, përgjegjësi për dëmin e shkaktuar mban Ndërmarrja Publike ose Organi i Shtetit që e ka nxjerr vendimin për krijimin e të njëjtave. Madje, kur dëmi shkaktohet nga kafshët e egra që gjenden në pronën private, përgjegjësi mban pronari i pronës private.

Përndryshe, themelimi i përgjegjësisë ndaj subjekteve të caktuar për dëmet që shkaktojnë kafshët e egra, janë nga më të ndryshmet dhe natyrisht se kjo varet nga vendi se ku gjendet edhe kafsha e egër.

P.sh *Shoqata e Gjuetarëve* është përgjegjëse për dëmin që shkaktojnë kafshët e egra, kur gjatë sezonit të gjuetisë, në **zonën** e gjuetisë shkaktohet dëmi nga kafshët e egra, etj. Pronari i kopshtit zoologjik, qoftë privat apo shtetëror është përgjegjës për dëmin që shkaktojnë kafshët e egra, kur ndonjë kafshë e egër del nga kopshti dhe kështu sulmon vizitorët, ose kafshët tjera etj.

*Ndërmarrja ose Organi Shtetërorë* është përgjegjës për dëmin që shkaktojnë kafshët e egra në parkun kombëtar<sup>179</sup>, në pjesë të tjera të zonave të mbrojtura, në pronë publike, apo

---

<sup>179</sup> Shih Ligjin Nr. 04/L-087 për Parkun Kombëtar “Sharri”, Gazeta Zyrtare 2/2013, data e publikimit 21.01.2013. Si dhe Ligjin Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës, Gazeta Zyrtare 85/2010, data e publikimit 09.11.2010. Ndërsa në Shqipëri, ekziston Ligji Nr. 81/2017 për Zonat e Mbrojtura, përafuar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 92/43/KEE, datë 21 maj 1992, “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës dhe faunës

edhe jashtë këtyre zonave të mbrojtura, kur kafsha e egër del nga to dhe shkakton dëm, kur p.sh. ujku sulmon dhe vret delet në bjeshkë; kur kafshët e egra janë lënë të mbipopullohen aq shumë sa që shkaktojnë dëm; kur ariu zbret në fshat dhe shkakton dëm në bagëti, ose në njerëz; kur rriqrat bëhen shkak i dëmeve, e në rastin më të rëndë të vdekjes së personave; kur qentë endacakë<sup>180</sup> sulmojnë qytetarët në pronën (rrugët) publike<sup>181</sup>, kështu duke u shkaktuar lëndime trupore etj.

Përgjegjësia e organeve shtetërore për dëmet që shkaktojnë kafshët e egra, rezulton mbi bazën e mbrojtjes së tyre, pra nëse mbrojtja e një kategorisë të kafshëve të egra bëhet përgjithmonë, ose përkohësisht. Mirëpo, edhe në rastin kur dëmi që shkaktohet nga kafshët e egra që nuk gëzojnë mbrojtje të përhershme, për palën e dëmtuar ekziston mundësia që të kërkoj nga gjykata që në bazë të dispozitave kushtetuese me të cilat garantohet pasuria dhe integriteti fizik i njeriut, të mund të bëjë zhdëmtimin.<sup>182</sup>

*Pronari i pronës private* është përgjegjës për dëmin që shkaktojnë kafshët e egra, kur p.sh. bletët e egra që kanë zënë vend në pronën e tij private, sulmojnë ndonjë kalimtar dhe kështu shkaktojnë dëm; ose kur ndonjë shpend grabitqar si p.sh. skifterë, hut, etj., ka bërë fole, kështu nga sulmi që bën herë pas herë ndaj të tjerëve, shkakton dëme etj. Sa për sqarim, edhe pse ky lloj dëmi rrjedh nga kafshët e egra, pra që konsiderohen kafshë pa pronar, pronari i pronës private është përgjegjës, ngase dëmi që rrjedh nga kafshët e egra është si rezultat i asaj që, kafsha e egër gjendet në pronën private (fushë, pyll, etj.) të tij<sup>183</sup>, andaj edhe çdo dëm që shkaktohet nga to, përbën shkak të themelimit të kësaj bazë juridike të përgjegjësisë, për çka edhe pronari duhet të mban përgjegjësi.

Ka raste kur subjektet përgjegjëse për dëmin e shkaktuar nga këto kafshë nuk mbajnë përgjegjësi, ngase personat e dëmtuar janë të vetëdijshëm se në zonat ku banojnë, mund të

---

së egër”, të ndryshuar, Numri CELEX 31992L0043, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 206, datë 22.07.1992, faqe 50.

<sup>180</sup> Parimisht qentë endacak nuk hyjnë në grupin e kafshëve të egra, mirëpo pas një kohe të gjatë të lënë në liri, e pa përkujdesje, ka probabilitet të ngritjes së temperamentit, kështu së bashku me elementin e frikës e të paparashikueshmërisë mund të shkaktojnë dëm ndaj të tjerëve. Prandaj, në rastet kur ky dëm shkaktohet nga këto kafshë në rrugët publike ku më së shpeshti jetojnë, atëherë përgjegjësi për to, mbajnë komunat, respektivisht drejtoritë përkatëse (konform nenit 17 shkronjën i) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare 28/2008, data e publikimit 04.06.2008) të cilat nuk kanë ofruar siguri për qytetarët nga këto kafshë të cilat fitojnë epitafin e egërsirës.

<sup>181</sup> Me pronë publike nënkuptojmë pronën e Republikës së Kosovës dhe pronën e njëjësive të administrimit të pushtetit lokal. Shih nenin 3 paragraf. 1 nënparagraf. 1 të Projektligjit për Pronën Publike, i cili është miratuar në mbledhjen e 85-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 02/85, datë 22.01.2019.

<sup>182</sup> Bardhi, A, *op.cit.*, fq. 134-135.

<sup>183</sup> Që pronari i pronës private të mbajë përgjegjësi për dëmin që shkakton kafsha e egër ndaj të tjerëve, kërkohet që kjo kafshë të jetë **në lidhje (posedim) të vazhdueshme me pronën private** të pronarit, në të kundërtën përgjegjësi nuk mund të mbajë pronari. Kjo lidhje mund të nënkuptohet kur kafsha e egër vendoset në pronën private për të zhvilluar riprodhimin ose strehimin etj. Koment i autorit.

banojnë po aty edhe kafshët e egra, andaj ju kërkohet që para se t'u shkaktohet dëmi, paraprakisht të ndërmarrin edhe masa për parandalimin e tyre. Pra, nëse një person vendos të jetoj në bjeshkë, është e kuptueshme se mund të hasë në kafshë të egra, prandaj duhet që ta sigurojë edhe vendin ku ka vendosur të jetojë.

Në fund të gjithë kësaj, themi se për të ekzistuar kjo bazë juridike e përgjegjësise, kërkohet që të **shkaktohet dëmi**, dëmi duhet të shkaktohet nga **kafsha e egër**, si dhe të ekzistojë **lidhja kauzale**, ndërmjet veprimit të kafshës së egër dhe pasojave të dëmit të shkaktuar.

### 5.9. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga kafshët në trajnime

Kafshët mund të shkaktojnë dëm edhe gjatë kohës kur janë në trajnime. Dëmi në këtë rast mund të jetë ndaj njeriut apo kafshëve të tjera. Dëm mund të pësoj trajnuesi i kafshëve, pronari i cirkut ose personat tjerë të punësuar në cirk<sup>184</sup>. Ky dëm rezulton si shkak i realizimit të pikave të trajnimit, ose trajnimit të kafshëve. Dhe kur dëmi shkaktohet gjatë kësaj kohe nga kafshët, atëherë themi se përgjegjës mund të jenë personat varësisht në dobi të kujt trajnohen kafshët. Pra, baza juridike e përgjegjësise mund të sajohet ndaj pronarit të cirkut, ndaj policisë, kur dëmin e pëson trajneri i qenve për nevojat e policisë, ndaj ushtrisë, kur qentë trajnohen për nevojat e këtyre të fundit, e kështu me radhë. Mirëpo, jo çdo herë policia ose ushtria, mbajnë përgjegjësi për dëmin që shkaktojnë kafshët e tyre, ngase në raste të caktuara, nëpërmjet kafshëve intervenojnë ndaj personave të caktuar që e kanë rrezikuar jetën dhe shëndetin e tyre ose të tjerëve.

Baza juridike e këtyre përgjegjësise është pa faj ose objektive. Ngase kryerja e detyrave në kuadër të këtyre institucioneve, përkatësisht në kuadër të cirkut, përbën veprimtari të rrezikshme, kështu për çdo dëm që rezulton në kuadër të saj, është dëm duke kryer veprimtari të rrezikshme. Thënë të drejtën ky lloj baze juridike në të shumtën e rasteve mbulohet me sigurim social, andaj personi i dëmtuar nuk e ka të vështirë ta gjejë personin përgjegjës dhe të realizojë kompensimin e dëmit. Mirëpo, baza e përgjegjësise pa faj gjen zbatim vetëm atëherë kur mungon një formë e këtillë e sigurimit të rastit.

### 5.10. Përgjegjësia e pronarit të fermave për dëmin e shkaktuar nga kafshët

---

<sup>184</sup> Alishani, A, *op.cit*, fq. 544.



Shpesh në ergelet e kuajve ndodh që t'u shkaktohet dëmi punëtorëve të ergeles, trajnuesve të kalorësve, kalorësve ose personave të tjerë<sup>185</sup>. Dëmet në këto raste janë me lëndim trupor, shkaktim të vdekjes. Parimisht pronari i ergeles përgjigjet për dëmin të cilin kuajt e ergeles e shkaktojnë, i cili dëm mund të shkaktohet gjatë trajnimit, gjatë të ushqyerit, gjatë përgatitjeve për kalërim, gjatë garave etj<sup>186</sup>. Duke qenë se kërkohet përkujdesje ndaj kafshëve, atëherë themi se kemi të bëjmë me një veprimtari e cila cilësohet e rrezikshme por edhe e dobishme, andaj për dëmin e shkakuar nga kjo veprimtari përgjigjet kryerësi i kësaj veprimtarie. Baza e kësaj përgjegjësie është pa faj ose objektive. Kjo është e kuptueshme dhe normale sepse dëmi është shkakuar nga veprimtaria e dobishme dhe e rrezikshme<sup>187</sup>. Vlen për t'u theksuar se edhe në këtë rast, sikurse në rastin e cekur më lart, rregullat e kësaj përgjegjësie mund të zgjidhen pjesërisht ose në tërësi me sigurim social si dhe me sigurim nga përgjegjësia.

### **5.11. Përgjegjësia për dëmin e shkakuar gjatë organizimit të aktiviteteve të ndryshme me kafshë**

Sikurse në të kaluarën, edhe në ditët e sotme, janë të shpeshta rastet e organizimit të veprimtarive të ndryshme me kafshë<sup>188</sup>. Pra, siç është theksuar edhe më lart, roli i kafshëve nuk është dosido, prandaj ato, që në të kaluarën e deri më sot, kanë pasur funksione nga më të ndryshmet. P.sh. për t'i përdorur në kohë luftërash, për punë, e deri në qëllimet argëtuese. Argëtimet me kafshë sot janë më të shpeshta. Kështu duke u bërë organizime të ndryshme me to, siç janë: garat me kuaj (rodeo), garat me vrapim ose dyluftim qensh, luftërat me dema (matadorët), organizimi i cirkut me kafshë, organizimi i qendrave për trajnimin e kafshëve, pjesëmarrja e kafshës në role të caktuara gjatë xhirimit të filmave, etj.

Nëse ndodh që gjatë këtyre organizimeve t'i shkaktohet dëm ndonjërit prej pjesëmarrësve apo dikujt nga publiku, atëherë, lind pyetja se kush do të përgjigjet për këtë dëm<sup>189</sup>.

Në rastin kur dëmi shkaktohet gjatë kohës së *garave me vrapim të kuajve (rodeo)*, e nga ky dëm pëson lëndime trupore, ose vdekje kalorësi, përgjegjësi themi se mban organizatori i këtyre garave. Kuptohet se kjo përgjegjësi, përkatësisht ky dëm, në të shumtën e

---

<sup>185</sup> Alishani, A, *op.cit*, fq. 545.

<sup>186</sup> Ibid.

<sup>187</sup> Ibid.

<sup>188</sup> Bardhi, A, *op.cit*, fq. 128.

<sup>189</sup> Ibid.

rasteve mbulohet me kontrata sigurimi. E nëse mungon një kontratë e këtillë, atëherë organizatori përgjigjet mbi bazën e përgjegjësisë pavarësisht fajit ose objektivë, ngase kalorësi ka marrë pjesë në kuadër të një veprimtarie të rrezikshme. Në të kundërtën, nëse do të vendosej që të shkohej me bazën e përgjegjësisë sipas fajit, atëherë përgjegjësia rrallëherë do të provohej, e kështu i dëmtuari nuk do të mund të kompensohej.

Përgjegjësi tjetër, pavarësisht fajit për dëmet e shkaktuara nga kafshët, mbahet edhe në rastet kur dëmi paraqitet gjatë kohës së *ushtrimit të lojërave me dema*. Këto lojëra janë karakteristikë për shtetet si: Spanja, Portugalia dhe vendet e Amerikës Latine<sup>190</sup>. Edhe te kjo përgjegjësi baza është e njëjtë sikurse tek garat në rodeo, ngase veprimtaria është e rrezikshme, dhe mjafton që pala e dëmtuar të provojë lidhjen kauzale për dëmin që ka pësuar nga kafsha gjatë kohës së lojërave.

Përgjegjësia pavarësisht fajit mbahet edhe në rastet kur dëmi shkaktohet nga *kafshët e egra apo kafshët shtëpiake gjatë organizimit të cirkut* me to. Subjekt përgjegjës për dëmin që shkaktajnë të njëjtat, mund të jenë pronari i cirkut, ose organizatori i këtyre manifestimeve.

Pronari i cirkut është përgjegjës për dëmin që shkaktajnë kafshët e egra apo kafshët shtëpiake, kur dëmi rezulton ndaj trajnerit ose dreserit të kafshëve. Në qoftë se vërtetohet se kafsha dëmin e ka shkaktuar duke qenë e provokuar, atëherë pronari i cirkut do të lirohet nga përgjegjësia<sup>191</sup>. Ndërsa në rastin kur kafsha del jashtë arenës së cirkut, përgjegjësi për çdo dëm që u shkaktohet personave të tretë, mban organizatori i manifestimeve. E kjo përgjegjësi është pavarësisht fajit (*strict liability*), ngase dëmi rrjedh nga një veprimtari me rrezik të shtuar për rrethin.

## **LIRIMI NGA PËRGJEGJËSIA JURIDIKO CIVILE PËR DËMIN E SHKAKTUAR NGA KAFSHËT**

Në bazë të rregullave tradicionale të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar ekziston mundësia për lirimin nga përgjegjësia, edhe pse kafsha ka shkaktuar dëmin<sup>192</sup>. Ky lirim organizohet sipas rregullave të të drejtave nacionale, ashtu edhe sipas rregullave të unifikuara<sup>193</sup>. Pra, me lirim nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga kafshët nënkuptojmë shkakun kur, pronari, poseduesi ose shfrytëzuesi i kafshës, gjegjësisht i kafshëve, nuk do të

---

<sup>190</sup> Ibid.

<sup>191</sup> Rekomandime të Gjykatës së Kasacionit në Romë, Sez.III civile, mbajtur më 23.11.1998 dhe 04.12.1998.

<sup>192</sup> Alishani, A, *op.cit*, fq. 559.

<sup>193</sup> Ibid.

përgjigjet për dëmin e kafshës, në qoftë se kafsha ose kafshët shkaktojnë dëme nën ndikimin e personit të dëmtuar, të veprimit të personit të tretë, *vis maior*, apo *cas fortuit*.

### **6.1. Dëmi i shkaktuar nga kafsha nën ndikimin e personit të dëmtuar**

Është rast tradicional i lirimit nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar në të gjitha llojet e përgjegjësive civile<sup>194</sup>. Ky lirim nga përgjegjësia për dëmin nga kafshët ekziston kur kafsha shkakton dëm nën ndikimin e veprimit të personit të dëmtuar ose me fajin e vetë të dëmtuarit ose me sjelljen e fajshme të tij. Në këtë rast, pronari, respektivisht poseduesi i kafshës lirohet nga përgjegjësia në rast se provon se dëmi është shkaktuar nga vetë veprimi i palës së dëmtuar ose i personit të tretë, gjë të cilën ai nuk ka mundur të parashihte dhe pasojat e të cilit nuk ka mundur t'i shmangë ose t'i mënjanojë<sup>195</sup>. Në praktikën gjyqësore dëmi i shkaktuar nga kafshët me veprimin ose nën ndikimin e veprimit të të dëmtuarit është i shpeshtë. Si p.sh. kur i dëmtuari e ngacmon qenin e huaj, e ky e sulmon; ose kur i dëmtuari paralajmërohet të mos afrohet në distanca të afërta në ndonjë zonë të rrezikshme në kopshtin zoologjik, mirëpo përkundër paralajmërimit ai vendos të afrohet dhe kështu pëson dëm nga ndonjë kafshë e kopshtit; ose kur i dëmtuari qëndron afër kalit duke mos qenë fare i kujdesshëm dhe kali e shqelmon dhe i shkakton lëndim trupor; ose kur fëmija e prek dashin dhe dashi e lëndon duke e qëlluar me bri; ose kur i dëmtuari i shtynë me qëllim lopët e huaja në parcelën bujqësore të vetën, që pas kësaj të synojë ndonjë kompensim nga pronari, ose poseduesi i tyre për dëmin e shkaktuar nga lopët, etj. Në këso rastesh, përgjegjësia nuk bie mbi pronarin, ose poseduesin e kafshës, pasi që shkaktar i dëmit nga kafshët është vetë i dëmtuari.

Ka të ngjarë që i dëmtuari në raste të caktuara të përgjigjet pjesërisht për dëmin e shkaktuar nga kafsha, ndërsa për pjesën tjetër pronari, ose poseduesi i saj<sup>196</sup>. Ky lloj përgjegjësie është propocional. Sipas kësaj situate për dëmin e shkaktuar nga kafsha, përgjegjësia i takon në pjesë edhe të dëmtuarit, por edhe poseduesit (ose pronarit). Thënë të drejtën ky lloj përgjegjësie është paksa abstrakt kur vihet në funksion të praktikës gjyqësore, pasi që kërkon një angazhim maksimal në vërtetimin e fakteve relevante të çështjes.

### **6.2. Dëmi i shkaktuar nga kafsha nën ndikimin e veprimit të personit të tretë**

---

<sup>194</sup> Alishani, A, *E Drejta e Detyrimeve – Pjesa e Përgjithshme*, Prishtinë, 2002, fq. 511.

<sup>195</sup> LMD, neni 158 parag. 2.

<sup>196</sup> Ibid, 158 (3).

Është faktor që ndikon në lirimin e pronarit, poseduesit nga përgjegjësia për dëmin që shkakton kafsha nën ndikimin e veprimit ose fajit të personit të tretë<sup>197</sup>. Ky person nuk ka asnjë raport me pronarin, ose poseduesin e kafshës, mirëpo me veprimet e tij nxitëse kundrejt kafshës së këtij të fundit, bën të mundur që të shkaktohet edhe dëmi ndaj të tjerëve. Natyrshëm se përgjegjësia e personit të tretë është edhe përgjegjësi sipas fajit. Pasi që, veprimet e tij të dëmshme inkuadrohen në kuadër të dashjes (qëllimit) si formë e fajit, e të cilat bëjnë të mundur që të jetë prezent dëmi nga kafsha.

### **6.3. Dëmi i shkaktuar nga kafsha nën ndikimin e *vis maior*, ose *cas fortuit***

Ose, siç njihet ndryshe: fuqia madhore është ngjarja e jashtme që nuk është e paraparë, ose që nuk mund të parashihet saktësisht se kur do të ndodhë dhe që nuk mund të përballohet, ose të shmanget<sup>198</sup>. Fuqia madhore, ka rëndësi tek përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga kafshët pasi që është shkak që pronari ose poseduesi i kafshës të mund të përfitojë nga shkarkimi i përgjegjësisë për dëmet që shkaktojnë kafshët e tij. Me këtë nënkuptojmë se, pa marrë parasysh faktin që të dëmtuarit i shkaktohet dëmi nga kafshët, mjafton që pronari ose poseduesi i saj duke u thirrur në *fuqinë madhore*, të ketë mundësinë që të lirohet nga përgjegjësia për dëmin e kafshëve. E kjo mënyrë e lirimit nga kjo përgjegjësi buron vetëm po që se ekzistojnë karakteristikat e fuqisë madhore në momentin kur shkaktohet dëmi, e të cilat janë: **1.** Ngjarja e paparaparë, **2.** Ngjarja të mos ketë mundësi të pengohet, të mënjanohet, ose të shmanget, si dhe **3.** Ngjarja të jetë e jashtme. (Themi se kemi të bëjmë me këto elemente kur p.sh. nga vapa e madhe kafsha pëson çrregullime, shqetësohet dhe në ato momente shkakton dëm etj.).

Thënë të drejtën dispozitat e LMD-së për këtë rast dhe rastet e lartpërmendura, nuk sanksionojnë në mënyrë të veçantë kushtet e lirimit nga përgjegjësia për kafshët, d.m.th. rregullat e lirimit nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga kafshët nuk i hasim në kuadër të kësaj përgjegjësie, por të njëjtat i gjejmë në kuadër të rregullave të përgjithshme, pra të

---

<sup>197</sup> Ibid, 158 (2).

<sup>198</sup> Dauti, N, *op.cit*, fq. 172.

sendeve ose veprimtarive të rrezikshme<sup>199</sup>, të cilat aplikohen *analogia iuris*, sepse në këtë rast kjo lëmi mbështetet në rregullat e përgjithshme të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar.

#### 6.4. Cas fortuit

*Cas fortuit*, ose *rasti*, nënkupton ngjarjen e cila ekziston kur nuk ka lidhje midis ngjarjes së caktuar dhe pasojave të caktuara<sup>200</sup>. Ai paraqet një ngjarje që rastësisht ka ndodhur, ose rastësisht është shkaktuar, përndryshe *rasti* është një dukuri e shpeshtë që shkaktohet, ose që mund të shkaktohet<sup>201</sup>.

Në të vërtetë, ajo se çka vazhdon të ekzistojë si dilemë ndërmjet doktrinarëve është se a mundet *cas fortuit* të jetë rrethanë që ndikon në lirimin e subjektit nga përgjegjësia objektive për dëmet që u shkaktojnë sendet ose veprimtaritë e rrezikshme të tij, të tjerëve? Sipas mendimit tim, edhe në këtë lloj të përgjegjësisë, *rasti*<sup>202</sup>, duhet të jetë shkak që ndikon në lirimin e pronarit, ose poseduesit nga përgjegjësia për dëmet që u shkaktojnë kafshët e tij, të tjerëve; pasi që dihet se dëmi shkaktohet si mungesë e lidhshmërisë së kauzalitetit. Kjo mund të ndodhë p.sh. kur nga zhurma e sirenës së makinës së policisë shkaktohet shqetësimi i kafshës dhe ajo shkakton dëm; ose kur në thundër të kalit hyn guri, ashtu që, nga dhimbja që pëson fillon të tendoset dhe shkakton dëm etj.

#### Përfundim

Në raportet ndërnjerëzore ka raste kur shfaqet dëmi. Me dëm nënkuptojmë humbje në mjete, në sende a në njerëz që pëson dikush. I tillë është edhe *rasti* kur dëmi shkaktohet nga kafshët. Dëmi nga kafshët paraqitet mjaft shpesh në realitetin shoqëror. Andaj, për këtë arsye ka lindur edhe nevoja për sajimin e përgjegjësisë juridiko-civile për dëmin e shkaktuar nga kafshët.

Për përgjegjësinë juridiko-civile për dëmin e shkaktuar nga kafshët, në disa të drejta pozitive bazën juridike të saj e gjejmë të klasifikuar, si p.sh. në LMD, KCGJ, etj., mirëpo në disa të drejta tjera, atë e hasim sipërfaqësisht për sa i përket bazës juridike të përgjegjësisë,

---

<sup>199</sup> LMD, neni 158 parag. 1.

<sup>200</sup> Alishani, A, *op.cit*, fq. 513.

<sup>201</sup> *Ibid*.

<sup>202</sup> Kodi Civil Italian, me nenin 2052 sanksionon rastin, për çka mendoj se është më se e drejtë.

ose lë të nënkuptohet se paraqet vetëm një bazë për çfarëdo dëmi që shkaktohet nga kafshët, qofshin ato të rrezikshme apo shtëpiake, p.sh. KCSH.

Në këtë aspekt, duke marrë për bazë këtë, më lindi edhe kureshtja për ta punuar këtë përgjegjësi. Thënë të drejtën, pasi që kam vendosur për ta trajtuar përgjegjësinë në fjalë, *prima facia*, e njëjta më është dukur e lehtë për ta realizuar, mirëpo vetëm pasi që jam lëshuar në orbitën e saj, kam kuptuar labirintin që posedon si institut. Ky labirint kishte të bënte me bazat juridike të përgjegjesisë, objektet e trajtimit të të cilave shpeshherë gërshetohen, si rezultat i cilësive të kafshëve, duke e vështirësuar ashtu edhe ndarjen e tyre. Prandaj, qëllimi im i vetëm përgjatë tërë hartimit të këtij punimi ishte që të sqarojë dallimet në mes të këtyre bazave, e nën këndvështrimin e tyre, të paraqes edhe kushtet që kërkohen për t'u sajuar, pastaj llojet e përgjegjësive të subjekteve, si dhe rrethanat që ndikojnë në shkarkimin e përgjegjesisë juridiko-civile për dëmin e shkaktuar nga kafshët.

## **B i b l i o g r a f i a**

1. Alishani, A, *E Drejta e Detyrimeve - Pjesa e Përgjithshme*, Prishtinë, 1985.
2. Alishani, A, *E Drejta e Detyrimeve – Pjesa e Përgjithshme*, Prishtinë, 2002.
3. Alishani, A, Alishani, A, *Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendet e rrezikshme ose veprimtaritë e rrezikshme në të drejtën kontinentale (Civil laë) dhe në të drejtën anglosaksone (common laë)*, Prishtinë, 2011.
4. Alishani, A, *Përgjegjësia për Mungesat Materiale të Sendeve*, Prishtinë, 2004, fq. 188-189.
5. Bardhi, A, *Përgjegjësia civile për dëmin jashtë kontraktor të shkaktuar nga të tretët në legjislacionin shqiptar*, Tiranë, 2016.
6. Bytyçi, A, *Përgjegjësia juridike civile për sendet dhe veprimtaritë e rrezikshme – aspekte krahasuese Kosovë – Shqipëri*, Prishtinë, 2019.
7. Dauti, N, *E Drejta e Detyrimeve - Pjesa e Përgjithshme*, Prishtinë, 2013.
8. Dauti, N & Berisha, R & Vokshi, A & Aliu, *Komentari i Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve*, Libri I, Prishtinë, 2013.
9. Dauti, N, *Kontratat*, Prishtinë, 2016.
10. Gams, A, *Hyrje në të Drejtën Civile*, 1986.
11. Gams, A, *Bazat e së Drejtës Reale*, 1972.

12. Kondili, V, *E Drejta Civile II, Pjesa e Posaçme, Pronësia, të drejtat reale të përkohshme, trashëgimia*, Geer, 2008.
13. Krasniqi, A, *E Drejta Biznesore*, Prishtinë, 2016.
14. Legier, G, *E Drejta Civile – Detyrimet*, Botimi 19 – 2008.
15. Maljkovic.M, *Objektivna odgovornost u gradanskom pravu (opasna stvar)*, Gopic, 2016.
16. Millosheviq, LL, *E Drejta e Detyrimeve*, 1977.
17. Mamuti, A, *Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit në Maqedoni*, Tiranë, 2013.
18. Muskaj, A, *Përgjegjësia civile nga shkaktimi i dëmit jo pasuror*, Tiranë, 2013.
19. Mataj, R, *Përgjegjësia jashtëkontraktore e organëve publike në Shqipëri*, Tiranë, 2017.
20. Musa, M & Musa, K, *E Drejta e Procedurës Civile – Pjesa e Dytë*, Gjilan, 2017.
21. Kanuni i Lek Dukagjinit, Përmbledhur nga Shtjefan Gjeçovi, Shkodër, 1933.
- 22. E drejta pozitive, ligjet e aplikueshme**
23. Kodi Civil i Francës (CC) - 1804.
24. Kodi Civil i Shqipërisë - 1994.
25. Kodi Civil i Austrisë (ABGB) - 1812.
26. Kodi Civil i Italisë - 1942.
27. Ligji për Detyrimet i Zvicrës - 1912.
28. Verzioni Final i Projekt Kodit Civil të Kosovës.
29. Kodi Penal i Kosovës, Gazeta Zyrtare 2/2019, data e publikimit 14.01.2019.
30. Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Gazeta Zyrtare 16/2012, data e publikimit 19.06.2012.
31. Ligji Nr. 02/L-10 për Përkujdesjen ndaj Kafshëve të Kosovës, Gazeta Zyrtare 5/2006, data e publikimit 01.10.2006.
32. Ligji Nr. 02/L-53 për Gjuetinë të Kosovës (LGJK), Gazeta Zyrtare 8/2007, data e publikimit 01.01.2007.
33. Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, Gazeta Zyrtare 38/2008, data e publikimit 20.09.2008.
34. Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPTDS), Gazeta Zyrtare 57/2009, data e publikimit 04.08.2009.

35. Ligji Nr. 04/L-087 për Parkun Kombëtar “Sharri”, Gazeta Zyrtare 2/2013, data e publikimit 21.01.2013.
36. Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës, Gazeta Zyrtare 85/2010, data e publikimit 09.11.2010.
37. Ligji Nr. 81/2017 për Zonat e Mbrojtura, për afuar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 92/43/KEE, datë 21 maj 1992, “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës dhe faunës së egër”, të ndryshuar, Numri CELEX 31992L0043, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 206, datë 22.07.1992, faqe 50.
38. Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare 28/2008, data e publikimit 04.06.2008.
39. Projektligji për Pronën Publike, i cili është miratuar në mbledhjen e 85-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 02/85, datë 22.01.2019.
- 40. Linqet elektronike**
41. <https://tiranatoday.al/ja-cilat-jane-6-lufterat-te-cuditshme-te-zhvilluara-ne-bote/> - konsultuar më 10.04.2020.
42. <https://fjale.al/thund%C3%ABr> – konsultuar më 23.04.2020.
43. <https://fjale.al/nallban> - konsultuar më 23.04.2020.

MSc.

Liredone

BUQAJ

KDU331:34(496.51)

## **MBROJTJA DHE SIGURIA E TË PUNËSUARVE NË KOSOVË DHE BAZA JURIDIKE E SAJ**

### ***Abstrakt***

*Me institutin e marrëdhënies së punës është paraqitur nevoja esenciale e mbrojtjes dhe siguris së punëtorëve që rezulton me ndryshimet teorike të marrëdhënies të punës. Këto marrëdhënie përcaktojnë objektin qendror të karakteristikave juridike të së drejtës së punës dhe sigurisë-mbrojtjes në punë. Marrëdhëniet e punës paraqiten midis punëdhënësi dhe punëmarrësi si pjesëmarrës të procesit të punës në të cilin punëtori në formën e caktuar ushtron një punë të caktuar me kontratë, gjersa punëdhënësi është i detyruar gjithashtu t'i përmbahet kontratës, duke i ndërmarrë masat e nevojshme për sigurinë dhe shëndetin në punë.*

*Politikat strategjike institucionale për përmirësimin dhe konsolidimin e kushteve të punës kanë për qëllim që të përmirësojnë mirëqenjen sociale të të punësuarve dhe më shumë*



*janë të orjentuara të krijojnë siguri në vendet e punës tek sektorin privat. Gjendja sociale e të punësuarve është jo e mirë, për shkak të kushteve të punës dhe të mos respektimit të të drejtave të puntorit në një marrëdhënie pune. Në kontekst, punëtorët e sektorit privat i janë duke u shkelur të drejtat. Një nga format është edhe mos pagimi i kontributeve nga ana e punëdhënësit për punëtorin sepse të njëjtin e mbanë në punë pa kontratë pune. Gjithashtu, shqetësuese është edhe fakti i sigurisë në punë dhe sigurimet shëndetësore të cilat realizohen në të gjitha shtetet e zhvilluara dhe sidomos në shtete e BE-së, ngase shteti ynë pretendon në një të ardhme të afërm të bëhet pjesë e saj.*

***Fjalët kyçe: punonjësi, punëdhënësi, ligji, mbrojtja dhe siguria në punë, etj.***

## **PROTECTION AND SAFETY OF EMPLOYEES IN KOSOVO AND ITS LEGAL BASIS**

### ***Abstract***

*The institute of labor relations has presented the essential need for protection and safety of workers that results in theoretical changes in labor relations. These relations define the central object of the legal characteristics of labor law and safety-protection at work. Employment relations are presented between the employer and the employee as participants in the work process in which the employee in a certain form performs a certain contract work, while the employer is also obliged to adhere to the contract, taking the necessary security measures and occupational health.*

*Strategic institutional policies for improving and consolidating working conditions aim to improve the social welfare of employees and are more oriented towards creating job security in the private sector. The social situation of the employees is not good, due to the working conditions and the non-respect of the employee's rights in an employment relationship. In this context, the rights of private sector workers are being violated. One of the forms is the non-payment of contributions by the employer to the employee because he keeps the same at work without an employment contract. Also worrying is the fact of safety at work and health insurance which are realized in all developed countries and especially in EU countries, because our country claims in the near future to become part of it.*

***The key words: employee, employer, law, protection and safety at work, etc.***

## Hyrje

Vështruar sipas të dhënave statistikore për sigurinë dhe shëndetin në punë, çdo vit në Bashkimin Europian, më shumë se 5500 njerëz humbin jetën e tyre si pasojë e aksidenteve në vendin e punës. Është shumë e vështirë që të përcaktosh ndikimin e sëmundjeve profesionale ndaj shëndetit dhe për këtë çështje nuk ka asnjë konsensus të të dhënave. Megjithatë, vlerësimet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) sugjerojnë se 159 000 njerëz në BE çdo vit vdesin si rezultat i sëmundjeve profesionale. Kompani të ndryshme në vende të BE-së, humbin rreth 143 milionë ditë pune çdo vit nga aksidentet në punë. Vlerësimet janë të ndryshme, por aksidente të tilla dhe shëndeti i keq i kushtojnë ekonomisë së BE-së të paktën 490 miliard Euro në vit. Çdo vit, më shumë se dy milion gra dhe burra vdesin si rezultat i aksidenteve dhe sëmundjeve të lidhura me vendin e punës. Punëtorët vuajnë afërsisht një humbje prej 270 milion euro çdo vit të lidhura me aksidentet dhe 160,000,000 të tjera të lidhura me incidentet dhe sëmundjet po në vendin e punës.<sup>203</sup> Për këtë arsye, ILO, që nga themelimi i saj e deri më sot, ka miratuar dhe publikuar 187 deklaratat dhe 198 rekomandime nga fusha e shëndetit dhe sigurisë në punë.

Dita Botërore për sigurinë dhe shëndetin në punë është një pjesë integrale e Strategjisë Globale mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Punë e drejtuar nga ILO (Organizata Internacionale e Punës), e cila promovon krijimin e një sigurie globale parandaluese dhe të një kulture shëndetësore me përfshirjen e të gjithë aktorëve. Prandaj, sipas ILO-s, 28 prilli është përcaktuar si Dita Botërore e sigurisë dhe shëndetit në punë për promovimin e parandalimit të aksidenteve dhe sëmundjeve të lidhura me vendin e punës.

Gjenza e formimit të Organizatës Internacionale të Punës (ILO), e gjejmë në lëvizjet e para të punëtorëve, d.m.th, në kohën e revolucioneve industriale. Ideja e parë erdhi nga organizata private që pastaj u përkrah edhe nga Kisha Katolike. Megjithatë, përpjekjet e para serioze u realizuan me lëvizjet ndërkombëtare të punës të vitit 1890, kur Mbreti Wilhelm II e thirri një konferencë me qëllim të përjashtimit (largimit) të fëmijëve nga puna nëpër miniera dhe ndalimit të punës ditëve të diela. Në vitin 1900 u themelua edhe Bashkimi i

---

<sup>203</sup> <http://www.ishp.gov.al/wp-content/uploads/2015/kalendar/Dita%20Boterore%20e%20Sigurise.pdf>.

Internacionales (private) për mbrojtjen ligjore të punëtorëve. Bashkimi i Internacionales, pas Luftës së Parë Botërore, e përpiloi Projektin Kushtetues të ILO-së.<sup>204</sup>

ILO është një element mjaft i rëndësishëm për politikën e mbrojtjes dhe sigurisë së punëtorëve. Megjithatë, asnjë konventë e ILO-s nuk është adaptuar nga institucionet e Kosovës.<sup>205</sup> Politikën sociale të Institucioneve të Republikës së Kosovës janë të përqendruara që në bashkëpunim me Zyrën e BE-së në Kosovë, të harmonizojnë legjislacionin mbi sigurinë dhe shëndetin në punë, duke përmirësuar kushtet e punës, pasi që sipas Kodit penal të Republikës së Kosovës, pasojat e kushteve jo të duhura dhe lëndimeve në punë kalojnë në nivelin e përgjegjësisë penale për punëdhënësin.<sup>206</sup>

Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) organizoi, Konferencë Kombëtare me temën Mbrojtja dhe Siguria në Punë më 25 nëntor 2011. Ky aktivitet u organizua në partneritet me organizatën turke të punëdhënësve MESS në kuadër të projektit të financuar nga Komisioni Evropian – Urat Lidhëse të Bashkëpunimit për Mbrojtjen dhe Sigurinë në Punë (European Cooperation Bridges on Occupational Health and Safety – ECBOHS). Kjo Konferencë kishte për qëllim sensibilizimin dhe marrjen e masave të nevojshme nga ana e punëdhënësve dhe punëmarrësve për ngritjen e nivelit të sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë. U analizua gjendja aktuale dhe sfidat për arritjen e standardeve evropiane të sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.<sup>207</sup>

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, së bashku me Trupat Ekzekutive të Inspektoratit të Punës në vitin 2015 kishin nisur fushatën vetëdijësuese rreth përmirësimit të kushteve të sigurisë në vendin e punës. Megjithë këto masa të ndërmarra nga institucionet për zbatimin e ligjit, numri i punëtorëve të cilët kanë gjetur vdekjen në vendin e punës dhe të atyre që kanë pësuar lëndime të rënda trupore ishte i lartë. Në vitin 2016, 9 punëmarrës kishin

---

<sup>204</sup> Arif Riza: E Drejta e Organizatave Ndërkombëtare dhe Organizatat Ndërkombëtare (Botimi I), Prishtinë, 2012, fq.231; *Shih po ashtu*, Heribert Franz Köck & Peter Fischer: Das Recht der Internationalen Organisationen 3. Auflage, Wien, 1997, fq.427.

<sup>205</sup> Afrim Hoti: Respektimi Dhe Mbrojtja e Të Drejtave Të Punëtorëve Në Kosovë, Prishtinë, Tetor 2011, fq.2. [http://www.solidar.org/system/downloads/attachments/000/000/292/original/37\\_kosovo\\_labourlaw\\_albanian.pdf?1457601322](http://www.solidar.org/system/downloads/attachments/000/000/292/original/37_kosovo_labourlaw_albanian.pdf?1457601322).

<sup>206</sup> Në Kodin Penal të Republikës së Kosovës (Nr.04/L-82, 20.04.2012), përkatësisht në kapitullin XIX janë paraparë Veprat Penale Kundër të Drejtave në Marrëdhëniet e Punës, konkretisht:

Neni 221, Cenimi i të drejtave nga marrëdhëniet e punës;  
Neni 222, Cenimi i të drejtave të punësimit apo papunësisë;  
Neni 223, Cenimi i të drejtave në menaxhim;  
Neni 224, Cenimi i të drejtave në grevë;  
Neni 225, Keqpërdorimi i të drejtës në grevë;  
Neni 226, Cenimi i të drejtave nga sigurimi social;  
Neni 227, Keqpërdorimi i të drejtave nga sigurimi social.

<sup>207</sup> <http://www.bspk.org/emerald.pdf>.

vdekur në vendin e punës, ndërsa 62 kishin pësuar lëndime të rënda ose 13 më shumë krahasuar me vitin 2015, ndërsa vetëm 3 janë kompensuar për lëndimet e pësuar në punë. Gjersa, në vitin 2017 gjatë aksidenteve në punë kanë vdekur 11 punonjës.

Në nivel nacional, Qeveria e Republikës së Kosovës, në bazë të propozimit të Ministrit të punës dhe mirëqenies sociale, themelon Këshillin Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë, i cili propozon, rekomandon dhe harton politika për përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përcjell në vazhdimësi gjendjen e sigurisë dhe shëndetit në punë të të punësuarve.<sup>208</sup>

Në nivel ndërkombëtar, Agjencia Europiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (EU-OSHA), e ngritur nga ana e Bashkimit Europian në vitin 1996 dhe e bazuar në Bilbao, Spanjë. Agjencia i mbledh së bashku përfaqësuesit nga Komisioni Europian, nga qeveritë e shteteve anëtare, nga organizatat e punëdhënësve dhe të punëtorëve si dhe ekspertë kryesorë prej secili nga EU-27 shtetet anëtare dhe përtej. Misioni i kësaj Agjencie është të kontribuon që t'a bëjë Europën një vend më të sigurtë, më të shëndetshëm dhe më produktiv për të punuar. Agjencia bën kërkime, zhvillon dhe shpërndan informacione të besueshme, të balancuara dhe të paanshme mbi shëndetin dhe mbi sigurinë si dhe organizon fushata gjithë europiane për rritjen e ndërgjegjësimin.<sup>209</sup>

Konfederata Europiane e Sindikatave (ETUC) është një organizatë sindikale, e cila është themeluar në vitin 1973, ajo tani përfaqëson 83 organizata sindikale në 36 vende europiane, plus 12 federata mbi bazë industrie. Objektivi kryesor i ETUC është që të promovojë Modelin Social Europian dhe të punojë për zhvillimin e një Europe të bashkuar të paqes dhe stabilitetit, ku njerëzit e punës dhe familjet e tyre të mund t'i gëzojnë të drejta të plota njerëzore dhe civile si dhe standarte të larta të jetesës. Modeli Social Europian mishëron një shoqëri të kombinuar me rritje të qëndrueshme ekonomike, me standarte të jetesës dhe të punës gjithnjë e në përmirësim, duke përfshirë një punësim të plotë, mbrojtje sociale, mundësi të barabarta, punë me cilësi të mirë, përfshirje sociale si dhe një proces të hapur dhe demokratik të politikëbërjes, i cili t'i përfshijë plotësisht qytetarët në vendimet që i prekin ata. ETUC beson se konsultimet me punëtorët, negociimi kolektiv, dialogu social dhe kushtet e

---

<sup>208</sup> Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë i Republikës së Kosovës, Neni 4, paragrafi 1;

Në paragrafin 2 të nenit 4, është potencuar se, Këshilli Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë, përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtarë: tre përfaqësues të Qeverisë, dy përfaqësues të punëdhënësve, dy përfaqësues të të punësuarve, dy ekspertë nga lëmi i sigurisë dhe shëndetit në punë, një ekspert i mjekësisë së punës dhe një ekspert ad hoc, varësisht nga natyra e çështjes. Mandati i anëtarëve të këshillit është 3 vjeçar.

<sup>209</sup> <https://osha.europa.eu/>.

mira të punës janë thelbësore për promovimin e përmirësimeve, të produktivitetit, të konkurrencës dhe të rritjes në Europë.<sup>210</sup>

## 1. Mbrojtja dhe siguria e të punësuarve në Kosovë

Shikuar historikisht, mbrojtja në punë përfshinë tërësinë e dispozitave, masave teknike, shëndetësore e shoqërore që kanë për qëllim sigurimin e kushteve sa më të përshtatshme për të parandaluar aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe disa sëmundje të tjera të përgjithshme që lidhen me mjedisin e punës. Të gjitha këto kanë për qëllim mbrojtjen e jetës dhe shëndetin e punëtorëve. Dispozitat e para të cilat janë miratuar, e që i përkasin të drejtës së punës ishin të lidhura me mbrojtjen e punëtorëve në punë. Këto dispozita fillimisht i referoheshin vetëm mbrojtjes së fëmijëve dhe grave, por më vonë ato u zgjeruan edhe në kategoritë e punëtorëve të tjerë.<sup>211</sup> Prandaj, mbrojtja, siguria dhe shëndeti në punë, janë komponente të rëndësishme të mbrojtjes së punonësorëve kundër aspekteve negative të punës, aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale. Gjersa, nga këndvështrimi tjetër nënkuptohet se, standardet e dobëta të sigurisë dhe shëndetit në punë, lëndimet trupore në punë, aksidentet me vdekje dhe sëmundjet profesionale shkaktojnë një barrë të rëndë për punëdhënësin dhe përgjegjësinë e shtetit për shkak të obligimeve monetare nga skema e sigurimeve shoqërore, shpenzimeve spitalore, rikualifikimit dhe zëvendësimit të punëtorëve dhe humbjes së produktivitetit në punë.

Konkretisht, siguria dhe shëndeti në punë janë masat parandaluese të marra që kanë si synim përmirësimin e kushteve gjatë procesit të punës, ruajtjen e jetës, integritetin e shëndetit, mbrojtjen fizike dhe mendore të punëmarrësve që përfshihen në procesin e prodhimit.<sup>212</sup> Mbrojtja në punë në ambientin e tanishëm siguron në mënyrë kontinuele integritetin fizik e moral të çdo punëtori. Mbrojtja gjatë punës, përkatësisht siguria dhe shëndeti gjatë punës si përmbledhje e masave, normave dhe standardeve të përcaktuara për krijimin e kushteve të sigurta për punë, është kategori kushtetuese.

Statusi i sigurisë së punëtorit në një marrëdhënie të punës është çështje e të drejtave elementare<sup>213</sup> kushtetuese dhe ligjore, por edhe çështje ekzistenciale dhe e dinjitetit të njeriut.

---

<sup>210</sup> <https://www.etuc.org/> .

<sup>211</sup> Hava Bujupaj-Ismajli: E Drejta e Punës (botimi i tretë me ndryshime dhe plotësime), Prishtinë, 2014, fq.176.

<sup>212</sup> <http://www.ishp.gov.al/wp-content/uploads/2015/kalendar/Dita%20Boterore%20e%20Sigurise.pdf>.

<sup>213</sup> Qamil Maqedonci: “Praktikumi” për zbatimin e dispozitave ligjore nga marrëdhënia e punës në Kosovë, Prishtinë, 2011, fq.12.

Nocioni i mbrojtjes në punë, në kuptimin e gjerë ka të bëjë me, sistemin e masave dhe mjeteve për mbrojtjen e punëtorit, si në aspektin e legjislacionit të punës, ashtu edhe në aspektin e aplikimit të masave teknike, organizative dhe masave të tjera me qëllim të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të punëtorëve. Ndërsa, me mbrojtje në punë nënkuptohet e drejta e punëtorëve për mbrojtje në punë si dhe obligimet e tij që t'i aplikojë rregullat e përcaktuara të masave mbrojtëse.<sup>214</sup>

Në kuptimin e ngushtë mbrojtja në punë përfshin atë pjesë të normave të së drejtës së punës që sanksionojnë posaçërisht (drejtpërsëdrejt) mbrojtjen në punë të punëmarrësve.<sup>215</sup> Sistemi i mbrojtjes i cili rrjedhë nga legjislacioni ynë i punës përfshinë normat juridike, të cilat rregullojnë të drejtat dhe obligimet në aspektin e kufizimit të kohës së punës, pushimit, mbrojtjes së të rinjëve dhe grave etj. Andaj, siguria dhe shëndeti gjatë punës sipas legjislacionit tonë është konceptuar si pjesë përbërëse e organizimit të punës dhe procesit të punës dhe mbi këtë bazë sigurohet çdo punëtor dhe çdo punë e dobishme, pa marrë parasysh llojin dhe kompleksitetin e punës, gjë që është në përputhje me parimin kushtetues lidhur me të drejtën e çdo punëtori për mbrojtje gjatë punës.

Duke u bazuar në të gjitha këto, mund të konkludohet se sistemi i mbrojtjes në punë si dhe normat që i referohen kësaj mbrojtjeje ndahen në dy grupe dhe përfshijnë: mbrojtjen e përgjithshme në punë dhe mbrojtjen e veçantë.<sup>216</sup>

Rregullat që i referohen mbrojtjes në punë ndahen në: sigurimin paraprak të masave mbrojtëse në punë, masat e përgjithshme të mbrojtjes në punë dhe masat e veçanta të mbrojtjes në punë.

Masat paraprake të mbrojtjes në punë kanë të bëjnë me:

Objektet investive në të cilat procesi i punës kryhet në ambient të hapur,

Mjetet për punë në repartet e mekanizuara,

Përdorimin e mjeteve për mbrojtje personale në punë.<sup>217</sup>

Sipas legjislacionit të punës, përkatësisht nenit 42 të Ligjit të Punës në Kosovë, punëtori ka të drejtë në sigurinë në punë me qëllim të mbrojtjes së shëndetit dhe të jetës së tij. Ai, gjithashtu, ka të drejtë të punojë në ambientin e përshtatshëm të punës dhe atë në pajtim me dispozitat e Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë të Republikës së Kosovës. Në këtë kontekst, punëdhënësi është i detyruar që punëtorit t'i sigurojë kushte të nevojshme për

<sup>214</sup> Hava Bujupaj-Ismajli: *supra note*, fq.176-177.

<sup>215</sup> Kudret Çela: *E Drejta e Punës*, Tiranë, 2010, fq.341.

<sup>216</sup> Hava Bujupaj-Ismajli: *supra note*, fq.177.

<sup>217</sup> *Ibid*, fq.177.

mbrojtje në punë me të cilat sigurohet mbrojtja e jetës dhe shëndetit të tyre. Përveç kësaj punëdhënësi detyrohet që në formë të shkruar ta informojë punëtorin para angazhimit të tij për rreziqet që mund t'i paraqiten në vendin e caktuar të punës dhe për masat mbrojtëse që është i obliguar t'i përdorë punëtori. Punëdhënësi duhet t'i udhëzojë ata për rreziqet në punë dhe masat mbrojtëse të cilat duhet të merren në përputhje me udhëzimet e lëshuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Punëdhënësi, po ashtu është i detyruar që t'i zbatojë rregullat dhe procedurat e përgjithshme për mbrojtje dhe siguri në punët të cilat përcaktohen me Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Ndërsa, punëtorët janë të detyruar t'u përmbahen rregullave për sigurinë dhe shëndetin në punë, me qëllim të shmangies së rrezikimit të shëndetit dhe sigurinë personale, si dhe sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve të tjerë.

Në nenin 43 të Ligjit të Punës, janë të parapara edhe disa masa të tjera të mbrojtjes në punë për punëtorët, si p.sh.: punëdhënësi nuk mund ta caktojë punëtorin që të punojë më gjatë sesa orari i plotë i plotë i punës, apo në punët e natës në rastet kur organi kompetentë ka konstatuar se caktimi i punëtorit në punë të tilla ndikon dëmsshëm në shëndetin e tij, për dallim nga kjo në punë dhe detyrat e punës që paraqesin rrezik të shtuar të lëndimit në punë, sëmundjeve të tjera, mund të caktohet punëtori i cili i plotëson kushtet e veçanta për punë, si p.sh. aftësia shëndetësore, përvoja e punës, përgaditja profesionale, mosha etj.

Për dallim nga mbrojtja e përgjithshme në punë, që i referohet të gjithë të punësuarve, mbrojtja e veçantë në punë përfshinë masat e veçanta mbrojtëse dhe i referohet kategorive të caktuara të punëtorëve, mendohet në ata punëtorë të cilët për shkak të natyrës apo karakterit të disa punëve nuk mund të kyçen në vendet e caktuara të punës. Masat e veçanta të mbrojtjes në punë përcaktohen për lloje të veçanta të proceseve teknologjike, veprimtari të caktuara dhe mjeteve të veçanta të punës, nëse për shkak të specificitetit dhe rrezikut nuk mund të sigurohen me masa të përgjithshme.

Masat e veçanta të mbrojtjes në punë zakonisht aplikohen për punët të cilat kryhen në nëntokë (xehetari, ndërtimit të tuneleve), nën ujë, në ambient të hapur, në lartësi, në objekte lëvizëse dhe në proceset kimike – teknologjike.

Masat e veçanta të mbrojtjes në punë përfshijnë edhe caktimin e vendeve të punës në të cilat nuk mund të sistemohen gratë, të rinjët, invalidët. Në këtë prizëm, legjislacioni i punës në Republikën e Kosovës, e ka rregulluar çështjen e mbrojtjes së veçantë për kategoritë e veçanta të punëtorëve.

## **1.1. Mbrojtja dhe siguria e të rinjve në punë**

Me ndihmën e ONP-PNEPF, Kosova ka miratuar një Udhëzim administrativ për parandalimin dhe eliminimin e menjëhershëm të punëve të rrezikshme për fëmijët, e cila përcakton sektorët e rrezikshëm dhe aktivitetet që ndalohen. Në mënyrë që të eliminohet puna e fëmijëve në Kosovë, duhet të ketë një qasje integruese nga aktorët kryesor, si MPMS-ja, Inspektorati i Punës, partnerët social dhe organizatat ndërkombëtare aktive, si ILO, UNICEF-i dhe BE-ja.<sup>218</sup>

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit European konsiderohet akti që përmban dy dispozita që parashikojnë rregullime të posaçme për fëmijët. Sipas nenit 24 të saj, fëmijët kanë të drejtën e mbrojtjes dhe kujdesit të nevojshëm për mirëqenien e tyre si dhe mund të shprehin lirisht pikëpamjet e tyre të cilat merren në konsideratë për çështje me interes për ta, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tyre. Gjithashtu sipas nenit 32 të Kartës, përcaktohet ndalimi i punës së fëmijëve dhe mbrojtja e të rinjve në vendin e punës.

Legjislacioni i punës, përkatësisht në nenin 45 të Ligjit të Punës është përcaktuar që personi nën moshën 18 vjeçare nuk mund të punojë në punët të cilat për nga natyra apo rrethanat të cilat kryhen mund të dëmtojnë shëndetin, sigurinë apo moralin e tyre. Punëdhënësi është i detyruar që të aplikojë masat e nevojshme për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetin e të rinjve, duke bërë specifikimin e vendeve të punës me rreziqe në procesin e punës. Aplikimin e masave punëdhënësi duhet ta bëjë në bazë të shkallës së rrezikshmërisë së vendit të punës për kategorinë e të rinjve. Për mbrojtjen e plotë të të rinjve në punë punëdhënësi është i detyruar të bëjë vlerësimin paraprak të rrezikshmërisë për vendet e punës para fillimit të punës së punëtorit të ri. Sipas dispozitave të këtij neni, i punësuar nën moshën 18 vjeçare nuk mund të punojë e rrezikshme si në vijim:

Në nëntokë, nën ujë, në lartësi të rrezikshme apo në vende të mbyllura,

Me makineri të rrezikshme, në pajisjet dhe veglat, të cilat duhen shfrytëzuar, dhe në transportimin e ngarkesave të rënda;

Në mjedis jo të shëndoshë, i cili për shembull i ekspozon të rinjtë në substancat e rrezikshme, faktorëve ose proceseve, temperaturave, zhurmave dhe dridhjeve që dëmtojnë shëndetin e tyre;

---

<sup>218</sup> Profili i Sistemit të Sigurisë Sociale në Kosovë (sipas Rezolutës 1244 [1999] të KS të OKB-së), 2010, fq.17-18.  
[http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms\\_168771.pdf](http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms_168771.pdf)



Nën kushte posaçërisht të vështira siç është puna me orar të gjatë, apo në rrethana të caktuara gjatë natës, puna në mjedis të mbyllur.<sup>219</sup>

Llojet punëve të rrezikshme të cekura më lartë, duhet të shqyrtohen çdo vit, nga organi përkatës i përfaqësuesit e tyre të cilët janë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ministritë e tjera përkatëse të Qeverisë, organizatat e punëdhënësve dhe organizatat të të punësuarve (sindikatat). Për zbatimin e drejtë dhe të plotë të këtij neni, MPMS-ja do të nxjerrë akte nënligjore në afatin e përcaktuar me ligj.

Përfundimisht, rëndësi speciale për “Mbrojtjen e të rinjëve në punë” përpos Kartës Sociale Europiane kanë edhe këto akte tjera ndërkombëtare, si: Konventa e OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve”, Konventa nr. 138 e ILO-s “Mosha minimale për punë”, Konventa nr. 182 e ILO-s “Format më të këqija të punës së fëmijëve”, Konventa nr. 182 e ILO-s “Për format me të rënda të punës së fëmijëve”, Konventa nr. 78 e ILO-s “Për kontrollin mjekësor të të rinjve (në sektorin joindustrial)”, Konventa nr. 77 e ILO-s “Për kontrollin mjekësor të të rinjve (në sektorin industrial)”, Konventa nr. 16 e ILO-s “Për kontrollin mjekësor të të rinjve (në sektorin detar)”, Konventa nr. 6 e ILO-s “Për punën e natës së të rinjve (në sektorin industrial)”, Direktiva 94/33/KKE “Për mbrojtjen e punonjësve të rinj në punë”.

## **1.2. Mbrojtja dhe siguria e femrave në punë**

Femrat e punësuarra gëzojnë mbrojtje të veçantë sipas legjislacionit të punës në Kosovë. Femrat shtatzëna dhe gjdhënëse u ndalohen punët dhe detyrat e punës që janë të përcaktuara si të dëmshme për shëndetin e nënës dhe fëmijës. Në këtë kontekst, atyre u ndalohet që të punojnë në vendet e punës që konsiderohen si punë veçanërisht të rënda fizike, punë që u ekspozohen faktorëve biologjikë, kimikë apo fizikë e që paraqesin rrezik për shëndetin riprodhues të tyre. Për caktimin e punëve të rënda të cilat mund të dëmtojnë shëndetin e femrave shtatzëna dhe gjdhënëse ministria mund të nxjerrë aktin nënligjor. Përgjatimisht, kryerja e punëve në nëntokë nuk vlen për femrat të cilat nuk janë shtatzëna e që kryejnë punë udhëheqëse, për personel shëndetësor dhe për studentët gajtë punës praktike.<sup>220</sup>

<sup>219</sup> Ligji i Punës i Republikës së Kosovës, neni 45, paragrafi 5.

<sup>220</sup> Hava Bujupaj-Ismajli: *supra note*, fq.181-182.

Femrat e punësuar gjatë kohës së shtatzanisë, nënat me fëmijë nën moshën trevjeçare nuk mund të detyrohet të punojë më gjatë se sa orari i plotë i punës dhe punë gjatë natës. Po ashtu prindi vetushqyes me fëmijë nën moshën tre vjeçare dhe me fëmijë me invaliditet të rëndë nuk mund të detyrohet të punojë më gjatë se sa orari i plotë i punës dhe në punën gjatë natës. Përjashtimisht, këto të drejta mund t'i shfrytëzojë edhe adaptuesi i fëmijës ose të braktisjes nga ana e prindit.

Sipas Rregullores së UNMIK-ut, femrës së punësuar i takonin të paktën 12 javë pushim lehonie me pagesë pas lindjes së fëmijës. Ky pushim njihet si periudhë kohore pune dhe paguhet nga punëdhënësi me një shkallë prej jo më pak se 2/3 e të ardhurave të femrës punonjëse. Me Ligjin e ri të punës femrat e punësuar kanë përfituar edhe në kohë por edhe në kompensim, pra nga 12 javë pushim me pagesë në 9 muaj pushim me pagesë. Formula aktuale e pushimit 6+3+3 gjithsesi se është inkurajuese për femrat e punësuar.

Femrat e punësuar gëzojnë të drejtën prej dymbëdhjetë (12) muajve, të pushimit të lehonisë. Femra e punësuar mund ta fillojë pushimin e lehonisë deri në dyzetepesë (45) ditë para datës kur pritet të lindë dhe atë me prezantimin e certifikatës mjekësore. Në periudhën prej njëzetetë (28) ditëve para datës kur pritet të lindë, punëdhënësi me pëlqimin e femrës shtatzënë, mund të kërkojë që ajo ta fillojë pushimin e lehonisë, nëse punëdhënësi mendon se femra e punësuar nuk është në gjendje t'i kryejë detyrat e saj. Ligji po ashtu ka paraparë pagesën e lehonisë sin ë vijim: Gjashtë (6) muajt e parë të pushimit të lehonisë pagesa bëhet nga punëdhënësi me kompensim 70% të pagës bazë. Tre (3) muajt në vijim, pushimi i lehonisë paguhet nga Qeveria e Kosovës me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë. Gjithashtu, Femra e punësuar ka të drejtë me këtë ligj që ta zgjasë pushimin e saj të lehonisë edhe për tre (3) muaj të tjera pa pagesë.

Nëse lehona nuk dëshiron ta shfrytëzojë të drejtën në pushim të lehonisë nga paragrafi 4 dhe 5 i nenit 49, duhet ta lajmëroj punëdhënësin më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë para përfundimit të pushimit. Sipas paragrafit 7 babai i fëmijës mund të marrë të drejtat e nënës, nëse nëna vdes ose e braktis fëmijën para se të përfundojë pushimi i lehonisë. Për të drejtat nga paragrafi 4 dhe 5 i këtij neni mund të barten te babai i fëmijës në marrëveshje me nënën. Të drejtat e përcaktuara sipas nenit 49 mund t'i realizojë edhe i ati i fëmijës me rastin e sëmundjes së nënës, braktisjes së fëmijës nga nëna dhe vdekjes së nënës. Babai i fëmijës ka të drejtën për: dy ditë pushim me pagesë me rastin e lindjes së fëmijës ose adoptimit të fëmijës; dyjavë pushim të papaguar pas lindjes së fëmijës, ose adoptimit të fëmijës, në periudhën

derisa fëmija ta ketë arritur moshën 3 vjeç. I punësuar duhet të informojë punëdhënësin për qëllimet e tij për ta marrë pushimin së paku 10 ditë më herët.

Mbrojtjen, përkatësisht të drejtat nga paragrafi 1 të neni 49, lidhur me paragrafin 1 të neni 50, mund t'i shfrytëzojë edhe adoptuesi i fëmijës, përkatësisht kujdestari i fëmijës, në rast të vdekjes së dy prindërve, ose nëse prindërit braktisin fëmijën.

Në nenin 51 të Ligjit të Punës, janë paraparë të drejtat e femrës së punësuar në rastin kur lind fëmijë të vdekur, ose nëse fëmija i vdes para skadimit të kohëzgjatjes së pushimit të lehonisë, ajo ka të drejtë për pushim lehonie sipas konstatimit të mjekut, për sa kohë i nevojitet të këndellet nga lindja dhe nga gjendja psiqike e shkaktuar nga humbja e fëmijës, por jo më pak se dyzetepesë (45) ditë, dhe për këtë kohë i takojnë të gjitha të drejtat mbi bazën e pushimit të lehonisë. Në rastet e caktuara femra e punësuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të kërkojë nga punëdhënësi që të kthehet në punë para skadimit të pushimit të lehonisë. Në rast se femra ka filluar të punojë më nuk ka të drejtë të shfrytëzojë pushimin e lehonisë.

Pas skadimit të pushimit të lehonisë njëri prej prindërve ka të drejtë të punojë me gjysmë orari të punës derisa fëmija të mbushë 2 vjet dhe atë vetëm në raste kur ai domosdoshmërisht ka nevojë për përkujdesje të veçantë për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore ose kur në raste kur fëmija është me aftësi të kufizuara të përhershme. Këtë mbrojtje dhe këto të drejta mund t'i gëzojë adoptuesi, kujdestari i fëmijës, në rastin e vdekjes së dy prindërve ose kur braktiset fëmija. Mënyra dhe procedura e realizimit të këtyre të drejtave bëhet sipas dispozitave të Ligjit për përkujdesje materiale, për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara.

Gjatë kohës së shtatzënisë, pushimit të lehonisë dhe mungesës në punë për shkak të përkujdesjes së veçantë ndaj fëmijës, punëdhënësi nuk mund t'ia shkëpusë kontratën të punësuarit dhe t'ia ndërrojë vendin e punës, përveç në rastet e shkëputjes së kontratës sipas neni 76 të Ligjit të Punës, që ka të bëjë me largimet kolektive nga puna.

Të gjitha këto dispozita ligjore për mbrojtjen në punë të femrës kanë rrjedhur nga dispozitat e akteve ndërkombëtare dhe ato prej tyre janë: Karta e të Drejtave Themelore të Punëtorëve, Konventa e OKB-së "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj Grave", Konventa nr. 103 e ILO-s "Për mbrojtjen e shtatzënisë", Konventa nr. 183 e ILO-s "Për mbrojtjen e amësisë", Direktiva 92/85/KEE "Mbi prezantimin e masave për të nxitur përmirësime në sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjëseve shtatzëna dhe të punonjëseve që sapo kanë lindur, ose janë me fëmijë në gj", Direktiva 96/34/KE "Për lejen prindërore",

Direktiva e ndryshuar 2006/54/KE “Për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta për burrat dhe gratë në çështje të punësimit dhe profesionit (e ribërë)” etj.

### 1.3. Mbrojtja dhe siguria e personave me aftësi të kufizuara

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Pakti i të Drejtave Civile dhe Politike, si dhe Pakti mbi të drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, trajtojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, si akte ndërkombëtare të cilat trajtojnë mbrojtjen në punë të personave me aftësi të kufizuara, janë: Karta Sociale Europiane<sup>221</sup>, Karta e të Drejtave Themelore e BE-së<sup>222</sup>, Konventa e OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, Direktiva 2000/78/KEE “Për një kuadër të përgjithshëm për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion” etj.

Sa i përket Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës, në nenin 47 të tij parasheh edhe mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara. Sipas këtij neni, i punësuarit tek i cili paraqitet aftësia e kufizuar, ka të drejtë të punojë në punën e tij ose sipas përshkrimit të punës ose punë tjera përkatëse, nëse sipas aftësisë së mbetur për punë mund ta kryejë atë punë pa rehabilitim profesional, po ashtu në këtë nen përcaktohetse i punësuarit të cilit i është zvogëluar aftësia shëndetësore për punë pas rehabilitimit profesional është aftësuar të kryejë punë të caktuara, konsiderohet i aftë për kryerjen e atyre punëve. Punëdhënësi ka për detyrë që të punësuarit t’ia sigurojë atë lloj pune për të cilën është aftësuar pas rehabilitimit profesional. Në rast se i punësuarit refuzon t’i pranojë punët sipas këtij neni, punëdhënësi me paralajmërim mund t’ia shkëpusë kontratën e punës të punësuarit.

Në Ligjin për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara,<sup>223</sup> përkatësisht në nenin 12, paragrafi 4, parasheh që varësisht nga shkalla dhe kategoria e aftësisë së kufizuar, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me akt të veçantë nënligjor, do të rregulloj dhe përcaktoj vendet e punës dhe punët e përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar. Më tutje, në nenin 13 paragrafi 3, parasheh që personi me aftësi të kufizuara mund të punojë natën, jashtë orarit të punës ose me orar të ndryshuar, në harmoni me vlerësimin e komisionit profesional, i cili ia ka përcaktuar aftësinë e zvogëluar të punësuarit. Gjersa në paragrafin 4 thuhet që bartësi i sigurimit të punësimit të personave me aftësi të

<sup>221</sup> Neni 15 i Kartës Sociale Europiane.

<sup>222</sup> Neni 21 i Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së.

<sup>223</sup> Ligji Nr.03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, 18.12.2008.

kufizuara, merren vesh me punëtorin rreth kushteve të punës dhe marrëdhënien e punës, kohën e punës, kohëzgjatjen e punës, mbikëqyrjen profesionale, mbulimin e shpenzimeve të përshtatjes dhe lartësinë e atyre shpenzimeve si dhe marrëdhëniet tjera nga puna. Gjithashtu, bartësi i sigurimit të punësimit nga paragrafët 1, 2 dhe 3 të nenit 18 të këtij ligji ose personi tjetër fizik ose juridik, mund të merret vesh me personin me aftësi të kufizuara, lidhur me përshtatjen e kushteve dhe marrëdhënieve të punës, kohën punës, kohëzgjatjen, mbikëqyrjen profesionale, mbulimin e shpenzimeve të përshtatjes së punës dhe lartësinë e atyre shpenzimeve si dhe marrëdhëniet tjera nga puna.

Gjithashtu, në nenin 54 të këtij ligji, parashihet që në rast të sëmundjes ose paaftësisë së përkohshme për punë, i punësuari është i obliguar të informojë punëdhënësin menjëherë ose më së largu gjatë ditës së mungesës nga puna. Në rast të sëmundjes ose lëndimit serioz që parandalon të punësuarin për ta informuar punëdhënësin sipas paragrafit 1 të këtij neni i punësuari duhet të bëjë përpjekje për të informuar punëdhënësin sa më shpejt që është e mundur.

Nëse i punësuari nuk mund të dëshmojë se ka bërë përpjekje të arsyeshme për të informuar punëdhënësin për mungesën e tij për vonesa të paarsyeshme, punëdhënësi mund të thirret në shkelje të kontratës. Nëse mungesa e lajmëruar nga puna zgjat më shumë se 3 ditë, punëdhënësi ka të drejtë të kërkojë nga i punësuari certifikatën mjekësore që arsyeton mungesën nga puna.

### **Përfundimi dhe rekomandimet**

Në kuadër të tematikave të analizuara në këtë studim shkencor lidhur me rregullimin ligjor të marrëdhënies së punës sipas standarteve të mbrojtjes së sigurisë dhe shëndetit të punonjësve dhe mbrojtjes së përgjithshme shoqërore të saj, u prezantua legjislacioni aktual dhe gjendja aktuale e mbrojtjes dhe sigurisë në punë, por edhe të drejtat dhe detyrimet të cilat duhet t'i përmbahen subjektet zbatuese gjatë procesit të marrëdhënies së punës. Në këtë kontekst, u vlerësuan aktet ndërkombëtare, aktet ligjore të së drejtës së punës dhe sigurisë në punë të BE-së dhe aspekti krahasues me vendet tjera. Megjithatë, ende ka nevojë të trajtohen për shkak të implementimit të dobët nga institucionet.

Për përmirësimin e kushteve të punës lidhur me mbrojtjen dhe sigurinë në punë janë bërë ndryshimet ligjore dhe janë nxjerrë dispozita të reja ligjore, përfshirë këtu edhe

rregulloret dhe udhëzimet e institucioneve kompetente. Andaj, me të drejtë është dhënë konsideratë ligjore mbrojtjes së veçantë në punë të punëtorëve gjinisë femërore dhe fëmijëve, ngase gjatë marrëdhënies së punës duhet t'i përshtaten ambientit dhe veprimtarisë në punë, në mënyrë që t'i evitohet rreziqet eventuale të sigurisë dhe shëndetit të tyre. Gjithashtu, me Konventat e ILO-s dhe aktet tjera ndërkombëtare janë përcaktuar dispozita konkrete të mbrojtjes së veçantë në punë, si dhe mundësisë së inkorporimit në punë të gjinisë femërore.

Siç paraqitet nevoja, legjislacioni i punës në Kosovë, duhet t'i përshtatet akteve ndërkombëtare, traktateve dhe direktivave të BE-së. Në përgjithësi është me rëndësi që të adaptohen këto akte ligjore ndërkombëtare, në mënyrë që mbrojtja dhe siguria e punonjësve në Kosovë të zbatohet sipas institucioneve të shteteve perëndimore, sepse tani që festoi jubileun e 10 vjetorit të Pavarësisë, ende nuk ka ndërmarrë hapat e duhura për konsolidimin e tregut të punës, e aq më pak konsolidimin e kushteve të punës. Në theks të veçantë, sektori privat është i pa zhvilluar dhe aksidentet në punë rezultojnë në sektorin privat për shkak të mos zbatimit të dispozitave ligjore nga punëdhënësi dhe Inspektoriati i Punës.

Duke dhogaritur në këto konkluzë, është e nevojshme të përmenden organet kompetente që duhet të jenë aktive në promovimin dhe monitorimin e implementimit të legjislacionit të punës, si: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektoriati i Punës, Gjykatat, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyes Civil, Sindikatat për Mbrojtjen e Punëtorëve, si dhe Shoqëria Civile.

Pavarësisht se Ligji i Punës dhe Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, kanë parashikuar dispozita afirmuese për punonjësit, mirëpo këto duhet të gjejnë zbatim në praktik.

*Në këtë drejtim ne nxjerrim rekomandimet e këtij studimi shkencor, si në vijim:*

*- Përafrimi i legjislacionit të punës (Ligjit të Punës në Kosovë dhe Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në unë i Republikës së Kosovës) me “acquis communautaire” dhe ratifikimi i Konventave përkatëse të ILO-s.*

*- Përmirësimi i kushteve të punës për të parandaluar aksidentet në punë dhe sëmundjeve profesionale, si dhe për zbatimin e një qëndrimi sistematik dhe pozitiv ndaj shëndetit dhe sigurisë në punë.*

*- Masat që ndërmerr punëdhënësi në bashkëpunim me punonjësit për të ngritur shkallën e sigurisë në punë, mbrojtjes së shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës, sigurisht do të ndikojnë në zvogëlimin e numrit të rasteve të aksidenteve në punë.*

- Sistemi i inspektimit të punës duhet të zgjerohet dhe të profilizohet, për të arritur standartet e shërbimeve inspektuese të vendeve të Rajonit dhe të shteteve anëtarëve të Bashkimit Evropian.
- Reduktimi i aksidenteve në punë, me theks të veçantë duhet të vihet kryesisht në uljen e numrit të aksidenteve me vdekje (p.sh. 11 punëtorë të vdekur në vendet e punës gjatë vitit 2017).
- Të krijohen standarte të barabarta për kompenzimin e punëtorëve të aksidentuar në punë bazuar në ligj dhe ekspertizave të bëra.
- Të ndërmerren masa ligjore ndaj punëdhënësve, të cilët nuk ofrojnë kushte të sigurta për mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve gjatë kryerjes së punës.

## **Literatura**

### ***Libra, monografi, artikuj profesional – shkencor dhe broshura:***

1. Afrim Hoti: Respektimi Dhe Mbrojtja e Të Drejtave Të Punëtorëve Në Kosovë, Prishtinë, Tetor 2011.
2. Arif Riza: E Drejta e Organizatave Nderkombetare dhe Organizatat Nderkombetare (Botimi I), Prishtine, 2012.
3. Hava Bujupaj-Ismajli: E Drejta e Punës (botimi i tretë me ndryshime dhe plotësime), Prishtinë, 2014.
4. Hava Ismajli: E Drejta Ndërkombëtare e Punës, Prishtinë, 2001.
5. Heribert Franz Köck & Peter Fischer: Das Recht der Internationalen Organisationen 3. Auflage, Wien, 1997.
6. K. Çela, P. Haxhi: E Drejta e Krahasuar e Punës, Tiranë, 2002.
7. Kudret Çela: E Drejta e Punës, Tiranë, 2010.
8. Qamil Maqedonci: “Praktikumi” për zbatimin e dispozitave ligjore nga marrëdhënia e punës në Kosovë, Prishtinë, 2011.

### ***Kode, ligje dhe dokumente ligjore:***

9. Dekreti Nr. DL-026-2013, të datës 31.05.2013 i Presidentes së Republikës së Kosovës, i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.22, 14.06.2013, Prishtinë.
10. Karta e Komunitetit për të Drejtat Themelore të Punonjësve/ 9 tetorit 1989.
11. Karta Sociale Europiane (e rishikuar), Strasburg, 3 Maj 1996, <https://rm.coe.int/168047e169> .

12. Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Nr.04/L-82, 20.04.2012).
  13. Konventa e 202 ONP C155 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”.
  14. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, Prishtinë
  15. Ligji Nr. 03/L-212 i Punës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2735>
  16. Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8689>
  17. Ligji Nr. 10 237, datë 18.2.2010 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë [http://www.chemicals.al/vkm/ligj\\_nr\\_10237\\_dt\\_18022010%20per%20sigurine%20ne%20pune.pdf](http://www.chemicals.al/vkm/ligj_nr_10237_dt_18022010%20per%20sigurine%20ne%20pune.pdf).
  18. Ligji Nr. 2003 / 19 për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8689>.
  19. Ligji Nr.03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, 18.12.2008.
  20. Ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë.
  21. Rregullore Nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë [http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2001regs/RA2001\\_27.pdf](http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2001regs/RA2001_27.pdf).
- Burime nga Interneti:**
22. Profili i Sistemit të Sigurisë Sociale në Kosovë (sipas Rezolutës 1244 [1999] të KS të OKB-së),
  23. [http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms\\_168771.pdf](http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms_168771.pdf).
  24. <http://www.ishp.gov.al/wp-content/uploads/2015/kalendar/Dita%20Boterore%20e%20Sigurise.pdf>.
  25. <http://www.bspk.org/emerald.pdf>
  26. <https://osha.europa.eu/>
  27. <https://www.etuc.org/>

MSc. Egzon QOVANAJ

KDU323.25(496.51)

## KRIMET E GJENOCIDIT NË KOSOVË, VËSHTRUAR SIPAS KPDGJ<sup>224</sup>

### *Abstrakt*

---

<sup>224</sup> Konventa Ndërkombëtare për Pengimin dhe Dënimin e Krimeve të Gjenocidit.



*Krimet e gjenocidit të kryera në Kosovë në periudhën 1998-1999, janë krime të parapara dhe të ndëshkuara me Konventa Ndërkombëtare dhe të argumentuara me të gjitha mjetet provuese dhe mekanizmat e vëzhguesve ndërkombëtarë të cilët kishin raportuar për krimet serbe të kryera kundër popullit shqiptar. Për më tepër, populli shqiptar (vendas) ishte objekt i mbrojtjes së Konventës Ndërkombëtare për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit. Ndërsa, policë, ushtarë dhe paramilitarë serbë, kanë kryer krime më ndaj popullit shqiptar, duke përdorur forma dhe mjete më barbare ndaj cilës do gjinie dhe moshe të popullatës civile.*

*Drejtësia penale ndërkombëtare përfshin dy institucione të rëndësishme, si: Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë (ICTY) dhe/ose Gjykata Penale Ndërkombëtare (ICC). Për krimet e kryera në Kosovë, janë gjykuar kriminel serbë të cilët dhanë urdhra dhe zbatuan urdhrat e instancave më të larta shtetërore dhe politike të Serbisë. Ndërsa në përgjithësi, Republika e Kosovës ende nuk e ka paditur Serbinë për krimet e gjenocidit sepse ekzistojnë pengesa të natyrës juridike. Megjithatë, ekziston një mundësi tjetër procedurale, që për shtetet ose entitetet që nuk janë anëtare të OKB-së, por që marrin mbi vete ose t'i pranojnë dispozitat nga statuti, atëherë edhe këtyre shteteve (entiteteve) u bëhet e mundur një gjë e tillë, mirëpo nga institucionet e Kosovës është krijuar një konfuzitet. Në këndvështrimin e Konventës për Pengimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit, del se në Kosovë janë manifestuar të gjitha format e gjenocidit të parapara me këtë Konventë.*

**Fjalët kyçe:** Konventa, Krimet, Gjenocidi, Kryerësit etj.

## **GENOCIDE CRIMES IN KOSOVO, VIEWED UNDER THE CPPCG<sup>225</sup>**

### **Abstract**

*The crimes of genocide committed in Kosovo in the period 1998-1999, are crimes foreseen and punished by International Conventions and argued by all means of proof and*

---

<sup>225</sup> International Convention on the Prevention and Punishment of the Crime of Genocide

*mechanisms of international observers who had reported on Serbian crimes committed against the Albanian people. Moreover, the Albanian (indigenous) people were the object of protection of the International Convention for the Prevention and Punishment of the Crime of Genocide. Meanwhile, Serbian police, soldiers and paramilitaries have committed more crimes against the Albanian people, using the most barbaric forms and means against any gender and age of the civilian population. International criminal justice includes two important institutions, such as the International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia (ICTY) and / or the International Criminal Court (ICC). For the crimes committed in Kosovo, Serbian criminals were tried who gave orders and carried out the orders of the highest state and political instances of Serbia. While in general, the Republic of Kosovo has not yet sued Serbia for genocide crimes because there are obstacles of a legal nature. However, there is another procedural possibility, that for states or entities that are not members of the UN, but that take over or accept the provisions of the statute, then these states (entities) are made possible to do so, but the institutions of Kosovo have created confusion. From the point of view of the Convention on the Prevention and Punishment of the Crime of Genocide, it appears that in Kosovo are manifested all forms of genocide provided by this Convention.*

***The key words: Convention, Crimes, Genocide, Perpetrators, etc.***

## **Hyrje**

Krimi i gjenocidit është lloji më i rëndë në mesin e të gjitha veprave penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare.<sup>226</sup>

Termi *gjenocid* është fërkuar nga fjala greko-romake: *genos* – që ka domethënje të racës, gjinisë apo fisit dhe prapashtesës *cide* – që ka domethënje vrasje, ose nga fjala latine *genus*, që domethënë “grup” dhe *caedere*, që domethënë “të vrasësh”.<sup>227</sup> Këtë term për here të parë e ka përpiluar çifuti polak,<sup>228</sup> avokati dhe profesori Rafael Lemkin,<sup>229</sup> nga fundi i Luftës

---

<sup>226</sup> Ismet Salihu: E Drejta Penale Ndërkombëtare, Prishtinë, 2011, fq.348; *Shih po ashtu* Ismet Salihu: E Drejta Penale (pjesa e posaçme), Prishtinë, 2014, fq.84; *Shih po ashtu* Ismet Salihu, Hilmi Zhitija & Fejzullah Hasani: Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Botimi I, Prishtinë, 2014, fq.409.

<sup>227</sup> Zejnullah Gruda: Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut I, botimi i dytë, Prishtinë, 2001, fq.283, E/CN.4/Sub.2/416, par.17; The United Nations and Human Rights, United Nations, New York, 1984, p.39; Human Rights Questions and Answers, United Nations, New York, 1987, p.22.

<sup>228</sup> Muhamed Shestanoviq: Krimi i Gjenocidit dhe Krimi i Harresës së Gjenocidit; SFIDAT E HULUMTIMIT TË KRIMEVE TË LUFTËS NË KOSOVË 1998-1999 (Përmbledhje e Punimeve të Konferencës Ndërkombëtare në Prishtinë 16 dhjetor 2011) Prishtinë, 2013, fq.169.

së Dytë Botërore, për të shënuar krimet e shkatuara nga gjermanët kundër hebraikëve. Kjo ka kontribuar që, qysh në kohën e luftës të fillojë të flitet për përgjegjësinë e fajtorëve për këto krime. Në këtë drejtim, Dhoma e Përfaqësuesve e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me një Rezolutë të miratuar më 19 mars 1943, e kishte shprehur neveritjen kundër këtyre krimeve,<sup>230</sup> dhe se fajtorët e drejtëpërdrejtë ose të tërthortë për këto akte kriminale të përgjigjen dhe të dënohen. Këtë qëndrim e kishin konfirmuar përfaqësuesit e Mbretërisë së Bashkuar, të SHBA-së dhe të Bashkimit Suvjetik në “Deklaratën për Mizoritë” të Konferencës së Moskës (19-30 tetor 1943).<sup>231</sup> Gjenocidi përmendet së pari në Rezolutën 96 (I) të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara të 11 dhjetorit 1946. Sipas kësaj rezolute, gjenocidi është “mohim i të drejtës për ekzistencë i grupeve të tjera njerëzore, siç është hemocidi, mohimi i të drejtës për jetë qenieve të veçanta njerëzore”. Fjalorët e së drejtës ndërkombëtare dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare gjenocidin e përkufizojnë si krim i kryer me qëllim të shfarosjes së plotë ose të pjesshme të një grupi kombëtar,<sup>232</sup> etnik,<sup>233</sup> racor ose fetar.<sup>234</sup> Ndërsa, domethënja juridike e krimit të gjenocidit, është definuar në Konventën për Pengimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me 9 dhjetor të vitit 1948 e ka aprovuar Konventën për Pengimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit,<sup>235</sup> dhe i ftoi shtetet ta nënshkruajnë, ta ratifikojnë ose ta pranojnë.<sup>236</sup> Konventa ka hyrë në fuqi më 12 janar 1951. Më 31 dhjetor 1996 me Konventë kanë qenë të obliguara 120 shtete të ndryshme të botës, ndërmjet të cilave është edhe ish-Jugosllavia.<sup>237</sup>

Shumica e hulumtuesve, duke përfshirë edhe organet gjyqësore (vendore dhe ndërkombëtare), gjenocidin e identifikojnë dhe i përceptojnë vetëm një pjesë të tij, do të thotë,

---

<sup>229</sup> Ljubo Bavcon: *Mednarodno kazensko pravo*, Lubjanë, 1997, str.92; *Shih po ashtu* Ismet Salihu: *E Drejta Penale Ndërkombëtare*, Prishtinë, 2011, fq.348.

<sup>230</sup> Rrjedhimisht, SHBA-të janë dhe kanë qenë gjithmonë kundër krimeve të gjenocidit, këtë e kanë treguar edhe në rastin e luftës në Kosovë 1998-1999.

<sup>231</sup> Ujedinjene nacije, *Zbirka dokumenata 1941-1945*, Drugo izdanje, Arhiv za pravne i drustvene nauke, Beograd, 1947, str.17-18.

<sup>232</sup> Grupi kombëtar (nacional) është grupi i cili indentifikohet me shtetin e ekzistues nacional, me shumicën e pjesëtarëve të një kombi brenda një shteti.

<sup>233</sup> Grupi etnik është i përbërë nga pakica kombëtare, apo ndonjë grup që i përket një gjuhe, një culture etj., siç janë në Kosovë p.sh. serbët, boshnjakët, turqit, romët etj. Grupeve etnike, përkatësisht pakicave u ofrohet mbrojtje e posaçme, ngase në të kaluarën zakonisht këto kanë qenë objekt i shkeljeve të të drejtave, objekt i sulmeve, madje edhe i krimit të gjenocidit.

<sup>234</sup> Vladimir Ibleq: *Rjecnik medjunarodnog javnog prava*, Zagreb, 1972, str.85; *Shih po ashtu* Diccionario de Derecho Internacional, Moscu, 1988, str.179; *Shih po ashtu* Jack C. Plano & Roy Olton: *Diccionario de Relaciones Internacionales*, Mexico, 1975, fq.414; *Shih po ashtu* Zejnullah Gruda: *supra note*, fq.283.

<sup>235</sup> Ismet Salihu: *E Drejta Penale Ndërkombëtare*, Prishtinë, 2011, fq.348.

<sup>236</sup> Historiku i përgaditjes dhe miratimit të Konventës: E/CN.4/Sub.2/416, par.30-41; Titulli original: *Convention on the Prevention and Punishment of the Crime of Genocide*. Teksti i Konventës: *A Compilation of International Instruments Volume I (Secord Part) Universal Instruments*, United Nations, New York and Geneva, 1994.

<sup>237</sup> Zejnullah Gruda: *supra note*, fq.293.

vrasjen e pjesëtarëve të grupit, me ç'rast, pa kurrfarë baze dhe argumentacioni, anashkalohen veprimet tjera të gjenocidit, e sidomos shkaktimi i lëndimeve të rënda trupore ose psikike të pjesëtarëve të grupit.<sup>238</sup>

Secili nga veprimet e përmendura, i bërë me qëllim të zhdukjes plotësisht apo pjesërisht një grup nacional, etnik, racor ose fetar si i tillë, është gjenocid, i cili juridikisht është i definuar në radhë të parë me qëllim – prandaj edhe flitet për qëllim të veçantë (dolus specialis). Në qoftëse kryerësi ka pasur për qëllim (mens rea) që, vetëm me një veprim të gjenocidit, sikurse është për shembull shkaktimi i lëndimeve të rënda trupore (actus reus), ta shkatërrojë në tërësi ose pjesërisht një grup nacional, etnik, racor ose fetar si të tillë dhe e argumenton këtë, kuptohet se është fjala për gjenocid të kryer.<sup>239</sup>

## **1. Krimet e gjenocidit sipas Konventës për Pengimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit**

Konventën për Pengimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit (9 dhjetor 1948), e kanë ratifikuar shumica e shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe njëherësh dispozitat e kësaj konvente i kanë inkuorporuar edhe në legjislacionet e tyre penale. Në nenin 1 të kësaj Konvente, thuhet se shtetet kontraktuese konstatojnë se gjenocidi i kryer në luftë dhe në paqe është krim sipas të drejtës ndërkombëtare dhe obligohen për pengimin dhe ndëshkimin e tij. Ndërsa në nenin 2 të kësaj Konvente, gjenocidi përfshin pesë elemente (akte – actus reus) të këtij krimi të bëra me qëllim që në tërësi ose pjesërisht, të zhduket, si i tillë një grup nacional, etnik, racor ose fetar, konsiderohen këto vepra:

Vrasja e pjesëtarëve të grupit;

Shkaktimi i lëndimeve të rënda trupore ose psikike mbi pjesëtarët e grupit;

Imponimi me qëllim i kushteve të vështira jetësore në grup me qëllim të zhdukjes së plotë ose të pjeshme fizike të grupit;

Imponimi i masave me qëllim që të parandalohet lindja brenda grupit; dhe

Transferimi me dhunë i fëmijëve nga një grup në tjetrin.<sup>240</sup>

---

<sup>238</sup> Smail Çekiq: Problemet Shkencore-Teorike dhe Metodologjike-Metodike të Hulumtimit të Viktimave të Gjenocidit; SFIDAT E HULUMTIMIT TË KRIMEVE TË LUFTËS NË KOSOVË 1998-1999 (Përmbledhje e Punimeve të Konferencës Ndërkombëtare në Prishtinë 16 dhjetor 2011) Prishtinë, 2013, fq.57.

<sup>239</sup> Konventa mbi Pengimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit, e 9 dhjetorit 1948, ICTY, Statuti, neni 4, Rimski Statut Medunarodnog Krivičnog Suda od 17 Jula 1998. (përkthimi zyrtar – neni 2 i ratifikimit), Službeni glasnik Bosne Hercegovine, član 6, Sarajevo, 6 mart 2003, fq.22; International Criminal Court, Elements of Crimes, U.N. Doc. PCNICC/2000/1/Add.2 (2000), neni 6.

<sup>240</sup> Ismet Salihu: E Drejta Penale Ndërkombëtare, Prishtinë, 2011, fq.348; *Shih po ashtu* Ismet Salihu: E Drejta Penale (pjesa e posaçme), Prishtinë, 2014, fq.85; *Shih po ashtu* Ismet Salihu, Hilmi Zhitija & Fejzullah Hasani:

Sipas Konventës (neni 3), janë të ndëshkueshme edhe marrëveshja për kryerjen e gjenocidit, shtytja e drejtpërdrejtë dhe publike për kryerjen e gjenocidit dhe bashkëpunimi në gjenocid. Gjithashtu kjo Konventë parasheh që personat të cilët kanë kryer apo në ndonjë mënyrë tjetër kanë marrë pjesë në kryerjen e këtij krimi, do të ndëshkohen pa dallim edhe nëse kanë qenë udhëheqës të shtetit, nëpunës të tij apo persona të rëndomtë.<sup>241</sup>

Në Kodin Penal të Republikës së Kosovës,<sup>242</sup> është paraparë dhe e sanksionuar krimi i gjenocidit. Rrjedhimisht sipas këtij Kodi, “Kushdo që me qëllim të asgjësimit të tërësishëm apo të pjesërishtëm të ndonjë grupi kombëtar, etnik, racor apo fetar kryen një ose më shumë nga veprimet e mëposhtme, do të dënohet me burgim së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet ose me burgim të përjetshëm, për: 1. vrasjen e anëtarëve të grupit; 2. shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore apo mendore të anëtarëve të grupit; 3. vënien e qëllimshme të grupit në kushte të tilla të jetës të cilat shpijnë në shfarosje të plotë apo të pjesërishtme fizike; 4. vënien e masave të cilat kanë për qëllim që të pengojnë lindjet brenda grupit; 5. transferimin me dhunë të fëmijëve të grupit në një grup tjetër.

- Vrasja e pjesëtarëve të grupit; konsiston në vrasje individuale apo massive të qëllimshme. Në sensin e konventës dhe doctrinës së të drejtës penale, kjo formë e kryerjes së krimi të gjenocidit konsiderohet se është kryer edhe nëse vritet një person që është pjesëtarë i grupit, me kusht që kjo vrasje të jetë pjesë e planit të paramenduar me qëllim të asgjësimit e të gjithë apo një pjese të grupit. Mirëpo, siç do të shohim në vijim, në këtë aspekt tani Tribunali i Hagës ka marrë qëndrim se për t’u konsideruar krimi i gjenocidit, sipas saj duhet të vritet një numër i konsiderueshëm i pjesëtarëve të grupit etnik, racor apo fetar.<sup>243</sup> Andaj, duke e shikuar në këtë kontekst, konkludojmë se, Konventa ka përcaktuar grupet kombëtare, etnike, racore

---

*supra note*, fq.410; *Shih po ashtu* Zejnullah Gruda: *supra note*, fq.293; KONVENTA PËR PENGIMIN DHE DËNIMIN E KRIMIT TË GJENOCIDIT, e 9 dhjetorit 1948, neni 2; INTERNATIONAL CRIMINAL COURT, ELEMENTS OF CRIMES, U.N. Doc. PCNICC/2000/1/Add.2(2000), neni 6; Gjykata Penale Ndërkombëtare për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare në Territorin e ish-Jugosllavisë – THE INTERNATIONAL CRIMINAL TRIBUNAL FOR THE FORMER YUOGOSLAVIA (në tekstin e mëtejshëm ICTY), Statuti, neni 4; RIMSKI STATUT MEDUNARODNOG KRIVIČNOG SUDA OD 17. JULA 1998.

<sup>241</sup> Ismet Salihu: E Drejta Penale Ndërkombëtare, Prishtinë, 2011, fq.350; *Shih po ashtu* Ismet Salihu: E Drejta Penale (pjesa e posaçme), Prishtinë, 2014, fq.86; *Shih po ashtu* Ismet Salihu, Hilmi Zhitija & Fejzullah Hasani: *supra note*, fq.410-411.

<sup>242</sup> Neni 142, Kodi Nr.06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi me 14 janar 2019; Sipas këtij Kodi, në Nenin 104 paragrafi 1 është përkufizuar se Krimi i Gjenocidit nuk prashkruhet.

<sup>243</sup> Jola Xhafo: E Drejta Penale Ndërkombëtare, Tiranë, 2009, fq.55; *Shih po ashtu* William A. Schabas: Gjenocidi në të Drejtën Ndërkombëtare (përkthim në shqip), Kembrixh, 2000, fq.191-195; *Shih po ashtu* Ismet Salihu: E Drejta Penale Ndërkombëtare, Prishtinë, 2011, fq.349; *Shih po ashtu* Ismet Salihu: E Drejta Penale (pjesa e posaçme), Prishtinë, 2014, fq.86; *Shih po ashtu* Ismet Salihu, Hilmi Zhitija & Fejzullah Hasani: *supra note*, fq.411.

ose fetare, si objekt mbi të cilin bëhet gjenocidi, prandaj, rastet individuale të vrasjes, të lëndimit fizik ose mental, nuk janë vepra gjenocidi, por vepra të thjeshta penale.

Në vijim të këtij teksti, po i përmendim disa nga ngjarjet reale të vrasjeve të kryera në Kosovë;

*Në fshatin Krajone të Drenicës, forcat serbe vranë barbarisht një fëmijë 11 vjeçar që po priste dru pranë shtëpisë së tij së bashku me djalin e xhaxhait, ndërsa djali i xhaxhait 17 vjeç u plagos rëndë. Duhet thënë dëhminë se, pas një sulmi që serbët ndërmorën në Prizren, u njohën kufomat e disa fëmijëve, që më pas u varrosën në varrezat e familjes.*

*Hetuesit britanikë zbuluan shumë kufoma fëmijësh nën 4 vjeç ndërmjet viktimave të shumta të krimeve të luftës. Duket qartë se këto krime janë kryer me kënaqësi sadisti. Ndërsa në fshatin Bellacerkva u gjendën 12 kufoma viktimash shqiptarë që ishin qëlluar nga afër. Ndërmjet tyre ishin katër vajza përkatësisht 6,9 dhe 12 vjeç, dhe tre fëmijë 6,4 dhe 7 vjeç. Me datë 25.12.1998, forcat serbe vranë nëntë shqiptarë, midis të cilëve edhe një nënë me foshnjën e saj.*

*Me datë 15.07.1999, u vranë tre fëmijë dhe u plagosën shumë të tjerë si pasojë e shpërthimit të një bombe në fshatin Viti.*

*Autoritetet serbe planifikuan vrasjen, gjenocidin, shpërnguljen dhe arrestimin për të spastruar Kosovën etnikisht nga rreth 2 milion shqiptarë, dhe ndodhi realisht vrasja e 10.000 shqiptarëve, shumë prej të cilëve ishin fëmijë të pafajshëm.*

*Faktet e dokumentuara tregojnë për një numër i madh kufomash fëmijësh, të gjitha të therura apo të gjymtuara, pas sulmit serb mbi fshatrat e komunave të Mitrovicës, Drenicës dhe Malishevës.*

*Në një rast, forcat serbe vranë një grua shtatzënë dhe disa fëmijë si ndëshkim për ndihmën që që iu dhanë disa të plagosurve shqiptarë, që u plagosën si pasojë e shpërthimit të makinës së një profesori të Universitetit të Prishtinës nga një minë token ë Obrirme të Komunës së Drenicës.*

*Në kulmin e agresionit serb, qendra e informacionit të Kosovës regjistroi emrat e 183 të vrarëve shqiptarë si pasojë e një sulmi serb kundër fshatrave të disa qyteteve. Ndërmjet viktimave ishin dhe foshnja, fëmijë të vegjël, gra shtatzëna, si dhe pleq, të sëmurë dhe të plagosur që nuk mundën të iknin nga fshatrat e tyre. Mënyrat e vrasjes ishin të ndryshme si; therje, pushkatim, diegie etj, nëpër shtëpi ose jashtë.*

*Në serinë e zbulimit të masakrave massive apo individuale, forcat e NATO-s gjetën 12 kufoma nga shqiptarët e Kosovës, ndërmjet tyre kufomat e djegura të dy fëmijëve të vegjël nga fshati Ruhot i komunës së Pejës.*

*Me datë 06.09.1998, Këshilli i Mbrojtjes së të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, bëri të ditur vrasjen e 11 shqiptarëve në Rahovec dhe plagosjen e mjaft të tjerëve si pasojë e agresionit serb mbi këtë zonë me 4 shtator. Shumica e të vrarëve, plagosurve dhe gjymtuarve ishin fëmij e gra. Në listën e 11 të vrarëve të publikuar nga Këshilli ndodheshin emrat e katër fëmijëve, katër grave dhe një të moshuarve. Ndërsa, tek lista e 16 të plagosurve ishin emrat e tre grave, pesë fëmijëve dhe një të moshuari.*

*Sipas raporteve të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, 88 fëmijë u vranë ose të pushkatuar, ose të therur, ose nga bombat, ose nga torturat, ose të ekzekutuar pa gjykim, e në të tjera mënyra barbare të përdorura nga serbët.*

*Me datë 23.07.1999, u zbuluan tre varreza massive në fshatin Makovc të Prishtinës. U nxorrën 50 kufoma shumica e të cilave ishin kufoma të rinjsh dhe fëmijësh. Kufomat u rivarrosën në varrezat e familjarëve përkatëse. Dy prej tyre nuk arritën të identifikoheshin sepse ishin shumë të deformuar.*

*Me datë 23.07.1999, një fëmijë 10 vjeçar shqiptar vdiq si pasojë e shpërthimit të një bombe të fshehur që serbët e kishin vënë shtëpinë e tij në fshatin Istog të Komunës së Pejës. Ndërkohë që shpërthimi i një mine token e Shtimje shkaktoi vdekjen e një student 16 vjeçar dhe plagosjen e dy të tjerëve.*

*Me datë 14.11.1998, u gjet kufoma e hedhur në disa rrënoja e një të riu 17 vjeçar, shqiptar nga fshati Obrie. Disa dëshmitarë okularë tregojnë se disa serbë e kishin masakruar atë.*

*Me datë 08.09.1998, u vranë një numër fëmijësh si pasojë e sulmit serb në disa fshatra dhe u plagosën shumë të tjerë.*

*Gazeta e përditshme "Bujku" bëri të ditur se 26 shqiptarë, midis të cilëve një numër i madh fëmijësh, u vranë si pasojë e sulmit barbar serb mbi fshatrat e krahinës së Vërrinit në Prizren.*

*Në vargun e raporteve rreth ngjarjeve në Kosovë, Qendra e Mbrojtjes së të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, bëri të ditur në raportin e saj të muajit gusht 1998 se një numër i madh shqiptarësh u vranë, kurse shumë të tjerë mbetën të plagosur. Ndërmjet tyre ishin 72 fëmijë.*

*Me datë 19 shtator 1998, u vranë dy fëmijë shqiptarë 12-14 vjeq dhe u plagosën 4 të tjerë përkatësisht 9, 12, 13 dhe 14 vjeq. Trupi i njërit prej viktimave ishte tepër i deformuar.*

*Kjo ndodhi pas shpërthimit të një bombe që serbët e kishin vënë në fshatin Leskovec të Prizrenit.*

*Një vajzë 12 vjeqare u vra si pasojë e një predhe që forcat serbe e qëlluan kundër karrocës së një familjeje nga Vushtria që po largohej me shumë të tjerë për t'i shpëtuar agresionit serb.*

*Me datë 30 shtator 1998, një numër foshnjesh u vranë nga forcat serbe në kampet e fshatrave të Suharekës pas një sulmi që ato ndërmorën ndaj tyre.<sup>244</sup>*

Në hulumtimet e krimeve të gjenocidit në Kosovë duhet të interpretohet çdo argument mbi sulmin e kryer me qëllim gjenocidi në çdo lokalitet të caktuar gjeografik: është bërë gjenocid kundër shqiptarëve si grup nacional dhe etnik, e jo, p.sh. është bërë krim i gjenocidit në Vushtrri.<sup>245</sup>

- Shkaktimi i lëndimeve të rënda trupore ose psikike mbi pjesëtarët e grupit; Shkaktimi i dëmtimeve të rënda fizike nënkupton gjymtime (prerje të gjymtyrëve të trupit, gjakosje) apo tortura si dhe forma tjera të dhunës të cilat mund të shkaktojnë edhe vdekje të anëtarëve të grupit. Me qëllim të mbrojtjes së individëve është paraparë edhe mundësia e dëmtimeve psikike. Këtë lloj ndarje të dëmtimit fizik dhe psikik e ka inicuar delegacioni kinez, i cili hodhi tezën e mundësisë të shkatërrimit të një grupi edhe nëpërmjet përdorimit të substancave që ndikojnë në psikën e njerëzve (ato narkotike dhe psikotrope). Gjithashtu këtu bëjnë pjesë edhe mënyra tjera të shkaktimit të mundimeve psikike.<sup>246</sup>

Në interpretimin e kësaj forme të krimit gjenocidal, po i përmendim disa nga ngjarjet reale të kryera ndaj popullatës civile në Kosovë;

*Me datë 04.12.1998, një fëmijë 10 vjeqar u plagos rëndë, kur serbët hapën zjarr Brenda spitalit të Pejës.*

*Në rajonin e Mitrovicës, një grup serbësh, rrahën një vajzë të vogël 10 vjeqare shqiptare, e cila po shkonte në shkollë.*

*Me datë 27.11.1998, policia serbe arrestoi dy nxënës shkolle, mosha e të cilëve ishte rreth 10 vjeq. Më pas i rrahën ata, u grisën librat dhe qantat.*

*Sipas dëshmitarit okularë, me datë 08.11.1998, një vajzë 6 vjeqare u plagos rëndë në kokë si pasojë e një përplasje midis karrocës, ku ajo ishte së bashku me pesë të tjerë dhe një tanku serb. Ngjarja ndodhi në fshatin Korenicë të Gjakovës dhe përplasja ndodhi me qëllim nga ana e serbëve.*

---

<sup>244</sup> Beqir Ismaili: Fëmijët e Kosovës ndërmjet dramës së të kaluarës dhe shpresave të së ardhmes, Tiranë, 2002, fq.43-67.

<sup>245</sup> Muhamed Shestanoviq: *supra note*, fq.173.

<sup>246</sup> Ismet Salihu: E Drejta Penale Ndërkombëtare, Prishtinë, 2011, fq.349.



*Në Shtime, forcat serbe arrestuan më shumë se 100 të rinj shqiptarë në mes të një rreshti të gjatë refugjatësh. Pastaj i dërguan në Ferizaj pasi i kishin rrahur dhe torturuar duke përdorur mënyra nga më të ndryshme të dhunës.*

*Dega e Komisionit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Gjilan bëri të ditur në raportin e saj mujor 85 raste në të cilat u shkelën të drejtat e qytetarëve shqiptarë, si dhe shumë raste ku gratë dhe fëmijët pësuan tortura trupore.*

*Tre serbë sulmuan egërsisht një të ri 23 vjeçar shqiptar banues në fshatin Drobesh të Vitisë. Pasi e morën në arat me grurë, e detyruan të pinte një solucion të panjohur, pastaj filluan ta torturonin duke prerë me thikë copëza trupi në formë S-je që do të thotë “SamoSlogaspusavaSrbiju” - Vetëm bashkimi e shpëton Serbinë. Të njëjtën shenjë e vizatuan edhe në ballin e të riut. Për ta rritur presionin psikologjik mbi të riun i lanë një letër ku shkruhej: „Do të vdesësh në 18 Tetor dhe ka për të qenë vdekje e tmerrshme“.*

*Me datë 25 tetor 1998 pesë fëmijë u plagosën rëndë, pasi forcat serbe hapën zjarr mbi ta ndërkohë që po mundoheshin të kapërcenin kufirin shqiptar. Fëmijët u dërguan në spitalin ushtarak në Tiranë.<sup>247</sup>*

- Imponimi me qëllim i kushteve të vështira jetësore në grup me qëllim të zhdukjes së plotë ose të pjesshme fizike të grupit; nënkupton imponim të aso rrethanave jetësore, të cilat me siguri do të shkaktonin vdekjen e personave. Rrjedhimisht, kjo mënyrë e kryerjes së këtij krimi shprehet në rastet kur grupi privohet nga e drejta e ushqimit, shpërngulja nga banesat dhe shtëpitë dhe vendosja e tyre në mjedise të ndotura të cilat janë të rrezikshme për shëndetin dhe jetën, reduktimi i shërbimeve mjekësore nën minimumin e nevojshëm dhe veprime të ngjashme. Në sensin e këtij lloji të veprimit, kushtet e këtilla të vështira të jetesës duhet t'i imponohen anëtarëve të grupit dhe jo vetëm një individ.<sup>248</sup>

Në interpretimin e kësaj forme të krimi gjenocidal, po i përmendim disa nga ngjarjet reale të kryera ndaj popullatës civile në Kosovë;

*Në fshatrat Mikushnic e Gllavoc, forcat serbe detyruan mase 20 mijë fëmijë (në mesin e tyre gra dhe pleq) të zhvendoseshin në një zonë me dyndje të madhe të shpërnguleshin me dhunë që kishte mungesa të mëdha në ushqime dhe barna.*

*Forcat serbe pushtuan një shkollë fillore në fshatin Demjan duke lërrë 300 fëmijë shqiptarë pa shkollë. Kështu nëse fëmija shpëton pa u vrrarë, nuk mund të kalojë dot një jetë normale.*

<sup>247</sup> Beqir Ismaili: *supra note*, fq.46-66.

<sup>248</sup> William A. Schabas: *supra note*, fq.203-210.

*Pas rrethimit të një fshati nga serbët dhe ndërprerjes së ndihmave humanitare me ushqime e barna, vdiqën me dhjetra shqiptarë, shumica prej tyre pleq e fëmijë.*

*Në Lipjan vdiq një foshnjë 8 muajshe për shkak të thatësisës dhe mungesës së ushqimit dhe barna ndër të shpërngulurit. E njëjta gjë ndodhi edhe në Gjakovë.*

*Mungesa e barnave shkaktoi vdekjen e një foshnje të sapolindur në një grup njerëzish që kishin ngritur qadtrat në kodrat e Malishevës dhe që vuanin nga uria dhe të ftohtët e madh. Serbët bllokuan shumë familje dhe ndalonin qdo lloj ndihme në ushqime dhe barna t'u arrinte atyre. Si rezultat i kësaj vdiqën shumë fëmijë.*

*Në kampet e të shpërngulurve në malin Gospojë në krahinën Lugu i Madh, përditë vdisnin fëmijë nga etja dhe uria, nga sëmundjet dhe epidemitë.*

*Në zonën e Jezercës, forcat serbe detyruan qytetarët shqiptarë të largohen nga fshatrat e tyre në një zonë malore pa strehë e pa ushqim. Midis të dëbuarve me dhunë kishte shumë fëmijë, gra e pleq.*

*Në një fshat forcat serbe mbajtën peng 50 qytetarë shqiptarë dhe i mbyllën në ndërtesën e shkollës fillore të fshatit. Të gjithë pengjet ishin nën 20 vjeq.*

*Me datë 25.12.1998, forcat serbe kapën rob shumë fëmijë dhe u ndaluan ndihmat ushqimore dhe mjekësore.*

*Në fshatin Rahovec vdiqën tre foshnje si pasojë e mungesës së asistencës mjekësore dhe ushqimore.*

*Tre foshnja në fshatin Lidrovc vdiqën si pasojë e mungesës së asistencës mjekësore, pasi serbët dogjën shtëpitë dhe fshatrat e krahinës së Malishevës. Kjo ndodhi ditën e mërkurë me datë 16 shtator 1998.*

*Në zonën e Bajgores dhe Shalës, forcat serbe dogjën dhe grabitën 17 fshatra shqiptarë. Banorët e këtyre fshatrave, kryesisht gra, pleq dhe fëmijë, u detyruan të arratiseshin nëpër male për të gjetur sigurinë, por mungesa e ushqimeve dhe barnave e keqësuan së tepërmi gjendjen e tyre.<sup>249</sup>*

I tillë ishte edhe plani “Patkoi”, që kishte për qëllim spastrimin e Kosovës duke i shpërngulur me dhunë nga territori i Kosovës. Me 19 prill 1999 Rudolf Sharping, në një emision special të BBC-së britanike kishte thënë : “Qëllimi i planit ‘Patkoi’ është spastrimi i Kosovës dhe dëbimi i popullsisë civile”. Sipas Sharpingut, plani përmbante hollësi deri në emërimin e njësiteve jugosllave. Andaj, ky plan serb për shfarosjen kolektive të shqiptarëve

---

<sup>249</sup> Beqir Ismaili: *supra note*, fq.42-65.

ishite bë sinonim i debateve në Bundestag-un Gjerman, në konferencat për shtyp dhe në debate për pakundërshtueshmërinë e krimeve, të cilat i ndërmerrnin forcat ushtarake-policore serbe.

- Imponimi i masave me qëllim që të parandalohet lindja brenda grupit; si formë e krimit të gjenocidit mund të kryhet me anë të: tredhjes, abortimit me dhunë, sterilizimit, duke i ndarë personat e gjinisë (seksit) së kundërt<sup>250</sup> dhe ndalimin e martesave.<sup>251</sup>

Shpesh herë, me pretekstin e vaksinimit kundra sëmundjeve ngjitëse, serbët u injektonin fëmijëve ilaçe që shkaktojnë sterilizimin e tyre në mënyrë që popullsia e Kosovës të mos shtohet as tani as në të ardhmen.

Në një ngjarje reale që ka ndodhur në vitet 1998-1999, pranë kodrave të Drenicës jetonte një nuse në familjen e të shoqit me miell dhe kripë si ushqim kryesor. Ndërkohë, gruaja ishte gati duke lindur, në kushtet ku nuk kishte asnjë mjet të duhur mjekësor. Ajo nuk u lejua të shkonte në spital dhe as nuk e lejuan mjekun të shkonte në shtëpinë e tyre.<sup>252</sup> Në kontekst me ngjarjen që ka ndodhur, shihet qartë se serbët e penguan gruan shtatzënë, me qëllim që të parandalohet lindja e foshnjës.

-Transferimi me dhunë i fëmijëve nga një grup në tjetrin; konsiderohet si formë e posaçme e pengimit të lindjeve. Përkatësisht në këto raste, fëmijët e një grupi transferohen në grupin tjetër i ekspozohen gjuhës së huaj, kulturës, fesë, zakoneve dhe vlerave tjera të huaja dhe me këtë asgjësohet një gjeneratë e tërë si dhe gjeneratat e ardhshme.<sup>253</sup>

Sipas frymës së Konventës, për t'u konsideruar se është kryer kjo vepër, është e mjaftueshme që njëra nga këto forma të krimit të paraparë në nenin 2 të jetë kryer edhe ndaj një pjesëtari të grupit nacional, etnik, fetar, apo racor, nëse është kryer me qëllim që grupi i tillë të asgjësohet tërësisht apo pjesërisht. Mirëpo lidhur me këtë, në praktikën e Tribunalit të Hagës për krimet e kryera në territorin e ish-Jugosllavisë, është marrë qëndrim se si krim i gjenocidit mund të konsiderohet nëse me rastin e kryerjes së këtij krimi është asgjësuar një numër i konsiderueshëm i pjesëtarëve të grupit nacional, etnik, fetar apo racor. Qëllimi i këtillë i Tribunalit të Hagës sipas mendimit tonë është në kundërshtim me dispozitën e Konventës së përmendur dhe njëherësh tregon se e drejta penale ndërkombëtare dhe jurisprudence penale ndërkombëtare, me gjithë zhvillimin e saj, edhe sot e kësaj dite nuk është formësuar dhe konsoliduar sa duhet, veçmas në aspektin e ligjshmërisë në këtë fushë, e cila kërkon që veprat penale të jenë të parapara në mënyrë të saktë, në mënyrë precize. Lidhur me këtë, është mjaftë

<sup>250</sup> Ismet Salihu: E Drejta Penale (pjesa e posaçme), Prishtinë, 2014, fq.87.

<sup>251</sup> William A. Schabas: *supra note*, fq.210-214.

<sup>252</sup> Beqir Ismaili: *supra note*, fq.46.

<sup>253</sup> William A. Schabas: *supra note*, fq.214-218.

dubioz (i dyfishtë) qëndrimi i Tribunalit të Hagës se për t'u konsideruar që është kryer krimi i gjenocidit, duhet të asgjësohet një numër i konsiderueshëm i anëtarëve të grupit.<sup>254</sup>

## 2. Kryerësi i krimit të gjenocidit

Kryerësi i krimit të gjenocidit konsiderohet çdo person që urdhëron kryerjen e këtij krimi, si dhe ai që e kryen. Urdhërdhënës konsiderohet personi civil apo ushtarak që gjendet në pozita të larta në hierarkinë shtetërore, ushtarake apo policore, i cili ka autorizime që të japë urdhëra. Si urdhërdhënës konsiderohet edhe personi i cili ka autorizime që të japë urdhra. Si urdhërdhënës konsiderohet edhe personi i cili në rrethanat konkrete mundet ta imponojë vullnetin e vet ndaj të tjerave ose në rastet kur një grup personash e pranojnë si udhëheqës, i zbatojnë urdhrat e tij.<sup>255</sup> Gjatë luftës në Kosovë, instancat më të larta shtetërore dhe politike të Serbisë kanë dhënë “Urdhra” për çdo formë të krimeve të kryera në Kosovë ndaj popullatës shqiptare. Janë dhënë urdhra për të gjitha masakrat ndaj populates civile shqiptare, urdhra për dëbime masive nga territori i Kosovës, urdhra për djegie të objekteve banuese, institucionale, kulturore, fetare etj.

Kryerës i drejtpërdrejtë mund të jetë një person apo shumë persona. Pozita zyrtare e cilit do kryes, pa marrë parasysh nëse është kryetar shteti apo person përgjegjës në qeveri, siç u theksua më sipër, nuk e përjashton nga përgjegjësia penale, madje nuk mund të merret as si rrethanë lehtësuese me rastin e matjes së dënimit.<sup>256</sup>

Për hulumtuesit e gjenocidit, hulumtuesit gjyqësor dhe gjykatësit që shqiptojnë aktgjykimet, në të cilat konfirmohet se gjenocidi ka ndodhur, “nuk është e domosdoshme të ekzistojë plani i gjenocidit”,<sup>257</sup> por esenciale është që kryerësi të ketë ditur për pasojat e veprës që e ka bërë. Në vitet e para të pasluftës, policët dhe prokurorët ndërkombëtarë të UNMIK-ut kanë filluar hetimet për rreth 200 policë, ushtarë dhe paramilitarë serbë për të cilët janë gjetur prova se kanë kryer krime të luftës. Disa prej kryerësve të krimeve në Kosovë janë gjykuar edhe nga institucionet e Kosovës.

---

<sup>254</sup> Ismet Salihu, Hilmi Zhitija & Fejzullah Hasani: *supra note*, fq.412.

Sipas autorëve, shprehja numër i konsiderueshëm është e papërcaktuar dhe në kundërshtim me parimin e legalitetit. Këtu shtrohet pyetja, nëse krimi i gjenocidit kryhet p.sh. ndaj popullit kinez, atëherë sipas këtij kriteri, për t'u konsideruar si numër i konsiderueshëm duhet të vriten 200 deri 300 milionë kinezë!

<sup>255</sup> Ismet Salihu: E Drejta Penale Ndërkombëtare, Prishtinë, 2011, fq.350.

<sup>256</sup> Ismet Salihu: E Drejta Penale (pjesa e posaçme), Prishtinë, 2014, fq.86.

<sup>257</sup> ICTY, Presuda, Žalbeno vijeće u Predmetu Radislav Krstić – Saopćenje za javnost.

*“Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Mitrovicë, një i pandehur serb i Kosovës ishte ngarkuar me kryerjen e veprës penale të gjenocidit. Me 18 janar 2001, gjykata e qarkut në Mitrovicë e dënoi atë me 14 vjet burgim. Duke vendosur sipas ankesës, me 31 gusht 2001 Gjykata Supreme e Kosovës, e ktheu prapa rastin në rigjykim. Me 25 tetor 2002 gjykata e qarkut në Mitrovicë, me përbërje nga vetëm gjyqtarë ndërkombëtarë, shpalli të pandehurin fajtor për kryerjen e veprës penale të krimeve kundër popullatës civile dhe e dënoi atë me 12 vite burgim. Me 15 korrik 2004, Gjykata Supreme e Kosovës duke vendosur sipas ankesës e ktheu përsëri rastin në shkallë të parë. Gjykata e qarkut në Mitrovicë, me një koleg të përbërë nga gjyqtarë ndërkombëtar, mbajti gjykimin i cili zgjati prej 16 gushtit 2007 deri me 22 maj 2008, dhe përsëri dënoi të pandehurin, kësaj radhe me tetë vite burgim. Duke vendosur sipas ankesës, me 7 tetor 2009, Gjykata Supreme me një koleg gjykues të përbërë vetëm prej gjyqtarëve të EULEX-it, e liroi të pandehurin nga të gjitha akuzat”.*<sup>258</sup>

Prokuroria e EULEX-it në Kosovë, me 20 prill 2017 ka ngritur Aktakuz kundër Zoran Vukotiq, për kryerjen e vrasjeve të 116 civilëve shqiptarë më 2 maj 1999. Ky krim kishte ndodhur kur popullata civile kishin zbritur në fshat për të gjetur ushqim. Atyre u kishin mbaruar të gjitha rezervat që kishin në malet ngjitur me Shalën e Bajgorës. Kërkimi i ushqimit për këto viktime, ishte shndërruar në një rën prej masakrave më të llahtarshme që kishin kryer forcat serbe.<sup>259</sup>

## **2.1. Veprimi i kryerjes**

Konventa e sipërpërmendur, veprimin e kryerjes së krimit të gjenocidit e ka përcaktuar në mënyrë restrictive, e jo ilustrive. Marrë në tërësi, siç u cek më sipër, veprimet e kryerjes së këtij krimi konsistojnë shkatërrimin, dëmtimin apo rrezikimin e integritetit biopsikik të

---

<sup>258</sup> Prokurori Publik kundër Miroslav Vuckovic; shih gjithashtu: Gjykimet e Krimeve të Luftës në Kosovë – Një Vlerësim Pas Dhjetë Viteve 1999-2009 fq.23-24, <http://www.osce.org/sq/kosovo/68570?download=true> .

<sup>259</sup> Më parë i akuzuari, figuronte si i kërkuar në faqen e Interpol-it për krime ndaj populates civile në Kosovë, gjersa i njëjti është arrestuar në vitin 2016 në Mal të Zi dhe është ekstraduar në Kosovë. I akuzuarii dyshohet për veprimet të cilat pretendohet se kanë ndodhur ndërmjet fshatrave Shtudime e Epërme dhe Shtudime e Poshtme, Komuna e Vushtrrisë dhe objekteve të Kooperativës Bujqësore, Vushtrri më ose rreth datës 2 maj 1999, si dhe për veprimet dhe sjelljet të cilat pretendohet se kanë ndodhur në Qendrën e Paraburgimit në Smrekovicë, Komuna e Mitrovicës gjatë javëve pas kësaj ngjarjeje.

I akuzuari, akuzohet për: Krime lufte kundër popullatës civile siç parashihet dhe ndëshkohet me anë të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ), dhe aktualisht i penalizuar me Kodin Penal të Kosovës (KPK), dhe kundër rregullave të së drejtës ndërkombëtare në fuqi gjatë kohës së konfliktit të armatosur të brendshëm në Kosovë. Këto krime përfshijnë vrasjet brutale dhe të kundërligjshme, trajtimin çnjerëzor, shkaktimin e vuajtjeve të mëdha, aplikimin e masave të frikësimit dhe terrorit, konfiskimin e pasurisë, plaçkitjen dhe vjedhjen në shkallë të gjerë të pasurisë që ishte e pajustificueshme.

anëtarëve të grupit.<sup>260</sup> Sipas Konventës, krimi i gjenocidit është koncipuar si vepër penale komisive, si vepër e cila mund të kryhet vetëm me veprim.

Sulmi planifikohet dhe bëhet me qëllim, pra me vetëdije dhe me paramendim, që plotësisht ose pjesërisht, të zhduket grupi, e kjo do të thotë edhe identiteti i grupit të sulmuar. Planifikuesit, nxitësit dhe kryerësit e sulmit të planifikuar e dinë se me sulm duhet të shkatërrohet plotësisht ose së paku pjesërisht grupi i sulmuar.<sup>261</sup>

## 2.2. Forma e fajit

Kuptimi esencial për ekzistimin e krimit të gjenocidit, qëndron në elementin e fajësisë së kryerësit ndaj viktimave të gjenocidit. Për gjykimin e e kryerësit të gjenocidit, organeve gjyqësore në radhë të parë i intereson “fajësia” e kryerësit ndaj viktimës, d.m.th. në çfarë shkalle ka ekzistuar “mensa rea”<sup>262</sup> e kryerësit për t’i shfarosur plotësisht apo pjesërisht pjesëtarët e grupit të sulmuar dhe a e ka ditur kryerësi se kjo që bën, është duke bërë për ta shfarosur plotësisht apo pjesërisht grupin e sulmuar. Prandaj, për t’u konsideruar se është kryer krimi i gjenocidit, krahas dashjes, gjykata duhet të konstatojë se ky lloj krimi është kryer me qëllim që tërësisht apo pjesërisht të asgjësohet grupi i caktuar nacional, etnik, racor apo fetar. Pra këtu është fjala për dashje gjenocidiale, përkatësisht për dashje specifike (dolis specialis).<sup>263</sup>

Ndërsa, kur gjykatat procesojnë sulmet representative dhe në bazë të tyre konkludojnë mbi fajësinë e (pa)vetëdijshme të kryerësit dhe konstatojnë ekzistimin e elementit subjektiv në këto sulme. Fajësia e (pa)vetëdijshme e sulmuesit ndaj viktimës është element vendimtar subjektiv në konkludimin se a ka ekzistuar qëllimi (mens rea) i kryerësit që ta shfarosë plotësisht apo pjesërisht pjesëtarin e grupit të sulmuar.<sup>264</sup>

## Përfundime

---

<sup>260</sup> Ismet Salihu: E Drejta Penale Ndërkombëtare, Prishtinë, 2011, fq.350-351.

<sup>261</sup> Muhamed Shestanoviq: *supra note*, fq.169.

<sup>262</sup> Ekzistimi i “mens rea-s” d.m.th “qëllimi” në kryerjen e krimit të gjenocidit, andaj, kryerja e veprave të tilla penale nënkupton se ato kryhen me paramendim, me qëllim, me synim të vetëdijshëm se me kryerjen e këtyre veprave, kryerësi krijon pasoja të drejtpërdrejta dhe ai që i kryen këto vepra është i vetëdijshëm për pasojat e tyre.

<sup>263</sup> Ismet Salihu, Hilmi Zhitija & Fejzullah Hasani: *supra note*, fq.412.

<sup>264</sup> Muhamed Shestanoviq: *supra note*, fq.172.

Nëse në mënyrë të përgjithshme do t'i numrojmë format e krimeve të kryera në Kosovë, rezulton se gjatë periudhës 1998-1999, forcat policore, ushtarake dhe paramilitare serbe, qëllimisht kanë shkatërruar mbi 100.000 objekte. **Rrjedhimisht, po i prezantojmë disa statistika:**

**100.589 shtëpi të shkatërruara, dëmtuara të popullatës shqiptare;**

358 shkolla të shkatërruara – të dëmtuara me dokumentacione të arkivuara;

71 zyra të vendit;

30 shtëpi kulture;

93 biblioteka publike dhe shkollore;

123 objekte shëndetësore;

215 objekte fetare (xhami, teqe, tyrbe);

5 kisha katolike;

88.101 objekte ndihmëse – përcjellëse.




Tabela 1. Dëmet materiale në Kosovë gjatë luftës 1998-99

**Si krime më të rënda, veçmas duhet theksuar vrasjet e 11.843 viktimeve nga Kosova, duke i klasifikuar sipas moshës dhe gjinisë, delë ky rezultat:**

1.392 fëmijë deri në 18 vjeç;

296 fëmijë deri në 5 vjeç;

1739 femra;

1882 të moshuar mbi moshën 65-vjeçare;  
 Të Pagjetur janë akoma 1450 banorë,  
 Të dhunuara rezultojnë 20.400 femra shqiptare.




Tabela 2. *Viktimat sipas moshës dhe gjinisë gjatë luftës në Kosovë 1998-99*

**Sipas të dhënave të UNCHR, në fillim të qershorit 1999, nga refugjatët e dëbuar prej Kosove:** 443.300 ishin vendosur në Shqipëri; 247.800 në Maqedoni; 69.300 në Mal të Zi; 21.700 në Bosnjë-Hercegovinë, gjithsej 782.100. Në vendet e tjera të botës u vendosën gjithsej 76.475, prej tyre rezultojnë këto të dhëna: 13.639 në Gjermani; 7.581 në Turqi; 5.829 në Itali; 5.730 në SHBA, pastaj në Francë, Norvegji, Suedi, Britani të Madhe, Poloni, Spanjë, Portugali, Finlandë, Zvicër, Izrael etj.<sup>265</sup>

### Literatura dhe burime shtesë

1. Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës dhe Instituti i Historisë.
2. Beqir Ismaili: Fëmijët e Kosovës ndërmjet dramës së të kaluarës dhe shpresave të së ardhmes, Tiranë, 2002.
3. Convention on the Prevention and Punishment of the Crime of Genocide. Teksti i Konventës: A Compilation of International Instruments Volume I (Secord Part) Universal Instruments, United Nations, New York and Geneva, 1994.

<sup>265</sup> *Shih:* Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës; Shifrat zyrtare mbi pasojat e represionit të përgjakshëm serb në Kosovë, të botuara në librin “Krimet e Serbisë në Kosovë 1998-1999”, “Krimet e Serbisë ndaj fëmijëve në Kosovë 1998-1999”, të publikuara nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës dhe Instituti i Historisë tregojnë për masakrat serbe në Kosovë, vrasjet, dhunimet, shkatërrimet dhe depërtimet.



4. Diccionario de Derecho Internacional, Moscu, 1988.
5. Edith Durham: Brenga e Ballkanit dhe Vepra të Tjera për Shqipërinë dhe Shqiptarët, Bot."8 Nëntori", Tiranë, 1991.
6. Gjykimet e Krimeve të Luftës në Kosovë – Një Vlerësim Pas Dhjetë Viteve 1999-2009, <http://www.osce.org/sq/kosovo/68570?download=true> .
7. Human Rights Questions and Answers, United Nations, New York, 1987.
8. Charny: "GENOCIDE - THE CAPTIVATING LEMKIN WORD THE WORLD HAS LEARNED TO USE AS AN OVERARCHING GENERIC CONCEPT WITH DEFINED MULTIPLE SUBCATEGORIES, Hiroshimë, 2004.
9. ICTY, Statuti, neni 4, Rimski Statut Medunarodnog Krivičnog Suda od 17 Jula 1998. (përkthimi zyrtar – neni 2 i ratifikimit).
10. International Criminal Court, Elements of Crimes, U.N. Doc. PCNICC/2000/1/Add.2 (2000).
11. Ismet Salihu, Hilmi Zhitija & Fejzullah Hasani: Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Botimi I, Prishtinë, 2014.
12. Ismet Salihu: E Drejta Penale (pjesa e posaçme), Prishtinë, 2014.
13. Ismet Salihu: E Drejta Penale Ndërkombëtare, Prishtinë, 2011.
14. Jack C. Plano & Roy Olton: Diccionario de Relaciones Internacionales, Mexico, 1975.
15. Jola Xhafo: E Drejta Penale Ndërkombëtare, Tiranë, 2009.
16. Kodi Nr.06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 14 janar 2019.
17. Ljubo Bavcon: Mednarodno kazensko pravo, Lubjanë, 1997.
18. Milan Bartos: Medjunarodno javno pravo. I knjiga, Kultura, 1954.
19. Muhamed Shestanoviq: Krimi i Gjenocidit dhe Krimi i Harresës së Gjenocidit; SFIDAT E HULUMTIMIT TË KRIMEVE TË LUFTËS NË KOSOVË 1998-1999 (Përmbledhje e Punimeve të Konferencës Ndërkombëtare në Prishtinë 16 dhjetor 2011) Prishtinë, 2013.
20. Službeni glasnik Bosne Hercegovine, član 6, Sarajevo, 6 mart 2003, fq.22;
21. Smail Çekiq: Problemet Shkencore-Teorike dhe Metodologjike-Methodike të Hulumtimit të Viktimave të Gjenocidit; SFIDAT E HULUMTIMIT TË KRIMEVE TË LUFTËS NË KOSOVË 1998-1999 (Përmbledhje e Punimeve të Konferencës Ndërkombëtare në Prishtinë 16 dhjetor 2011) Prishtinë, 2013.
22. The United Nations and Human Rights, United Nations, New York, 1984.

23. Ujedinjene nacije, Zbirka dokumenata 1941-1945, Drugo izdanje, Arhiv za pravne i društvene nauke, Beograd, 1947.
24. Vladimir Ibleq: Rjecnik medjunarodnog javnog prava, Zagreb, 1972.
25. William A. Schabas: Gjenocidi në të Drejtën Ndërkombëtare (përkthim në shqip), Kembrixh, 2000.
26. Zejnullah Gruda: Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut I, botimi i dytë, Prishtinë, 2001.

**Ma. Sc. Endrit AJETI**  
**(49651)**

**KDU 347.65**

## **TRASHËGIMIA LIGJORE DHE SHQYRTIMI I SAJ NË SISTEMIN E NOTERISË**

### ***Abstrakt***

*Lindja dhe vdekja e njeriut janë procese natyrore që zhvillohen përkundër vullnetit të njeriut. Kështu, me kalimin e kohës shoqëria ka kaluar nga ajo primitive, ku veglat e prodhimit ishin në pronësi të bashkësisë shoqërore, në atë bashkohore, ku këto vegla kaluan në pronësi private të personave, nga të cilën edhe u shfaq nevoja për bartjen e të drejtës së pronësisë së këtyre veglave nga personi i vdekur tek të afërmit e tij të cilët ende jetojnë dhe se kujt do ti takojë kjo pasuri. Në këtë këndvështrim një problem i tillë është zgjidhur me ndihmën e procedurës për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, me anë të së cilës bartet masa pasurore apo prona private nga personi që ka vdekur tek të afërmit e tij.*

***Fjalët kyçe: trashëgimtarët, trashëgimlënsi, pasuria trashëgimore, sistemi i noterisë.***

### ***Abstract***

*The birth and death of human being are natural processes that takes place despite of their will. So over time society has moved from the primitive, where production tools were owned by the social community, to the contemporary one, when this tools passed in private property of humans. From where it comes the need to pass the right of possession for tools from dead people to the nearest family members, who are still alive or to whom this property will belong. From this point of view, this problem is solved by procedure for review of hereditary property, by which the property or private property is transferred from the person who died to their relatives.*

**Keywords: inheritor, testator, hereditary property, notary system.**

## **Hyrja**

Procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore paraqet një ndër procedurat më të rëndësishme të procedurës jokontestimore. Me ndihmën e kësaj procedure transmetohet masa pasurore prej trashëgimlënsit apo personit që ka vdekur tek trashëgimtarët e decujusit apo tek të afërmit e personit të vdekur. Kur flasim për këtë procedurë duhet të nisemi nga ajo se cili është organi kompetent për shqyrtimin e kësaj pasurie? Si organ kompetent për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore në bazë të legjislacionit në fuqi janë përveç Gjykatave Themelore në Republikën e Kosovës edhe Noterët e licencuar nga Ministria e Drejtësisë.

Parimisht procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore inicohet ex-officio nga Oda e Noterëve të Republikës së Kosovës në bashkëveprim me Organin Administrativ, mirëpo një procedurë e tillë mund të inicohet edhe nga personat të cilët pretendojnë se kanë të drejtën në trashëgimi si dhe palët e interesuara. Në fakt nga praktika e përgjithshme e noterisë kjo procedurë zakonisht inicohet me kërkesën e personave që pretendojnë se kanë të drejtën në trashëgim dhe se incimi i kësaj procedure sipas detyrës zyrtare deri më tani nuk ka ndodhur.

Procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore në sistemin e noterisë kalon në disa etapa, duke filluar nga përpilimi i dëshmisë së vdekjes nga ZGJC dhe dërgimi në ONK, pastaj ky i

fundit e dërgon tek noteri kompetent. Pasi të arrijë dëshmia e vdekjes tek noteri, noteri bënë publikimin e njoftimit në portalin shtetëror të Republikës së Kosovës për ti ftuar edhe personat e tjerë që pretendojnë se kanë të drejtën në trashëgim përveç atyre që janë përfshirë në dëshminë e vdekjes. Pastaj pason faza e mbajtjes e seancës informuese me të cilën trashëgimtarët njoftohen me të drejtat dhe detyrimet e tyre në trashëgim si dhe mbajtjen e seancës kryesore me të cilën trashëgimtarët duhet të deklarohen se pranojnë apo heqin dorë nga pasuria trashëgimore të lënë nga decujusi. Në fund të kësaj procedure kemi fazën e përpilimit dhe nxjerrjes së aktvendimit të trashëgimisë, ku përcaktohet se kush do të jetë titullar i pasurisë trashëgimore.

### **Inicimi i procedurës për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore**

Në rast të vdekjes së një personi duhet të inicohet procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore dhe mbi bazën e së cilës zhvillohet edhe procedura për transmetimin e masës pasurore prej trashëgimlënësit tek trashëgimtarët e decujusit. Në bazë të ligjit për procedurën jokontestimore, procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore inicohet sipas detyrës zyrtare nga gjykata porsa gjykata të merr informacion se një person ka vdekur. Mirëpo, me ndryshim plotësimet e vitit 2018 të LPJK, kjo gamë e autorizimeve është zgjeruar në atë mënyrë që edhe palët e interesuara si dhe noterët të mund ta inicojnë një procedurë të tillë pas informimit nga organi administrativ kompetent. Si palë të interesuara konsiderohen personat të cilët pretendojnë se kanë të drejtën në trashëgim, legatarët apo edhe personat e tjerë të cilëve i'u është njohur e drejta që të mund të inicojnë një procedurë të tillë, ndërkaq noterët e inicojnë këtë procedurë trashëgimore duke bashkëvepruar me Odën e Noterëve dhe Organin Administrativ.

Rrjedhimisht, nga kjo që u tha më lartë kuptojmë se kjo procedurë inicohet nga pala e interesuar, gjykata apo nga noteri, pas informimit të tyre nga organi kompetent administrativ se një person ka vdekur ose është shpallur i vdekur me vendim gjyqësor të formës së prerë.<sup>266</sup> E gjithë procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore sipas të drejtës materiale dhe procedurale të së drejtës së noterisë ndahet në disa faza kryesore, dhe atë:

#### **1. Ndërmarrja e veprimeve paraprake;**

#### **2. Seanca informuese për njoftimin e trashëgimtarëve me të drejtat dhe detyrimet e tyre;**

<sup>266</sup> Neni 127, Ligji nr. 06/L-007 për ndryshim-plotësimin e Ligjit për Procedurën Jokontestimore.

### **3. Seanca kryesore për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, dhe**

### **4. Përpilimi dhe nxjerrja e aktvendimit për trashëgimi.**

#### **1. Veprimet paraprake**

Posa të inicohet procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, duhet që të ndërmerren veprimet paraprake për shqyrtimin e pasurisë së tillë. Veprimet që kryhen përpara fillimit të seancave trashëgimore quhen veprime paraprake. Veprimet paraprake janë çështjet të cilat paraqiten në procedurë për vendosjen e së cilës nuk është kompetent organi i cili zhvillon procedurën, por për zgjidhjen e së cilës është kompetent ndonjë organ tjetër, kurse pa zgjidhjen paraprake të këtyre veprimeve nuk është e mundur të përfundoj procedura.

Si veprime paraprake konsiderohen: a) Përpilimi i dëshmisë së vdekjes, b) Inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë dhe c) Masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë trashëgimore.

#### **1.1.Përpilimi i dëshmisë së vdekjes**<sup>267</sup>

Me rastin e vdekjes së një personi ose shpalljes si i vdekur me vendim gjyqësorë të formës së prerë nga gjykata, hartohet dëshmia e vdekjes. Dëshmia e vdekjes hartohet nga Zyra e Gjendjes Civile, sipas të dhënave të marra në mënyrë të pavarur nga regjistri civil kurse të dhënat për hartimin e dëshmisë së vdekjes mund të verifikohen edhe nga të afërmit e personit të vdekur, nga personat me të cilin personi i vdekur ka bashkëjetuar, si dhe nga personat e tjerë që mund të japin të dhëna që shënohen në dëshminë e vdekjes.<sup>268</sup>

Pas përpilimit të dëshmisë së vdekjes, zyra e gjendjes civile në afat prej 15 ditëve nga dita e regjistrimit të vdekjes i'a dërgon dëshminë e vdekjes Odës së Noterëve të Kosovës, pastaj ONK dëshminë e vdekjes e dërgon tek noteri kompetent sipas radhës alfabetike.

Mirëpo, në qoftë se ZGJC nuk ka mundësi të sigurojë të dhëna të nevojshme për hartimin e dëshmisë së vdekjes, do ta dërgojë dëshminë e vdekjes tek ONK vetëm me ato të dhëna që disponon (dëshmi e vdekjes jo e plotë), duke i treguar shkaqet për të cilat nuk ka mundur ta

---

<sup>267</sup> Me ndryshim plotësimet e fundit të vitit 2018 të LPJK, emërtimi i fjalës aktvdekje është zëvendësuar me fjalën dëshmi e vdekjes, pra në tërë tekstin e ligjit, fjala aktvdekje është zëvendësuar me fjalën dëshmi e vdekjes.

<sup>268</sup> Neni 133, Ligji nr. 06/L-007 për ndryshim-plotësimin e Ligjit për Procedurën Jokontestimore.

përpilojë dëshminë e vdekjes të plotë dhe do t'i paraqesë të dhënat që mund t'i shërbejnë noterëve për të gjetur trashëgimtarët dhe pasurinë e trashëgimlënësit. Noteri pasi të mbedh informacionet e nevojshme rreth trashëgimtarëve, do të kërkojë nga organi kompetent për mbajtjen e regjistrave të gjendjes civile plotësimin e dëshmisë së vdekjes ose verifikimin e të dhënave në rast se tek noteri paraqitet ndonjë paqartësi rreth dëshmisë së vdekjes.<sup>269</sup> Megjithatë, mund të ndodhë që pas inicimit të procedurës trashëgimore apo pas arritjes së dëshmisë së vdekjes tek noteri nga ONK, noteri mos të jetë kompetent për procedimin e lëndës së tillë, atëherë në raste të tilla noteri do t'ia kthej mbrapa lëndën Odës së Noterëve të Kosovës në mënyrë që ky i fundit ta dërgoj tek noteri kompetent për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore.<sup>270</sup>

## 1.2. Inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë

Inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë trashëgimore bëhet me qëllim të sigurimit të pasurisë që ajo të jetë e mbrojtur nga vjedhja, fshehja, ose asgjësimi. Inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë së trashëgimlënësit paraqet një tërësi të veprimeve procedurale me të cilat vërtetohet përbërja dhe vlera e pasurisë trashëgimore.<sup>271</sup> Këto dy veprime procedurale nuk janë gjithmonë të detyrueshme. Pasuria e trashëgimlënësit patjetër do të regjistrohet dhe inventarizohet në këto raste: a) kur nuk dihen trashëgimtarët apo vendbanimi i tyre; b) kur trashëgimtarët janë persona që për shkak të moshës së mitur, sëmundjes mendore ose rrethanave të tjera nuk janë fare të aftë, ose nuk janë plotësisht të aftë që të kujdesen vetë për punët e veta, dhe c) kur pasuria trashëgimore duhet t'i dorëzohet komunës apo personit juridik tjetër.<sup>272</sup> Përkundër kësaj, edhe kur nuk ekzistojnë rrethanat e sipërtheksuara noteri mund të vendos që të bëhet inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë në rast se këtë e kërkojnë trashëgimtarët, legatarët ose kreditorët e trashëgimlënësit, me qëllim që të dihet vlera e pasurisë trashëgimore.<sup>273</sup>

Me anë të inventarizimit përfshihet e gjithë pasuria e të vdekurit, sikurse ajo e luajtshme ashtu edhe ajo e paluajtshme që ka qenë në posedim të tij në momentin e vdekjes. Inventarizohet edhe pasuria që i ka takuar të vdekurit e që është në posedim të personit tjetër, duke treguar se te kush ndodhet kjo pasuri dhe me çfarë baze juridike. Gjithashtu përfshihet edhe sendi që në momentin e regjistrimit ka qenë në posedim të decujusit edhe pse për të

<sup>269</sup> Po aty, neni 134.

<sup>270</sup> Po aty, neni 154.

<sup>271</sup> H. Podvorica, „Klinika juridike e drejta familjare dhe trashëgimore”, Prishtinë, 2015, fq. 141.

<sup>272</sup> M. Musa, K. Musa, „E drejta e procedurës civile II”, Gjilan, 2017, fq. 108.

<sup>273</sup> F. Brestovci, „E drejta procedurale civile II”, Prishtinë, 2006, fq. 274.

pretendohet se është pronarë dikush tjetër. Në inventarin e pasurisë trashëgimore duhet të shënohen kreditë dhe detyrimet e të vdekurit, e veçanërisht tatimi i papaguar dhe kontributet tjera që i jepen shtetit.

Inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë të trashëgimlënësit bëhet nga shërbimi komunal kompetent në prani të dy qytetarëve të moshës madhore, e kur është nevoja edhe me prezencën e ekspertit. Prania e ekspertit është e nevojshme kur trashëgimlënësi lë pas vete pasuri të madhe, vepra arti, aksione të ndërmarrjes, ku për inventarizim dhe vlerësimin e saj kërkohet dije profesionale. Madje, noteri mund të kërkojë të bëhet inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë së trashëgimlënësit nga eksperti edhe nëse ka mospajttime lidhur me inventarizimin dhe vlerësimin e pasurisë trashëgimore.<sup>274</sup>

## **1.2. Masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë trashëgimore**

Masën e përkohshme për sigurimin e pasurisë trashëgimore mund ta caktoj shërbimi komunal kompetent si dhe noteri. Shërbimi komunal kompetent në raste të ngutshme do ta caktoj masën për sigurimin e pasurisë trashëgimore në qoftë se konstatohet se asnjëri nga trashëgimtarët e pranishëm nuk është i aftë të administrojë pasurinë trashëgimore, e nuk ka përfaqësues ligjor, ose në rast se trashëgimtarët janë të panjohur apo mungojnë, si dhe kur rrethanat tjera kërkojnë kujdes të posaçëm, në këto raste shërbimi komunal kompetent, do t'ia dorëzojë pasurinë ose vetëm një pjesë të saj për ruajtje personit të sigurt dhe lidhur me këtë shërbimi komunal do ta njoftoj menjëherë noterin në territorin e të cilës gjendet kjo pasuri.<sup>275</sup> Noteri këtë masë mund ta ndryshoj gjatë gjithë kohës kur ta sheh të arsyeshme se masa e tillë nuk është e nevojshme.<sup>276</sup>

Pjesëmarrësve në procedurë me sëmundje mendore apo me zhvillim të metë psikik, të mitur dhe të paaftë për t'i mbrojtur interesat e veta, pa përfaqësues ligjor, pa zotësi veprimi, si dhe në rastet e tjera të përcaktuara me ligj, noteri i'a emëron një përfaqësues të përkohshëm të pasurisë trashëgimore, mirëpo para se të emëroj kujdestarin e përkohshëm sipas mundësive për personalitetin e kujdestarit do të kërkojë mendimin e personave që paraqiten si trashëgimtar. Këtë mendim noteri e kërkon nga trashëgimtarët me zotësi veprimi apo nga pjesëmarrësit në procedurën trashëgimore, të cilët do të ishin në gjendje t'i kuptonin veprimet dhe pasojat e veprimeve të veta, sepse kërkimi i mendimit për personalitetin e kujdestarit nga

<sup>274</sup> Neni 144, Ligji nr. 06/L-007 për ndryshim-plotësimin e Ligjit për Procedurën Jokontestimore.

<sup>275</sup> Neni 145, Ligji nr. 06/L-007 për ndryshim-plotësimin e Ligjit për Procedurën Jokontestimore.

<sup>276</sup> H. Podvorica, „*Klinika juridike e drejta familjare dhe trashëgimore*”, Prishtinë, 2015, fq. 140.

trashëgimtarët pa zotësi veprimi, nuk do të kishte efekt juridik. Noteri këtë masë mund të caktoj në të gjithë fazat e zhvillimit të procedurës, me propozim të personave të interesuar apo sipas detyrës zyrtare.<sup>277</sup>

## **2. Seanca informuese për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore**

Pasi ta dorëzojë Oda e Noterëve të Kosovës (ONK) tek noteri kompetent dëshminë e vdekjes, noteri konstaton se a është kompetent për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore. Nëse konstaton se nuk është kompetent do t'ia dërgoj dosjen e lëndës Odës së Noterëve, e më pas ONK e dërgon tek noteri kompetent. Mirëpo, nëse noteri konstaton se për këtë çështje është kompetent, përveç njoftimit të drejtpërdrejt me trashëgimtarët që janë të njohur, noteri do të bëjë publikimin e njoftimit për iniciimin e procedurës trashëgimore dhe në Portalin Shtetërorë të Republikës së Kosovës dhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Njoftimi për iniciimin e procedurës trashëgimore përmban: emrin, mbiemrin dhe emrin e njërit prind të personit të vdekur; adresa e fundit e vendbanimit të personit të vdekur; emrin, mbiemrin dhe vendbanimi i trashëgimtarëve të identifikuar në dëshminë e vdekjes,<sup>278</sup> si dhe njoftimi që të gjithë trashëgimtarët e tjerë të cilët për shkaqe të ndryshme nuk janë shënuar në dëshminë e vdekjes që brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e publikimit të njoftimit në Gazetën Zyrtare të paraqiten tek zyra e noterit kompetent të përcaktuar nga ONK për të deklaruar se edhe ata janë bashkëtrashëgimtar së bashku me trashëgimtarët e paraqitur në dëshminë e vdekjes.<sup>279</sup>

Në të njejtën kohë trashëgimtarët e identifikuar kanë për obligim ta informojn noterin për ndonjë trashëgimtarë të mundshëm të pa identifikuar në dëshminë e vdekjes, e për të cilën ata janë në dijeni duke i treguar informatat në lidhje me atë se ku është vendndodhja e tyre. Në këtë aspekt, noteri i njofton se deklarimi i rremë lidhur me mosparaqitjen e trashëgimtarëve të mundshëm apo fshehja e trashëgimtarëve paraqet vepër penale dhe është e dënueshme në bazë KPRK.

Pas kalimit të afatit prej 30 ditëve, noteri i fton të gjithë trashëgimtarët e paraqitur në dëshminë e vdekjes si dhe ata të cilët për çfardo arsye nuk janë shënuar në dëshminë e vdekjes e të cilën arrijnë të dëshmojnë se edhe ata janë trashëgimtarë që të marrin pjesë në seancën informuese. Këtë seancë noteri e mban para se të bëhet heqja dorë nga trashëgimia ose ndarja

<sup>277</sup> Neni 147, Ligji nr. 06/L-007 për ndryshim-plotësimin e Ligjit për Procedurën Jokontestimore.

<sup>278</sup> Njoftimi mbi Iniciimin e Procedurës Trashëgimore, Nr. 129/2020, e datës 09.10.2020, Noter Ramadan Bunjaku.

<sup>279</sup> Neni 161, Ligji nr. 06/L-007 për ndryshim-plotësimin e Ligjit për Procedurën Jokontestimore dhe Njoftimi mbi Iniciimin e Procedurës Trashëgimore, Nr. 14/2020, e datës 09.07.2020, Noter Sefadin Blakaj.



e trashëgimisë në bazë të së cilës trashëgimtarët e decujusit do të informohen nga noteri me të drejtat dhe detyrimet e tyre si trashëgimtarë.<sup>280</sup>

Çdo trashëgimtarë që nuk merr pjesë në seancën informuese do të konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta e tij për të marrur pjesë në seancën informuese përveç nëse ai trashëgimtar ka dërguar deklaratën të vërtetuar tek noteri. Mirëpo, mosparaqitja e tij në seancën informuese nuk e privon nga e drejta e tij për të marr pjesë në seancën kryesore për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore.

Në këtë seancën pra në seancën informuese noteri do t'i njoftojë trashëgimtarët me të drejtat dhe detyrimet e tyre si në vijim:

- Trashëgimtarët prezent njoftohen për publikimin e njoftimit lidhur me inicimin e procedurës trashëgimore në Portalin Shtetërorë të Republikës së Kosovës dhe paralajmërohen nga noteri për obligimin e tyre ligjor që në rast të mospërfshirjes eventuale të ndonjë trashëgimtari në dëshminë e vdekjes ta njoftojn noterin;
- Udhëzohen dhe këshillohen nga noteri që të prezantojnë ndonjë testament apo dokument tjetër të shkruar nëse decujusi ka lënë për radhitjen e pasurisë së tij për së gjalli;
- Njoftohen se ligji i'u garanton të drejta të barabarta në pjestimin-ndarjen e pasurisë trashëgimore të lënë nga decujusi pa marr parasysh moshën apo gjinin, nëse të njejtit eventualisht nuk janë marrur vesh ndryshe për ndarjen e pasurisë trashëgimore;
- Njoftohen se deklaratat mbi pranimin e pasurisë trashëgimore apo refuzimin e pasurisë trashëgimore janë të parevokueshme;<sup>281</sup>
- Se deklaratat trashëgimore lidhur me pranimin apo refuzimin e pasurisë trashëgimore mund të jepen edhe me anë të videoincizimit;
- Njoftohen se nëse nuk e kuptojnë dhe dijnë të flasin gjuhën shqipe kanë të drejtën e përdorimit të gjuhës së tyre amëtare dhe prezenca apo prania e interpretit-përkthyesit do të bëhet me shpenzimet e zyrës së noterisë.<sup>282</sup>

Nëse nga të dhënat e dëshmisë së vdekjes noteri konstaton se trashëgimlënësi nuk ka lënë pasuri apo ka lënë vetëm pasuri të luajtshme, e asnjëri nga trashëgimtarët nuk e kërkon të shqyrtohet çështja, atëherë noteri me aktvendim do të vendos që të mos shqyrtohet fare pasuria trashëgimore.<sup>283</sup> Sikundër që edhe në rast se vlera e pasurisë trashëgimore është

<sup>280</sup> Neni 161A, Ligji nr. 06/L-007 për ndryshim-plotësimin e Ligjit për Procedurën Jokontestimore.

<sup>281</sup> Procesverbali mbi Seancën Informuese, LRP. Nr. 5711/2019, e datës 23.12.2019, Noter Hevzi Murseli.

<sup>282</sup> Procesverbali mbi Seancën Informuese, LRP. Nr. 001/2020, e datës 03.01.2020, Noter Hevzi Murseli.

<sup>283</sup> Neni 157, Ligji nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore.

shumë e vogël sa që nuk do të mund t'i mbuloj as shpenzimet që do t'i shkaktonte për shqyrtimin e saj, edhe në rastet e tilla noteri nuk do ta shqyrtojë fare pasurinë trashëgimore.

Pas përfundimit të seancës informuese, noteri i fton të gjithë trashëgimtarët e decujsit për mbajtjen e seancës kryesore për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore.

Me ligj nuk është përcaktuar intervali kohor brenda sa ditësh duhet të mbahet seanca kryesore për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore nga dita e përfundimit të seancës informuese, mirëpo nga praktika e përgjithshme e noterisë seanca kryesore për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore mbahet brenda 5 ditëve nga dita e përfundimit të seancës informuese.

### **3. Seanca kryesore për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore**

Seanca kryesore për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore është stadi qëndror dhe themelor i procedurës trashëgimore. Kështu noteri do t'i shqyrtojë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pasurinë trashëgimore, sidomos me të drejtën e trashëgimit, me madhësinë e pjesës trashëgimore dhe me të drejtën e legut.<sup>284</sup> Në këtë rrjedhë noteri do të shqyrtoj të gjitha çështjet e rëndësishme për marrjen e vendimit meritor, sidomos do të merren deklaratat e nevojshme për nxjerrjen e vendimit të ligjshëm dhe të drejtë si dhe do të bëhet mbledhja e materialit procedural lidhur me çështjet kontestuese për të cilat noteri është i autorizuar të vendosë në procedurën e shqyrtimit të pasurisë trashëgimore.

Deri në mbarim të seancës trashëgimore, trashëgimtarët mund të deklarohen se heqin dorë nga pjesa e pasurisë trashëgimore që do i'u takon sipas ligjit apo edhe të deklarohen se pranojnë pasurinë trashëgimore që i'u takon sipas ligjit.

Deklaratat trashëgimore janë shprehje e njëanshme e vullnetit me anë të së cilës trashëgimtarët deklarohen se e pranojnë apo heqin dorë nga e drejta e tyre në trashëgim. Ekzistojnë dy mënyra për tu deklaruar trashëgimtarët, e para është kur trashëgimtarët gjatë zhvillimit të seancës kryesore për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore në procesverbal deklarohen se e pranojnë apo heqin dorë nga e drejta në trashëgim, ndërsa mënyra e dytë është kur trashëgimtarët deklarohen nga distanca, atëherë kur një person shkruan një deklaratë të tillë, dhe e vërteton tek organi kompetent kurse këtë i'a parashtron noterit kompetent derisa zhvillohet procedura e trashëgimit.

---

<sup>284</sup> Neni 162, Ligji nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore.

Deklarata për pranimin e pasurisë trashëgimore është shprehje e njëanshme e vullnetit në të cilën trashëgimtarët shprehin vullnetin e tyre se dëshirojnë të pranojnë pasurinë trashëgimore.

Trashëgimtarët nëpërmjet deklaratave të tyre mund të deklarohen edhe se heqin dorë nga e drejta në trashëgim. Deklarata për heqjen dorë nga trashëgimia poashtu është akt i njëanshëm juridik i trashëgimtarit, me të cilin ai shpreh vullnetin e lirë se nuk do të trashëgoj, pra nuk do të marr të drejta dhe detyrime nga trashëgimi.

Për heqjen dorë nga trashëgimia trashëgimtarët mund të deklarohen vetëm pas vdekjes së decujusit, sepse trashëgimtari e fiton të drejtën në trashëgim në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit. Për këtë arsye heqja dorë nga e drejta në trashëgim para vdekjes së trashëgimlënësit nuk do të prodhoj asnjë efekt juridik, sepse nuk mund të hiqet dorë nga një e drejtë që ende ska lindur e as që ekziston.<sup>285</sup>

Heqja dorë nga trashëgimi nuk mund të jetë e pjesshme apo me kusht. Kur trashëgimtarët heqin dorë nga trashëgimi vlenë edhe për pasardhësit e tij, përveç kur ai/ajo shprehimisht deklaron se heq dorë vetëm në emër të vet. Trashëgimtari që ka hequr dorë nga trashëgimi konsiderohet sikur të mos ketë qenë kurrë trashëgimtarë, e më pas pjesa e tij/saj u shtohet trashëgimtarëve tjerë të decujusit. Këtu vije në shprehje insituti i së drejtës së shtimit.<sup>286</sup>

Nëse një trashëgimtar dëshiron të heqë dorë nga e drejta në trashëgim, noteri marrjen e deklaratës së tillë e bënë me audio dhe videoincizim, i cili për çdo rast duhet të njoftohet se deklarata e tij është duke u marrur me videoincizim, mirëpo me kërkesën e palës noteri mundet që një deklaratë të tillë të mos ta marrë me këto mjete.<sup>287</sup>

Kur noteri konstaton se një trashëgimtar është nën shtrëngim për të hequr dorë nga trashëgimia e tij, noteri nuk e pranon një gjë të tillë dhe do të referoj çështjen tek prokurori i shtetit.

Për personat që janë thirrur në trashëgim e nuk kanë marrur pjesë në seancën për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore konsiderohen se dëshirojnë të bëhen trashëgimtar dhe me vendim të noterit shpallen trashëgimtar, pra edhe nëse ndonjëri nga trashëgimtarët e paraqitur në dëshminë e vdekjes nuk prezantojnë në seancën trashëgimore, noteri ex-officio i shpall trashëgimtar.<sup>288</sup>

---

<sup>285</sup> Neni 134, Ligji nr. 2004/26 për Trashëgimin e Kosovës.

<sup>286</sup> H. Podvorica, „E drejta trashëgimore”, Prishtinë, 2010, fq. 53.

<sup>287</sup> Neni 131, Ligji nr. 06/L-007 për ndryshim-plotësimin e Ligjit për Procedurën Jokontestimore.

<sup>288</sup> Neni 164, Ligji nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore.

Për të qenë e vlefshme deklarata për heqjen dorë nga trashëgimia duhet ti plotësoj disa kushte: a) që përmbajtja e deklaratës duhet të jetë e kuptueshme, b) që përmbajtja duhet të jetë e lejueshme dhe c) që të shpreh qartë vullnetin e lirë se trashëgimtari heqë dorë nga trashëgimia.<sup>289</sup> Në këtë rrjedhë, në kuadër të deklaratave trashëgimore, legjislacioni ynë aktual e njeh të drejtën që trashëgimtari të heqë dorë nga e drejta e tij në trashëgim në dobi të një bashkëtrashëgimtari tjetër, mirëpo heqja dorë në dobi të trashëgimtarit të caktuar nuk konsiderohet si heqje dorë nga trashëgimi, por si deklaratë për cedimin e pjesës trashëgimore tek trashëgimtari apo bashkëtrashëgimtari tjetër.<sup>290</sup> Ky deklaram i trashëgimtarit mund të bëhet në dy mënyrat e sipërtheksuara, qoftë me deklaratë të vërtetuar pranë organit kompetent apo edhe në mënyrë shprehimore e cituar në procesverbalin për shqyrtimin kryesor.

Në qoftë se gjatë shqyrtimit të pasurisë trashëgimore si trashëgimtar na paraqiten personat e mitur dhe personat e tillë dëshirojnë të heqin dorë nga e drejta e tyre në trashëgim, atëherë noteri duhet të merr pëlqimin e organit të kujdestarisë.<sup>291</sup>

#### 4. Aktvendimi mbi trashëgimin

Noteri pas përfundimit të seancave, të seancës informuese dhe seancës për shqyrtimin kryesorë të pasurisë trashëgimore, çështjen në mënyrë meritore e vendos me aktvendim, të cilin e nxjerr pasi të vërtetohen se cilëve pjesëmarrës u takon e drejta për të trashëguar dhe të njejtit do t'i shpall për trashëgimtarë.<sup>292</sup> Pra, noteri i shpall personat trashëgimtar të pasurisë trashëgimore në bazë të aktvendimit.<sup>293</sup> Ky aktvendim është meritore dhe definitiv-përfundimtar, themi se është meritore sepse me këtë lloj vendimi çështja zgjidhet në themel, kurse themi se është përfundimtar sepse me dhënien e vendimit të tillë merr fund zgjidhja e një çështje nga ana e noterit. Aktvendimi mbi trashëgimi bënë pjesë në grupin e vendimeve të natyrës deklarative.<sup>294</sup>

---

<sup>289</sup> H. Podvorica, „E drejta trashëgimore”, Prishtinë, 2010, fq. 85.

<sup>290</sup> Po aty, neni 133.

<sup>291</sup> Neni 130.3, Ligji nr. 06/L-008 për ndryshim-plotësimin e Ligjit për Trashëgimin e Kosovës.

<sup>292</sup> M. Musa, K. Musa, „E drejta e procedurës civile II”, Gjilan, 2017, fq. 114.

<sup>293</sup> H. Podvorica, „Klinika juridike e drejta familjare dhe trashëgimore”, Prishtinë, 2015, fq. 146.

<sup>294</sup> F. Brestovci, „E drejta procedurale civile II”, Prishtinë, 2006, fq. 281.

Noteri në bazë të këtij vendimi njeh vetëm qenien apo mosqenien e një marrdhënie juridike. Me anë të aktvendimit për trashëgimi që ka marrë formë të prerë konstatohet se çka hyn në pasurinë trashëgimore, se kush është trashëgimtar i të vdekurit, sa është e madhe pjesa e pasurisë që i takon, se a i është kufizuar apo ngarkuar e drejta e trashëgimit dhe në cilën mënyrë, si dhe a ekzistojnë dhe cilat të drejta të legatit ekzistojnë.<sup>295</sup> Kjo që është konstatuar me anë të aktvendimit të formës së prerë për trashëgim mund të kontestohet në procedurë kontestimore vetëm nga ai person që nuk është i lidhur me aktvendimin.<sup>296</sup>

#### **4.1. Marrëveshja mbi ndarjen e pasurisë trashëgimore**

Në procedurën për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore noteri nuk e bënë ndarjen e pasurisë së trashëguar, që do të thotë se noteri nuk e përcakton se cilëve trashëgimtar i'u takojnë sendet në përbërje të pasurisë trashëgimore, sepse për ndarjen dhe mënyrën e ndarjes të pasurisë së përbashkët vendoset në procedurën për ndarjen e sendeve dhe paluajtshmërive në bashkëpronësi. Mirëpo, nuk ka pengesë që vetë trashëgimtarët gjatë procedurës trashëgimore të arrijn marrëveshje me të cilën përcaktojnë se cilëve trashëgimtar u takojn sendet e caktuara. Në rastet e tilla, e sipas kërkesës së trashëgimtarëve, noteri marrëveshjen e arritur e inkorporon në aktvendimin për trashëgimi.<sup>297</sup>

Në rast se nuk arrihet marrëveshja për ndarjen dhe mënyrën e ndarjes së pasurisë trashëgimore, secili nga trashëgimtarët ka të drejtë që pasi të bëhet i formës së prerë aktvendimi mbi trashëgimi, ta iniciojë procedurën tjetër jokontestimore dhe atë procedurën për ndarjen e sendit apo pasurisë së përbashkët. Kështu ndodh, sepse noteri me aktvendim për trashëgimi i cakton në mënyrë ideale pjesët e trashëgimtarëve (pjesën alikuote) në pasurinë trashëgimore, ndërsa për ndarjen e kësaj pasurie pala duhet ta inicioj procedurën për ndarjen e sendit të përbashkët.<sup>298</sup>

#### **4.2. Aktvendimi i pjesshëm për trashëgimi**

Aktvendimi i pjesshëm quhet ai vendim me të cilin noteri vendos vetëm për një pjesë të pasurisë trashëgimore. Noteri e jep këtë vendim kur përbërja e pasurisë trashëgimore vetëm

<sup>295</sup> Aktvendimi mbi Trashëgimin, LRP. Nr. 5695/2019, e datës 20.12.2019, Noter Hevzi Murseli.

<sup>296</sup> Neni 178, Ligji nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore.

<sup>297</sup> Neni 172, Ligji nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore.

<sup>298</sup> F. Brestovci, „E drejta procedurale civile II”, Prishtinë, 2006, fq. 281.

pjesërisht është jokontestuese me anë të së cilës e cakton trashëgimtarët dhe pjesën e pasurisë së pakontestueshme që hyn në pasurinë trashëgimore.<sup>299</sup> Nxjerrja e një vendimi të tillë nga noteri ka një rëndësi të veçant për arsye se: a) përshpejtohet procedura e konstatimit të personave që kanë të drejtë në trashëgimi dhe shpallja e trashëgimtarëve, si dhe b) reduktohet në maksimum shpenzimet e procedurës.

## **Përfundimet**

Procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore është e rregulluar me dispozitat e Ligjit për Procedurën Jokontestimore, Ligjin për Trashëgimin e Kosovës, dhe Ligjin për Noterinë, duke filluar nga incimi i kësaj procedure e deri tek përpilimi dhe nxjerrja e aktvendimit për trashëgimi;

Si organ kompetent për zhvillimin e kësaj procedure janë: Gjykatat Themelore dhe Noterët e Republikës së Kosovës, për çështjet jokontestuese trashëgimore;

Noterët këtë procedurë e inicojnë ex-officio në bashkëveprim apo bashkëpunim me Odën e Noterëve të Kosovës dhe Zyrën e Gjendjes Civile;

Procedimi i çështjeve jokontestuese trashëgimore nga ana e Noterëve paraqet eliminimin e mbingarkesës së madhe që kanë pasur Gjykatat lidhur me procedimin e këtyre lëndëve;

Se në bazë të LTK dhe LPJK, trashëgimtarët që janë thirrur në trashëgim kanë të drejtë të pranojnë pasurinë e tyre trashëgimore që i'u takon në bazë të ligjit;

Trashëgimtarët e thirrur në trashëgim kanë të drejtë që të mos e pranojnë pasurinë trashëgimore që i'u takon sipas ligjit, pra të heqin dorë nga e drejta e tyre në trashëgim;

Në rast të heqjes dorë nga trashëgimia, pjesa e tyre trashëgimore iu kalohet apo cedohet bashkëtrashëgimtarëve tjerë të të njejtës rradhë;

Trashëgimtarët e decujusit kanë po ashtu të drejtë që pjesën e pasurisë trashëgimore që i'u takon sipas ligjit ta cedojn në dobi dhe për interes të bashkëtrashëgimtarëve të tjerë;

Në rast kur trashëgimtarët e pranojnë pasurinë trashëgimore që i'u takon sipas ligjit dhe e cedojnë në dobi dhe për interes të bashkëtrashëgimtarëve të tjerë nuk konsiderohet se kanë hequr dorë nga pasuria trashëgimore.

## **Literatura**

---

<sup>299</sup> Neni 177, Ligji nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore.

- Brestovci F, E Drejta Procedurale Civile II, Prishtinë, 2006;
- Podvorica H, E Drejta Trashëgimore, Prishtinë, 2010;
- Podvorica H, Podvorica F, Klinika Juridike e Drejta Familjare-Trashëgimore, Prishtinë, 2015;
- Musa M, Musa K, E Drejta e Procedurës Civile II, Gjilan, 2017;
- Ligji nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore;
- Ligji nr. 06/L-007 për ndryshim-plotësimin e Ligjit për Procedurën Jokontestimore;
- Ligji nr. 2004/26 për Trashëgimin i Kosovës;
- Ligji nr. 06/L-008 për ndryshim-plotësimin e Ligjit për Trashëgimin e Kosovës;
- Procesverbali mbi Seancën Informuese, me shenjë LRP. Nr. 5711/2019, i datës 23.12.2019, Noter Hevzi Murseli;
- Njoftimi mbi Inicimin e Procedurës Trashëgimore, Nr. 014/2020, i datës 09.07.2020, Noter Sefadin Blakaj;
- Procesverbali mbi Seancën Informuese, me shenjë LRP. Nr. 001/2020, i datës 03.01.2020, Noter Hevzi Murseli;
- Aktvendimi mbi Trashëgimin, me shenjë LRP. Nr. 5695/2019, i datës 20.12.2019, Noter Hevzi Murseli;
- Njoftimi mbi Inicimin e Procedurës Trashëgimore, Nr. 129/2020, i datës 09.10.2020, Noter Ramadan Bunjaku.

## **F A L Ë N D E R I M E**

Revista Juridiko-Sociale “Justiniani II” është revistë e Fakultetit Juridik, që përfaqëson një tribunë të rëndësishme të procesit shkencor dhe shërben si mjet informacioni për një gamë të gjerë lexuesish.

Botimi i revistës synon të nxisë dhe promovojë punën studimore, kërkimore dhe shkencore nga studentë, personeli akademik, si dhe kërkuesit shkencor në përgjithësi.

Përgëzime për të gjithë autorët për botimin e krijimeve të tyre në Revistën Juridiko-Sociale, “Justiniani II”.

Falënderim dhe mirënjohje e veçantë për të gjithë Ju që bashkëpunuat dhe ishit pjesë e këtij publikimi !

Duke shprehur besimin e plotë, se do të vijojmë pandërprerë publikimin e saj, me krijime gjithnjë më të arrira, me qëllim të nxitjes, promovimit dhe përkrahjes së veprimtarisë hulumtuese dhe shkencore në sferën e drejtësisë sociale nga studjues dhe kërkues shkencor.

Deri në bashkëpunimin e radhës,

Mirëmbetshi !

Kryeredaktorja:

MSc. (PhD. Cand.) Simeana

BESHI